

**PËRMBLEDHJE E
VENDIMEVE TË
KOMISIONERIT PËR
MBROJTJEN NGA
DISKRIMINIMI**

2018 - 2019

Përmbajtja

Parathënie.....	8
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË	10
1. E. Gj., kundër Shoqërisë “Philip Morris Albania” sh.pk., (PMA)	10
2. A. B. kundër Rektorit të Universitetit të Tiranës (UT).....	12
3. L. M., kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Vlorë (I.E.V.P., Vlorë)	16
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË RACËS.....	19
4. Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” (LRER), kundër gazetarit SH. N.	19
5. L. A., kundër Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Berat (DRP)	21
6. Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane - Rome” (LRER) kundër faqes Facebook të portalit “Jeta Osh Qef” (JOQ).....	23
7. Shoqata “Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian” (TDKE) kundër Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Shkodër (UK SHkodër)	25
8. Grup personash, banorë në magazinat e ish-Ndërmarrjes Gjeologjike kundër Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a., (UK Korçë)	27
9. Çështje ex-officio mbi segregimin e nxënësve romë dhe egjiptianë në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, Shkodër.....	29
10. Grup personash kundër Bashkisë Krujë	33
11. Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” (LRER) kundër gazetarit A.Ç.	35
12. Grup personash kundër Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Fier (UK Fier)	37
13. A. XH., kundër Universitetit të Arteve Tiranë (UART).....	39
14. Grup personash, kundër Bashkisë Korçë.....	42
15. F. P., kundër Universitetit të Arteve Tiranë (UART).....	44
16. J. H., kundër Bashkisë Tiranë dhe Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHEF)	46
ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË	49
IDENTITETIT GJINOR DHE ORIENTIMIT SEKSUAL	49
17. Çështje ex-officio e nisur kundër shtetasit P. B.	49

18. F. H., kundër punonjësve të Policisë së Komisarariatit Nr. 6 Tiranë	52
ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE	54
19. F. A., kundër Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Drejtorisë së Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terciare (DAPSHET), ish DSHSUKS.....	54
20. E. M., kundër Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Mat” sh.a., (UK Mat).....	57
21. D. Q., kundër Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë (SRGJ)	60
22. A. B., kundër Postës Shqiptare sh.a dhe Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat.....	62
23. SH. S., kundër Postës Shqiptare sh.a, Filiali Mat.....	64
24. P. V., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUT)	67
25. L. A., kundër Kryeinspektorit, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastrë (ISHMPUT Gjirokastrë) dhe Inspektoriati Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë (ISHMPUT).	70
26. V. J. kundër Albpetrol sh.a.....	73
27. F. Y. kundër Albpetrol sh.a.	76
28. A. D., kundër S. R., Kryeinspektor (i komanduar) pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Gjirokastrë (ISHMPUT).	79
29. K. B., kundër Albpetrol sh.a.....	82
30. A.S., kundër Spitalit Rajonal (SR) Gjirokastrë	85
31. V. H., kundër Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST)	88
32. A. H., kundër Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a	91
33. K. L., kundër Bashkisë së Kavajës	94
34. Y. D., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.....	97
35. N. C., kundër Drejtorisë së Shërbimit Spitalor (DSHS) Mat	100
36. E. D., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (DRT) Gjirokastrë	103
37. A. Z., kundër Bashkisë Tiranë.....	106
38. A.B., kundër Shërbimit Spitalor Skrapar.....	109
39. L. D. kundër Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Shkodër	112
40. R. S., kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)	115

41. E. C., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)	117
42. H. D., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)	119
43. B. XH., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.	121
44. A. LL., kundër Bashkisë Gjirokastrë	124
45. B. D., kundër Postës Shqiptare dhe Filialit të Postës Fier	127
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE	131
46. Grup personash kundër Bashkisë Tiranë	131
47. Grup personash kundër Bashkisë Lezhë	134
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI	137
PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE	137
48. L. DH., kundër Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (USH)	137
49. L. DH., kundër Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (USH)	140
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQERORE	143
50. E. D., kundër Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) të Bashkisë Durrës	143
51. Rr. Rr., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)	146
52. Ex-Officio e çështjes së përlllogaritjes së punës së kryer të të dënuarve me burgim kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB)	148
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË SHTATZANISË	151
53. J. H. , kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) (ish- ZQRPP)	151
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRKATËSISË PRINDËRORE	154
54. O. G., kundër Kolegjit Independent Tiranë	154
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRGJEGJËSISË PRINDËRORE	156
55. A. B., kundër Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP) ..	156
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË MOSHËS	158
56. A. H., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT)	158
57. M. K., kundër Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)	162
58. D.O., kundër Drejtorisë së Shërbimit Spitalor (DSHS) Mat	165

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES FAMILJARE.....	168
59. R. M., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.	168
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË VENDBANIMIT	171
60. Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane - Rome” (LRER), kundër Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime sh.a. Elbasan (UKE)	171
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE.....	173
61. Ex-officio lidhur me mungesën e ilaçeve gjatë muajit Janar 2017 në Shërbimin e Hematologjisë pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT)	173
62. L. B., kundër Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)	175
63. A. Ç., kundër Ujësjetellës Kanalizime sh.a., Mat. (UKM)	178
64. Ankues E. G., kundër Bibliotekës Kombëtare Tiranë	180
65. G. H., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.	183
66. K. K., kundër Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Drejtorisë së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUT)	186
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR	188
67. D. E., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë (IEVP)	188
68. G.K., kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR) Korçë	191
69. S. G., kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR) Korçë dhe Shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë	194
70. Ankues D. S., kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR), Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”	197
71. Ankuese F. B., kundër Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë	199
72. Ankues S. L., kundër Aleat sh.p.k. pranë Njesisë Bashkiake Nr. 6 dhe Nr. 7 në Tiranë, Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë Tiranë	202
73. T. M., kundër J. M., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe njëkohësisht N/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe V. V., Shef i Policisë Bashkiake Sarandë	205
74. Ex-officio për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e banesave sociale aktuale për personat me aftësi të kufizuar	207
75. Shoqata Shkodrane e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës kundër Bashkisë Shkodër	210

76. Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Qarku Durrës kundër Bashkisë Durrës.....	214
77. B. N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Qendra Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).....	218
78. Ex-officio e Pacientëve me Hemofili në Shqipëri kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).....	221
79. K. M., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Qendes Spitalore Universitare Tirane (QSUT)	225
80. A. B., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).....	228
81. A. N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS).....	232
82. E. K., kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Korçë	235
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PÛRKATËSISË NË NJË GRUP TË VEÇANTË.....	240
83. E. J., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), Tiranë.	240
84. N. M., kundër ish Kancelarit dhe Administratorit të Universitetit të Tiranës (UT)	243
85. D. D., kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS)	246
86. B. B., kundër Drejtorit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH)..	249
87. P. S., kundër Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)	251
88. F. B., kundër Spitalit Universitar të Traumës (SUT)	254
ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR ÇDO SHKAK TJETËR.....	257
89. A. B., dhe E. I., kundër M. B., dhe B. L., në cilësitë si drejtor/botues dhe kryeredaktor të Gazetës TemA.	257
90. Grup personash kundër Bashkisë Mallakastër	260
91. E. G., kundër Bibliotekës Kombëtare Tiranë	263
92. V. H., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.....	265
93. A. H., Kundër Shoqërisë Albpetrol Sh.A.	269
94. F. Ç., kundër Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak Nr. 6670.....	272

Parathënie

Institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është një organ publik i pavarur, i cili ka për funksion garantimin e zbatueshmërisë së Ligjit nr.10221 datë 04/02/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, si dhe të gjithë legjislacionit shqiptar në lidhje me barazinë dhe mosdiskriminimin.

Një ndër kompetencat më të rëndësishme që ky institucion ka, është ai i trajtimit të ankesave që mbërrijnë nga individë, grupe individësh dhe organizata të shoqërisë civile me qëllim konstatimin e diskriminimit dhe ndreqjen e sjelljes diskriminuese të konstatuar.

Komisioneri mund të ngrejë edhe çështje kryesisht ose *ex officio*, si dhe ka të drejtë të vendosë sanksione administrative kundrejt subjekteve që nuk zbatojnë vendimet që kanë konstatuar diskriminim.

Qëllimi i kësaj përmbledhje vendimesh të Institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është që ti shërbejë publikut të gjerë për ta informuar mbi veprimtarinë e këtij institucioni, por sidomos edhe për ta udhëzuar atë mbi shkaqet, format dhe fushat e diskriminimit me qëllim për një kuptueshmëri më të mirë të tyre.

Përmbledhjet e vendimeve janë hartuar në mënyrë të tillë që ta japin aspektet më thelbësore të vendimit, por sigurisht për një hulumtim më të thellë do të nevojitej konsultimi i tyre në tërësi. Gjithashtu, funksioni i përmbledhjes së vendimeve ka për qëllim edhe të lehtësojë gjetjen e tyre sipas interesit të subjekteve, në faqen ëeb të institucionit ku publikohen të gjitha vendimet.

Së fundmi, qëllim specifik është ai i nxitjes së operatorëve të së drejtës, juristë, avokatë, gjyqtarë, lektorë, studiues, studentë, punonjës administrate që të konsultojnë këto vendime për një njohjen e praktikës së maturuar prej 10 vjetësh nga institucioni por, edhe për të shprehur sensin e tyre kritik mbi kuptimin dhe arsyeshmërinë e vendimarrjes, si dhe të nxitjes së debatit juridik, social dhe politik mbi të drejtat e njeriut e më specifikisht të parimit të barazisë dhe atij të mosdiskriminimit.

Uroj që kjo përmbledhje të shërbejë për qëllimin e saj dhe të jetë një mjet i dobishëm për çdokënd të interesuar.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Robert Gajda

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË

1. E. Gj., kundër Shoqërisë “Philip Morris Albania” sh.pk., (PMA)

VENDIM NR. 243, DATË 17.11.2018

Shkaku: Gjinia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar në pozicionin e përfaqësuesit në terren pranë Shoqërisë “PMA” dhe në vitin 2018 i është mohuar dhënia e lejes prindërore për shkak të gjinisë.

FAKTET

Ankuesi E. Gj., ka filluar marrëdhënien e punës pranë të paditurit, Shoqëria “PMA” sh.p.k., në datë 15.06.2014 kur palët kanë nënshkruar kontratën individuale të punës, pa afat të caktuar, në pozicionin përfaqësues në terren, pozicion të cilin ankuesi e ka mbajtur deri në datë 25.05.2018, data e largimit nga puna.

Në datë 02.10.2017, ankuesi E. Gj., është bërë prind i fëmijës së dytë.

Referuar legjislacionit¹ në fuqi, i cili parashikon se 63 (gjashtëdhjetë e tre) ditë pas lindjes së fëmijës babai mund të kërkojë lejen e lindjes, duke qenë se bashkëshortja e tij nuk mund të përfitonte leje lindje, E. Gj., ka kërkuar nga kompania, mbështetur në legjislacionin² shqiptar, përfitimin e një viti leje për kujdes ndaj fëmijës³ (Paternity leave) së tij të dytë.

Punëdhënësi, nëpërmjet e-mailit, ka njoftuar se mund të fillojë lejen, në muajin Janar 2018 për një afat prej 4 (katër) muajsh, dhe i është kërkuar të vërë në dispozicion të kompanisë: informacion në lidhje me plotësimin e kushteve për përfitimin e lejes (bashkëshortja e ushtron këtë të drejtë apo nuk ka kushte për ta përfituar), kopje të certifikatës familjare, kopje të certifikatës së lindjes së fëmijës dhe raportin mjekësor. Në vijim, E. Gj., i dërgoi punëdhënësit dokumentet e kërkuara dhe vijoi me përfitimin e lejes së kërkuar. Pasi përfundoi lejen dhe u kthye në punë, në datë 25.05.2018, Shoqëria “PMA” i njoftoi E. Gj., ndërprerjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës.

Situata diskriminuese lidhet me faktin e mos dhënies të lejes së barrë lindjes për kërkuesin, duke u trajtuar ndryshe nga punonjëset femra që përfitonin lejen e barrë lindjes, si dhe trajtimi ndryshe me punonjëset femra, që kishin përfituar lejen e barrë lindjes, duke i bllokuar aksesin

¹ Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligji Nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

² Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Ligji Nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

³ Në Nenin 27 “E ardhura për barrë lindje”, pika 7 e Ligjit “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, citohet se: “Pas periudhës prej 63 ditësh pas lindjes, të drejtën e lejes për kujdes ndaj fëmijës e ka edhe babai ose birësuesi i siguruar, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron apo nuk ka kushte për ta përfituar nëna”.

në sistemet e brendshme të kompanisë dhe duke i kërkuar dorëzimin e të gjithë aseteve të punës (telefon, laptop etj).

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 27.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Shoqëria “PMA”:

- *Në ndryshim nga punonjëset femra të kompanisë që kanë përfituar leje të plotë lindje, ankuesit nuk i është dhënë mundësia për të përfituar lejen e plotë. Në këto kushte, evidentohet se në raport me punonjëset femra të shoqërisë, ankuesi është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe të pabarabartë.*
- *Në ndryshim nga punonjëset femra të kompanisë që kanë përfituar lejen, ankuesit nuk i është dhënë mundësia për të përdorur asetet e kompanisë edhe gjatë lejes. Në këto kushte, evidentohet se në raport me punonjëset femra të PMA-së, ankuesi është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe të pabarabartë.*

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën argumente ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se miratimi i lejes për kujdes ndaj fëmijës, për një periudhë më të shkurtër në raport me punonjëset femra të PMA-së, ka ardhur si pasojë e gjinisë, së ankuesit. Referuar informacionit të dhënë, shoqëria i kishte miratuar minimumin e lejes prindërore të parashikuar në Kodin e Punës. Justifikimi i PMA-së lidhet me lejen prindërore, të parashikuar në Kodin e Punës dhe jo me lejen për kujdes ndaj fëmijës, të kërkuar nga ankuesi.

Komisioneri vlerëson se E. GJ., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Shoqërisë “PMA”, trajtim i cili ka lidhje me gjininë e ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit E. GJ., nga ana e Shoqërisë “PMA” sh.p.k., për shkak të gjinisë.

2. A. B. kundër Rektorit të Universitetit të Tiranës (UT)

VENDIM NR. 145, DATË 02.07.2018

Shkaku: Gjinia dhe Përkatësia në një grup të veçantë
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

A. B. ka punuar pranë Rektoratit të UT në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit Juridik, pranë Drejtorisë Juridike. Me Vendim të Rektorit të UT-së, ajo është liruar nga detyra për shkak të “gjinisë” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”.

FAKTET

Ankuesja A. B. është punësuar në vitin 2009 pranë Rektoratit të UT dhe së fundmi ka ushtruar detyrën në pozicionin e Përgjegjëses së Sektorit Juridik, pranë Drejtorisë Juridike.

Ankuesja ka pretenduar se situata diskriminuese ndaj saj, ka filluar që në momentin, kur në Rektorat u shfaq problematika e kalimit me vonesë të pagave të muajve gusht – shtator 2017 të punonjësve të këtij institucioni, çështje për të cilën, ajo është interesuar zyrtarisht pranë Rektorit dhe Kancelarit të këtij institucioni.

Që nga ajo periudhë, A. B. ka pretenduar se është gjendur para diskriminimit nga ana e Rektorit të UT, i cili e ka mbingarkuar me detyra dhe me punë të papërbalueshme, duke i kërkuar të realizojë detyra, të cilat nuk bënin pjesë në përshkrimin e tij të punës, duke e ngarkuar të hartojë shkresa me përmbajtje jo etike dhe me gjuhë jo korrekte profesionalisht drejtuar Dekanëve të Fakulteteve, gjë që ka shkaktuar si pasojë indinjatë dhe konflikte personale me ankuesen. A. B., pretendoi se i është kërkuar nga Rektori i UT, të mos pranojë urdhëra dhe shkresa nga Kancelari i institucionit, duke shkaktuar përballje dhe konflikte me këtë të fundit.

Ankuesja shprehet se pavarësisht sa më sipër, ajo ka mundur ta përballojë të gjithë këtë situatë, duke realizuar me përkushtim detyrat e ngarkuara, pavarësisht se një gjë e tillë ka patur kosto për të, pasi ka lënë pas dore fëmijën e saj të mitur.

Në vijim të kësaj situatë, me Vendimin Nr. 184, datë 19.12.2017, nga ana e Rektorit të UT-së është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme me A. B.

Administratori i UT-së ka relatuar rastin e saj në Bordin e Administrimit. Ky i fundit, në cilësinë e organit më të lartë kolegjal të UT, për çështjet administrative dhe financiare, me Vendimin Nr. 28, datë 21.12.2017, ka vendosur shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Vendimit Nr. 184, datë 19.12.2017, të Rektorit të UT, si një akt të dalë në kundërshtim me kompetencat funksionale që Rektori ka në bazë të nenit 39, pika 5, të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Vendimi i Bordit të Administrimit është përcjellë për zbatim pranë Administratorit dhe ankuesja ka vazhduar ushtrimin e detyrave të saj normalisht, deri në momentin, kur ka marrë dijeni mbi faktin, që pozicioni i saj i punës është shpallur vakant në Buletinin Nr. 9, datë 05.03.2018 të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Situata diskriminuese lidhet me faktin e shpalljes së vendit vakant, në kushtet kur A.B., punon në detyrën e Përgjegjëses së Sektorit Juridik, nuk është kryer asnjë procedurë disiplinore për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si dhe nuk i është paraqitur ndonjë njoftim për zgjidhjen e kontratës së punës me UT.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Konventa e OKB-së *“Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (2014);*
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE e 27 nëntorit 2000 *“Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”,*
- Direktiva e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE e 5 korrikut 2006 *“Për zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”;*
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”* (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”* (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10;

KONKLUZIONE

Rektori, në aktet e depozituara në cilësinë e provës pranë KMD-së, nuk ka përcjellë asnjë akt administrativ, që provon shkeljet e kryera nga ankuesja, aq më tepër, kur në vendim thuhet shprehimisht se shkeljet janë të evidentuara dhe provuara. Rektori i UT-së nuk ka depozituar pranë Komisionerit provat dhe faktet që dispononte, mbi bazën e së cilave, A.B. i është zgjidhur kontrata e punës. Në këtë kontekst, Komisioneri e gjen me vend të gjykojë se për sa kohë, Rektori nuk i është përgjigjur kërkesës së tij dhe nuk ka depozituar provat e kërkuara në një proces shqyrtimi administrativ të ankesës së një punonjëseje, e cila pretendon diskriminim, këto prova nuk ekzistojnë.

Në Vendimin e Rektorit është shënuar që ankueses i është tërhequr vërejtja në mënyrë të vazhdueshme. Në këtë kontekst, presupozohet që ndaj A. B., duhet të jenë dhënë paraprakisht masa disiplinore, më të lehta, derisa Rektori me vendimin e sipërpërmendur, të zgjidhë kontratën e punës, në mënyrë të menjëherëshme dhe për shkaqe të justifikuara. Për sa më sipër, gjatë shqyrtimit të provave të depozituara në këtë proces administrativ rezulton se A. B., nuk ka qenë asnjëherë subjekt i dhënies së ndonjë mase disiplinore. Rektori nuk ka depozituar në cilësinë e provës asnjë akt administrativ që të vërtetojë faktin se ankueses i është dhënë masë disiplinore paraprake dhe asnjë procesverbal, ku të rezultojë se asaj i është

tërhequr vëmendja nga ana e Rektorit, për ndonjë nga motivacionet e përmendura në Vendimin Nr. 184/2017.

Komisioneri u mbështet edhe në përfundimet e ekipit të kontrollit të Ministrisë së Arsimit, Rinisë dhe Sportit, përkatësisht në pikën C/9/a të Projekt-Raportit Nr. 3411/1/2018, ku është cituar shprehimisht: “... Si në vendimin e Rektorit dhe në dokumentet e vëna në dispozicion nuk ka fakte/prova që të provojnë se kjo punonjëse (A. B.) nuk ka kryer detyrat sipas nenit 9, pika 2.5 të Rregullores së Brendshme të Rektoratit të UT-së”. Në këto kushte, Komisioneri doli në përfundimin se trajtimi i padrejtë dhe disfavorizues i ankueses, nga Rektori i UT-së ishte mëse evident.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “gjinisë”, mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, si dhe duke iu referuar specifikisht pikës 11, të Projekt-Raportit Nr. 3411/1/2018, të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, rezultoi se sikurse ankuesja, ka patur edhe punonjës të tjerë, të cilët ndodhen në kushte të njëjta apo të ngjashme me të. Këta janë punonjës, të cilëve iu është zgjidhur kontrata e punës të mënyrë të menjëhershme dhe justifikuar.

Nga informacioni i përcjellë nga Administratori i UT-së, rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve të administratës së Rektoratit është 66, ndër të cilët 42 punonjëse janë femra dhe 24 punonjës janë meshkuj. Pra, në administratën e Rektoratit, rreth 64 % e punonjësve është femra dhe 36 % e punonjësve janë meshkuj. Nga këta punonjës, Rektori ka zgjidhur kontratën në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të justifikuara gjatë vitit 2017 me 5 punonjës, 4 prej të cilave janë femra dhe 1 punonjës mashkull. Komisioneri ka konstatuar se numri i punonjësve femra është më i madh, fakt që demonstron që Rektori ka ndërmarrë masë për zgjidhje të kontratës së punës pa shkaqe të justifikuara, kryesisht ndaj kësaj gjinie. Në këtë kontekst, vlen për t’u theksuar fakti se në pozicionin e punës së ankueses, Rektori ka punësuar me kontratë pune 3-mujore, një punonjës mashkull (E.M.)⁴, fakt që përforcon pretendimin për diskriminim për shkak të gjinisë.

Në lidhje me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të “gjendjes ekonomike”, “gjendjes shoqërore”, “gjendjes civile” dhe “përgjegjësisë prindërore”, shkaqe këto, që lidhen të gjitha në mënyrë të drejtpërdrejtë me gjendjen familjare të ankueses, e cila është e divorcuar, Komisioneri gjykon se ndërprerja e marrëdhënieve të punës së ankueses, nuk ka ardhur si rrjedhojë e diskriminimit të saj, nga ana e Rektorit të UT, për shkaqet e sipërpërmendura.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri ka konstatuar dhe është vënë në dijeni të konfliktit institucional brenda institucionit të Rektoratit dhe specifikisht konfliktit për kompetencë të Rektorit nga njëra anë dhe të Administratorit dhe Bordit të Administrimit të UT, nga ana tjetër. Një fakt i tillë u bë i qartë gjatë seancës dëgjimore të realizuar pranë Komisionerit, por u evidentua gjithashtu përgjatë korrespondencës zyrtare, që Komisioneri ka

⁴ Referuar Vendimit Nr. 40, datë 28.03.2018, të Rektorit të UT. “Për emërimin me kontrata pune me afat të caktuar 3 (tre) mujore të personelit ndihmës akademik me karakter administrative në Rektoratin e UT”.

patur me të dy titullarët e këtij institucioni, si dhe provave respektive të depozituara nga palët në këtë proces administrativ.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “gjinisë” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”, të A. B., nga ana e Rektorit të UT-së.

Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e Rektorit të UT-së, për kthimin e ankueses, në pozicionin e mëparshëm të punës.

3. L. M., kundër Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale, Vlorë (I.E.V.P., Vlorë)

VENDIM NR. 159, DATË 09/08/2018

Shkaku: Gjinia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja L. M. ka punuar pranë I.E.V.P. Vlorë në pozicionin “Specialiste Edukimi”. Ajo lirohet nga detyra me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, me motivacion “*mospërputhje e kriterëve arsimorë me funksionin organik*” për shkak të “gjinisë”.

FAKTET

L.M. është e diplomuar për “Mësuesi”, Dega “Cikël i Ulët” (me kohë të pjesshme) pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë dhe aktualisht ndjek studimet pasuniversitare për Master Profesional, dega “Psikologji Klinike”, pranë IAL jo publike.

L. M. ka punuar prej datës 06.06.2011, pranë I.E.V.P., Vlorë, duke mbajtur pozicione të ndryshme pune.

Në datën 03.11.2016, ankuesja është emëruar “specialiste edukimi”, detyrë, të cilën e ka ushtruar deri në datën 31.03.2018, moment në të cilin, nëpërmjet Urdhërit Nr. 2898/1, datë 19.03.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, është liruar nga detyra me motivacion “*mospërputhje e kriterëve arsimorë me funksionin organik*”.

Situata diskriminuese lidhet me faktin se L. M., është liruar padrejtësisht nga detyra për shkak të moshës dhe gjinisë nga ana e Drejtorit të I.E.V.P., Vlorë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Konventa e OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (2014);
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”,
- Direktiva e Parlamentit Europian dhe të Këshillit 2006/54/KE të 5 korrikut 2006 për “Zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe marrëdhëniet gjatë punës”;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;

- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10,
- Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008, “Për barazinë gjinore në Shqipëri”, neni 6.

KONKLUSIONE

L. M. dhe E. M. ish-specialistë të Sektorit të Çështjeve Shoqërore pranë I.E.V.P. Vlorë, janë konsideruar nga ana e punëdhënësit, se nuk e plotësonin kriterin arsimor për pozicionin e tyre të punës. Ndërkohë që, për L.M. është vendosur ndërprerja e marrëdhënieve të punës, për E.M., është vendosur transferimi në I.E.V.P. Rrogozhinë.

Komisioneri gjykon se ankuesja L. M., është trajtuar dukshëm në mënyrë të ndryshme dhe të disfavorshme, në kushte e rrethana të njëjta me E. M.

Ndonëse, Komisioneri konstaton se ankuesja L. M., nuk mund të qëndronte në pozicionin e saj të punës, pasi nuk plotësonte kriterin arsimor për këtë pozicion pune, gjykon se ajo nuk është trajtuar njëjloj, në krahasim me punonjës të tjerë, të cilët janë ndodhur në të njëjtën situatë me të.

Gjatë hetimit rezultoi se trajtimi ndaj të cilit është ekspozuar L. M., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë, është i pabarabartë e disfavorizues, pasi në pozitë të njëjtë apo të ngjashme me të, kanë qenë edhe punonjës të tjerë të I.E.V.P. Vlorë, të cilët prekeshin nga Urdhëri Nr. 6783, datë 13.11.2017, i Ministrit të Drejtësisë, “*Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale*”, por pavarësisht kësaj, ata janë trajtuar ndryshe nga ankuesja.

Gjatë analizimit të provave rezultoi se 4 (katër) punonjës të tjerë, të gjinisë mashkullore, përkatësisht E. M., F. F., D. E., dhe K. D., pavarësisht se nuk plotësonin kriterin arsimor për pozicionin e tyre të punës, janë mbajtur në punë dhe nuk janë liruar nga detyra, sikurse është vepruar për L. M.

Nisur nga fakti se punonjësit e trajtuar në mënyrë të favorshme i përkasin gjinisë mashkullore dhe e vetmja punonjëse, e cila është trajtuar ndryshe në të njëjtat kushte e rrethana, i përket gjinisë femërore, bën që Komisioneri të gjykojë se Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë e kanë diskriminuar L. M., për shkak të gjinisë. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se L.M. i është nënshtruar një trajtimi diskriminues për shkak të gjinisë.

Lidhur me pretendimin e ankueses për diskriminim për shkak të moshës, KMD gjykoi se ky pretendim nuk është i mbështetur në fakte dhe prova.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “gjinisë”, së L. M., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë.

Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “moshës”, së L. M., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P. Vlorë.

Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P Vlorë, për sistemimin në punë të ankueses.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË RACËS⁵

4. Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” (LRER), kundër gazetarit SH. N.

VENDIM NR. 181, DATË 05.12.2019

Shkaku: Raca
Forma: Shqetësim (Gjuhë urrejtje)
Statusi: Në proces

Shoqata “LRER” ka paraqitur ankesë lidhur me gjuhën e përdorur në media ndaj komunitetit egjiptian, nga ana e gazetarit SH. N.

FAKTET

Në emisionin “Top Show” 4 të datës 10.09.2019, ka qenë i ftuar Sh. N. Në minutën e parë të videos së publikuar në kanalin web të Top Channel Albania, në Youtube 5, Sh. N., përdor një shprehje, e cila është diskriminuese për të etiketuar një person të komunitetit egjiptian.

Gjatë diskutimit në lidhje me çështjen e ish Ministrit të Punëve të Brendshme, ai shprehet se për të fshehur gjurmët nuk do të përdorte kushëririn e tij, por do të gjente një “evgjit” në lagje për ta bërë këtë. Shoqata ka adresuar tek Komisioneri shqetësimin e saj.

Sh. N., shfaq publikisht mendimin e tij se anëtarët e pakicës egjiptiane janë inferiorë dhe mund të përdoren lehtësisht. Kjo shprehje në kontekstin e përdorur e bën të ndihet keq pakicën egjiptiane dhe krijon shqetësim për ta, si dhe forcon më tej stereotipet e krijuara ndaj minoritetit egjiptian.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 3, 17, 22 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”.

⁵ Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”. Në këtë kuptim, në diskriminimin për shkak të racës janë përfshirë dhe çështjet që në objekt të tyre kanë diskriminimin për shkak të etnisë.

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur (“për të fshehur gjurmët nuk do të përdorte kushërinin e tij, por do të gjente një evgjë në lagje për ta bërë këtë”) në emisionin Top Show të datës 10.09.2019 në televizionin Top Channel, nga ana e Sh. N., është një rast i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minojë rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Ligjit Nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Komisioneri mban parasysh faktin e rëndësishëm që mediat audiovizive ndiqen nga shumë shikues. Pjesëmarrësit në këto emisione, siç është rasti i Sh. N., i cili administron⁶ një prej këtyre mediave, janë persona publikë që kanë impakt tek publiku.

Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit.

Komisioneri vlerëson se, përhapja e veprimeve të tilla nëpërmjet mediave audiovizive përbën një mjet të fuqishëm të ndikimit në publik dhe mund të ndikojë në mbajtjen e qëndrimeve negative, përçmuese, denigruese, agresive dhe diskriminuese për të gjithë individët apo komunitetin egjiptian në Shqipëri.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se pavarësisht faktit nëse diskutimi⁷ i bërë nga ana e Sh. N., nuk mund të ketë patur qëllim të drejtpërdrejtë nxitjen e urrejtjes (në formën e përçmimit dhe denigrimit) apo diskriminimin e komunitetit egjiptian, përdorimi i saj ka vendosur në pozita diskriminuese në formën e shqetësimit, anëtarët e komunitetit egjiptian.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit në formën e shqetësimit për shkak të racës të shtetasve që i përkasin komunitetit egjiptian nga ana e gazetarit Sh. N.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, Sh. N., të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi dhe në mënyrë flagrante prek dinjitetin e personave të komunitetit egjiptian.

⁶ Referuar Ekstraktit të Qendrës Kombëtare të Biznesit, prej datës 01. 12. 2016, administron median on-line K.....al.

⁷ Në emisionin Top Show më datë 10.09.2019, në Televizionin Top Channel.

5. L. A., kundër Drejtorisë Rajonale të Punësimit, Berat (DRP)

VENDIM NR. 29, DATË 25.01.2018

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesja, anëtare e komunitetit Rom, ka probleme shëndetësore, pamjaftueshmëri shikimi me syrin e majtë. E ndodhur në gjendje të vështirë ekonomike, paraqitet tek zyra e punës duke i bërë me dije problemin shëndetësor. Edhe pse zyra e punës njih problematikën e gjendjes shëndetësore të saj, në mënyrë diskriminuese i ofron punë vetëm në pozicionin rrobaqepëse, profesion që nuk mund ta ushtrojë për shkak të gjendjes shëndetësore.

FAKTET

Institucioni i Komisionerit gjatë takimeve të zhvilluara në qytetin e Beratit, në kuadër të aktivitetit “Ditë të hapura”, ka administruar disa ankesa lidhur me sjelljen dhe trajtimin e personave të komunitetit Rom dhe Egjiptian nga ana e subjekteve publike dhe private në qytetin e Beratit. Një nga këto ankesa është në emër të shtetases L. A.

Ankuesja jeton me djalin e saj 5 vjeç, nuk përfiton pension apo ndihmë ekonomike dhe ka probleme shëndetësore me syrin e majtë. E ndodhur në gjendje të vështirë ekonomike, paraqitet tek zyra e punës. Ankuesja kërkon nga DRP Berat që të punësohet.

Në formularin e punëkërkesit, ka kërkuar që të punësohet në profesionin si punëtore ndihmëse dhe ka përshkruar veten si person me aftësi të kufizuara në punë, pasi ka probleme me shikimin.

Zyra e punës i ofron punë në rrobaqepësi. L. A., bën me dije se mund të punojë në cdo detyrë tjetër por vetëm në rrobaqepësi nuk mundet për shkak të problemeve me shikimin e syrit të majtë. L. A., pretendon se Zyra e punës i ofron punë vetëm si rrobaqepëse sepse e di që nuk mundet dot.

Situata diskriminuese lidhet me faktin se veprimet e kryera nga DRP Berat, duke mos bërë të mundur ofrimin e mundësisë së punësimit të një punë të përshtatshme, për L. A., e ka vendosur në pozitë të disfavorshme për shkak të racës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 3, 17 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenet 1, 3/1/2, 7/1, 20/1/a, 32/1/a dhe c/ dhe nenin 33/10.
- Ligji Nr.146, datë 17.12.2015 “Për punëkërkesit”.

KONKLUSIONE

Referuar formularit të punëkërkesit, lidhur me faktin e kundërshtimit, mospranimi apo refuzimit të vendit të punës nga ankuesja vërtetohet se kundërshtimi nuk është konfirmuar nga ankuesja, dhe nga ana e specialistit të zyrës së punës nuk është vendosur shënimi përkatës, mbi refuzimin e nënshkrimit nga ana e punëkërkesit.

Komisioneri ka vlerësuar se DRP Berat, në përputhje me parashikimet ligjore që garantojnë përshtatjen e ofertës për punë, ka bërë që ankuesja, për shkak të racës të mos gëzojë në baza të barabarta me punëkërkesit e tjerë të drejtën për t'u punësuar.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri konstaton se veprimet e kryera nga DRP Berat, duke mos bërë të mundur ofrimin e mundësisë së punësimit të ankuses në një punë të përshtatshme, kanë qenë diskriminuese.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit të L. A., nga ana e DRP Berat, për shkak të racës.

Referuar pikës 1, të vendimit, DRP Berat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrë masat për ofrimin e mundësisë së punësimit, në një punë të përshtatshme, për L. A., sipas parashikimeve ligjore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i ka rekomanduar subjektit ankues, që të paraqitet pranë DRP Berat për të përfituar nga programet e punësimit.

6. Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane - Rome” (LRER) kundër faqes Facebook të portalit “Jeta Osh Qef” (JOQ)

VENDIM NR. 135, DATË 13.06.2018

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim në formën e shqetësimit (Gjuhë urrejtje)
Statusi: Zbatuar

Shoqata “LRER” ka paraqitur ankesë lidhur me gjuhën e përdorur në media ndaj komunitetit rom, nga ana e portalit “JOQ”.

FAKTET

Shoqata “LRER” paraqiti pranë institucionit të Komisionerit ankesën në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “racës”.

Në referim të informacionit të administruar, u konstatua se, portali mediatik, JOQ (joq.al) në datë 17.03.2018, ka publikuar në facebook një material nëpërmjet të cilit transmeton një mesazh të një personi i cili shpreh haptazi diskriminim për komunitetin rom duke i quajtur “harixhinj”, “gabel” dhe “racë e zezë”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 3, 17 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 10128, datë 11.05.2009 “Për Tregtinë Elektronike”.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur (gabel, harixhinj dhe racë e zezë) në mesazhin e publikuar në datë 17.03.2018 në faqen facebook të JOQ është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Toleranca dhe respekti për dinjitet të barabartë të të gjitha qenieve njerëzore përbëjnë themelet e një shoqërie demokratike dhe pluraliste. E drejta e individëve, për të shprehur lirisht mendimet e tyre nuk duhet të “fyejë, tronditin apo shqetësojnë” të tjerët.

Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit.

Komisioneri vlerëson se, përhapja e veprimeve të tilla nëpërmjet medias sociale përbën një mjet të fuqishëm të përhapjes së informacionit. Praktika e vendosur nga portali “JOQ”, përmes publikimit të një informacioni në faqet e tij on-line, për persona apo grupe personash që i përkasin komunitet rom, mund të kontribuojë në mbajtjen e qëndrimeve negative, agresive dhe diskriminuese për të gjithë individët apo komunitetin rom në Shqipëri.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit të shtetasve që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian nga ana e medias sociale JOQ për shkak të racës, në formën e shqetësimit.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, nga ana e administratorit të medias të sipërcituar, të merren masa që në të ardhmen të ndalohet postimi i komenteve diskriminuese ndaj personave që i përkasin komunitetit rom/egjiptian apo çdo personi tjetër.

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, Administratori i medias on-line: JOQ, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.

7. Shoqata “Të Drejtat e Komunitetit Egjiptian” (TDKE) kundër Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Shkodër (UK SHkodër)

VENDIM NR. 128, DATË 27.09.2019

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesi/OJF, është përfaqësues i banorëve të lagjes “Liria” Shkodër që i përkasin kryesisht, komunitetit egjiptian. Prej vitesh, banorët e kësaj lagjeje kanë kërkuar nga ana e Bashkisë dhe UKSH-së, të furnizohen me ujë të pijshëm, sistemimin e kanalizimeve të ujërave të zeza dhe rregullimin e ndriçimit në lagje por nga ana e këtyre institucioneve nuk është ndërmarrë asnjë masë.

FAKTET

Ankuesit janë banorë të lagjes “Liria” Shkodër. Komuniteti rom dhe egjiptian, banorë të lagjes “Liria” në qytetin e Shkodrës, prej vitesh ndeshen me një situatë shumë të keqe sa i përket furnizimit me ujë të pijshëm, mungesës së kanalizimeve dhe mungesës së ndriçimit.

Edhe pse problematika është e njohur nga Bashkia Shkodër e cila pranon se furnizimi me ujë të pijshëm i lagjes kërkon një kombinim të infrastrukturës së re dhe rehabilitimit të pajisjeve, banorët e lagjes “Liria” vijnë të mos furnizohen me ujë të pijshëm prej shumë vitesh.

Së dyti, rrjeti i kanalizimeve të ujërave të ndotura është në gjendje shumë të keqe dhe ka nevojë për ndërhyrje të specializuar nga ana e organeve përgjegjëse, fakt ky i pranuar dhe nga UK Shkodër kur pohon se zona është në fazën e studimit të fizibilitetit për një zgjidhje përfundimtare.

Së treti, ka mungesë në ndriçimin e rrugicave të lagjes, fakt ky i pranuar dhe nga Bashkia Shkodër kur shprehet se, do të shikohet mundësia për ndriçimin e rrugicave të vogla.

Në analizë të sa më sipër, mungesa e ujit të pijshëm për një pjesë të banorëve, e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ndriçimit të rrugicave, është fakt i njohur prej kohësh, për të cilat Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër, nuk kanë marrë asnjë masë për t’i dhënë zgjidhje.

Situata diskriminuese konsiston në mospërmbushjen e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të racës banorët e komunitetit rom dhe egjiptian.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 116.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës (ECRI).
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 1304, datë 11.12.2009, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a.”.

KONKLUSIONE

Institucioni i Bashkisë Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër sh.a, dështuan të provonin para Komisionerit se kanë bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situate, pasi pavarësisht zbatimit të projektit me objekt “Ndërtimi i kanalizimeve të ujërave të zeza dhe ngritja e çezmave publike” të realizuar në vitin 2017, me financim të Bashkimit Evropian dhe të zbatuar nga UNDP, nuk u mundësua furnizimi efektivisht me ujë të pijshëm, trajtimi i ujërave të ndotura dhe ndriçimin e rrugicave, të të gjithë banorëve të lagjes “Liria”.

Në këtë këndvështrim, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm për një pjesë të banorëve, e trajtimit të ujërave të ndotura dhe ndriçimit të rrugicave, është fakt i njohur prej kohësh, për të cilat Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër sh.a nuk kanë marrë asnjë masë për t’i dhënë zgjidhje.

Mospërmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, ka vendosur banorët e komunitetit rom dhe egjiptian, që banojnë në këtë zonë, në pozita të pafavorshme. Bashkia Shkodër dhe Shoqëria UK Shkodër sh.a kanë dështuar në marrjen e masave të duhura për përmirësimin e kushteve të jetesës të këtyre banorëve.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e strukturave të Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë UK Shkodër sh.a, në dëm të ankuesve dhe banorëve të kësaj lagjeje kanë sjellë për pasojë vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të racës.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, të banorëve të lagjes “Liria”, nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë “UK Shkodër” sh.a.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Bashkisë Shkodër dhe Shoqërisë “UK Shkodër” sh.a

8. Grup personash, banorë në magazinat e ish-Ndërmarrjes Gjeologjike kundër Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime Korçë sh.a., (UK Korçë)

VENDIM NR. 151, DATË 25.10.2019

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesit banojnë tek magazinat e ish-Ndërmarrjes Gjeologjike dhe i përkasin komunitetit egjiptian. Kësaj kategorie i është ndërprerë furnizimi me ujë, pasi konsumi i ujit matet vetëm nëpërmjet një matësi të përbashkët dhe fatura i shkon aforfe në një masë të madhe. Banorët kërkojnë të mos diskriminohen për shkak të racës, por të trajtohen njësoj si gjithë konsumatorët e tjerë, ku çdo familje të ketë matës të veçantë.

FAKTET

Ankuesit janë banorë në zonën e ish-Ndërmarrjes Gjeologjike dhe furnizimi me ujë për të pirë dhe për sigurimin e higjienës personale të 29 familjeve sigurohet nëpërmjet një çezme publike dhe faturimi i ujit të konsumuar sigurohet nëpërmjet një matësi. Kjo situatë është që në vitin 2004, kur banorët janë autorizuar nga Bashkia Korçë për të banuar në këtë zonë.

Rezulton e provuar se dhe situata higjenike e tualeteve është shumë e keqe për shkak të pamjaftueshmërisë së furnizimit me ujë.

Nga verifikimet e kryera rezulton se në zonën e ish-Ndërmarrjes Gjeologjike, banojnë persona me aftësi të kufizuara, fëmijë dhe të moshuar gjë që e bën edhe më të domosdoshëm e jetik furnizimin me ujë të pijshëm brenda banesës.

Gjithashtu, referuar faturës tatimore të shitjes për muajin Prill 2019 për konsumatorin familjar SH. K., me Nr. Klienti 672555, vlera totale për tu paguar (përfshirë kamatëvonesën) ishte në masën 581.409 lekë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Rekomandimi Nr. 7, ECRI(2003)8 i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe jo Tolerancës (ECRI).
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 1304, datë 11.12.2009, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetës Kanalizimeve sh.a.”.

KONKLUSIONE

Institucioni i Bashkisë Korçë dhe Shoqëria UK Korçë sh.a, dështuan të provonin para Komisionerit se kanë bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e situatës së pamjaftueshmërisë së furnizimit me ujë të pijshëm të çdo familjeje të kësaj zone, gjë e cila ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situatë për 15 vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se Shoqëria UK Korçë sh.a përmes mosveprimit, ka neglizhuar të përmbushë detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse. Banorët janë të ndërgjegjshëm kur deklarojnë se janë dakord për të marrë përsipër lidhjen e kontratave individuale për çdo familje dhe të paguajnë për ujin që konsumojnë. Por për të arritur aty nga ana e UK Korçë duhet të bëhet një studim dhe të evidentohen familjet që përfitojnë nga parashikimet e VKM-së nr. 18, datë 12.01.2018 “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe të vendosjes së matësve të ujit për kategoritë në nevojë”.

Nuk mund të pretendohet se është përmbushur detyrimi ligjor për furnizimin me ujë të pijshëm vetëm për faktin se ekziston një çezëm publike në territorin e ish Ndërmarrjes Gjeologjike. Furnizimi me ujë nuk përfshin vetëm ekzistencën e një çezme publike që furnizon me ujë të pandërprerë, por aksesin e qytetarëve në ujin e pijshëm, në mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme, si për përdorimin personal, ashtu edhe për atë shtëpiak, për më tepër që aty banojnë dhe persona me aftësi të kufizuara, fëmijë dhe të moshuar.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë UK Korçë sh.a, në dëm të banorëve të strehuar në ish Ndërmarrjen Gjeologjike, kanë sjellë për pasojë vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të racës dhe gjendjes së tyre sociale.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, të banorëve të strehuar në ish Ndërmarrjen Gjeologjike, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Shoqërisë UK Korçë sh.a.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Shoqërisë UK Korçë sh.a.

9. Çështje ex-officio mbi segregimin e nxënësve romë dhe egjiptianë në Shkollën 9-vjeçare “Liria”, Shkodër

VENDIM NR. 58, DATË 08.05.2019

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë (segregim)
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Referuar informacionit të përcjellë nga ERRC, rezulton se pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, Shkodër ndjekin mësimin kryesisht nxënës romë dhe egjiptianë, që banojnë në lagjen “Liria” dhe lagjen “Përtej Bunës”, duke krijuar segregim të këtyre nxënësve.

FAKTET

Pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria”, e cila ndodhet pranë vendbanimit të hershëm të familjeve egjiptiane në hyrje të qytetit të Shkodrës, ndjekin mësimin kryesisht nxënës romë dhe egjiptianë, që banojnë në lagjen “Liria” dhe lagjen “Përtej Bunës”. Shkolla 9-vjeçare “Liria” ka në administrim edhe shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, në Ajasem.

Një pjesë e nxënësve të Shkollës 9-vjeçare “Liria” zhvillojnë mësim pranë Institucionit Fetar “Kuvendi i Fretërve Kapucinë”, pranë Fshatit të Pages. Aktualisht në këto 3 (tre) institucione mësojnë 130 nxënës të zonës përreth. Në ndërtesën kryesore të Shkollës “Liria” mësojnë vetëm 51 nxënës, ndërkohë që pjesa tjetër e nxënësve mëson pranë dy ndërtesave të tjera.

Problematikat e adresuara nga ERRC konsistojnë në faktin se Shkolla 9-vjeçare “Liria” është një shkollë e segreguar kryesisht me nxënës nga minoriteti egjiptian dhe ai romë dhe vetëm me një numër të kufizuar nxënësish jo romë/egjiptianë. Fëmijët romë dhe egjiptianë të kësaj shkolle janë të përjashtuar nga mësimi i integruar.

ERRC thekson faktin se institucionet përgjegjëse nuk kanë marrë masat e mjaftueshme, për të luftuar diskriminimin nëpër institucionet mësimore. Këto institucione janë në dijeni të kësaj situate mbipërfaqësimi të fëmijëve romë dhe egjiptianë në Shkollën 9-vjeçare “Liria” dhe në shkollat anekse të saj. Institucionet përgjegjëse në Shkodër nuk kanë ndërgjegjësimin e duhur mbi pasojat afatgjata të segregimit, që është duke ndodhur pranë kësaj shkolle.

ERRC vë në dukje të Komisionerit edhe çështjen e performancës së Shkollës 9-vjeçare “Liria”, e cila sipas informacionit të përcjellë nga kjo shoqatë renditet në vendin e 75, nga 77 shkolla të Shkodrës. Kjo, sipas ERRC-së ka ardhur si pasojë e segregimit të nxënësve romë dhe egjiptianë që mësojnë në godinat e kësaj shkolle. Tregues të qartë të cilësisë së ulët janë numri i ulët i nxënësve që frekuentojnë shkollën rregullisht dhe cilësia e përgatitja e nxënësve të kësaj shkolle.

Një tjetër shqetësim i ngritur nga ERRC ka të bëjë edhe me sistemimin nëpër shkolla të fëmijëve romë të ardhur nga qytete të tjera. Rasti i paraqitur nga kjo shoqatë konsiston në sistemimin e 69 fëmijëve romë/egjiptianë në fillim vitin shkollor 2017-2018, 40 prej të cilëve të mbështetur në materialet didaktike dhe suportin e nevojshëm për të kryer procedurat e

regjistrimit në shkollë nga stafi i organizatës ARSIS, do të regjistroheshin në njërën nga shkollat afër zonës, ku fëmijët banonin.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.SH., neni 18;
- Memorandumi Shpjegues i Rekomandimit nr. 7, për Politikën e Përgjithshme të ECRI-t “*Mbi legjislacionin kombëtar për luftën kundër racizmit dhe diskriminimit racial*”, (miratuar në 13 dhjetor 2002 dhe amenduar në 7 dhjetor 2017), pika 16;
- Ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, neni 3, pika 3, neni 7, pika 1, nenet 17-19, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa c), pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, si dhe nenin 33, pikat 10, 11 e 13,
- Ligji Nr. 69/2012 “*Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, neni 30, pikat 3 e 4;
- Vendimi i Nr. 682, datë 29.07.2015, i Këshillit të Ministrave, “*Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit*” (i ndryshuar);
- Urdhëri Nr. 343, datë 19.8.2013, e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, “*Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar*” (i ndryshuar);
- Rekomandimi Nr. 4, datë 11.09.2014, i Komisionerit “*Mbi çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuencimit në shkollë, lidhur me fëmijët romë dhe egjiptianë*”

KONKLUSIONE

Nga analizi i të dhënave të administruara gjatë hetimit administrativ, u konstatua se raporti ndërmjet nxënësve romë dhe egjiptianë me ata të mazhorancës, është përafërsisht 4:1.

Rezultoi se edhe në shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, për vitin shkollor 2018-2019, numri i nxënësve romë është më i madh se numri i nxënësve të mazhorancës, si dhe u konstatua se në klasën e I, V dhe VII ka vetëm nxënës romë.

Nga hetimi rezultoi se situata e përbërjes komunitare në Shkollën 9-vjeçare “Liria” dhe Shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, për dy vitet e fundit shkollor, përbën një rast të pastër segregimi apo veçimi të nxënësve romë dhe egjiptianë.

Komisioneri gjykon se vullneti i prindërve është tepër i rëndësishëm lidhur me përzgjedhjen e institucionit arsimor, ku do të mësojnë fëmijët e tyre, por faktor vendimtar, në lidhje me vendimmarrjen e prindërve për të regjistruar fëmijët e tyre në shkollë, ku përqendrimi i nxënësve romë dhe egjiptianë është shumë më i madh, sesa numri i nxënësve të mazhorancës, është mungesa e një procesi të rregullt informues të institucioneve përgjegjëse ndaj këtyre prindërve për t’i njohur ata me konceptin e segregimit apo veçimit, si dhe me pasojat e tij tek fëmijët e tyre.

Nëse prindërit romë dhe egjiptianë do të ishin pjesë e një procesi të tillë informues, i cili duhet të ishte gradual dhe i përshtatshëm për nivelin e tyre arsimor dhe kulturor, nëse ata do të njiheshin me pasojat e segregimit apo veçimit të fëmijëve të tyre, nga fëmijët e tjerë, si dhe nëse do të informoheshin mbi faktin se ata mund t’i regjistrojnë fëmijët e tyre edhe në shkollë

të tjera që ndodheshin më larg vendbanimit të tyre, në lagjen “Liria”, por transporti për këta fëmijë do të sigurohej falas nga DAR apo Bashkia Shkodër, vendimmarrja e tyre mund të kishte qenë e ndryshme.

Njëkohësisht, në mënyrë që të luftohet segregimi shkollor, zgjedhja e shkollës duhet të kontrollohet në mënyrë të kujdesshme nga institucionet përgjegjëse. Komisioneri gjykon se duhet të vendosen rregulla të qarta lidhur me këtë proces dhe duhet të balancohet parimi i zgjedhjes së shkollës me synimin që të shqyrtohen dhe përmbushen të gjitha nevojat arsimore. Në parim, ky proces përfshin masa të tilla sikurse ngushtimi i raportit të nxënësve nga grupet e paavantazhuara, janë romët dhe egjiptianë, me nxënësit e tjerë⁸ në shkolla të caktuara. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se nxënësit romë dhe egjiptianë të Shkollës 9-vjeçare “Liria” bashkë me shtesat e saj, diskriminohen në formën e segregimit, nga ana e DAR Shkodër.

Komisioneri gjykon se, nëse kërkohet parandalimi dhe evitimi i situatave segreguese në shkolla, si dhe nëse duhet të krijohet një raport sa më i pranueshëm, ndërmjet numrit të nxënësve romë dhe egjiptianë me numrin e nxënësve të mazhorancës, duhen krijuar e ofruar mundësitë optimale dhe kushtet e duhura, për të arritur këtë qëllim. Komisioneri i jep përparësi faktit të ndalimit të segregimit dhe për ta arritur këtë qëllim, duhen përdorur të gjitha mjetet dhe burimet e nevojshme, që janë në dispozicion. Nëse, pranë vendbanimit të fëmijëve romë do të ndodheshin 3 shkolla në largësi të ndryshme, nën 2 km, fëmijët romë dhe egjiptianë do të frekuentonin shkollën më të afërt, duke krijuar përqendrim të madh, të tyre pranë kësaj shkolle, ndërkohë që do të frekuentonin pak ose aspak 2 shkollat e tjera. Në këto kushte, Komisioneri gjykon se do të favorizohej segregimi i këtyre nxënësve dhe përqendrimi i tyre në shkolla të caktuara. Për të shmangur dhe parandaluar segregimin e fëmijëve të këtyre komuniteteve, Komisioneri rekomandon, që fëmijëve romë dhe egjiptianë t’u sigurohet transport falas edhe kur largësia ndërmjet shkollës dhe vendbanimit të tyre është nën 2 km.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, nga ana e DAR Shkodër, për shkak të “racës”, së nxënësve romë dhe egjiptiane, që mësojnë pranë Shkollës 9-vjeçare “Liria” Shkodër dhe Shkollën vartëse “Isuf Tabaku”, Ajasem, Shkodër.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masat e nevojshme nga DAR Shkodër, për shmangien e situatës së segregimit, duke zbatuar Dispozitat Normative, në lidhje me zbatimin e kriterit të regjistrimit të nxënësve sipas zonës së shkollës.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masat e nevojshme nga ana e DAR Shkodër, drejtuesit e shkollave në këtë qark, nën mbështetjen dhe asistencën e ERRC-së dhe organizatave të tjera, për kryerjen procesit informues me familjet rome dhe egjiptiane, mbi segregimin dhe pasojat e tij në arsim.

⁸ Shih Rekomandimin Nr. 4, datë 11.09.2014, të KMD-së “Mbi çështje të regjistrimit, shpërndarjes dhe frekuentimit në shkolla, lidhur me fëmijët romë dhe egjiptianë”.

DAR Shkodër të marrë masat e nevojshme, për vitin e ardhshëm shkollor, për një shpërndarje sa më të njëtrajtshme të nxënësve romë dhe egjiptianë në shkollat e qarkut Shkodër.

Rekomandohet që Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sportit të kryejë propozimet përkatëse, për ndryshimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 682, datë 29.07.2015 *“Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” (i ndryshuar)*, duke përfshirë transport falas për nxënësit romë dhe egjiptianë, edhe për largësitë nën 2 km.

10. Grup personash kundër Bashkisë Krujë

VENDIM NR. 236, DATË 26.11.2018

Shkaku: Raca, gjendja shoqërore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Mbyllur me gjobë për moszbatim vendimi të KMD

Prej vitesh, banorët e lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë, pjesa më e madhe e të cilëve i përkasin komunitetit rom, u mohohet nga Bashka Krujë furnizimi me ujë të pijshëm, si dhe sistemimi kanalizimeve të ujërave të zeza, për shkak të racës dhe “gjendjes shoqërore”.

FAKTET

Një grup personash, banorë të lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë, pjesa më e madhe e të cilëve i përkasin komunitetit rom (rreth 250 familje), të cilët jetojnë në kushte të vështira ekonomike, në ankesën e tyre pranë KMD, parashtruan dy problematika:

Së pari, mungesën e ujit të pijshëm prej më shumë se 10 vitesh në këtë lagje. Me përjashtim të 6-7 familjeve të vendosura në fillim të lagjes, pjesa tjetër e banorëve nuk kanë ujë të pijshëm si rezultat i mungesës së rrjetit shpërndarës të ujit të pijshëm. Të ndodhur në këto kushte, banorët ishin të detyruar të siguronin ujin përmes shpimeve apo puseve në oborret e shtëpive të tyre; por uji ishte i pa kontrolluar dhe në shumicën e rasteve kishte shkaktuar sëmundje tek banorët.

Së dyti, problematika tjetër lidhej me kanalizimet e ujërave të bardha dhe atyre të zeza. Ujërat e zeza kalonin përmes disa tubave të ngushtë nëntokësorë të cilët shpesh bllokohehin duke dalë në sipërfaqe afër shtëpive të banimit. Kjo shkaktonte një mungesë të theksuar higjene. Rrjeti i kanalizimeve ishte i amortizuar dhe kishte nevojë për ndërhyrje të specializuara nga ana e organeve përgjegjëse shtetërore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës (ECRI).
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështjet: Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa Nr. 34369/97, “Neshkov dhe të tjerë kundër Bullgarisë” dhe “Jordan Petrov kundër Bullgarisë” dhe “Halil Adem kundër Bullgarisë”.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23.

- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 1304, datë 11.12.2009, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjellës Kanalizimeve sh.a.”.

KONKLUSIONE

Institucioni i Bashkisë Krujë dështoi të provonte para Komisionerit se ka bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situate.

Në këtë këndvështrim, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm apo lejimi i përdorimit të linjave të pakontrolluara për të siguruar mbulimin e nevojave minimale për ujë, nga ana e Bashkisë Krujë, u ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situate për vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se Bashkia përmes mosveprimit, ka neglizhuar të përmeshte detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Lidhur me sa mësipër, Komisioneri konstatoi se, komunitetit rom të lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë, i është mohuar e drejta e aksesit në furnizimin me ujë të pijshëm si dhe përsa i përket kushteve të higjenes si pasojë e mos marrjes të masave për rregullimin e tubacioneve të ujërave të zeza. Mungesa e ujit të pijshëm dhe higjenes nxit stigmën ndaj tyre duke i përjashtuar nga shoqëria, gjë që për pasojë sjell dhe diskriminim të tyre.

Bazuar në informacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe faktin që gjendja pranohet nga të dyja palët në proces; u konstatua që gjendja e këtyre banorëve vijon të mbetet e pa zgjidhur. Nga ana e Bashkisë Krujë, nuk u paraqit asnjë provë, argument apo fakt i dokumentuar, që të justifikonte mosmarrjen e masave për sigurimin e ujit të pijshëm, apo ndërhyrjen konkrete për përmirësimin në sistemin e ujërave të zeza.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Strukturave të Bashkisë Krujë, në dëm të ankuesve, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit, për shkak të racës dhe gjendjes shoqërore, të banorëve të lagjes “Kastriot”, Njësia Administrative Fushë-Krujë, nga ana e Bashkisë Krujë.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Bashkisë Krujë.

11. Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome” (LRER) kundër gazetarit A.Ç.

VENDIM NR. 142, DATË 28.06.2018

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim në formën e shqetësimit
Statusi: Mbyllur me gjobë për moszbatim vendimi të KMD

Gazetari A. Ç., në emisionin e datës 21.05.2018 të televizionit Fax News, ka përdorur shprehje dhe gjuhë fyese kundrejt komunitetit rom.

FAKTET

Ankesa është sjellë për shqyrtim pranë KMD nga një organizatë jo fitimprurëse, LRER, e cila në fokus të veprimtarisë së vet ka mbrojtje dhe promovimin e të drejtave të komunitetit rom dhe egjiptian. Thelbi i ankesës kishte të bënte me një etiketim të gazetarit A. Ç.

Gjatë emisionit të datës 21.05.2018 të televizionit Fax News, evidentohet fakti se, gazetari A. Ç., ka përdorur shprehje dhe gjuhë fyese kundrejt komunitetit rom.

Tema e diskutimit në këtë emision kishte lidhje me audio përgjimin e vëllait të Ministrit të Brendshëm dhe gjatë diskutimit për të treguar që kjo bisedë është shumë e rëndësishme, gazetari A. Ç., thotë shprehimisht se: “Nuk jemi duke fol për jevgjit në rrugë”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 3, 17, 18, 22, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështjet: “Feret kundër Belgjikes”, “Delfi AS kundër Estonisë” dhe “Vejdeland dhe të tjerë kundër Suedisë”.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1,3/5, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Komisioneri pasi nuk mori asnjë përgjigje nga ana e gazetarit A. Ç., megjithëse e kishte njoftuar shkresërisht disa herë, vlerësoi të konkludojë lidhur me çështjen, bazuar në parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative, ku sanksionohet se, për faktet të cilat janë të njohura publikisht, si dhe për ato fakte të cilat janë të ditura për organin administrativ për shkak të funksioneve të tij, nuk nevojitet verifikim, nuk lind nevoja për verifikim.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, shprehja e përdorur nga gazetari A. Ç., nxisit haptazi ndjenja përbuzjeje ndaj komunitetit rom dhe egjiptian.

Komisioneri u shpreh se mirëkupton dhe respekton të drejtën e çdo individi për të shprehur mendimet dhe opinionin e vet personal lidhur me çështje të ndryshme, por vlerëson se një

gjuhë e tillë cënon interesat, dinjitetin dhe të drejtat themelore të komunitetit rom dhe egjiptian në Shqipëri dhe nxit urrejtjen ndaj tyre.

Gjuhën e përdorur nga gazetari A. Ç., Komisioneri e konsideron në tejkalim të lirisë së shprehjes të sanksionuar në nenin 22 të Kushtetutës, referuar kufizimeve që parashikon Konventa për lirinë e shprehjes, të parashikuar në nenin 10 të saj dhe qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur (*“nuk jemi duke fol për jevgjit në rrugë”*) në emisionin e datës 21.05.2018 të televizionit Fax Neës, nga ana e A. Ç., është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit, të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mbajti parasysh faktin e rëndësishëm që mediat audiovizive ndiqen nga shumë njerëz dhe pjesëmarrësit në këto emisione (siç është rasti i A. Ç.,) janë persona publikë që kanë impakt në publikun që i ndjek. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit. Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se, përhapja e veprimeve të tilla nëpërmjet mediave audiovizive përbën një mjet të fuqishëm të ndikimit në publik dhe mund të ndikojë në mbajtjen e qëndrimeve negative, agresive dhe diskriminuese për të gjithë individët apo komunitetin rom dhe egjiptian në Shqipëri.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit në formën e shqetësimit të shtetasve që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian nga ana e gazetarit A. Ç., për shkak të racës, në formën e shqetësimit.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, A. Ç., të dalë me një deklaratë publike (verbale apo të shkruar) me anë të së cilës distancohet nga përdorimi i një gjuhe të tillë e cila paragjykon haptazi dhe në mënyrë flagrante prek dinjitetin e personave të komunitetit rom dhe egjiptian.

12. Grup personash kundër Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Ujësjetllës Kanalizime sh.a. Fier (UK Fier)

VENDIM NR. 8, DATË 17.01.2019

Shkaku: Raca, etnia dhe gjendja sociale
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesit, janë banorë të lagjes Mbrostar të qytetit të Fierit dhe i përkasin komunitetit rom. Prej vitesh, së bashku me banorët e tjerë të lagjes Mbrostar, kanë kërkuar nga ana e Bashkisë Fier dhe Shoqërisë UK Fier, të furnizohen me ujë të pijshëm, por nga ana e këtyre institucioneve nuk është ndërmarrë asnjë masë duke i trajtuar ata në mënyrë të pabarabartë dhe diskriminuese në raport me pjesën tjetër të banorëve të qytetit të Fierit.

FAKTET

Ankuesit janë banorë të lagjes Mbrostar të Bashkisë Fier.

Kjo zonë nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga ana e Drejtorisë së Ujësjetllës Kanalizime Fier sh.a. (në vijim UK Fier sh.a.).

Mungesa e ujit të pijshëm, është fakt i njohur prej kohësh referuar ankesave të banorëve, për të cilat Bashkia Fier dhe UKF sha., nuk kanë marrë asnjë masë për t'i dhënë zgjidhje kësaj situate.

Të ndodhur në këto kushte, disa prej banorëve kanë gjetur zgjidhje alternative, hapjen e puseve në mënyrë private, duke siguruar mbulimin e nevojave minimale për ujë.

Situata diskriminuese lidhet me faktin se Bashkia Fier dhe UK Fier sha., edhe pse ka dijeni, nuk merr asnjë masë për rregullimin e problematikës për shkak të racës dhe gjendjes sociale të banorëve që preken.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 116 dhe 18.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës (ECRI).
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

- Vendimi Nr. 1304, datë 11.12.2009, i Këshillit të Ministrave *“Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetellës Kanalizimeve sh.a.”.*

KONKLUSIONE

Institucioni i Bashkisë Fier dhe UK Fier sh.a., dështuan të provonin para Komisionerit se kanë bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situate, pasi nuk mund të pretendohet se është përmbyshur detyrimi ligjor për furnizimin me ujë të pijshëm vetëm për faktin se ekziston rrjeti fizik i dëmtuar i linjave të ujit. Furnizimi me ujë nuk përfshin vetëm ekzistencën e rrjetit fizik të furnizimit me ujë, por aksesin e qytetarëve në ujin e pijshëm; në mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme, si për përdorimin personal, ashtu edhe për atë shtëpiak.

Në këtë këndvështrim, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm apo lejimi i përdorimit të puseve të pakontrolluara për të siguruar mbulimin e nevojave minimale për ujë, nga ana e Bashkisë Fier dhe UK Fier sh.a, u ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situate për vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se Bashkia Fier dhe UK Fier përmes mosveprimit, kanë neglizhuar të përmbyshin detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Strukturave të Bashkisë Fier dhe UK Fier, në dëm të ankuesve dhe banorëve të lagjes Mbrostar, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes së tyre sociale.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të racës, etnisë dhe gjendjes sociale, të shtetasve A. Y., A. Sh., dhe K. Y., dhe të banorëve të lagjes “Mbrostar”, nga ana e Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime sh.a.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Bashkisë Fier dhe Shoqërisë Ujësjetellës Kanalizime sh.a.

13. A. XH., kundër Universitetit të Arteve Tiranë (UART)

VENDIM NR. 82, DATË 02.07.2019

Shkaku: Raca
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi, i përket komunitetit egjiptian dhe ndjek studimet pranë UAT. Me vendim të Bordit të Administrimit të Universitetit është përjashtuar nga e drejta për t'u përjashtuar nga pagesa e tarifës vjetore të studimeve. Veprimet e ndërmarra nga ana e Bordit të Administrimit të Universitetit kanë përballur ankuesin me një trajtim të pabarabartë dhe diskriminues për shkak të racës.

FAKTET

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ të ankesës së shtetasit A. Xh., rezulton se ankuesi pas zhvillimit të konkursit të pranimit për vitin akademik 2017-2018 është shpallur fitues dhe është regjistruar si student i vitit të I-rë, në degën Pikturë, pranë Fakultetit të Arteve të Bukura të Universitetit të Arteve. Aktualisht ka përfunduar vitin e parë dhe ndjek vitin e dytë të studimeve.

Në vitin akademik 2017-2018, ka dorëzuar dokumentacionin për të përfituar përjashtimin nga tarifa vjetore e studimit, pasi i përket komunitetit egjiptian të Shqipërisë.

Bordi i Administrimit të UART, me Vendimin Nr. 07, datë 21.05.2018, ka miratuar studentët që përfitojnë dhe nuk përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit për secilin Fakultet të UART. Në pikën 4 të relacionit shoqërues të vendimit të sipërcituar është përcaktuar se studenti A. Xh., nuk përfiton përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, pasi nuk ka konkuruar në kuotat e parashikuara për kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian.

Referuar legjislacionit, vlerësohet se nuk parashikohet ndryshim për sa i përket kategorive që përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, pasi studentët romë dhe ballkano-egjiptian përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit pavarësisht konkurimit nëpërmjet kuotave apo jo.

Në vlerësim të udhëzimeve të MASR për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve për vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018, nuk përcaktohet ndonjë ndryshim në drejtim të mospërjashtimit nga pagesa e tarifave vjetore të shkollimit pasi këto udhëzime rregullojnë procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve dhe nuk përcaktojnë kategoritë e individëve që përjashtohen apo jo nga tarifa vjetore e shkollimit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.

- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (CERD) të miratuar nga shteti Shqiptar nëpërmjet Ligjit nr.7768, datë 09.11.1993 *“Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor”*, neni 7.
- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 *“Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”*, neni 4.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- VKM nr. 269, datë 23.09.2017 *“Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”*.
- VKM Nr. 866, datë 23.10.2015 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 638, datë 22.07.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifën e shkollimit për vitin akademik 2015-2016”*.
- Udhëzimi nr.15, datë 19.05.2017 të MASR *“Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018”* i ndryshuar me Udhëzimin Nr.18.

KONKLUZIONE

Komisioneri, konstaton se studenti A. Xh., si anëtar i komunitetit egjiptian të Shqipërisë, i cili sipas përcaktimeve të pikës 1/e të VKM-s Nr. 269, datë 23.09.2017, duhet të rezultonte përfitues për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, është vënë në pozita jo të favorshme në përputhje me parashikimet e vetë kësaj VKM-je, duke ia mohuar atij mundësinë për të përfituar nga përjashtimi i pagesës së tarifës së shkollimit. Pra, studenti A. Xh., është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të racës së tij.

Komisioneri konstaton se, kemi trajtim të papërligjur, jo objektiv dhe të pajustificuar në argumente, të studentit A. Xh., që i përket kategorisë së listuar në pikën 1 të VKM Nr. 269, datë 29.03.2017, sa i takon përjashtimit nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit. Mosmiratimi i aplikimit të A. Xh., për përjashtimin nga tarifa vjetore e studimit nga ana e Bordit të Administrimit, përbën një ushtrim arbitrar të veprimtarisë administrative, në kundërshtim me Kushtetutën dhe në shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, të Ligjit Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit A. Xh., nga ana e UART dhe Bordit të Administrimit për shkak të racës.

Në referim të pikës 1, UART dhe Bordi i Administrimit, si subjekte që kanë konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrin masa për përjashtimin e studentit A. Xh., nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit.

14. Grup personash, kundër Bashkisë Korçë

VENDIM NR. 252, DATË 18.12.2018

Shkaku: Raca dhe gjendja sociale
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesit janë një grup banorësh të cilët i përkasin komunitetit rom/egjiptian, që jetojnë në godinën e ish- konviktit të Shkollës Bujqësore, Korçë. Nga ana e tyre, pretendohet mos marrja e masave për përmirësimin apo sigurimin e kushteve normale të jetesës, për strehimin në kushte sa më dinjitoze nga ana e Bashkisë Korçë, e cila i ka vendosur ata në pozita të pafavorshme.

FAKTET

Në mbështetje të provave të grumbulluara, rezultoi se në muajin Tetor 2016, pas rikonstruksionit të godinës së ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, familjet e subjekteve ankues janë vendosur në godinën e ish- konviktit të Shkollës Bujqësore, Korçë për një periudhë të përkohshme. Bashkia Korçë gjatë vitit 2017, pasi ka hartuar projektin, zgjedhur truallin dhe lejen e ndërtimit, ka aplikuar pranë Ministrisë së Zhvillimit Urban për ndërtimin e një blloku banesash për komunitetin rom/egjiptian të qytetit. Sipas informacionit të administruar, Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pranë Bashkisë Korçë, për periudhën 2017-2018-2019, ka përcaktuar prioritetet e investimeve, ku evidentohet se një prej tyre është ndërtimi i banesave për komunitetin rom dhe egjiptian.

Pavarësisht mundësive që u janë krijuar familjeve të vendosura në godinën e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore, kushtet e banimit të ndërtesës dhe hapësirat nuk janë të mjaftueshme për numrin e familjeve të vendosura në të. Në këto ambjente, të përshtatura nga ana e Bashkisë Korçë, banojnë rreth 35 familje dhe afërsisht 130 banorë. Secila nga familjet e strehuara shfrytëzon nga një dhomë konvikti për të jetuar, si dhe një tualet të përbashkët për 5 familje. Referuar konstatimeve të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Korçë dhe Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Korçë, godina e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, nuk plotëson kushtet minimale higjeno-sanitare për të qenë ambjente banimi. Në këto kushte, mos marrja e masave të nevojshme nga ana e Bashkisë Korçë, për higjenizimin e godinës dhe riparimin e dëmeve të saj, sjell agravimin deri në shpërthimin e ndonjë epidemie tek banorët.

Nga informacioni i administruar, nga ana e Bashkisë Korçë, pas ankesës së bërë tek KMD dhe kërkesave të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor Korçë dhe Drejtorisë Rajonale të Shëndetësisë Korçë, janë marrë masat për pastrimin dhe largimin e ujërave të ndotura nga kati i nëndheshëm (bodrum) i godinës, por nuk është ndërmarrë asnjë hap për të ndërhyrë në 2 (dy) katet e sipërme të ndërtesës për të eliminuar lagështirën që gjendet në të.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 116 dhe 18.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, Neni 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 10 138, datë 11.5.2009 “Për Shëndetin Publik”, neni 19.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 3, 9, 23 dhe 24.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUZIONE

Bashkia Korçë, nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion lidhur me projekte apo plane, mbi masat aktuale që ka marrë ose që do të ndërmarrë për përmirësimin apo sigurimin e kushteve normale të jetesës, për strehimin në kushte sa më dinjitoze të banorëve të ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Kushtet e higjeno-sanitare, ishin fakte të njohura dhe të konstatuara nga institucionet shtetërore, për të cilat Bashkia Korçë nuk ka marrë asnjë masë për t’i dhënë zgjidhje të qëndrueshme kësaj situate. Mos përmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, për përmirësimin apo sigurimin e kushteve normale të jetesës, për strehimin në kushte sa më dinjitoze nga ana e Bashkisë Korçë, vendos në pozita të pafavorshme banorët e ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Pavarësisht faktit që nga ana e Bashkisë Korçë janë marrë masat për strehimin e banorëve të zhvendosur si rezultat i ndërtimeve urbanistike, Komisioneri vëren se duhet të kishte marrë masat për krijimin e kushteve të përshtatshme të jetesës për këta banorë, si dhe të kujdesej në vijimësi për godinën, në mënyrë që të eliminoheshin pasojat e ardhura nga mbipopullimi i godinës së ish-Konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë.

Në përfundim të arsyetimit të sipërcituar dhe bazuar në informacionin e administruar nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatohet se me anë të mosveprimeve, Bashkia Korçë ka sjellë trajtimin e pafavorshëm dhe të pabarabartë të banorëve të ish konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë për shkak të racës dhe gjendjes së tyre sociale.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të subjekteve ankues, K. G., K. M., M. G., dhe E. Ll., për shkak të racës dhe gjendjes së tyre sociale, nga ana e Bashkisë Korçë.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Bashkisë Korçë, për përmirësimin e kushteve të jetesës në godinën e ish-konviktit të Shkollës Bujqësore Korçë, duke bërë higjenizimin e menjëhershëm të godinës, sistemimin e tubacioneve të ujërave, eliminimin e lagështirës në këto ambiente, si dhe sistemimin e kabujve elektrik në korridoret e godinës.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Bashkisë Korçë, për sigurimin e ujit të pijshëm, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga e marrja dijeni për këtë vendim.

15. F. P., kundër Universitetit të Arteve Tiranë (UART)

VENDIM NR. 228, DATË 13.11.2018

Shkaku: Etnia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesi, i përket komunitetit egjiptian dhe ndjek studimet pranë UART. Me vendim të Bordit të Administrimit të Universitetit është përjashtuar nga e drejta për t'u përjashtuar nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit.

FAKTET

Shtetasi F.P., pas zhvillimit të konkursit të pranimit për vitin akademik 2017-2018 është shpallur fitues dhe është regjistruar si student i vitit të I-rë, në degën Pedagogji Muzikore, pranë Fakultetit të Muzikës të Universitetit të Arteve.

Në muajin mars 2018, ka dorëzuar dokumentacionin për të përfituar përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, pasi i përket komunitetit egjiptian të Shqipërisë.

Bordi i Administrimit të UART, me Vendimin Nr. 07, datë 21.05.2018, ka miratuar studentët që përfitojnë nga tarifa vjetore e shkollimit për secilin Fakultet të UART. Në pikën 4 të relacionit shoqërues të vendimit të sipërcituar është përcaktuar se studenti F. P, nuk përfiton përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, pasi nuk ka konkuruar në kuotat e parashikuara për kandidatët e komunitetit rom dhe egjiptian.

Referuar legjislacionit, vlerësohet se nuk ka patur ndryshim të legjislacionit për sa i përket kategorive që përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, pasi studentët romë dhe ballkano-egjiptian përfitojnë përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit pavarësisht konkurimit nëpërmjet kuotave apo jo.

Gjithashtu, në vlerësim të udhëzimeve të MASR për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve për vitin akademik 2016-2017 dhe 2017-2018 nuk përcaktohet ndonjë ndryshim në drejtim të mospërjashtimit nga pagesa e tarifave vjetore të shkollimit pasi këto udhëzime rregullojnë procedurat e aplikimit dhe regjistrimit të kandidatëve dhe nuk përcaktojnë kategoritë e individëve që përjashtohen apo jo nga tarifa vjetore e shkollimit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial (CERD) të miratuar nga shteti Shqiptar nëpërmjet Ligjit nr.7768, datë 09.11.1993 “Për

aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën ndërkombëtare për zhdukjen e të gjitha formave të dallimit racor”, neni 7.

- Ligji Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- VKM Nr. 269, datë 23.09.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”.
- VKM Nr. 866, datë 23.10.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 638, datë 22.07.2015 “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë në programet e studimeve të ciklit të parë, programet e studimeve jouniversitare profesionale dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, si dhe tarifatat e shkollimit për vitin akademik 2015-2016”.
- Udhëzimi Nr. 15, datë 19.05.2017 të MASR “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet e arsimit të lartë, për vitin akademik 2017-2018” i ndryshuar me Udhëzimin Nr. 18.

KONKLUSIONE

Komisioneri, konstaton se studenti F. P., si anëtar i komunitetit egjiptian të Shqipërisë, i cili sipas përcaktimeve të pikës 1/e të VKM-s Nr. 269, datë 23.09.2017, duhet të rezultonte përfitues për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit, është vënë në pozita jo të favorshme në përputhje me parashikimet e vetë kësaj VKM-je, duke ia mohuar atij mundësinë për të përfituar nga përjashtimi i pagesës së tarifës së shkollimit. Pra, studenti F. P., është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të etnisë së tij.

Komisioneri konstaton se, kemi trajtim të papërligjur, jo objektiv dhe të pajustificuar në argumente, të studentit F. P., që i përket kategorisë së listuar në pikën 1 të VKM Nr. 269, datë 29.03.2017, sa i takon përjashtimit nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit. Mosmiratimi i aplikimit të F. P., për përjashtimin nga tarifa vjetore e studimit nga ana e Bordit të Administrimit, përbën një ushtrim arbitrar të veprimtarisë administrative, në kundërshtim me Kushtetutën dhe në shkelje të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit F. P., nga ana e UART dhe Bordit të Administrimit për shkak të etnisë.

Në referim të pikës 1, UART dhe Bordi i Administrimit, si subjekte që kanë konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrin masa për përjashtimin ose rimbursimin e studentit F. P., nga pagesa e tarifës vjetore të shkollimit.

16. J. H., kundër Bashkisë Tiranë dhe Qendrës Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve (QEZHEF)

VENDIM NR. 29, DATË 04.03.2019

Shkaku: Etnia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesi, i përket komunitetit egjiptian. Ai ka kërkuar të regjistrojë fëmijën në kopësht, por nuk ka mundur për shkak të tarifës së përcaktuar nga ana e Bashkisë Tiranë, pasi është i papërballueshëm për shkak të kushteve ekonomike në të cilat ndodhet.

FAKTET

Gjatë vitit 2018-2019, subjekti ankues është paraqitur pranë QEZHEF, për të regjistruar fëmijën në kopësht, por për shkak të situatës ekonomiko-financiare mjaft të vështirë dhe faktit që nuk trajtohet me ndihmë ekonomike, nuk mund të përfshihet në asnjërën nga kategoritë e listuara në VKB Nr. 40 dhe si rrjedhojë nuk mund të regjistrojë fëmijën në kopësht.

Përmes sugjerimit nga ana e QEZHEF, me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë Nr. 40, datë 29.03.2018 *“Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”*, është vendosur përcaktimi i disa kategorive që përfitojnë pa pagesë shërbimin në çerdhe dhe kopësht për fëmijët e tyre, ku ndër to janë:

1. Fëmijët me statusin e jetimit;
2. Fëmijë të familjeve ku kujdestari ligjor ka statusin e jetimit;
3. Fëmijë me aftësi të kufizuara;
4. Fëmijë ku kujdestari ligjor është me aftësi të kufizuara;
5. Fëmijë të familjeve mono prindërore, ku kujdestari ligjor e ka pagën në/nën nivelin e pagës minimale të miratuar me aktin nënligjor përkatës;
6. Fëmijë të familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Ndonëse janë përcaktuar disa kategori që përfitojnë falas këtë shërbim, në VKB-në e miratuar, fëmijët që vijnë nga familje që i përkasin komunitetit rom apo egjiptian nuk trajtohen si një kategori e veçantë përfituesish. Në interpretim të informacionit të dhënë nga ana e QEZHEF dhe Këshillit Bashkiak Tiranë, familjet që i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian, nuk shihen si kategori e veçantë në këtë VKB, por bëjnë pjesë dhe përfshihen në kategorinë e përfituesve që vijnë nga familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- “Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës”, e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 7531/1991, datë 11 Dhjetor 1991.
- “Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racial”, e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 7768, datë 09 Nëntor 1993.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 57 dhe 116.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2016-2020, i miratuar me VKM Nr. 1072 Datë 23.12.2015.
- Plani i Zhvillimit të Komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë e Tiranës 2017-2020, hartuar nga Bashkia Tiranë në vitin 2017.
- Udhëzimi Nr. 21, datë 08.08.2014, Kreun I, i Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

KONKLUZIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Tiranë, QEZHEF dhe Këshilli Bashkiak Tiranë:

- *Në ndryshim nga kategoritë e tjera përfituese, nga VKB Nr. 40, datë 29.03.2018 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës”, të cilat janë parashikuar në mënyrë nominale, kategoria e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian, nuk është parashikuar.*
- *Pavarësisht politikave të hartuara nga shteti shqiptar dhe nga vetë Bashkia Tiranë, kjo e fundit ka dështuar në krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta për fëmijët e komunitetit rom dhe egjiptian.*

KMD vlerëson se Bashkia Tiranë ka diskriminuar shtetasen XH. H., duke dështuar të krijojë përjashtim nga rregulli për fëmijët rom dhe egjiptian edhe pse është në dijeni të situatës aktuale të këtyre komuniteteve si dhe është angazhuar për integrimin e këtyre komuniteteve bazuar në politikat e hartuara nga shteti shqiptar për krijimin e shanseve dhe mundësive të barabarta në shoqërinë shqiptare.

Komisioneri vlerëson se praktika e ndjekur nga Bashkia Tiranë, QEZHEF dhe Këshilli Bashkiak Tiranë, duke mos përfshirë si kategori të veçantë regjistrimin në kopësht të fëmijëve të komunitetin rom dhe egjiptian, si dhe miratimi i VKB-së Nr. 40, datë 29.03.2018, duke pretenduar se këto familje duhet të përfitojnë nga pika 6 e vendimit, i ka trajtuar të gjitha familjet njëloj pa marrë parasysh kushtet e ndryshme sociale që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) për shkak të etnisë⁹, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, pasi kemi të bëjmë me trajtimin e çështjes së

Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

arsimit të fëmijëve të familjeve të komunitetit rom dhe respektimit të të drejtave të tyre, si një element i theksuar qartë edhe në pesë prioritetet, që vendi ynë duhet të përmbushë në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të etnisë, të shtetases XH. H., nga ana e Bashkisë Tiranë dhe QEZHEF Tiranë.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, Bashkia Tiranë, të marrë masa të menjëhershme për hartimin dhe përfshirjen e fëmijëve që vijnë nga familje të komunitetit rom dhe egjiptian, si kategori që përfiton regjistrimin në kopshte pa pagesë.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË IDENTITETIT GJINOR DHE ORIENTIMIT SEKSUAL

17. Çështje ex-officio e nisur kundër shtetasit P. B.

VENDIM NR. 108, DATË 21.08.2019

Shkaku: Identiteti gjinor dhe orientimi seksual
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë (Gjuhë urrejtje)
Statusi: Në gjykatë

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke marrë indicien nga informacioni i transmetuar në televizionin ABC News, me urdhërin Nr. 101, datë 03.06.2019, filloi procedurën “Për ndjekjen ‘ex officio’ të çështjes së shprehjeve të përdorura nga shtetasi P. B. në emisionin “Thumb” të datës 25.05.2019”.

FAKTET

Sipas informacionit të administruar, shtetasi P. B., në cilësinë e organizatorit të eventit Miss Shqipëria, ka qenë i ftuar në pjesën e dytë të emisionit të transmetuar në ABC Neës, të titulluar “Thumb”, më datë 25.05.2019.

Gjatë diskutimeve të mbajtura në emision, fillimisht P. B., është shprehur se: “... kur filloi historia e homoseksualizmit që duhet zyrtarizuar, e që është një gjë normale që të martohet gruaja me grua dhe burri me burrin, që prapë për mua nuk është normale...mbaje mend mbas 5-6 vjetësh ka për të dalë dhe kjo për këta që përdhunojnë kalamajt e vegjël, si quhen ...”.

Në këtë moment ndërpritet nga prezantueset e emisionit duke i sqaruar se nuk është e njëjta gjë. Më pas P. B., vijon duke cituar se: “do të quhet normale fare, po sepse bota po devijon aq shumë nga të gjitha gjërat sa unë se di se ku do përfundojë në fakt”.

Nga prezantueset e emisionit i është drejtuar pyetja: “Ti do ta penalizojë p.sh. një vajzë që ti e di që është lezbike, nga pjesëmarrja në Miss Shqipëria apo Miss Globi, nëse ti e di që është lezbike?” Në përgjigje të kësaj pyetje P. B., është shprehur se shpresonte që t’ia fshihnin, të mos e dinte, pasi një gjë e tillë nuk do t’i pëlqente. Në vijim pyetjes së drejtuesëve të emisionit lidhur me: “Nuk ka një mis lezbike për P. B.”, ai i është përgjigjur “Jo”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 3, 17, 22 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Rishikimi i 10-të (ICD-10), në Kapitullin e V-të-Çrregullime mendore dhe të sjelljes (F00-F99), lidhur me Klasifikimin Ndërkombëtar të Statistikave të Sëmundjeve dhe Problemeve lidhur me Shëndetin (ICD), të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBT).

- Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “*Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinor*”, miratuar në datë 31 mars 2010.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7895, datë 27.01.1995 “*Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë*”.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Komisioneri mban parasysh faktin e rëndësishëm që emisioni “Thumb” është një program i ndjekur nga shumë teleshikues dhe pjesëmarrësit për shkak të shikueshmërisë janë persona publikë si dhe televizioni “ABC Neës” është një televizion i ndjekur në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Rëndësia që merr liria e fjalës për personat publikë sjell dhe një përgjegjësi më të madhe, për të treguar më tepër kujdes dhe për të evituar gjuhën që nxit mos tolerancën dhe diskriminimin mes publikut. Lufta kundër mungesës së tolerancës dhe diskriminimit janë thelbësore në mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, të drejta dhe liri që përbëjnë një nga bazat e shtetit.

Shprehja e përdorur nga P. B., vendos në të njëjtat pozita anëtarët e komunitetit LGBTI dhe personat që kryejnë marrëdhënie seksuale me të mitur, apo të njohur si “pedofilë” në fushën e mjekësisë, psikologjisë, në gjuhën e përditshme të folur, dhe në konceptin e zbatimit të ligjit.

Gjithashtu, shprehjet e përdorura krijojnë në radhët e publikut dhe veçanërisht të atyre personave që nuk janë të mirë informuar në lidhje me çështjet e orientimit seksual apo identitetit gjinor, ndjenja keqkuptimi, refuzimi, e tek disa ndjenja urrejtje ndaj komunitetit LGBTI.

Deklarata e P. B., se nuk do të donte që pjesë e Miss Shqipëria apo Miss Globe të ishte një person që i përket komunitetit LGBTI apo më saktësisht të ishte lezbike, në mënyrë të drejtpërdrejtë vendos në pozita diskriminuese grupimin e personave që mund të aspirojnë në të ardhmen të bëhen pjesë e kompeticionit të Miss Shqipëria dhe pas deklaratës së dhënë nga P. B., për shkak paragjykitimi apo refuzimit nga ana e tij nuk do të dëshirojnë të konkurojnë. Komisioneri vlerëson se gjuha e përdorur nga P. B., është një rast flagrant i shkeljes së dinjitetit të drejtave dhe lirive themelore të individit të sanksionuara dhe në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe mosndëshkimi i një sjellje diskriminuese kaq të hapur, do të minonte rëndë arsyen e vetë ekzistencës së ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Papërgjegjshmëria e lirisë së fjalës e përdorur nga P. B., paragjykon dinjitetin dhe cënon sigurinë e personave për shkak të identitetit gjinor apo orientimit seksual. Duke qenë se, paligjshmëria e sjelljes është aq flagrante, standarti të cilit Komisioneri i është referuar, është ai i një “standarti të vërtetë” që duhet të ekzistojë në një shoqëri demokratike, siç është “dinjiteti njerëzor”, pa qenë e nevojshme identifikimi i një krahasuesi, siç kërkohet nga pika 2, e nenit 3, të Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Komisioneri vlerëson se shprehjet e përdorura nga ana e P. B. ,në emisionin “Thumb” më datë 25.05.2019 kanë vënë në pozita diskriminuese për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor personat që i përkasin komunitetit LGBTI në formën e shqetësimit.

VENDIMI

Shprehjet e përdorura nga P. B., në emisionin “Thumb” më datë 25.05.2019, adresuar komunitetit LGBT në Shqipëri janë diskriminuese sipas parashikimit të nenit 3, pikat 2 dhe 5 e Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pasi ato prodhojnë efektin e paragjykit, nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër personave për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

Në referim të pikës 1, P. B., si personi i cili ka konsumuar sjelljen diskriminuese si më sipër, të kërkojë publikisht ndjesë brenda 15 (pesëmbëdhjetë) diteve nga marrja dijeni për këtë vendim dhe të evitojë në të ardhmen përdorimin e gjuhës e cila prodhon efektin e e paragjykit, nxitjes, shpërndarjes ose promovimit të urrejtjes ose formave të tjera të diskriminimit kundër personave për shkak të identitetit gjinor dhe orientimit seksual.

18. F. H., kundër punonjësve të Policisë së Komisarariatit Nr. 6 Tiranë

VENDIM NR. 124, DATË 17.09.2019

Shkaku: Orientimi seksual
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë (Gjuhë urrejtje)
Statusi: Në proces

Ankuesi është anëtarë i komunitetit LGBTI. Gjatë ndalimit nga ana e punonjësve të Policisë së Komisarariatit Nr. 6 Tiranë, ndaj tij janë është përdorur një fjalor fyes dhe gjuhë urrejtje.

FAKTET

Në datë 07.06.2019, ka qenë duke kaluar në zonën e Astirit, në shoqërinë e bashkëjetuesit, shtetasit A. M., kur është ndaluar nga një patrullë policie.

Nga ana e punonjësve të policisë u është kërkuar që të paraqesin dokumentin e identifikimit. Pas verifikimit të dokumentit të identifikimit të shtetasve, punonjësit e policisë kanë kërkuar të shoqërojnë për në ambjentet e Komisarariatit të Policisë Nr. 6, Tiranë, shtetasin A. M., me arsyetimin se është në kërkim policor. Në momentin që punonjësit e policisë kanë shoqëruar për në automjetin e policisë shtetasin A. M., shtetasi F. H., ka kërkuar të shoqërohej edhe ai në ambjentet e komisarariatit dhe ka kapur për dore shtetasin A. M.. Në këtë moment, nga ana e punonjësve të policisë, ka filluar të përdoret një fjalor fyes duke cituar shprehjet: “... pse vishesh si femër, ju duhet të vriteni dhe të zhdukeni fare ...”.

Shtetasi A. M., pas gjuhës së përdorur nga ana e punonjësve të policisë, ka kërkuar prej tyre arsyen pse duhen vrarë apo zhdukur, në një kohë që edhe ata janë njerëz siç janë edhe punonjësit e policisë. Në përgjigje, njëri prej punonjësve të policisë ka goditur shtetasin A. M.. Sipas ankuesit, në gjendje paniku dhe depresioni, ai ka prerë damarët e një prej gjymtyrëve. Pasi është konstatuar ky veprim i shtetasit F. H., punonjësit e policisë kanë kërkuar që ta dërgojnë në një qendër spitalore për t’i dhënë ndihmën e shpejtë, por nuk është pranuar nga ankuesi duke i vënë në dijeni punonjësit e policisë se do të depozitonte ankesë tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në këto kushte, punonjësit e policisë kanë lajmëruar shërbimin e urgjencës, i cili ka dërguar një autoambulancë dhe i ka dhënë ndihmën e parë ankuesit. Më pas, ankuesi dhe bashkëjetuesi i tij janë lënë të lirë nga punonjësit e policisë dhe janë larguar për në ambjentet e banimit.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 3, 17, 22 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.

- Rekomandimi CM/Rec (2010)5 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës “*Mbi masat për të luftuar diskriminimin mbi baza të orientimit seksual dhe identitetit gjinore*”, miratuar në datë 31 mars 2010.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Shprehjet e përdorura në adresë të ankuesit nga ana e strukturave të Komisaritit Nr. 6 të Policisë Tiranë, në mënyrë të drejtpërdrejtë vendos në pozita diskriminuese atë, duke krijuar një ndjenjë mosbesimi në strukturat e Policisë së Shtetit.

Sa më sipër, KMD në mungesë të argumenteve të Komisaritit të Policisë Nr. 6 Tiranë për të përligjur sjelljen e punonjësve të policisë kundrejt ankuesit, vlerëson se është pikërisht orientimi seksual i ankuesit shkak i trajtimit të padrejtë dhe të paligjshëm të tij, nga ana e strukturave të Komisaritit Nr. 6 të Policisë Tiranë.

Në përfundim, për sa më sipër, në mungesë të një justifikimi të arsyeshëm, lidhur me pretendimet e ngritura nga subjekti ankues, Komisioneri vlerëson se shprehjet e përdorura nga ana e punonjësve të policisë së Komisaritit të Policisë Nr. 6, Tiranë, kanë vënë në pozita diskriminuese për shkak të orientimit seksual ankuesin në formën e shqetësimit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të orientimit seksual, të F. H., nga ana e punonjësve të policisë së Komisaritit të Policisë Nr. 6, Tiranë.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa nga ana e strukturave të Komisaritit të Policisë Nr. 6, Tiranë, për informimin dhe trajnimin e punonjësve, lidhur me Ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, që ngjarje të tilla të mos përsëriten më në të ardhmen.

ÇËSHTJE TË DISKRIMINIMIT PËR SHKAK TË BINDJEVE POLITIKE

19. F. A., kundër Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Drejtorisë së Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terciare (DAPSHET), ish DSHSUKS.

VENDIM NR. 121, DATË 09.09.2019

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune, në detyra të ndryshme pranë FSDKSH, për një periudhë prej 11 vitesh. Me Urdhërin Nr. 37, datë 25.05.2018, të Drejtorit të DAPSHET, ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me DSHSUKS, për shkak të ristrukturimit të institucionit. Ankuesi ka kërkuar transferimin e tij pranë Drejtorisë së Kontrollit në FSDKSH, por nuk është transferuar për shkak të bindjes politike.

FAKTET

F. A., që nga data 01.09.2007 deri në datë 25.08.2018 ka qenë në marrëdhënie punësimi, në detyra të ndryshme, pranë ISKSH, aktualisht, FSDKSH.

Me Urdhërin Nr. 105, datë 22.12.2016 “Për emërim në pozicionin e punës” të Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor është emëruar Specialist Ekonomist në Sektorin e Kontrollit Ekonomiko-Financiar pranë Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare dhe Kontrollit Spitalor (DSHSUKS).

Me Vendimin nr. 63, datë 25.09.2017 të Këshillit Administrativ, është miratuar pakësimi me 163 punonjës të FSDKSH.

Në zbatim të vendimit të sipërpërmendur, ka dalë Vendimi Nr.14, datë 02.02.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH “Për miratimin e strukturës organizative, strukturës së brendshme dhe të rregullores për organizimin, funksionimin dhe përshkrimin e punës së FSDKSH”.

Me Urdhërin Nr. 37, datë 25.05.2018, të Drejtorit të DAPSHET, F. A., i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me DSHSUKS, për shkak të ristrukturimit të institucionit.

Në vijim të procesit të ristrukturimit, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve të FSDKSH, me Memon Nr. 3205, datë 29.06.2018 drejtuar Sektorit të Marrëdhënieve me Qytetarët ka dërguar njoftimin për publikimin në faqen zyrtare të FSDKSH të vendeve vakant në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve.

Ankuesi me shkresën datë 10.07.2018, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të FSDKSH, në të cilën ka kërkuar anulimin e Urdhërit Nr. 37 datë 25.05.2018 “Për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës” dhe transferimin e tij në Sektorin e Kontrollit të Spitaleve pranë Drejtorisë së Kontrollit në FSDKSH si dhe ka kërkuar që të merren masa për ndalimin e paligjshmërisë dhe të diskriminimit ndaj tij.

Në përgjigje të kërkesës së ankuesit për transferimin e tij, FSDKSH justifikohet me faktin se F.A nuk ka depozituar pranë Fondit kërkesën dhe dosjen përkatëse.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 124, datë 05.03.2014 i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Statutit të FSDKSH”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Referuar pikës 2 të nenit 15 të Statutit të FSDKSH përcaktohet se, “Personeli i Drejtorisë së Shërbimeve Spitalore Universitare të Fondit, emërohet nga drejtori i drejtorisë”.

Bazuar në kompetencën e mësipërme, Komisioneri vlerëson se, Drejtori i DAPSHET ka tagrin ligjor për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës të punonjësve në varësi por nuk ka kompetenca ligjore për emërimin apo transferimin e punonjësve pranë FSDKSH.

Mbështetur në analizimin e fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se nuk ndodhemi në kushtet e trajtimit të pabarabartë të ankuesit, në krahasim me punonjës të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme, me të, nga ana e Drejtorisë së Administrimit të Paketave Shëndetësore dhe Ekzaminimeve Terciare.

F. A., i është nënshtruar një qëndrimi të pabarabartë dhe disfavorizues nga ana e FSDKSH, pasi mosmarrja në shqyrtim e kërkesës së tij për transferim në Sektorin e Kontrollit Spitalor në Fond, dhe pretendimit të tij për diskriminim në këtë shkresë, ka rezultuar se ka privuar subjektin ankues për të vazhduar marrëdhëniet e punësimit pranë Fondit.

Komisioneri vlerësoi se procesi i emërimit të punonjësve të Sektorit të Kontrollit të Spitaleve dhe mos marrja në shqyrtim e kërkesë/ankesës së F. A., ka qenë për shkak të bindjes politike të ankuesit. Gjithashtu, nga krahasimi me punonjësit e tjerë që rezultuan fitues gjatë procesit të konkurrimit me dosje për pozicionet, Specialist Ekonomist në Sektorin e Kontrollit të

Spitaleve pranë Drejtorisë së Kontrollit të Fondit, rezulton se H. T., i cili është në kushte të njëjta me ankuesin, në periudhën 2003-2007 ka qenë Kryetar Komune, i zgjedhur nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Në kushtet kur, nga ana e FSDKSH, nuk u arrit të provohej një përligjje e arsyeshme dhe objektive, lidhur me mos shqyrtimin e kërkesës së F. A., për trajtim diskriminues, dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja, Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e FSDKSH, pikërisht për shkak të bindjes së tij politike.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, të shtetasit F. A., nga ana e FSDKSH, për shkak të bindjes politike.

Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit F. A., nga ana e DAPSHET (ish DSHSUKS), për shkak të bindjes politike.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e FSDKSH të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me F. A..

20. E. M., kundër Shoqërisë “Ujësjellës Kanalizime Mat” sh.a., (UK Mat)

VENDIM NR. 94, DATË 05.04.2018

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Shoqërisë UK Mat sh.a., nga viti 2013 deri në vitin 2016. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit dhe ristrukturimit të Shoqërisë, ankuesi me Vendimin nr.34, datë 16.08.2016, është njoftuar për lirimin e tij nga detyra e K/Degës Ekonomike dhe emërimin e tij në pozicionin si Specialist Finance, për shkak të bindjeve të tij politike.

FAKTET

Ankuesi është punësuar pranë UK Mat sh.a, me datën 01.04.2013, me Vendimin e Administratorit, në pozicionin “Kryetar i Degës Ekonomike”.

Me VKM Nr. 63, datë 27.01.2016, është vendosur riorganizimi e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura në Republikën e Shqipërisë, sipas ndarjes së re administrativo-territoriale, në përputhje me Ligjin Nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, duke ju transferuar bashkive të gjitha aksionet e shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve sh.a.

Me Vendimin të Kryetarit të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë UK Mat, është vendosur shkarkimi i P. S., si Administrator i shoqërisë dhe me Vendim të mëpasshëm, datë 12.04.2016 është vendosur emërimi i A.L., në detyrën e Administratorit të Shoqërisë UK Mat sh.a.

Në datë 14.07.2016, administratori i Shoqërisë UK Mat sh.a, ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për zgjidhje të kontratës së punës” për E. M., me motivacionin “Thyerje të rëndë të disiplinës në punë”, për moszbatim të Urdhrit të Administratorit të Shoqërisë, vërejtje e cila është kundërshtuar nga ankuesi, duke kërkuar revokimin e vendimit të administratorit të shoqërisë, ankesë e cila nuk ka marrë përgjigje.

Në vijim, E. M., është njoftuar për lirimin e tij nga detyra e K/Degës Ekonomike dhe emërimin e tij në pozicionin si Specialist Finance për shkak të ristrukturimit të Shoqërisë “UK Mat” sh.a në zbatim të strukturës së re të shoqërisë.

E. M., ka kundërshtuar aktin “Për lirim-emërim punonjësi” në të cilin ka cituar në mënyrë të qartë se po diskriminohet nga ana e Shoqërisë “UK Mat” sh.a.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr.115/2014, “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.
- VKM Nr. 63, datë 27.01.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

KONKLUZIONE

Komisioneri vlerëson se, ndryshimi i pozicionit të punës të ankuesit nga K/Degës Ekonomike në Specialist Finance, i ka ndryshuar atij në thelb dy nga elementët thelbësorë të kontratës së punës: pozicionin e punës dhe pagën. Ndryshimi i këtyre kushteve është bërë në mënyrë të njëanshme, pa pëlqimin me shkrim të ankuesit, i paargumentuar dhe për më tepër në dëm të tij.

Shoqëria “UK Mat sh.a” duhet të sillte prova dhe parashtrime që të provonin të kundërtën e pretendimeve të ankuesit. Mirëpo, gjatë komunikimit shkresor me zyrën e Komisionerit, Shoqëria “UK Mat sh.a” nuk ka arritur të argumentojë (kriteret e përdorura) se si ka arritur në përfundimin e caktimit të E. M., në postin e specialistit dhe jo në pozicionin e shefit të sektorit apo të faktojë studimin mbi vendosjen e kategorive të pagave, por ka theksuar faktin se Shoqëria “UK Mat sh.a” nuk ka patur dijeni për bindjet politike të E. M., duke qenë se një dokument i tillë nuk cilësohet në dosjen personale të punonjësve.

Gjithashtu, shoqëria “UK Mat sh.a” nuk ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin apo studimin që është kryer mbi ristrukturimin e shoqërisë dhe kriteret e përdorura për përzgjedhjen e punonjësve që do ndryshonin pozicionin e punës për shkak të ristrukturimit, në mënyrë që të provonte se emërimi në detyrën e specialistit të E. M., është bërë për shkaqe të arsyeshme dhe jo për shkak të bindjes politike të E. M..

Komisioneri vlerëson se të gjitha pasojat negative në marrëdhënien e punësimit mes subjektit ankues dhe punëdhënësin A. L., kanë ardhur pas ndryshimit të administrimit të Shoqërisë “UK Mat” sh.a nga P.S., drejt pushtetit lokal dhe konkretisht drejt Bashkisë Mat e cila pas zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015 drejtohet nga një përfaqësues i subjektit politik “Partia Demokratike e Shqipërisë” dhe administratori i shoqërisë A. L., është emëruar nga Kryetari i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë UK Mat.

Nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, paligjshmëria e veprimeve apo mos veprimeve nga ana e Shoqërisë “UK Mat sh.a” në dëm të ankuesit, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, nga ana profesionale, duke e zbritur në detyrë dhe nga ana financiare duke e zbritur ndjeshëm në pagë.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7, pika 1¹⁰, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se E. M., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Shoqërisë “UK Mat sh.a”, trajtim i cili ka lidhje me bindjet e tij politike.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit E. M., nga ana e Shoqërisë “Ujësjellës Mat” sh.a, për shkak të bindjes politike.

¹⁰ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

21. D. Q., kundër Spitalit Rajonal “Omer Nishani” Gjirokastrë (SRGJ)

VENDIM NR. 81, DATË 19.03.2018

Shkaku: Bindjet politike, për shkak të ankimeve pranë KMD-së
Forma: Diskriminim në formën e viktimizimit
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë SRGJ në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Teknologjisë. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit, ankuesi fillimisht është zbritur në detyrë dhe pas ankimit tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është larguar nga detyra, për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Subjekti ankues në datë 26.05.2014 ka filluar punë pranë SRGJ në pozicionin si Specialist IT dhe në datë 03.02.2016 është emëruar në pozicionin Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Teknologjisë dhe Informacionit.

Subjekti ankues, në datë 21.07.2017 është ulur në detyrë nga pozicioni, Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit dhe Teknologjisë dhe Informacionit në pozicionin Operator në Sektorin e IT-së dhe ka kaluar përkohësisht në funksion të Sektorit Teknik, me arsyetimin se në Sektorin e IT-së, nuk ka qenë eficient.

Ankuesi i ka kërkuar Përgjegjësit të Sektorit Teknik, ku ishte kaluar me Urdhërin e sipërcituar, që t'i përcaktohej qartë puna dhe detyrat që duhej të kryente në këtë sektor.

Më pas, me shkresë zyrtare, ankuesi i është drejtuar Drejtorisë së Spitalit, duke i kërkuar t'i jepej fund sjelljes diskriminuese dhe të padrejtë ndaj tij.

Me shkresën nr. 494, datë 22.12.2017, Drejtori i Spitalit Rajonal Gjirokastrë ka urdhëruar lirim të menjëhershëm nga detyra të D.Q.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri dhe kronologjia e ngjarjeve, rezultoi se, të gjitha lëvizjet e pozicioneve të punës janë bërë në dëm të subjektit ankues duke përkeqësuar situatën e tij profesionale dhe ekonomike. Komisioneri konstaton se ai është kaluar nga një pozicion në tjetrin duke u ulur në detyrë, pa pasur asnjë masë disiplinore ndaj tij dhe në kundërshtim me arsimimin e tij.

Përfundimisht, ai është larguar nga puna, dhe lidhur me këtë, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, nuk ka sjellë asnjë argumentim që të përligjë këtë veprim. Komisioneri konstaton se SRGJ, jo vetëm nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të parashikuar në Ligjin Nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, duke mos marrë asnjë masë për të rregulluar situatën, por përkundrazi, e ka përkeqësuar atë deri në largimin përfundimtar të ankuesit nga puna.

Komisioneri konstaton se SRGJ e ka diskriminuar ankuesin në formën e viktimizimit, (për shkak se pasojat në dëm të ankuesit nga ana e SRGJ kanë ardhur pas depozitimit të ankesës së tij pranë KMD-së). Lidhur me këtë, Komisioneri vëren se, pasojat rënduese në vijim apo masat e ndërmarra nga SRGJ kanë ardhur kryesisht pas datë së depozitimit të ankesës dhe kanë ardhur si rezultat i këtij ankimimi.

Komisioneri gjen të pa arsyetuar dhe në shkelje të ligjit të gjitha masat përkeqësuese të ndërmarra në dëm të ankuesit, gjë që ka çuar në trajtim të disfavorshëm të tij.

Për sa më sipër, Komisioneri gjen të provuar dhe të mbështetur në argumente bindëse dhe në ligj, se bindjet politike të ankuesit dhe ankimimi pranë KMD-së kanë çuar në trajtimin e pafavorshëm, të padrejtë dhe të paligjshëm të tij, nga ana e punëdhënësit, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë. Komisioneri vlerëson se D. Q., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe në formën e viktimizimit për shkak të ankimimit pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të D. Q., nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

22. A. B., kundër Postës Shqiptare sh.a dhe Filialit të Postës Shqiptare sh.a Berat

VENDIM NR. 154, DATË 18.07.2018

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Postës Skrapar në pozicionin K/Degë. Pas ndryshimit të Drejtuesit të Postës Shqiptare, ankuesit i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, për shkak se ishte anëtar i LSI-së.

FAKTET

Ankuesi A. B., është emëruar nga Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a në pozicionin K/Degës në Degën e Postës Skrapar pranë Filialit të Postës sh.a Berat.

Drejtori i Filialit të Postës Berat, bazuar në Vendimin e Drejtorisë së Shoqërisë “Mbi zgjidhjen e menjëhershme të marrëdhënieve të punës dhe ato financiare me Posta Shqiptare sh.a të A.B., ... etj” ka urdhëruar: “1. Zgjidhjen e Kontratës të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare të A. B., me detyrë Kryetar i Degës së Postës Skrapar, pranë Filialit të Posta Shqiptare sh.a Berat”.

Me shkresën dërguar pranë zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Posta Shqiptare sh.a, në mes të tjerash sqaroi se: “Zgjidhja e kontratës individuale të punës të A. B., është bërë për shkaqe të justifikuara të cilat i njeh ligji. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me A.B., është marrë si pasojë e humbjes së besimit nga punëdhënësi të punëmarrësi, pas mosrealizimit të fitimeve, dhe rritjes të pajustificuar të shpenzimeve nga Dega e Postës Skrapar, duke sjellë një keq menaxhim financiar”.

Në nenin 15/a të Kontratës së Punës datë 05.03.2014 të lidhur mes Drejtorisë së Përgjithshme të Postës Shqiptare dhe A. B., shkruhet: “Zgjidhja e menjëhershme. a. Punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë kontratën në mënyrë të menjëhershme edhe kur kontrata është pa afat, kur ka shkaqe të arsyeshme, (të vlerësuara nga ai si të tilla) dhe kur këto shkaqe lidhen direkt me mosrespektimin e kushteve dhe afateve të kontratës nga pala tjetër.....”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.

- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Nga verifikimet e bëra në dokumentacionin e dërguar nga palët nuk rezulton se ndaj A. B., të jetë marrë ndonjë vërejtje apo masë disiplinore, apo të jetë konstatuar dëm financiar nga organet përkatëse po ashtu nuk ka vlerësime të performancës në punë për punonjësin A. B.

Komisioneri vlerëson se argumenti i Postës Shqiptare se vendimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me A. B., është marrë pas mosrealizimit të fitimeve dhe rritjes të pajustificuar të shpenzimeve nga Dega e Postës Skrapar, duke sjellë keqmenaxhim financiar, nuk qëndron pasi nga ana e punëdhënësit, Posta Shqiptare sh.a dhe Filiali Berat nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë provë për të faktuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me A. B., është bërë për shkak të keqmenaxhmit financiar të Degës së Postës Skrapar, për më tepër që nga ana e punëdhënësit nuk është zhvilluar një procedurë administrative në të cilën të evidentoheshin shkeljet e sipërcituara dhe që punëmarrësi të ishte në gjendje të parashtronte argumentet e tija.

Për sa më lart, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për largimin e ankuesit nga puna konstaton se ankuesi është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe se masa e marrë për largimin e tij nga puna është e pajustificuar dhe e pa argumentuar ligjërisht.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se A. B., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a dhe Filiali Berat, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit A. B., nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a dhe Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat, për shkak të bindjes politike.

Në referim të pikës 1, Posta Shqiptare sh.a dhe Filiali i Postës Shqiptare sh.a Berat, si subjekte që kanë konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e A. B., në vendin e mëparshëm të punës.

23. SH. S., kundër Postës Shqiptare sh.a, Filiali Mat.

VENDIM NR. 241, DATË 27.11.2018

Shkak: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë Postës Shqiptare, Filiali Mat në pozicionin si punonjës shërbimi në Zyrën Postare Koms. Pas ndryshimit të Drejtuesit të Filialit të Postës Mat, ankuesi fillimisht i është ndryshuar pozicioni i punës dhe më pas i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, për shkak se ishte anëtar i LSI-së.

FAKTET

Ankuesi SH. S., është emëruar nga Shoqëria “Posta Shqiptare” sh.a Filiali Mat në pozicionin si punonjës shërbimi në Zyrën Postare Koms.

Në datë 10.11.2017, me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare sh.a, A.B është emëruar “Drejtör” në Filialin e Postës Mat.

Në datë 19.12.2017, Drejtori i Filialit të Postës Mat, A. B., ka urdhëruar kalimin e ankuesit nga pozicioni “Kryetar i Zyrës Postare” Koms në pozicionin “Punonjës me kohë të pjesshme”.

Drejtori i Filialit të Postës Mat ka njoftuar Sh.S., mbi fillimin e procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës bazuar në Kodin e Punës.

Drejtori i Filialit të Postës Mat, që në datë 16.11.2017 ka qenë në djeni të shkresës në të cilën është kërkuar informacion për rishikimin e strukturës dhe që nuk duhet të kishte punonjës me kohë të pjesshme dhe përsëri në datë 19.12.2017 ka urdhëruar kalimin e ankuesit në punonjës me kohë të pjesshme.

Ankuesi është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare pas afatit të njoftimit 2 mujor, në datë 12.03.2018. Sh. S., duke mos rënë dakord me vendimmarrjet e njëpasnjëshme, duke i quajtur të marra në kundërshtim me ligjin, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm me një ankesë administrative në të cilën ka shprehur pretendimet e tij.

Subjekti ankues është njoftuar për revokimin e shkresës Nr. 566/1, datë 12.01.2018, “Njoftim për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës” duke e kthyer dhe njëherë Sh. S., në punonjës me kohë të plotë.

Drejtori i Filialit të Postës Mat, më pas, ka dhënë masën disiplinore “Vërejtje me shkrim” për punonjësin Sh. S., me motivacionin për mospërbushje së detyrave në kohë dhe efektivitet, sikurse ka rezultuar nga niveli i ulët i volumit të të ardhurave nga shërbimi i arkëtimit të faturave të OSHEE.

Filiali i Postës Mat, ka organizuar programe kontrolli të njëjtë me Zyrën Postare Komsi dhe në Zyrat Postare, Macukull, Xibër, Fushë Bulqizë dhe Shupenzë në të cilat janë konstatuar parregullsia të ngjashme me parregullsitë e konstatuara në Zyrën Postare Komsi. Për parregullsitë e konstatuara nga grupi i kontrollit në këto zyra, nga ana e Drejtorit të Filialit të Postës Mat është marrë masa e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës për punonjësit, Sh. S., Zyra Postare Koms, H. G., Zyra Postare Macukull, D. S., Zyra Postare Xibër, të gjithë këto anëtarë të subjektit politik LSI dhe masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për punonjësit E. D., Zyra Postare Fushë Bulqizë dhe A. N., Zyra Postare Shupenzë.

Sh.S është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në mënyrë të menjëhershme për shkaqe të justifikuara për parregullsi dhe mospërbushje të detyrës në kohë, cilësi e efektivitet.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Pas zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017, në të cilat u shpall fituese subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë, A. B., u emërua “Drejtör” i Filialit të Postës Mat, i cili gjatë procesit zgjedhor të vitit 2017 ishte aktivizuar si anëtar i propozuar nga subjekti politik, Partia Socialiste në Komisionin e Qendrës së Votimit Nr. 0946, të KZAZ Nr.16 të Qarkut Dibër.

Vetëm për punonjësit, Sh. S., D. S., dhe H. G., si anëtarë të subjektit politik LSI në periudhën dhjetor 2017, ishte marrë masa e kalimit nga punonjës me kohë të plotë në punonjës me kohë të pjesshme, pavarësisht se Drejtör i Filialit të Postës Mat që në datë 16.11.2017 ka qenë në dëgjim të shkresës Nr. 3533 në të cilën është kërkuar informacion për rishikimin e strukturës dhe që nuk duhet të kishte punonjës me kohë të pjesshme.

Gjatë muajit Shkurt 2018 janë organizuar programe kontrolli vetëm për Zyrat Postare, Koms, Xibër dhe Macukull ku kanë qenë të punësuar anëtarë të subjektit politik LSI, ndërkohë që programet e tjera të kontrollit janë organizuar pas një periudhe kohore pesë dhe gjashtë mujore. Në lidhje me këtë, për të provuar se ka pasur planifikim dhe një grafik për organizimin e kontrolleve në 38 zyrat postare në varësi, Filiali i Postës Mat nuk solli prova

për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se organizimi i programit të kontrollit ka qenë tendencioz dhe është bërë për largimin e tij nga puna.

Në ndryshim për shkeljet e konstatuara nga grupet e kontrollit për punonjësit Sh. S., D. S., dhe H. G., është marrë masa disiplinore e largimit nga puna ndërsa për punonjësit E. D., dhe A. N., është marrë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”.

Komisioneri gjykon se në rastin e punonjësit Sh.S, rezulton një shkelje e Akt-Marrëveshjes të lidhur mes ISSH Tiranë dhe Postës Shqiptare sh.a, por nga ana tjetër nga vetë punëdhënësi për rastet e shkeljeve të të njëjtës natyrë, të konstatuar në Zyrat Postare Fushë Bulqizë dhe Shupenzë është marrë masë disiplinore më e lehtë, gjë që vlerësohet se dhe në rastin e Sh. S., nga ana e Filialit të Postës Mat mund të ishte marrë masë disiplinore më e lehtë dhe jo largim nga puna.

Komisioneri vlerëson se të gjitha veprimet e kryera në dëm të ankuesit janë bërë pas emërimit të A. B., si drejtues i Filialit të Postës Mat.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, Filiali i Postës Mat nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se kalimi në punonjës me kohë të pjesshme, organizimi i programit të kontrollit dhe largimi nga puna, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së tij politike.

Nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, veprimet e kryera nga ana e Filialit të Postës Mat në dëm të ankuesit, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, nga ana profesionale dhe morale.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se Sh. S., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Filialit të Postës Mat, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit Sh. S., nga ana e Filialit të Postës Shqiptare sh.a Mat, për shkak të bindjes politike.

Në referim të pikës 1, Filiali i Postës Shqiptare sh.a Mat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e Sh. S., në vendin e mëparshëm të punës.

24. P. V., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUT)

VENDIM NR. 162, DATË 14.08.2018

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë QSUT në pozicionin mjek. Për shkak të denoncimeve të bëra në media, lidhur me problematikat që paraqiten në menaxhimin dhe furnizimin me medikamente të pavioneve të ndryshme të QSUT-së, është larguar nga puna.

FAKTET

Ankuesi P. V., që nga viti 1989 ka qenë në marrëdhënie punësimi pranë QSUT në pozicionin si mjek.

Subjekti ankues njoftohet nga QSUT për zhvillimin e një takimi në lidhje me situatën e ndodhur në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme në datë 17.08.2017. Në datë 07.09.2017 është zhvilluar takimi ndërmjet subjekteve, në të cilën palët kanë parashtruar argumentet e tyre.

QSUT i është adresuar Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë për kompetencë e vendimmarrje, i cili në përgjigjen e tij ka informuar QSUT-n se ka filluar praktikën e shqyrtimit të ankesës.

Komisioni Disiplinor Profesional i Këshillit Rajonal Tiranë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga QSUT kundrejt anëtarit të UMSH-së, P. V., për shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, gjatë ngjarjes së datës 17.08.2017 dhe pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga palët, ka vendosur shpalljen të pafajshëm të P. V.

Vendimi i mësipërm është marrë në shqyrtim dhe nga Komisioni i Gjyimit Disiplinor Profesional i Shkallës së Dytë (Apeli), i cili ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

P. V., është vënë në dijeni për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në datë 29.12.2017, për moskryerje të detyrave funksionale, sipas së cilës mjeku i shërbimit mjekësor në QSUT: *“Përgjigjet për realizimin e plotë dhe në kohë të protokolleve të mjekimit dhe të procedurave të tjera të caktuara për të sëmurët e tij” si dhe në shkelje të nenit 2/2 të Kodit Etik: “Të gjithë pacientët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, me standard të njëjtë duke parandaluar çdo qëndrim diskriminues. Duhet të shmangen sjellje të paqarta dhe të dyshimta”.*

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.

- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Rregullore për Gjykimin Disiplinor Profesional të miratuar me Vendimin nr.1, datë 08.04.2016 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Komisioneri vlerëson se të gjitha pasojat negative deri në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës mes subjektit ankues dhe punëdhënësin QSUT, kanë ardhur pas qëndrimeve publike të mbajtura nga P. V., dhe pas kandidimit të tij në zgjedhjet e vitit 2017 për subjektin politik LSI.

Bazuar në legjislacionin mbi Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë, Komisioneri vlerëson se organi që ka kompetencën kryesore për vlerësimin profesional dhe etik të mjekëve janë Komisionet Disiplinore të Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë.

Komisioneri vlerëson se, duke patur në vëmendje profilin publik dhe veprimtarinë politike të P. V., drejtuesit e QSUT janë shpejtuar në marrjen e vendimit për shkëputjen e marrëdhënieve të punës me P. V., pasi në zbatim të kompetencave ligjore mund të kishin pritur vendimin përfundimtar të Komisioneve Disiplinore të Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë dhe pastaj bazuar në gjetjet dhe konstatimet e Komisioneve Disiplinore mund të kishin ndërmarrë veprime në drejtim të mjekut P. V.

Komisioneri ka bindjen se fakti që QSUT nuk ka marrë për bazë dhe mendimet profesionale të mjekëve të repartit ku ka ndodhur ngjarja, tregon veprimet tendencioze dhe të shpejta të QSUT për të zgjidhur marrëdhëniet e punës me P. V.

Komisioneri vlerëson se nga ana e QSUT-s nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë provë për të faktuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me P. V., është bërë për shkak të moskryerjes së detyrave funksionale dhe për shkelje të Kodit të Etikës, pasi QSUT-ja dështoi për të dërguar pranë Komisionerit, kopje të protokollit të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, lidhur me trajtimin e pacientëve që paraqesin problematika psikomotore, kopje të rregullores, protokollit apo dispozitave ligjore mbi të cilën mbështeten detyrat dhe përgjegjësitë e mjekut në Triazh dhe informacionin mbi rezultatet e hetimit për të gjetur përgjegjësitë për punonjësit e tjerë gjatë ngjarjes së datës 17.09.2017¹¹.

Komisioneri vlerëson se vendimmarrja e drejtuesve të QSUT ka qenë e paarsyeshme dhe jo proporcionale pasi është bazuar më shumë në relacionin informues të punonjësve të Policisë

¹¹ Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore datë 30.11.2017.

së Shtetit se sa në opinionin dhe vlerësimet profesionale të mjekëve të repartit të urgjencës dhe Komisionit Disiplinor të Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë.

Veprimet tendencioze të QSUT në drejtim të mjekut P. V., përforcohen për më tepër dhe nga qëndrimet publike¹² të mbajtura nga ana e P. V., në lidhje kundërshtimet e politikave shëndetësore dhe mungesës së ilaçeve në spitale gjatë periudhës pas vitit 2014 dhe disa masave disiplinore të marra nga ana e QSUT në drejtim të P. V., të cilat janë kundërshtuar në gjykatë dhe i kanë dhënë të drejtë pretendimeve të P. V.

Në përfundim, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se P. V., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e QSUT, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike dhe qëndrimet publike të ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit P. V., nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, për shkak të bindjes politike.

Në referim të pikës 1, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e P. V., në vendin e mëparshëm të punës.

¹² Intervistë datë 20.01.2014 për TV Klan, emision datë 25.04.2014 në RTSH, intervistë datë 11.01.2016 për News 24, emision datë 08.02.2016 në Neës 24. Gazeta Telegraf datë 24.09.2014, Gazeta Shqiptare datë 27.10.2015, Gazeta Shëndeti datë 30.03.2017, Gazeta Telegraf datë 23.01.2017.

25. L. A., kundër Kryeinspektorit, Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastrë (ISHMPUT Gjirokastrë) dhe Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Tiranë (ISHMPUT).

VENDIM NR. 187, DATË 01.10.2018

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie pune pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë në pozicionin Përgjegjës të Sektorit të Policisë Pyjore Tepelenë. Pas ndryshimit të Drejtuesit të institucionit, ankuesi është larguar nga detyra, për shkak se ishte anëtar i LSI-së.

FAKTET

Ankuesi është emëruar në detyrën e Inspektorit në Sektorin e Policisë Pyjore në ISHMPU Gjirokastrë. Më pas është ngritur në detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Policisë Pyjore Tepelenë pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë.

Në datën 11.05.2018, ankuesit i jepet masa disiplinore “Vërejtje”, me motivacion “Moskryerja e detyrave duke braktisur aksionin “Pastrojmë tokën që duam”.

Ankuesi, me shkresën Memo, i është drejtuar Kryeinspektorit, ISHMPUT-së dhe S. R., Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, në të cilën ka shprehur kundërshtimet dhe sqarimet e tij, në lidhje me masën e marrë. Pavarësisht memos së dërguar nga ankuesi, asnjë prej Kryeinspektorëve të sipërpërmendur, nuk i ka kthyer përgjigje ankuesit.

Në datë 10.07.2018, ankuesi njoftohet për zgjidhje të marrëdhënieve të punës. Referuar shkresës në fjalë, zgjidhja e marrëdhënieve të punës ka ardhur si pasojë e moskryerjes së detyrave sipas procedurave ligjore.

Për shkeljet e përsëritura, Kryeinspektori i ISHMPUT ka urdhëruar largimin e S. R., nga detyra e Kryeinspektorit të ISHMPUT Gjirokastrë dhe vazhdimin e punës në detyrën e Inspektorit në Sektorin e Policisë Pyjore Përmet.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.

- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe shkronjën “ç”, pika 3, Kreu III, të Vendimit Nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- VKM Nr. 103, datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i ndryshuar).

KONKLUZIONE

Komisioneri nuk ka kompetencë të shqyrtojë vlefshmërinë e masave disiplinore të dhëna nga Kryeinspektori i ISHPMUT-së, por fakti që nuk është reaguar ndaj observacioneve të parashtruara nga ankuesi mbi 2 (dy) masat e para disiplinore të dhëna ndaj tij, është fakt që dëshmon për ekspozimin e L.A. ndaj një qëndrimi të padrejtë e disfavorizues, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, në kundërshtim me nenin 37, paragrafi 2, i Ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), ku parashikohet shprehimisht: *“Procedura e shqyrtimit të masës disiplinore nga punëdhënësi duhet të garantojë të drejtën e punëmarrësit për t’u dëgjuar, mbrojtur, parashtruar fakte dhe prova brenda një afati të arsyeshëm”*. Asnjë nga të drejtat e punëmarrësit nuk janë zbatuar në rastin e L. A., për dy masat disiplinore të dhëna ndaj tij.

Njëkohësisht, fakt që provon për një qëndrim të padrejtë ndaj L. A., është edhe dhënia e masave disiplinore ndaj tij, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, pa patur asnjë kompetencë për të dhënë masa disiplinore ndaj inspektorëve në varësi të tij. Në bazë të interpretimit të pikave 6/a dhe 11 të Vendimit nr. 103, datë 04.02.2015, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (i ndryshuar), kompetenca për dhënie masash disiplinore i njihet vetëm Kryeinspektorit të ISHMPUT-së. Ndërkohë që nëse i referohemi shkresës nr. 165, datë 20.04.2018, të S. R., Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, rezulton se L. A., i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”.

Komisioneri vlerëson se dhënia e masave disiplinore nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë ka qenë tendencioze për shkak të bindjeve politike të ankuesit, për të arritur në largimin e ankuesit nga puna, pavarësisht se në vijim të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe shkronjën “ç”, pika 3, Kreu III, të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë” janë vënë në dijeni nga Departamenti i Administratës Publike për shkeljet e konstatuara nga punonjësi L. A., në lidhje me zbatimin e ligjit të sipërcituar.

Gjatë komunikimit shkresor me zyrën e Komisionerit, ISHMPUT ka arritur të argumentojë lirin nga puna të punonjësit L. A., për shkak të moszbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” si dhe shkronjën “ç”, pika 3, Kreu III, të Vendimit nr.17/2016 të Kuvendit të Republikës së

Shqipërisë”, por nuk ka arritur të argumentojë qëllimin e ligjshëm të dhënies së masave disiplinore të njëpasnjëshëm ndaj punonjësit L. A.,

Nisur nga shqyrtimi i fakteve, Komisioneri gjykon se, paligjshmëria e veprimeve apo mos veprimeve nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë në dëm të ankuesit, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, nga ana profesionale dhe morale.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë nuk u sollën argumente ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se dhënia e disa masave disiplinore të njëpasnjëshme ndaj tij, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së tij politike.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se L. A., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit L. A., nga ana e Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale Gjirokastrë, për shkak të bindjes politike.

26. V. J. kundër Albpetrol sh.a.

VENDIM NR. 16, DATË 30/01/2019

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka punuar pranë Albpetrol sh.a. në pozicionin “Drejtor” i Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës. Fillimisht, ankuesja është ulur në detyrë, e në vijim është përfshirë në pushim kolektiv. V. J. është anëtare dhe aktiviste e një subjekti politik dhe ndërmarrja e veprimeve diskriminuese nga Albpetrol sh.a. ndaj saj, bëhej për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Ankuesja V. J. ka punuar pranë Albpetrol sh.a., që prej muajit nëntor 2013. Ajo ka punuar përgjatë periudhës 01.11.2013 – 14.11.2017¹³, në pozicionin “Drejtor” i Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës, pranë Albpetrol sh.a.

Në vijim, përgjatë periudhës, V. J., ka punuar në pozicionin “*specialist në dispozicion*” të Drejtorisë së Administrimit dhe Ruajtjes së Pronës.

Më pas, ankuesja është emëruar në pozicionin “*ekonomiste pagash dhe kostosh*”¹⁴ pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos. Ankueses i është dhënë masa disiplinore “vërejtje me shkrim”, në vitin 2015, në bazë të rekomandimeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, dërguar pranë Albpetrol sh.a.

Në vijim, ajo është përfshirë në pushimin kolektiv të zbatuar nga Albpetrol sh.a. V. J., është anëtare dhe aktiviste e forcës politike LSI, Fier, si dhe Kryetare e Gruas së kësaj force politike në Rajonin nr. 3, të qytetit të Fierit.

Për sa më sipër, pretendimi i ankueses, për diskriminim për shkak të bindjes politike, lidhet me momentin e uljes në detyrë dhe atë të përfshirjes në pushim kolektiv. Përveç sa më sipër, V. J., pretendon se është diskriminuar nga Albpetrol sh. a., edhe për shkak të gjendjes shëndetësore të bashkëshortit të saj, i cili ka diagnozën AVC ishemik temporal sin, kardioembolik, HTA, FA. Ndër të tjera, V. J., shprehet se kjo gjendje, bashkëshortit të saj, i ka ardhur si pasojë e stresit të përcjellë nga ana e saj në familje, për shkak të problemeve në punë. Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, ankuesja shtoi edhe pretendimin për diskriminim për shkak të moshës dhe gjendjes së saj, shëndetësore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;

¹³Referuar Vendimit Nr. 316, datë 01.11.2013. dhe Vendimit Nr. 531, datë 14.11.2017, të Administratorit të Albpetrol sh.a;

¹⁴Referuar Vendimit Nr. 72, datë 08.02.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a.

- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10.

KONKLUSIONE

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, KMD gjykoi se V. J., i është nënshtruar një qëndrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a., pasi ulja e saj në detyrë ka qenë e pamotivuar në aktin përkatës, fakt që nuk mund të konsiderohet normal, kur një shoqëri në përmasat e Albpetrol sh.a., nuk jep një motiv të mbështetur, në aktin e lëvizjes dhe uljes në detyrë të një drejtori në administratën e tij të brendshme.

Komisioneri analizoi rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, të pasqyruara në dy Raportet Përfundimtare të Auditimit ndaj Albpetrol sh.a., por në kushtet, kur akti i uljes së detyrë të ankueses nuk i është referuar Raportit të fundit të KLSH, si dhe një motivacion i tillë nuk është reflektuar në këtë akt, ky fakt nuk mund të merret në konsideratë si i mirëqenë, duke e konsideruar që ka qenë *de facto* motivacioni i munguar në aktin përkatës të nënshkruar nga Administratori i Albpetrol sh.a.

Gjatë procedurës së hetimit, Komisioneri është vënë në dijeni të faktit se V. J., është zëvendësuar nga S. K., i cili pas verifikimeve të kryera në faqen e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, rezulton se ka qenë kryetar i KZAZ-së nr. 57, në Fier, gjatë zgjedhjeve kombëtare të vitit 2017, duke përfaqësuar Partinë Socialiste. Një fakt i tillë përbën dyshim të arsyeshëm se V. J., është lëvizur nga pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Ruajtjes dhe Administrimit të Pronës” për motive politike, duke emëruar në pozicionin e saj të punës, një person, i cili ka një përkatësi partiake të forcës politike në pushtet, pavarësisht se ky individ ishte aktualisht punonjës i shoqërisë (drejtor në një nga qendrat e Albpetrol sh.a.)

Lidhur me pretendimin e ankueses se është diskriminuar për shkak të bindjes politike, pasi është përfshirë në pushimin kolektiv, të zbatuar nga Albpetrol sh.a., Komisioneri gjykoi se referuar strukturës paraardhëse dhe asaj aktuale të Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve është reduktuar me 22 të tillë. Në këtë kontekst rezulton se 22 punonjës i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna, ndër të cilët edhe V. J. Pozicioni i punës së V. J., është suprimuar dhe në kushtet, kur ky pozicion pune ka qenë i vetëm, V. J., nuk i është nënshtruar vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit. Në kushtet e zbatimit të një procesi madhor ristrukturimi, nëpërmjet së cilit iu nënshtruan pushimit kolektiv rreth 450 punonjës të Albpetrol sh.a., Komisioneri gjykon se Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankueses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Komisioneri i gjeti të pambështetura pretendimet e ankueses, për shkaqet e tjera të pretenduara nga ana e saj.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të *“bindjes politike”*, të V. J., nga ana e Albpetrol sh.a., si pasojë e transferimit të saj nga Drejtore e Drejtorisë së Ruajtjes dhe Administrimit të Pronës, në një pozicion hierarkisht më të ulët, pranë Qendrës së Emergjencave dhe Mjedisit, Naftë dhe Gaz, Patos (Q.E.M.N.G. Patos).

Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të *“bindjes politike”*, *“moshës”* dhe *“gjendjes shëndetësore”*, së V. J., nga ana e Albpetrol sh.a., si pasojë e përfshirjes së saj në pushimin kolektiv të zbatuar nga kjo shoqëri.

Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të *“gjendjes shëndetësore të bashkëshortit”*, së V. J., nga ana e Albpetrol sh.a.

27. F. Y. kundër Albpetrol sh.a.

VENDIM NR. 141, DATË 04.10.2019

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

F. Y. ka punuar pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a., në pozicionin operator injektimi uji, pranë Q.P.N. Fier. Ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë shoqëri, si pasojë e shkurtimit të vendit të punës. F. Y., është anëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe është diskriminuar për shkak të bindjes politike nga ana e Albpetrol sh.a.

FAKTET

F. Y., ka qenë punonjës i Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. nga viti 1979 dhe së fundmi ka mbajtur pozicionin e punës “operator injektimi uji” pranë Qendrës së Prodhimit të Naftës, Fier.

Ankuesi ka përfunduar Shkollën Teknike të Naftës në Ballsh përgjatë viteve 1971-1975, si dhe ka punuar për shumë vite në pozicione drejtuese në Sektorët e Naftës pranë kësaj shoqërie. F. Y., ka një eksperiencë 40 vjeçare në këtë fushë.

Në zbatim të Programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, kjo shoqëri ka ndërmarrë hapat për reduktimin e fuqisë punëtore në këtë sektor. Mbështetur në Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Albpetrol sh.a., si dhe në Vendimin e Administratorit të shoqërisë, struktura organizative e Qendrës së Prodhimit të Naftës fier nga 406 punonjës u bë 286 punonjës. Në vijim, struktura e Sektorit Ballsh-Hekal, si pjesë e kësaj qendre, me dorëzimin e vendburimit të naftës nga 143 vende pune u bë 23 vende pune.

Pas dorëzimit të vendburimit të naftës, 88 ish-punonjës të Sektorit Ballsh-Hekal u punësuan nga Koncesionari, Shoqëria “Anio Oil” sh.a., përzgjedhja e të cilëve është kryer nga vete Koncesionari. Ndërkohë që, 22 punonjës të këtij sektori iu nënshtruan pushimit kolektiv, sikurse edhe ankuesi. Nga 3 (tre) punonjës, që punonin në pozicionet “operator injektimi uji” pranë Sektorit Ballsh-Hekal, 2 (dy) të tillë i janë nënshtruar pushimit kolektiv, ndërkohë që punonjësi A. I., është transferuar në një pozicion tjetër pune dhe nuk i është përfshirë në pushim kolektiv. Transferimi i A. I., është kryer zyrtarisht pikërisht 3 ditë para se kolegut të tij, që punonte në pozicion analoge me të.

Në fund të muajit shtator 2018, ankuesi F. Y., është njoftuar për ndërprerjen të marrëdhënieve të punës me Albpetrol sh.a., për shkak të ristrukturimit të shoqërisë dhe në vijim atij i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me këtë shoqëri, si pasojë e shkurtimit të pozicionit të tij, të punës “operator injektimi uji”, në Sektorin e Prodhimit të Naftës Ballsh-Hekal, pranë Q.N.P. Fier.

Për sa më sipër, ankuesi pretendon se ai i plotësonte të gjitha kriteret për të qëndruar në punë dhe për t’u mos përfshirë në ristrukturim, por Albpetrol sh.a. e ka larguar nga puna, për shkak të bindjeve të tij, politike, të djathta.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), si dhe neni 33, pika 10.

KONKLUSIONE

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se F. Y., i është nënshtruar një qendrimi të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë në krahasim me punonjës të tjerë, të Sektorit Ballsh-Hekal, që ndodheshin në kushte të njëjta me të, nga ana e Albpetrol sh.a.

F. Y., i është nënshtruar pushimit kolektiv, për shkak të ristrukturimit të Sektorit Ballsh-Hekal, si pasojë e dorëzimit të vendburimeve të naftës një shoqërie koncesionare, ndërkohë që kolegu i tij, që punonte në të njëjtin pozicion pune, A. I., është transferuar nga Administratori i Albpetrol sh.a., vetëm pak ditë nga fillimi i procedurave për pushim kolektiv, në një pozicion tjetër pune (që nuk u suprimua) brenda të njëjtit Sektor.

Komisioneri ka konstatuar një trajtim të pabarabartë ndërmjet dy individëve që ndodhen në kushte të njëjta, ndërkohë që Albpetrol sh.a., i cili në bazë të nenit 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)¹⁵, ka patur barrën e provës për të provuar se subjekti ankues nuk është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të disfavorshme dhe të pabarabartë, për shkak të bindjeve politike, nuk e ka kryer një gjë të tillë.

Albpetrol sh.a. depozitoi dosje të mangëta të të tre ish-operatorëve të injektimit të ujit pranë Sektorit Ballsh-Hekal dhe nuk dërgoi pranë KMD-së, asnjë dokument apo akt administrativ, që të justifikonte faktin e transferimit të A. I., nga operator injektimi uji, në operator prodhimi pranë të njëjtit sektor, vetëm disa ditë para fillimit të procedurave për pushim kolektiv të dy punonjësve të tjerë, që punonin në të njëjtat pozicione pune.

Njëkohësisht, Albpetrol sh.a. depozitoi një vlerësim pune të viti 2019, për F. Y., por nuk depozitoi vlerësimet e punës për 2 punonjësit e tjerë, në mënyrë që Komisioneri të evidentonte treguesit e performancës, si dhe të kryente një krahasim të performancës në punë ndërmjet dy operatorëve të injektimit të ujit, që iu nënshtruan pushimit kolektiv dhe A. I., i cili ende punon pranë Sektorit Ballsh-Hekal.

¹⁵ Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e procedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

Për sa më sipër, mos dhënia e argumentimit përkatës nga ana e Albpetrol sh.a., në lidhje me lëvizjen e A. I., në pozicionin e operatorit të prodhimit, ndërkohë që ankuesi iu nënshtrua pushimit kolektiv, si dhe mos dërgimi i informacionit të plotë, lidhur me dosjet e ish-punonjësve “operatorë injektimi uji” pranë Sektorit Ballsh-Hekal, pavarësisht insistimit të Komisionerit, krijon dyshimin e arsyeshëm që F. Y., diskriminohet për shkak të bindjes së tij politike.

Komisioneri gjykon se Shoqëria Albpetrol nuk ka depozituar prova, fakte dhe argumentime bindëse, nëpërmjet së cilave të provohej e kundërta e pretendimeve të ankuesit F. Y., Në këto kushte KMD, çmon se ankuesi është diskriminuar për shkak të bindjes politike.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, të F. Y., për shkak të bindjes politike, nga Albpetrol sh.a.

Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, Albpetrol sh.a. të marrë masa të menjëhershme, për punësimin e F. Y., në një pozicion pune brenda kësaj shoqërie.

28. A. D., kundër S. R., Kryeinspektor (i komanduar) pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizimit, Dega Gjirokastër (ISHMPUT).

VENDIM NR. 219 , DATË 23/10/2018

Shkak: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi, i cili punon si Inspektor pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër, ka marrë disa masa disiplinore nga ana e Kryeinspektorit të komanduar të këtij institucioni, për shkak të bindjes politike.

FAKTET

A. D., ka filluar punë pranë Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujrave dhe Turizmit, në datën 11.05.2017, në pozicionin e Përgjegjës të Sektorit të Policisë Pyjore Përmet, pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër. Në vijim, ai transferohet në pozicionin e Inspektorit të Sektorit të Policisë Pyjore Tepelenë, pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër.

Kryeinspektori (i komanduar në detyrë), pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastër, në datë 20.04.2018, jep masë disiplinore “vërejtje”, me motivacion “*moskryerje e detyrave duke braktisur aksionin “pastrojmë tokën që duam”*” për 10 (dhjetë) inspektorë të ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër, përkatësisht për inspektorët, S. Z., A. D., B. S., L. A., Y. S., E. P., E. K., T. G., S. R., A. S, ndër të cilët edhe për inspektorin A. D.

Në vijim, Kryeinspektori i ISHMPUT, në Nivel Qendror, i jep A. D., masën disiplinore “vërejtje”, me motivacion “*moskryerje e detyrave duke braktisur aksionin “pastrojmë tokën që duam”*”.

Nëpërmjet Memos datë 17.05.2018, A. D., i është drejtuar A. L., Kryeinspektor (i komanduar në detyrë), pranë ISHMPUT-së, në nivel qendror dhe S. R., Kryeinspektor (i komanduar në detyrë) i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër, ku shpreh kundërshtimet dhe sqarimet e tij, në lidhje me masën e marrë. Pavarësisht memos së dërguar nga ankuesi, asnjë prej Kryeinspektorëve të sipërpërmendur, nuk i kthen përgjigje A. D.

Në vijim, sërish në datën 17.05.2018, A. D., i jepet masa disiplinore “tërheqje vëmendjeje”¹⁶, nga ana e eprorit të tij, direkt, S. R., Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër. Motivacioni i masës së dhënë është “*komunikim jo korrekt me eprorin*”.

¹⁶ Masa disiplinore i është dhënë nëpërmjet shkresës nr. 252, datë 17.05.2018, të S. R., Kryeinspektor i ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastër.

A. D., e informon me e-mail Kryeinspektorin e ISHPMUT në nivel qendror, mbi këtë masë të dhënë ndaj tij, duke theksuar faktin se është dërguar për inspektim në Tepelenë, fillimisht nëpërmjet një urdhëri verbal nga ana e eprorit të tij direkt, S. R., dhe në vijim pas kërkesës së ankuesit, i është vënë në dispozicion autorizimi për inspektim. Pas kthimit të tij në punë, në të njëjtën ditë, A. D., është informuar mbi këtë masë disiplinore që i është dhënë nga eprori direkt. Pavarësisht e-mailit të dërguar nga A. D., në adresë të ISHPMUT, në Nivel Qendror, ky institucion nuk pati asnjë reagim zyrtar mbi çështjen e parashtruar nga ankuesi.

A. D., pretendon se ai i ka kryer me korrektësi të gjitha detyrat e ngarkuara nga eprori, por të gjitha masat disiplinore e marra ndaj tij, kanë ardhur si rrjedhim i diskriminimit që atij po i bëhet për shkak të bindjeve të tij, politike, të cilat janë të ndryshme nga ato të titullarit të tij.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10.

KONKLUZIONE

Komisioneri konstaton se se nuk ka asnjë parashikim specifik dhe të qartë, lidhur me çështjen e dhënies së masave disiplinore për punonjësit e ISHPMUT-së, në nivel qendror apo edhe në degët rajonale, fakt që u pohua edhe nga strukturat përkatëse të Sektorit të Burimeve Njerëzore, pranë ISHMPUT-së, në Nivel Qendror, të cilat theksuan faktin se, dhënia e masave disiplinore është tagër e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në Nivel Qendror, pas marrjes së propozimit për masë disiplinore nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së në nivel vendor. Ky fakt provon për një qëndrim të padrejtë ndaj A. D., është dhënia e masave disiplinore ndaj tij, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, pa pasur asnjë kompetencë për të dhënë masa disiplinore ndaj inspektorëve në varësi të tij.

Komisioneri gjykon se fakt mbështetës i qëndrimit të padrejtë ndaj ankuesit është edhe se S. R., me detyrë Kryeinspektor i komanduar pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, i është tërhequr vëmendja zyrtarisht nga ISHPMUT, në nivel qendror, pasi ai nuk ka të drejtë vendimmarrjeje për dhënie masash disiplinore ndaj inspektorëve, që ka patur në varësi. Në referencë të nenit 109, germa a), të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, aktet e nxjerra nga S. R., në mungesë të kompetencës ligjore, konsiderohen të paligjshme. Në raste të tilla zbatohen parashikimet e nenit 110, germa b) të ligjit të sipërpërmendur, ISHPMUT, në nivel qendror, në cilësinë e organit epror, duhet të kishte shpallur pavlefshmërinë absolute të akteve të sipërpërmendura.

Pavarësisht sa më sipër, ISHMPUT, në nivel qendror, mbështetur në ankesat e punonjësve të ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, ka kryer verifikimet përkatëse dhe ka marrë masa

ndaj S. R., duke i tërhequr vëmendje dhe duke e ulur në detyrë. Ndërkohë që masa e fundit disiplinore e propozuar ndaj A. D., nga ana e S. R., nuk është zbatuar dhe ankuesi punon ende në pozicionin e tij të punës.

Komisioneri konstaton gjithashtu që nuk është reaguar ndaj observacioneve të parashtruara nga ankuesi mbi 2 (dy) masat e para disiplinore të dhëna ndaj tij, është fakt që dëshmon për ekspozimin e A. D., ndaj një qëndrimi të padrejtë e disfavorizues, nga ana e Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë dhe Kryeinspektorit të ISHMPUT-së, në nivel qendror, në kundërshtim me nenin 37, paragrafi 2, i ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar). Asnjë nga të drejtat e punëmarrësit nuk janë zbatuar në rastin e A. D., për dy masat e para disiplinore të dhëna ndaj tij.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë nuk u depozituan argumente dhe prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit, se dhënia e disa masave disiplinore të njëpasnjëshme ndaj tij, nuk ka ardhur si pasojë e bindjes së tij politike. Referuar parashikimit ligjor të sipërpërmendur, ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë duhet të depozitonte prova dhe parashtrime që të provonin të kundërtën e pretendimeve të ankuesit, ndërkohë që ky institucion nuk ka arritur të argumentojë qëllimin e ligjshëm të dhënies së masave disiplinore të njëpasnjëshme ndaj A. D.

Nisur nga shqyrtimi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se veprimet apo mos veprimet e ndërmarra nga ana e ISHMPUT, Dega Rajonale Gjirokastrë, në dëm të ankuesit kanë sjellë si pasojë pozicionimin e tij në kushte të disfavorshme.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të A. D., për shkak të bindjeve politike, nga ana e ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë.

Të merren masa të menjëhershme nga ana e ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë ose ISHMPUT-së, në nivel qendror, për shpalljen e pavlefshmërisë absolute të masave disiplinore të dhëna, nga ana e S. R., ish-Kryeinspektor, pranë ISHMPUT-së, Dega Rajonale Gjirokastrë, ndaj A. D.

29. K. B., kundër Albpetrol sh.a.

VENDIM NR. 14, DATË 24.01.2019

Shkak: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar pranë Albpetrol sh.a. prej disa vitesh. Është anëtar dhe aktivist i një subjekti politik. Ndaj tij janë ndërmarrë veprime diskriminuese nga Albpetrol sh.a. për shkak të bindjes politike.

FAKTET

Ankuesi K.B., ka filluar punë pranë Albpetrol sh.a. në datën 18.04.2014, në pozicionin e specialistit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, nëpërmjet kontratës individuale të punës të lidhur ndërmjet tij dhe punëdhënësit të tij, Shoqërisë Albpetrol sh.a.

K.B. ka punuar në pozicionin e sipërpërmendur, deri në datën 04.01.2017, pasi në vijim në muajin dhjetor 2016, K. B., është ngritur në detyrë dhe është transferuar në pozicionin e Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimeve pranë Q.F.M.T Patos.

Ankuesi ka punuar në këtë detyrë deri në datën 12.12.2017, datë në të cilën me urdhër të Drejtorit të Q.F.M.T Patos, ai ka kaluar në pozicionin e specialistit në Sektorin e Prokurimeve pranë Q.F.M.T Patos, lëvizje, për të cilën ai thekson se është bërë pa pëlqimin e tij dhe në kushtet e një presioni të madh politik, pasi ai është anëtar i forcës politike LSI, si dhe anëtar e përfaqësues i kësaj forcë politike në Këshillin Bashkiak Fier.

Në vijim, ai pretendon se i është kërkuar të japë dorëheqjen. Pas depozitimit të ankesës së tij pranë KMD-së, K. B., njoftohet zyrtarisht, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv. Në vijim, ankuesi merr dijeni mbi Vendimin e Administratorit të shoqërisë, për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit organizativ të Albpetrol sh.a.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, germa a), si dhe neni 33, pika 10.

KONKLUSIONE

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se K. B., i është nënshtruar një qëndrimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e Albpetrol sh.a., pasi ulja e tij në detyrë ka qenë e pambështetur në një kërkesë formale me shkrim për dorëheqje, si dhe kjo lëvizje është kryer zyrtarisht nga Drejtori i Q.F.M.T. Patos, i cili nuk ka tagër dhe nuk ka qenë i autorizuar nga Administratori të nxjerrë akte të tilla.

Komisioneri gjykon se qëndrimi i mbajtur nga ana e Albpetrol sh.a. ndaj K. B., ka qenë tendencioz dhe është shprehur hapur në dy momentet e mësipërme. Komisioneri krijoi bindjen se veprimet e Albpetrol sh.a. ndaj ankuesit janë të qëllimta. Komisioneri gjykon se ndërmjet qëndrimit të padrejtë dhe disfavorizues, ndaj të cilit, K. B., është ekspozuar nga ana e Albpetrol sh.a. dhe shkakut të diskriminimit të pretenduar nga ankuesi, që është një shkak i mbrojtur ligjrisht, sikurse edhe me fakte e prova konkrete, ekziston një lidhje shkakësore.

Gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, Albpetrol sh.a. nuk paraqiti pranë Komisionerit fakte konkrete, që të provonin që ulja në detyrë e ankuesit ishte kryer mbi baza të ligjshme, objektive dhe të arsyeshme, si dhe të argumentohej e justifikohet bindshëm e kundërta e asaj që pretendohet nga K. B. Për sa më sipër, Komisioneri përgjatë hetimit dhe analizimit të provave konkrete krijoi bindjen që ky trajtim i padrejtë dhe i disfavorshëm i Albpetrol sh.a. është i lidhur drejtpërdrejtë me bindjen politike të ankuesit.

Gjatë kohës që ankesa ka qenë për shqyrtim pranë KMD-së, Albpetrol sh.a. e njofton zyrtarisht K. B., mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv.

Pas marrjes dijeni për këtë fakt, Komisioneri e njofton zyrtarisht Albpetrol sh.a., që në referencë të nenit 15, pika 2, të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, marrëdhëniet e punës me ankuesin nuk duhet të ndërpriteshin, për sa kohë që ankesa e këtij të fundit ishte duke u shqyrtuar pranë KMD-së. Shoqëria “Albpetrol” sh.a. dërgon zyrtarisht konfirmimin e saj që një gjë e tillë nuk do të ndodhë. Pavarësisht sa më sipër, ndërkohë që Komisioneri ishte në shqyrtim e sipër të ankesës së K. B., Albpetrol sh.a. i dërgon ankuesit Vendimin “*Mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të rristurimit organizativ*”, duke kundërshtuar në këtë mënyrë haptazi dispozitat ligjore.

Mbështetur në provat e administruara, Komisioneri krijoi dyshimin e arsyeshëm dhe përforcoi bindjen e tij, që ankuesi është viktimizuar nga Albpetrol sh.a., për shkak të ankimimit të tij pranë KMD-së.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “bindjes politike”, të K. B., nga ana e Albpetrol sh.a., lidhur me uljen e tij në detyrë, nga pozicioni i Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve, në pozicionin e specialistit, pranë të njëjtë sektor, në Q.F.M.T. Patos.

Konstatimin e viktimizimit të K. B., nga ana e Albpetrol sh.a., si pasojë e ankimimit të tij kundër kësaj shoqërie, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjes politike”, të K. B., nga ana e Albpetrol sh.a., lidhur me përfshirjen e ankuesit në pushimin kolektiv, të zbatuar nga kjo shoqëri.

Në referencë të pikave 1 dhe 2, të këtij vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Albpetrol sh.a., për sistemimin e ankuesit në një pozicion analog pune, me atë të Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimeve, pranë Q.F.M.T. Patos.

30. A.S., kundër Spitalit Rajonal (SR) Gjirokastrë

VENDIM NR. 117, DATË 04.05.2018

Shkaku: Bindjet politike, racë
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues për 9 vite ka qenë në marrëdhënie pune me SR Gjirokastrë, në pozicionin oksigjenist. Në vitin 2018 është larguar nga detyra me motivacionin e dëmit të shkaktuar nga mungesa e 20 bombulave të oksigjenit. Ankuesi është diskriminuar për shkak të bindjeve politike dhe të racës.

FAKTET

Subjekti ankues me datë 01.04.2010 ka lidhur marrëdhëniet e punës me SR Gjirokastrë dhe për 9 vite ka qenë në pozicionin Oksigjenist. Me datë 09.01.2018 është bërë lirimi i menjëhershëm i tij nga detyra, me motivacionin se ka rezultuar mungesa e bombulave të oksigjenit.

Referuar shënimit të datës 02.05.2014, në regjistrin përkatës, rezultoi se ankuesi i nuk ka qenë fare në turn. Personat që kishin bërë dorëzimin e 20 bombulave të oksigjenit në cilësinë e personave të autorizuar nga shoqëria “Messer Albagas” shpk ishin P. GJ., dhe L. K., në cilësinë e punonjësve të Spitali Rajonal Gjirokastrë, të cilët dhe kishin nënshkruar në regjistr¹⁷ për marrjen e tyre në dorëzim.

Në inventarët e paraqitura pranë KMD-së nga ana e Spitalit, për vitet: 2014, 2015, 2016, 2017 mungesa e bombulave të oksigjenit konstatohet vetëm në vitin 2017. (Në të gjitha inventaret janë konstatuar 52 copë bombula oksigjeni në gjendje fizike dhe vetëm në vitin 2017 konstatohen 32 bombula oksigjeni në gjendje fizike, pra ka një mungesë prej 20 bombulash).

Ndërkohë që, në shkresën zyrtare të Spitalit bëhet me dije se, mungesa e bombulave të oksigjenit ka rezultuar që nga viti 2014.

Bazuar në Kartën e anëtarësisë, ankuesi provoi se është anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, si dhe referuar vërtetimit me nr.80 prot., datë 06.01.2018 të Shoqatës “Egjiptianët e Bashkuar të Shqipërisë”, është pjesëtar i komunitetit egjiptian.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.

¹⁷ Kopje e shkresës ndodhet e depozituar në dosjen e ankuesit.

- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 12, 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Komisioneri, gjatë shqyrtimit të çështjes, konstatoi se motivacioni për shkëputjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, lidhur me mungesën e bombulave të oksigjenit, nuk qëndron, nuk provohet dhe është i pabazuar pasi:

- *Së pari*, ankuesi sikurse u provua nga regjistri përkatës nuk ka qenë në turnin gjatë të cilit është bërë marrja në dorëzim e 20 bombulave të oksigjenit.
- *Së dyti*, u provua se bombulat ishin marrë në dorëzim/firmosur procesverbali nga dy punonjës të tjerë.
- *Së treti*, Spitali ishte kontradiktor dhe i pasaktë në deklaratimet e veta lidhur me momentin e marrjes dijeni për mungesën e bombulave: nga inventarët e paraqitura për vitet 2014-2017 rezultonte se mungesa e 20 bombulave ishte konstatuar në vitin 2017, ndërsa me datë 07.02.2018 Spitalit bënte me dije se, mungesa e bombulave të oksigjenit ka rezultuar që nga viti 2014.
- *Së katërti*, bazuar në procesverbalin e shoqërisë “Messer Albagas” shpk, Spitalit i ishte kthyer sasia prej 20 bombulash oksigjeni, të cilat mungonin që në vitin 2014, duke rakorduar kështu gjendjen e bombulave të oksigjenit sipas inventarit.

Argumentin e punëdhënësit (SR Gjirokastrë) se ka vlerësuar si rrethana të rënda mangësitë e hasura në bombulat e oksigjenit, të cilat kanë shkaktuar një dëm ekonomik për institucionin, Komisioneri e gjeti të pabazuar pasi:

- Ankuesi nuk ishte personi përgjegjës për dorëzimin e tyre pranë firmës përkatëse,
- Vlera e një bombule oksigjeni ishte 385 lekë të rinj, pra, në total 20 bombula kanë vlerën e 7700 lekëve.
- Mungesa e 20 bombulave, nisur nga vlera e tyre monetare, nuk mund të konsiderohet si rrethanë e rëndë për të justifikuar masën e largimit të menjëhershëm nga puna, pasi një masë e tillë është jo proporcionale, e pa arsyeshme dhe e pa justifikuar në raport me dëmin financiar që i ka sjellë Spitalit. Për më tepër në rrethanat kur bombulat ishin zëvendësuar.

Nga ana e Spitalit nuk u soll asnjë statistikë, (megjithëse iu kërkua nga Komisioneri) lidhur me numrin e punonjësve që i përkisnin këtij komuniteti, të punësuar aktualisht pranë këtij institucioni dhe as të atyre të larguar.

Në përfundim, Komisioneri gjen të paligjshëm largimin e ankuesit nga puna dhe konstaton se ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë dhe të pafavorshme dhe se masa e marrë për

largimin e tij nga puna ishte e qëllimshme, e pajustificuar dhe e pa argumentuar ligjërisht dhe se kishte ardhur për shkak të bindjeve të tij politike dhe të racës.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit për shkak të bindjeve politike dhe të racës, të A. S., nga ana e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

Referuar pikës pikës 1, të vendimit, Spitali Rajonal Gjirokastrë, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj subjektit ankues, A. S., të bëjë rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, si oksigjenist.

31. V. H., kundër Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST)

VENDIM NR. 168, DATË 31.08.2018

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues ka filluar punë si Auditues i Brendshëm në OST sh.a.
OST sh.a ka përfunduar marrëdhënien e punës me ankuesin, me motivacionin e mosçertifikimit të tij si auditues i brendshëm.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë i punësuar në OST sh.a me detyrë Teknik Specialist Ekspert në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.

Në zbatim të Vendimit të Këshillit Mbikqyrës “Për lirimin nga detyra të punonjësit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të OST sh.a”, në datë 19.02.2018, OST sh.a ka përfunduar marrëdhënien e punës me ankuesin për shkak të mosçertifikimit si auditues i brendshëm.

Në listën e rezultateve paraprake të testimit për provimin me shkrim, sezoni 2017-2018 e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik, e cila fillon me nr.sekretimi 1 (një) dhe mbyllet me numër 48 (dyzet e tetë), subjekti ankues, i cili mban numrin rendor 42 të kësaj liste ka marrë tek provimi me shkrim rezultatin prej 66.5 pikësh; fakt ky që provonte se ai ishte në përfundim të kursit të detyruar të kualifikimit të auditueve të brendshëm të sektorit publik.

Ankuesi ka provuar se ka qenë anëtar dhe aktivist i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integritet”, në Njësinë Nr. 7, në fushatën elektorale të Qershorit 2017, nëpërmjet dokumentit të anëtarësisë me nr.9801, datë 31.05.2016, si dhe fotove të realizuara gjatë aktivitetit në këtë fushatë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

- Ligji Nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 11.

KONKLUSIONE

Komisioneri, gjatë shqyrtimit të çështjes, për analogji krahasuese me subjektin ankues i kërkoi OST sh.a dokumentacion provues edhe për punonjësin J. XH., (nëse ai përmbush kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në ligj) por nga ana e OST sh.a nuk u soll asnjë argumentim apo dokumentacion provues lidhur me këtë fakt.

Komisioneri duke mos patur dokumentacionin përkatës, i cili duhej të sillej nga OST sh.a, nuk mund të shprehet nëse punonjësi J.Xh., i përmbush apo jo kriteret e kërkuara nga ligji; dhe për pasojë nuk mund të shprehet as sa i takon trajtimit të pa favorshëm të ankuesit krahasuar me të. Në këto kushte, Komisioneri i është referuar trajtimit të subjektit ankues në raport me parashikimet ligjore.

Komisioneri, pas këqyrjes dhe verifikimit të dokumentacionit të depozituar nga palët në proces, vlerësoi se subjekti ankues i përmbushte kriteret e kërkuara nga Ligji Nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe se OST sh.a në njoftimin për zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënies së punës, ka referuar gabimisht nenin 11, pikën 2/c të Ligjit nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”.

Në interpretim të parashikimeve të nenit 11, të këtij ligji, në tërësinë e tij, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues përmbushte:

Së pari, kriterin arsimor, sipas të cilit punonjësi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të ketë diplomë universitare të nivelit të dytë në shkencat ekonomike, pasi ankuesi është diplomuar në Fakultetin “Ekonomi Agrarë” të Institutit të Lartë Bujqësor të Tiranës, në vitet 1982-1986, duke marrë titullin “Ekonomist Plani i Lartë” dhe kjo konsiderohet e përfshirë në shkencat ekonomike, sikurse është përcaktuar në germën a) të pikës 2, të nenit 11 të këtij ligji.

Së dyti, kriterin e përvojës në profesion, pasi referuar Librezës së Punës së ankuesi e përmbushte këtë kriter (si i punësuar në pozicione pune ku është përmbushur kriteri i diplomës universitare e nivelit të dytë në shkencat ekonomike, pavarësisht specifikimit “Ekonomist Plani i Lartë, për sa kohë si kusht i posaçëm citohet thjesht “shkenca ekonomike

Së treti, parashikim e bërë në germën ç, të pikës 2, të nenit 11 të ligjit Nr.114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, pasi ankuesi ka qenë në ndjekje të rregullt të kursit për certifikimin e tij si auditues i brendshëm, gjatë sezonit 2017-2018 dhe logjikisht duhet ta mbyllte atë, brenda afateve të parashikuara në ligj, 2 vite.

Në kushtet kur, nga ana e OST sh.a nuk u arrit të provohej që largimi nga puna i ankuesit ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa për largimin e tij ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të pafavorshëm, të padrejtë dhe të paligjshëm nga ana e punëdhënësit, OST sh.a pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit për shkak të bindjeve politike, të V. H., nga ana e Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a.

Referuar pikës 1, të vendimit, OST sh.a, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj subjektit ankues, V. H., të bëjë rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

32. A. H., kundër Shoqërisë “Trajtimi i Studentëve Nr. 2” sh.a

VENDIM NR. 223, DATË 30.10.2018

Shkak: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi, A. H., ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë “Rezidenca Studentëve Nr. 2” sh.a. Punëdhënësi ka vendosur uljen e tij në detyrë, nga Kryetar i Degës Hoteleri, në Përgjegjës Emergjence në Degën Teknike, Sektori Mjekësi. Ulja në detyrë ka ardhur si shkak i bindjeve të tij politike.

FAKTET

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhëniet e punës me Shoqërinë me datë 02.11.2010. Gjatë viteve ka ushtruar detyra të ndryshme. Më datë 14.10.2013 është emëruar në detyrën e K/D Hoteleri, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në datën 13.02.2018.

Bazuar në Vendimin Nr. 63, datë 17.11.2017 të Këshillit Mbikqyrës është miratuar struktura e Shoqërisë për vitin 2018, e cila në total parashikonte 192 punonjës. Nga këta 104 punonjës ishin parashikuar për Degën Hoteleri. Theksojmë se, referuar parashikimit të kriterit arsimor të kësaj strukture, për pozicionin e KD/Hoteli ishte parashikuar që kriteri i kërkuar të ishte “Arsimi i lartë”.

Ndërkaq, nëpërmjet shkresës të KLSH-së¹⁸ “Raport Përfundimtar dhe Rekomandime për Auditimin e Shoqërisë”, Drejtorisë së Shoqërisë dhe Këshillit Mbikqyrës iu rekomandua të marrin masa për rishikimin e strukturës organizative, për përshtatjen e vendit të punës sipas profesioneve, duke shmangur dublimet në detyrat e punonjësve dhe punësimet e panevojshme.

Në zbatim të rekomandimeve sipërcituar, u miratua struktura e Shoqërisë për vitin 2018, me gjithsej 186 punonjës. Dega Hoteleri u emërtua Drejtoria Hotelerisë dhe gjithsej ishte parashikuar të kishte 48 punonjës. Referuar parashikimit të kriterit arsimor të kësaj strukture, për pozicionin e Drejtorit të Drejtorisë Hoteleri, ishte parashikuar që kriteri i kërkuar të ishte “Arsimi i lartë”.

Ndërkaq, me Vendimin nr.14, datë 13.02.2018 “Ulje në detyrë”, ankuesit i është ndryshuar pozicioni i punës nga K/D Hoteleri në Përgjegjës Emergjence në Degën Teknike, Sektori Mjekësi.

Ankuesi ka dokumentuar angazhimin e tij politik si anëtar i forcës politike LSI, si anëtar dhe aktivist i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim”, referuar dokumentit të anëtarësisë me nr.1714, datë 18.03.2016, si dhe përmes dokumentacionit si përfaqësues i kësaj force

¹⁸ Shkurtesë për Kontrollin e lartë të Shtetit.

politike në KZAZ Nr. 34, gjatë procesit zgjedhor për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë për vitin 2017.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerëson se:

Së pari, ulja në detyrë e ankuesit ishte bërë para se të miratohej struktura e re e Shoqërisë.

Së dyti, kriteri i përcaktuar në strukturën e vjetër të Shoqërisë¹⁹ për pozicionin e KD/Hoteleri ishte “Arsim i lartë”. Po ashtu, rezulton e provuar se dhe në strukturën e re të Shoqërisë²⁰ kriteri arsimor i kërkuar për pozicionin e D/Drejtorisë Hoteleri ishte prapë “Arsim i lartë”.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, arsyetimi i Shoqërisë se ankuesi ishte ulur në detyrë për shkak se në strukturën e re ishte parashikuar që kriteri arsimor kishte ndryshuar në “I lartë (bachelor +master)” ndërsa ankuesi kishte arsim të lartë bachelor dhe jo master; haptazi ishte i pabazuar në fakte e prova.

Komisioneri vlerëson se kalimi i ankuesit nga pozicioni i punës “Kryetar Dege/Hoteleri” në “Përgjegjës Emergjence”, ishte në fakt ndërprerje e kontratës së parë të punës dhe fillim i një kontrate të re pune, pavarësisht se ka vijuar vazhdimësia e marrëdhënies kontraktore të punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit në aspektin financiar; pasi ankuesit i kanë ndryshuar tre elementë thelbësorë siç janë: pozicioni, kategoria dhe paga.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se nga ana e Shoqërisë nuk u arrit të provohej një përligje e arsyeshme dhe objektive e veprimeve të saj ndaj ankuesit, lidhur me uljen e tij në detyrë. Argumentimi i Shoqërisë se ulja në detyrë e ankuesit kishte ardhur si rezultat i mospërshtatjes së kriterit të tij arsimor me pozicionin e punës, rezulton i pa bazuar në prova.

¹⁹ Miratuar me Vendimin Nr. 63, datë 17.11.2017 të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë.

²⁰ Miratuar me Vendimin Nr.76, datë 27.04.2018 të Këshillit Mbikqyrës të Shoqërisë.

Në kushtet kur, nga ana e Shoqërisë nuk u arrit të provohej që ulja në detyrë e ankuesit kishte ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; dhe nga ana tjetër ankuesi provoi dhe dokumentoi se mbartte një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të A. H., nga ana e Shoqërisë “Rezidenca e Studentëve Nr. 2” sh.a, për shkak të bindjeve politike.

33. K. L., kundër Bashkisë së Kavajës

VENDIM NR. 174, DATË 25.11.2019

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune me Bashkinë e Kavajës, nga viti 2011 deri me datë 11.05.2018 dhe së fundmi ka mbajtur detyrën e Specialistes së Marrëdhënieve me Publikun, në Njësine Administrative Golem. Nëpërmjet Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë Kavajë është larguar nga puna, për shkak bindje politike.

FAKTET

Me datë 29.07.2011, ka filluar punë si “Punonjëse Biblioteke”. Me datë 03.10.2011, është transferuar në detyrën “Inspektore e Marrëdhënieve me Publikun”. Me datë 10.04.2012 është transferuar në detyrën “Përgjegjëse e Sektorit të Marrëdhënieve me Publikun”. Me datë 12.06.2015 është pezulluar nga detyra. Me datë 12.06.2015 është shfuqizuar pezullimi nga detyra. Me datë 03.08.2017 të Kryetarit të Bashkisë dhe me Vendimin nr.22, datë 03.08.2017 të Njesisë Përgjegjëse për Burimet Njerëzore, është transferuar përkohësisht në detyrën “Përgjegjëse” e Sektorit të Shërbimit Social”.

Me Urdhërin datë 27.09.2017 të Kryetarit të Bashkisë dhe me Vendimin datë 27.09.2017 është transferuar në detyrën “Specialiste e Marrëdhënieve me Publikun” në Njësine Administrative Golem.

Me Urdhërin, datë 11.05.2018 është larguar nga detyra, me motivacionin “Për mosrespektim të orarit të punës”.

Subjekti ankues, nëpërmjet Vërtetimit të lëshuar nga Kryetarja e Forumit të Gruas Socialiste Kavajë, me datë 15.05.2019, ka provuar anëtarësinë dhe angazhimin e saj politik pranë këtij Forumi.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, neni 41, pika 1,

- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- VKM Nr.115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor (KD) në Shërbimin Civil”.
- Udhëzimi Nr.1, datë 02.04.2014 i Departamentit të Administratës Publike (DAP) “Për elementët kryesorë procedurale dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”.

KONKLUSIONE

Komisioneri konstatoi se, procedimi disiplinor ndaj ankuses është bërë në shkelje flagrante të procedurës së përcaktuar në aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë statusin e nëpunësit civil, lidhur me krijimin e Komisionit Disiplinor, përbërjen e tij, si dhe procedurën e ndjekur nga ky Komision për dhënien e masës disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” për ankuesen, gjë që e bën atë një akt të paligjshëm.

Kështu, shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurës të procedimit disiplinor ndaj ankuses, kishin të bënin:

- *Së pari*, me përbërjen e Komisioni Disiplinor, të ngritur pranë Bashkisë Kavajë.
- *Së dyti*, mosprezencën e njërit nga anëtarët e KD në Komision dhe mosrespektimin e procedurës lidhur me këtë fakt.
- *Së treti*, mosrespektimin e dispozitave urdhëruese për mbrojtjen e të drejtave të nëpunësit civil, lidhur me respektimin e afatit të shqyrtimit të shkeljes së komunikuar ankuses, nga ana e KD.

Për sa më lart, Komisioneri konstatoi se, KD ka shkelur në mënyrë flagrante afatet procedurale të përcaktuara në VKM-në respektive.

Në këtë kontekst, ankuses nga ana e Bashkisë Kavajë, nuk i janë siguruar garancitë ligjore të parashikuara nga kuadri ligjor në fuqi, në mënyrë që ajo si nëpunëse civile të kishte mundësi reale për t’u mbrojtur efektivisht, me qëllim që masa disiplinore e dhënë ndaj saj të mund të shqyrtohej në respektim të plotë të procedurës disiplinore, për rrjedhojë, e gjithë procedura e ndjekur nga ana e KD, Bashkia Kavajë lidhur me ecurinë disiplinore ndaj ankuses është në kundërshtim flagrant me dispozitat urdhëruese të kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon marrëdhënien juridike të nëpunësit civil, gjë që e bën vendimmarrjen e tyre të paligjshme.

Në kushtet kur, nga ana e Bashkisë Kavajë nuk u arrit të provohej që vendimmarrja e saj lidhur me masën disiplinore të largimit nga Shërbimi Civil të ankuses, ishte e drejtë dhe e bazuar në ligj, dhe nga ana tjetër ankuesja provoi dhe dokumentoi se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi; Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të paligjshëm, nga ana e Bashkisë Kavajë, pikërisht për shkak të bindjeve politike.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, K. L., për shkak të “bindjeve politike”, nga ana e Bashkisë Kavajë.

34. Y. D., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.

VENDIM NR. 41, DATË 11.03.2019

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim në formën e shoqërimit
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a., prej 32 vitesh, në pozicionin Specialist Avolzhimi, pranë QSHGJ Patos. Pas ndryshimit të Drejtuesit të Institucionit dhe ristrukturimit të Shoqërisë, ankuesi është larguar nga detyra, për shkak të shoqërimit me dhëndrin e tij A. H., i cili kishte aktivitet të njohur politik si aktivist i PD.

FAKTET

Ankuesi Y. D., ka qenë punonjës i Shoqërisë Albpetrol sh.a prej 32 vitesh, deri në datë 07.10.2018. Subjekti ankues mbart shkaku të bindjes politike pasi ka depozituar pranë KMD-së Kartën e Anëtarësisë ku evidentohet se ankuesi është anëtarë i subjektit politik Partia Demokratike, po ashtu ka faktuar dhe se A.H., është dhëndri i tij. A. H., gjithashtu ka paraqitur ankesë për diskriminim pranë KMD, kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a., për shkak të bindjeve politike të tij.

Gjatë procesit të ristrukturimit organizativ të shoqërisë Albpetrol sh.a, në referencë të përcaktimeve të Urdhërit nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcës Nr.1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri, Komisioni i vlerësimit pranë kësaj qendre ka vlerësuar me pikëzim 5 (pesë) axhustatorët/specialist avolzhimi të Sektorit të Shërbimit Mekanik, pranë QSHGJ Patos, një ndër të cilët ishte edhe ankuesi. Sikurse është përmendur edhe më sipër, kriteret mbi të cilat u krye vlerësimi me pikëzim, sipas urdhërit të sipërpërmendur ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Mbështetur në këto kriterë, duke iu referuar Procesverbalit të datës 04.07.2018, rezultoi se ata janë vlerësuar respektivisht si më poshtë:

- A. H., është vlerësuar me 80 pikë.
- SH. H., është vlerësuar me 80 pikë.
- L. D., është vlerësuar me 65 pikë.
- TH. SH., është vlerësuar me 65 pikë.
- Y. D., është vlerësuar me 65 pikë.

Nga ana tjetër, ankuesi dhe A. H., punonin pranë së njëjtës Shoqërie, prej një kohe relativisht të konsiderueshme. Ankuesi ka provuar dhe dokumentuar faktin se A. H., ishte dhëndri i tij dhe se ky fakt njihej nga punëdhënësi.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 496/10, datë 25.06.2018, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018”.

KONKLUZIONE

Pavarësisht nënshtrimit të procesit të rivlerësimit të ankuesit, njëlloj me punonjësit e tjerë të QSHGJ Patos, Komisioni i vlerësimit nuk arriti të provojë se, ai është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe objektive. Përkundrazi, u konstatua dhe provua me dokumentacion se ankuesi ishte vlerësuar në mënyrë të pa saktë dhe të padrejtë. Komisioneri ka konstatuar se, Y. D., është vlerësuar në mënyrë të padrejtë dhe kishte pasaktësi në vlerësimin e dy prej këtyre kriterëve. Në vlerësimin përfundimtar, Komisioni duhet ta kishte vlerësuar me 80 pikë.

Në qoftë se do të ishte vlerësuar drejt, ai do të ishte renditur në 3 pozicionet e para dhe automatikisht duhet të ishte klasifikuar si fitues i pozicionit të punës.

Shoqëria Albpetrol sh.a dështoi të provonte se procedura e ndjekur dhe masat e marra prej saj, kishin qenë të ligjshme, të drejta dhe të arsyeshme kundrejt subjektit ankues.

Po ashtu, nuk arriti të provonte se trajtimi i padrejtë dhe i pabarabartë nga ana e saj i ankuesit krahasuar me punonjësit e tjerë të QSHGJ Patos, nuk kishte të bënte me shoqërimin e tij me A. H., i cili, pas zgjidhjes së kontratës së punës me Shoqërinë kishte paditur këtë të fundit për diskriminim për shkak të bindjeve politike, në gjykatë dhe pranë KMD.

Komisioneri vlerësoi se situata diskriminuese ndaj ankuesit, lidhur me dy momentet sipërcituar, kishte ardhur si pasojë e ankimimit të A.H., dhe kohës kur ka ndodhur ky ankimim kundër punëdhënësit Albpetrol sh.a. Në kontekst të kësaj A. H., ka mbajtur detyrën e Drejtorit të Drejtorisë Juridike pranë administratës së Albpetrol sh.a, prej datës 04.11.2013 deri më datë 15.01.2018. Me vendimin Nr. 14, datë 15.01.2018, i është zgjidhur kontrata e punës dhe është liruar nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Juridike. Pretendimin për

diskriminim për shkak të bindjeve politike e ka bërë prezent para KMD²¹. Ndërkohë ankuesi është njoftuar zyrtarisht për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me datë 06.08.2018.

Në përfundim, Komisioneri vlerësoi se Y. D., ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., trajtim i cili kishte lidhje me shoqërimin e ankuesit me dhëndrin e tij A.H., i cili kishte aktivitet të njohur politik si aktivist i forcës politike PD.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, në formën e shoqërimit, të Y. D., me A. H., nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a, lidhur zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me të.

²¹ KMD është shprehur me Vendimin nr.13, datë 24.01.2019, nëpërmjet të cilit ka konstatuar diskriminim në formën e viktimizimit, të shtetasit A. H., nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a, për shkak të ankimit²¹ të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier.

35. N. C., kundër Drejtorisë së Shërbimit Spitalor (DSHS) Mat

VENDIM NR. 95, DATË 16.07.2019

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar në pozicionin e Arkëtares/Llogaritares, pranë DSHS Mat nga viti 2013. Në vitin 2018 është larguar nga puna për shkak të për shkak të bindjeve politike të tij.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie të pandërprera pune me DSHS Mat dhe ka mbajtur detyrën e shoferit të autoambulancës, pranë këtij Institucioni, nga data 14.06.2016 deri në datën 31.12.2018, datë kur i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës. Nga aktet e dosjes rezultojnë se fillimisht mes palëve janë nënshkruar dy kontrata të njëpasnjëshme, me afat 3 muaj (respektivisht kontratat e datave: 14.06.2016-14.09.2016 dhe 15.09.2016-31.12.2016) dhe më pas kontrata me afat një vjeçar, deri në përfundimin e afatit kohor të përcaktuar në kontratën e fundit, me datë 31.12.2018. (Kontrata me afat të caktuar nga data 03.01.2018-31.12.2018).

Ankuesi ka depozituar kartën e anëtarësisë në partinë politike “Lëvizja Socialiste për Integritet” dhe kopje të Listës së numëruesve të KZAZ të Bashkisë Mat, ku rezultojnë dhe emri i tij, duke dokumentuar kështu bindjet e tij politike.

Referuar akteve shkresore të dosjes së ankuesit, rezultojnë se ndaj tij janë dhënë dy masa disiplinore:

- Fillimisht, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, me motivacionin: *“Për thyerje të etikës, mos mbajtjes të uniformës së punës, moszbatim korrekt të grafikut dhe të orarit të punës, mungesë e theksuar lidhur me përgjegjësinë për automjetet...”*
- Rreth 8 muaj pas dhënies të masës së parë disiplinore ndaj ankuesit, me datë 17.12.2018 është ushtruar kontroll nga ana e grupit të kontrollit me objekt: *“Mbajtjen e mjeteve në gatishmëri për autoambulanca: AA 946 DH për shërbimin e Tiranës dhe AA 953 DH për shërbim të brendshëm”*.

Referuar konstatimeve të cituara në procesverbal nga grupi i kontrollit, për kontrollin e ushtruar në të dyja automjetet sipërcituar rezultoi se: automjeti që kishte në përdorim ankuesi, kishte mungesë oksigjeni (bombula bosh) dhe automjeti në përdorim të shoferit L. B., ishte jashtë kushteve higjeno-sanitare si dhe i pa pajisur me zinxhirë.

Me datë 18.12.2018, DSHS Mat ka njoftuar ankuesin për zgjidhjen e kontratës së punës duke e njohur dhe me shkakun e zgjidhjes së kësaj marrëdhënie pune, që ishte: *“...mungesa e oksigjenit në autoambulancë, gjë e cila përbën shkak për rëndimin e gjendjes shëndetësore të*

pacientit deri në humbjen e jetës. Kjo përbën shkelje të përsëritur të detyrimeve të përcaktuara në Kontratën Individuale të Punës”.

Nëpërmjet shkresës datë 26.12.2018 “Vendim për zgjidhjen e kontratës së punës” DSHS Mat ka zgjidhur marrëdhëniet e punës me ankuesin.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës²² “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Lidhur me argumentimin e DSHS Mat se largimi i ankuesit kishte ardhur si rezultat i mos rinovimit të kontratës me afat të caktuar/njëvjeçarë, pasi përgjatë vitit 2018 ai është ndëshkuar me masa disiplinore dy herë, pra ka patur shkaqe të arsyeshme lidhur me këtë; Komisioneri vlerësoi se:

- *Së pari*, lidhur me dhënien e masës së parë disiplinore, të datës 26.04.2018, konstatohen disa pasaktësi dhe janë shtuar elementë të tjerë rëndues për ankuesin, të cilat nuk ishin konstatuar nga grupi i kontrollit.
- *Së dyti*, dhënia e masës së dytë disiplinore ndaj ankuesit nga ana e DSHS Mat, me datë 18.12.2018, është argumentuar si shkelje e përsëritur e detyrimeve të përcaktuara në Kontratën Individuale të Punës nga ana e ankuesit.
- *Së treti*, rezultoi e provuar shkresërisht se ankuesi megjithëse në kushte të njëjta me dy shoferë të tjerë të DSHS Mat ishte trajtuar ndryshe, duke u ndëshkuar vetëm ai me masë disiplinore/largim nga puna.

Nga këqyrja e dokumentacionit provohet se subjekti ankues ka ezauruar rrugën administrative të kërimit zyrtar lidhur me kompletimin e automjetit me të gjithë komponentët e nevojshëm në mënyrë që ai të ishte në efikasitet të plotë për shërbimin që duhej të ofronte. Në këtë mënyrë, ankuesi ka përmbushur dhe detyrimin që atij i buronte në përmbushje të funksionit të tij si shofer i autoambulancës, lidhur me përgjegjësinë për

²² Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

automjetin. Pra, pretendimet e Institucionit se ankuesi ka kryer shkelje të rënda nuk qëndrojnë, përkundrazi është provuar dhe dokumentuar e kundërta: kryerja e detyrave funksionale nga ana e ankuesit me përgjegjshmëri dhe konform parashikimeve të kontratës për pozicionin e tij si shofer autoambulance.

Ankuesi ka depozituar kartën e anëtarësisë në parti të politike “Lëvizja Socialiste për Integritet” LSI, me Nr. 5596 dhe kopje të Listës së numëruesve të GNV-ve për KZAZ nr.16, të Bashkisë Mat, ku rezultojnë dhe emri i tij, duke dokumentuar kështu bindjet e tij politike.

Nga ana tjetër, referuar listës së përfaqësuesve të partive politike, në KZAZ Nr.16, të Bashkisë Mat, rezultojnë se A. V., Drejtorja e DSHS Mat ka qenë përfaqësuese e Partisë Socialiste. Pra, qartazi ankuesi dhe Drejtorja e DSHS Mat, (njëherësh dhe punëdhënësi i ankuesit) i kanë patur të ekspozuara bindjet e tyre politike dhe kanë qenë në dijeni për bindjet e njëri-tjetrit.

Në kushtet kur, nga ana e DSHS Mat nuk u arrit të provohej që zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm për qëndrimin e punëdhënësit ndaj tij dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të N. C., nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor (DSHS) Mat, për shkak të bindjeve politike të tij.

36. E. D., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT) dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (DRT) Gjirokastrë

VENDIM NR. 109, DATË 23.08.2019

Shkaku: Bindjet politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie të pandërprera pune pranë DRT Gjirokastrë dhe ka mbajtur detyrën “Llogaritare/Arkëtare” në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, pranë këtij Institucioni, nga viti 2015 deri në datën 26.12.2018, datë kur i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës, për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie të pandërprera pune pranë DRT Gjirokastrë dhe ka mbajtur detyrën “Llogaritare/Arkëtare” në Sektorin e Funksioneve Mbështetëse, pranë këtij Institucioni, nga data 22.07.2015 deri në datën 26.12.2018, datë kur i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës.

Referuar kronologjisë së ngjarjeve dhe akteve shkresore të dosjes së ankueses, rezulton se ndaj saj janë dhënë dy masa disiplinore:

- Me Vendimin datë 01.06.2018 “Për dhënie mase disiplinore” DPT²³ ka vendosur që ankueses t’i jepet masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna” për mospërbushje të detyrave funksionale dhe moszbatim të urdhërit të eprorit.
- Ndërkaq, DRT Gjirokastrë, nëpërmjet shkresës datë 25.09.2018 i ka tërhequr vëmendjen ankueses duke cituar se kishte ankesa nga disa tatim pagues të ndryshëm për sjellje jo etike gjatë shërbimit.
- Me shkresën datë 14.11.2018, DRT Gjirokastrë ka propozuar fillimin e procedimit disiplinor për dhënie mase disiplinore me zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës, shkresë e cila në thelb u referohej problematikave të trajtuara dhe në masën e parë të datës 01.06.2018.
- Me datë 14.11.2018 ankuesja është njoftuar për fillimin e procedurës për dhënie mase disiplinore.
- Me datë 07.12.2018 ankuesja u paraqit para Komisionit Disiplinor të DPT Tiranë dhe parashtoi objeksionet e veta.
- Me Vendimin datë 17.12.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të DPT-së, ankuesi është zgjidhur kontrata e punës, me motivacionin e mospërbushjes së rëndë të detyrave funksionale, duke sjellë pasojë shumë të rënda për DRT Gjirokastrë, dhe për shkeljen e rregullave të etikës në punë me eprorët.

²³ Vendim i cili është marrë pas propozimit të DRT Gjirokastrë për fillim të ecurisë disiplinore ndaj ankueses.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokoli 12 i saj.
- Jurisprudencë e GJEDNJ²⁴.
- Konventa e Organizatës Ndërkombëtare të Punës²⁵ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se DRT Gjirokastër dhe DPT nuk arritën të provonin se:

- Dhënia e masave disiplinore ndaj ankuses kishte ndjekur një procedurë të rregullt ligjore,
- Dhënia e masave disiplinore kishte qenë e drejtë dhe e bazuar në ligj.

Po ashtu, Komisioneri gjeti të paprovuara dhe të pa bazuara ligjërisht pretendimet e DRT Gjirokastër, lidhur me:

- Komunikimin jo etik të ankuses me subjektet që merrnin shërbimet pranë Institucionit, përse kohë nuk është dokumentuar asnjë ankesë me shkrim e ndonjë subjekti kundër saj.
- Sjellje jo etike dhe veshje të papërshtatshme të ankuses, pasi nuk u provua me asnjë fakt apo mjet nga ana e DRT Gjirokastër, megjithëse ankuesja kishte kërkuar të sillleshin në cilësi prove pamjet filmike të kamerave të vendosura në Institucion.
- Komunikimin jo-etik të ankuses me eprorin, me datë 15.11.2018, pasi edhe nëse ka ndodhur një debat apo komunikim i tillë, ai i referohet momentit të pas fillimit të procedurës për zgjidhjen e kontratës së punës, dhe në këto kushte nuk mund të shërbente si shkak për fillimin e procedurës disiplinore ndaj saj.
- Dëmin që ka shkaktuar ankuesja ndaj Institucionit me veprimet apo mosveprimet e saj. Nuk është provuar nga ana e DRT Gjirokastër apo DPT Tiranë që ankuesja të ketë shkaktuar ndonjë dëm konkret, as me veprimet, as me mosveprimet e saj.

Bazuar në procedurën e ndjekur nga Komisioni Disiplinor (KD) pranë DPT, për rastin e subjektit ankues, rezultoi e provuar se përbërja e KD ishte në kundërshtim me parashikimin e urdhëruar nga Drejtori i Përgjithshëm i DPT dhe për rrjedhojë, vendimmarrja e KD nuk mund të konsiderohet e ligjshme.

²⁴ Çështja Redfearn kundër Mbretërisë së Bashkuar.

²⁵ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

Në kushtet kur, nga ana e DPT dhe DRT Gjirokastrë nuk u arrit të provohej që zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesen ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj saj ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se qëndrimi i punëdhënësit ndaj saj ishte tendencioz dhe nga ana tjetër ankuesja provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të saj politike.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit i E. D., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Gjirokastrë, për shkak të bindjeve të saj politike.

37. A. Z., kundër Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 83, DATË 02.07.2019

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka mbajtur detyrën e Drejtueses së Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë. Për shkak se ka marrë pjesë në protestën e datës 16.02.2019, të mbajtur nga opozita, punëdhënësi i ka ndërprerë menjëherë kontratën e punës.

FAKTET

Mbështetur në aktet e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, rezulton se subjekti ankues, me Urdhërin Nr. 5160, datë 31.01.2019, të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, është emëruar në pozicionin e Drejtorit të Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, institucion në varësi të Bashkisë Tiranë.

Më datë 16.02.2019, ditë e shtunë, kur ankuesja ka qenë në pushim zyrtar, ka marrë pjesë së bashku me Nënkryetaren e Bashkisë Tiranë, K. M., dhe Drejtorin e Tregjeve, S. H., në protestën e organizuar nga ana e opozitës, si anëtare e subjektit politik, Partia për Drejtësi, Integritet dhe Unitet (PDIU).

Më datë 18.02.2019, dy ditë pas zhvillimit të protestës, në disa media kombëtare është publikuar artikulli me titull “*Ekskluzive/Lali Eri mbështet protestën e opozitës, zyrtarët e tij në protestë*”, me anë të të cilit komentohej se kryetari i Bashkisë Tiranë kishte mbështetur protestën kundër qeverisë duke sjellë si argument pjesëmarrje e punonjësve të Bashkisë Tiranë, anëtarë të Partisë Drejtësi, Integritet dhe Unitet. Ndër të tjera në këtë artikull citohej se: “... Në protestën masive të thirrur nga opozita më 16 shkurt, në ballë të një grupi të përfaqësuesve të PDIU-së ishte kryetari SH.I., ndërsa më pas krahët e ngrohtë ia mbante nënkryetarja e Bashkisë Tiranë, K. M. dhe drejtori i tregjeve në kryeqytet S. H.”. Gjithashtu, bashkë me artikullin janë publikuar edhe 5 foto, ku në njërin prej tyre shfaqet edhe ankuesja, A. Z.

Po më datë 18.02.2019, media Panorama Online, ka publikuar artikullin me titull “*‘Jam qytetare e lirë’, nënkryetarja e shkarkuar e Bashkisë reagon pas vendimit të Veliajt: E nderuar që ...*”, në të ndër të tjera citohet se: “*Tjetër e shkarkuar është edhe A. Z., drejtor i qendrës komunitare ‘Gonxhe Bojaxhi’*”. Gjithashtu edhe media online dosja.al dhe 27.al, kanë cituar largimin e punonjësve të Bashkisë Tiranë të cilët janë larguar nga detyrat që mbanin në Bashkisë Tiranë, për shkak të pjesëmarrjes në protestën e datës 16.02.2019.

Sipas provave të administruara, ankuesja më datë 18.02.2019 dhe 19.02.2019 ka vijuar ushtrimin e detyrës së saj gjatë të gjithë orarit zyrtar të punës, duke komunikuar normalisht me eprorin direkt, A. R., nëpërmjet aplikacionit mobile ËhatsApp, si dhe duke marrë

përgëzime për punën e kryer. Më datë 19.02.2019, ankuesja ka marrë dijeni për largimin nga puna.

Referuar provave të administruara gjatë procedurës hetimore, janë evidentuar raste ku punonjës të Bashkisë Tiranë, të cilët mbajnë pozicione drejtuese, kanë marrë pjesë në aktivitete politike. Në rastet e sipërcituara, ndaj punonjësve që kanë marrë pjesë në aktivitete politike, Bashkia e Tiranës nuk rezulton të ketë mbajtur të njëjtin qëndrim me ankuesen.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- gjatë periudhës që ankuesja ka ushtruar detyrën pranë Qendrës Sociale “Shtëpia e Përbashkët” apo Qendrës Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, nuk është marrë asnjë masë disiplinore ndaj saj. Gjithashtu, nuk rezulton e provuar se gjatë kësaj periudhe kohore që ka punuar në Bashkinë Tiranë të ketë patur rrethana të cilat çënojnë vazhdimësinë e marrëdhënieve të punës.
- ndaj punonjësve që kanë marrë pjesë në aktivitete politike të organizuara nga subjekti Partia Socialiste, Bashkia e Tiranës nuk rezulton të ketë mbajtur të njëjtin qëndrim me ankuesen.
- procedura e largimit nga detyra e ankueses ka nisur menjëherë pas pjesëmarrjes në protestën e mbajtur nga opozita, ku edhe subjekti politik në të cilin aderon ankuesja.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”, neni 59.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Rregullore e Bashkisë “*Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë së Tiranës*”, neni 30.

KONKLUSIONE

E drejta për të shprehur mendimet dhe bindjet politike, sidomos në forma qytetare nëpërmjet tubimeve, është një e drejtë kushtetuese dhe liria për të marrë pjesë është e garantuar. Punonjësit e administratës nuk mund të ushtrojnë të drejtat e tyre politike kur ata janë duke kryer shërbimin e tyre publik. Rrjedhimisht, në kushtet kur tubimi ka qenë i organizuar ditën e shtunë, pra në një ditë pushimi, ankuesja ka qenë krejtësisht e lirë për të shprehur bindjet e saj politike pa pasur asnjë lloj pasoje negative për ushtrimin e lirisë së saj.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se A. Z., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Bashkisë

Tiranë, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankueses dhe pjesëmarrjen e saj në protestën e opozitës më datë 16.02.2019.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetases A. Z., nga ana e Bashkisë Tiranë për shkak të bindjeve politike.

38. A.B., kundër Shërbimit Spitalor Skrapar

VENDIM NR. 102, DATË 30.07.2019

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar pranë Shërbimit Spitalor Skrapar, në pozicionin e shoferit të autoambulancës, prej 30 vitesh. Pas ndryshimit të Drejtuesit të Institucionit, ankuesi është larguar nga detyra, për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi ka punuar pranë Shërbimit Spitalor Skrapar, në pozicionin e shoferit të autoambulancës, prej 30 vitesh. Gjatë detyrës së ushtruar, nga viti 2015 deri më datë 24.01.2018, ka patur në përdorim autoambulancën. Secila autoambulancë e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar edhe ajo me të cilën ai punonte, përdorej nga 2 shoferë me sistem turni 24-orësh.

Sipas informacionit të administruar në media, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, A. D., i cili ka bërë largimin e ankuesit nga puna, është pjesë e strukturave të subjektit politik Partia Socialiste e Shqipërisë. Gjithashtu, ankuesi ka paraqitur pranë KMD-së prova të mjaftueshme për të vërtetuar shkakun e diskriminimit të pretenduar të bindjeve politike.

Me emërimin në detyrë të Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar, autoambulanca në përdorim të ankuesit, ishte kaluar në përdorim shtetasit A. A. Në këto kushte, më datë 24.01.2018, me anë të procesverbalit të mbajtur në prezencë të Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar A. D., Përgjegjëses së Sektorit të Menaxhimit Spitalor T. S., Specialistes së Burimeve Njerëzore A. L., dhe shoferit Sh. D., autoambulanca i është dorëzuar A. A., me të gjithë pajisjet në rregull, por në mungesë të njërit prej çelësve. Sipas procesverbalit, nga ana e Drejtorit të Institucionit dhe Përgjegjëses së Sektorit të Menaxhimit Spitalor, u kushtëzua largimi nga puna i A. B., nëse nuk dorëzonte çelësin e dytë të autoambulancës. Pas dorëzimit të çelësit, autoambulanca iu kalua shoferit A. A.

Nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, me Urdhërin Nr. 1, datë 24.01.2018, A. B., i jepet masa disiplinore vërejtje për moszbatim të urdhërit, lidhur me dorëzimin e çelësit të automjetit, në momentin që është bërë kalimi i autoambulancës në përdorim të shoferit A. A.

Mbështetur në Urdhrat e miratuar nga ana e Drejtorit të Shërbimit Spitalor Skrapar, është krijuar Komisioni i Auditit të Brendshëm, i përbërë nga Xh. Ll., me detyrë Nën drejtor Ekonomike, N. D., me detyrë Specialiste Ekonomiste dhe M. P., me detyrë Operatore Kosto,

të cilët gjatë fillimit të vitit 2018, kanë ushtruar kontroll, lidhur me konsumin e karburantit dhe kontrole të pjesëve të këmbimit për automjetet e institucionit.

Gjithashtu, gjatë kontrollit të ushtruar nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar ndaj drejtuesve të autoambulancave, mbi ndërrimin e pjesëve të këmbimit, janë gjetur në shkëlqe edhe drejtues të tjerë të autoambulancave, por ndaj tyre nuk është marrë asnjë masë. Pavarësisht këtij fakti, edhe pse gjatë marrjes në dorëzim të automjetit nga servisi, kanë qenë edhe punonjës të tjerë të cilët kanë firmosur dhe kanë konstatuar që janë ndërruar pjesët e këmbimit, si dhe janë kryer të gjitha shërbimet e kërkuara, nuk janë ngarkuar me përgjegjësi nga drejtuesit, por vetëm ankuesi.

Në kushtet që A. B., ka qenë drejtuesi i automjetit që ka tërhequr automjetin nga subjekti që ka kryer shërbimet, me vendimin Nr. 25, datë 12.04.2018, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar ka zgjidhur në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me të. Gjithashtu, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar më datë 27.04.2018, ka paraqitur pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Berat, kallëzim për veprën penale “*Shpërdorimi i detyrës*”, ndaj A. B.

Përsa më sipër, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, vendosi “*Pushimin e çështjes penale në ngarkim të shtetasit A. B.,*” dhe rezultoi se asnjë nga pretendimet e ngritura ndaj shtetasit A. B., nga ana e Shërbimit Spitalor Skrapar, nuk qëndrojnë dhe nuk janë të provuara.

Mbështetur në informacionin dhe provat e administruara, nga Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, janë ngarkuar me përgjegjësi, janë larguar nga puna, si dhe janë kallëzuar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Berat, A. B., dhe shtetasi S. K., të cilët kanë paraqitur ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me pretendim largimin nga puna për shkak të bindjeve politike.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- “*Karta Sociale Evropiane*” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Pavarësisht faktit që gjatë marrjes në dorëzim të automjetit me targë AA 183 KY, nga servisi, kanë qenë edhe punonjës të tjerë të cilët kanë firmosur dhe kanë konstatuar që janë ndërruar pjesët e këmbimit, si dhe janë kryer të gjitha shërbimet e kërkuara, asnjë prej tyre nuk është ngarkuar me përgjegjësi, por vetëm ankuesi.

Komisioni për normën e konsumit të karburantit, i përbërë nga të njëjtët punonjës nga viti 2015 deri në vitin 2018, kanë vlerësuar të njëjtin konsum karburanti për 2 vite rradhazi, ndërsa me emërimin e A. D., në krye të Shërbimit Spitalor Skrapar, kanë ndryshuar qëndrim duke vlerësuar se autoambulanca që kishte në përdorim ankuesi ka një konsum më të ulët.

Pavarësisht faktit që e njëjta autoambulancë është përdorur nga dy drejtues (shoferë), është penalizuar duke u larguar nga detyra vetëm ankuesi.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se A. B., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Shërbimit Spitalor Skrapar, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit A. B., nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Skrapar, për shkak të bindjeve politike.

Në referim të pikës 1, Drejtoria e Shërbimit Spitalor Skrapar, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e A. B., në vendin e mëparshëm të punës.

39. L. D. kundër Zyrës Vendore Arsimore (ZVA) Shkodër

VENDIM NR. 137, DATË 02.10.2019

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka konkuruar dhe kërkuar të punësohet në pozicionin e mësueses nga ZVA Shkodër, por një gjë e tillë nuk i është ofruar nga ana e strukturave drejtuese të këtij institucioni, për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesja, L. D. nga viti 2002 ka filluar punë si mësuese provizore në Sistemin Arsimor në shkollën të ndryshme të qytetit të Shkodrës. Në muajin dhjetor 2016, ankuesja ka filluar punë me kontratë të përkohshme në pozicionin e mësueses në profilin Biologji-Kimi, në Shkollën e mesme “Jordan Misja”, Shkodër.

Sipas informacionit të administruar nga palët, ankuesja ka konkuruar në portalin “Mësues për Shqipërinë”, ndër vite, duke u vlerësuar si më poshtë:

- në vitin 2015-2016, ka qenë e renditur në vend të pestë në profilin, Kimi, me 55.8 pikë
- në vitin 2016-2017, ka qenë e renditur në vend të dytë në profilin Biologji, me 57.3 pikë.

Në muajin Maj 2017, mësuesja që ankuesja zëvendësohet, për arsye personale ka ndërprerë marrëdhënien e punës, duke dhënë kështu dorëheqjen nga pozicioni i punës. Në këtë moment, drejtorja e shkollës “Jordan Misja”, me anë të shkresës datë 03.05.2017, i është drejtuar Drejtorisë Arsimore Rajonale Shkodër, duke e njoftuar se: *“...pas përfundimit të procedurave për ndërprerjen e kontratës së punës me mësuesen J. Sh., vendi është i lirë. Në këtë vend, është punësuar me kontratë të përkohshme L. D.. Për arsye të ndryshimit të Kurrikulës dhe pritshmërisë së numrit të nxënësve të klasës, kjo ngarkesë mësimore për vitin shkollor 2017-2018, pritët të reduktohet, gjë për të cilën kërkojmë të vlerësohet shpallja ose jo e këtij vendi pune në këto kushte. Meqenëse është fundi i vitit shkollor, propozojmë që mësuesja aktuale të vazhdojë deri në përfundimin e këtij viti shkollor.”*

Përsa më sipër, ankuesja i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar dhe ZVA Shkodër, për tu emëruar në pozicionin e mësueses në Shkollën “Jordan Misja”.

Në referim të provave të vëna në dispozicion nga ana e palëve në proces, u evidentuan tre momente që duhet të analizoheshin nga ana e Komisionerit, lidhur me trajtimin e pabarabartë nga ana e DAR Shkodër. Momenti i parë kishte të bënte me mos-emërimin e ankueses në pozicionin mësueses së profilit Biologji-Kimi në shkollën e mesme “Jordan Misja”. Momenti

i dytë me mosrespektimin e renditjes së emërimit të kandidatëve të portalit “Mësues për Shqipërinë” 2016-2017, të profilit Biologji-Kimi. Ndërsa momenti i tretë, me emërimin e një mësuesi tjetër në profilin Biologji-Kimi, në shkollën e mesme “Jordan Misja” dhe jo të ankueses.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 69, datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, neni 57.
- Udhëzimi nr. 38, datë 06.10.2015 i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit “Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”, Kreun 9.

KONKLUZIONE

Komisioni i Vlerësimit për emërimin e kandidatit A. V., në shkollën “Shaban Banushi”, Melgushë, i është referuar renditjes së kandidatëve pjesëmarrës në portalin “Mësues për Shqipërinë” 2015-2016, ndërkohë që duhej të merrej për referencë renditja e kandidatëve në portalin e vitit 2016-2017. Në këtë kuptim, ankuesja duke qënë në renditje e dyta në portalin 2016-2017, me numër më të madh të pikësh se shtetasi A. V., duhet t’i ishte ofruar më parë asaj apo kandidatëve të renditur i pari apo i dyti, përpara se ti ofrohej A. V.

Nga Komisioneri u evidentua se nuk ishte respektuar procedura ligjore, nga ana e Komisionit të Vlerësimit të DAR Shkodër dhe shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, për emërimin e kryer për vendin vakant në profilin/lëndën Biologji-Kimi në rastin e emërimit të mësuesit A. V., të renditur në vendin e katërt të portalit “Mësues për Shqipërinë” 2016-2017.

Në vlerësim të dokumenteve të administruara mbi procedurat e përdorura nga DAR Shkodër dhe shkollës “Shaban Banushi”, Melgushë, për emërimet e punonjësve arsimor, Komisioneri konstatoi se emërimi i shtetasit A. V., është bërë në kundërshtim me legjislacionin e arsimit, duke vënë kështu ankuesen në kushte të pafavorshme.

Në përfundim, sipas të dhënave të administruara, drejtuesi i ZVA Shkodër kishte një aktivitet të njohur politik, të bërë publik edhe në media. Bazuar në provat e administruara, subjekti ankues mbart shkakun e bindjes politike pasi ka depozituar pranë KMD-së vërtetimin datë

04.07.2019, lëshuar nga subjekti politik Partia Demokratike, Dega Shkodër, Seksioni Vukatanë

Nga ana e DAR Shkodër nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përligjin faktin se procedura e ndjekur për emërimin e mësuesit të Biologji-Kimisë në shkollën “Shaban Banushi”, Melgushë ka ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerësoi se L. D., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e DAR Shkodër, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankueses.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetases L.D., nga ana e Drejtorisë së Arsimore Rajonale Shkodër (aktualisht Zyra Vendore Arsimore Shkodër), për shkak të bindjes politike, lidhur me procedurën e emërimit të mësuesit të lëndës Biologji-Kimisë në shkollën “Shaban Banushi”, Melgushë.

Në referim të pikës 1, Zyra Vendore Arsimore Shkodër, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, në zbatim të pikës 8, të Kreut 4 të Udhëzimit nr. 38, datë 06.10.2015 të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit *“Për procedurat e lëvizjes paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionet arsimore publike të sistemit arsimor parauniversitar”*, të marrë masat e menjëhershme për shpalljen e pavlefshme të kontratës së lidhur në shkelje të kësaj dispozite me shtetasin A. V.

Në referim të pikës 1, Zyra Vendore Arsimore Shkodër, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë emërimin e L. D., me ngarkesë të plotë mësimore dhe të përhershme.

40. R. S., kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE)

VENDIM NR. 158, DATË 02.08.2018

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar pranë OSHEE-së, në pozicionin e Shefit të Agjencisë pranë Drejtorisë Rajonale Burrel/Agjencia Burrel dhe në vitin 2017 është larguar nga puna për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi ka punuar pranë OSHEE-së, në pozicionin e Shefit të Agjencisë pranë Drejtorisë Rajonale Burrel/Agjencia Burrel, prej datës 30.12.2013. Më datë 12.10.2017, shtetasi P. Ll., i është drejtuar drejtuesit të institucionit, duke e informuar se R. S. është përjashtuar nga puna pak kohë më parë për shkelje të rënda në marrëdhëniet e punës, si dhe vijon të punojë në firma private pavarësisht se është i punësuar pranë OSHEE-së. Referuar informacionit të sipërcituar, OSHEE pa bërë verifikimet përkatëse, ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me ankuesin.

Nga verifikimet e bëra në dokumentacionin e dërguar nga palët nuk vërtetohet fakti se ndaj R. S. të jetë marrë ndonjë vërejtje apo masë disiplinore, apo të jetë konstatuar pretendimi se ka kryer punë private për të tretët gjatë orarit zyrtar të punës, bazuar në denoncimin e ardhur pranë OSHEE sh.a., po ashtu nuk ka vlerësime të performancës në punë për punonjësin R. S.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, rezultoi se R. S., ishte anëtar i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” dhe në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 21 Qershor 2015, ai ishte emëruar anëtar i KZAZ-së Nr. 16, për Qarkun e Dibrës, si përfaqësues i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim.

Pas largimit të tij nga pozicioni Shef i Agjencisë Burrel, pranë Drejtorisë Rajonale Burrel, në këtë vend pune më datë 06.04.2018, ishte emëruar E. Gj. Nga verifikimet e kryera, rezultoi se E. Gj., në zgjedhjet vendore të vitit 2011, ka qenë kandidat, i renditur i 5-ti në listën shumëmemërore për Këshilltar në Bashkinë Burrel, si përfaqësues i subjektit politik “Partia Socialiste e Shqipërisë”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.

- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Neni 9.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Megjithëse në shkresën datë 16.07.2018 të OSHEE sh.a, citohet se: “... nga verifikimet e kryera pas ankesës së P. Ll., është vërtetuar punësimi në aktivitet privat të punonjësit R. S.”, Komisioneri vlerëson se ky argumentim nuk qëndron pasi nga ana e punëdhënësit, OSHEE sh.a nuk u vu në dispozicion të Komisionerit asnjë provë për të faktuar se janë kryer verifikimet përkatëse dhe është vërtetuar pretendimi i ngritur. Për më tepër që nga ana e punëdhënësit nuk është zhvilluar një procedurë administrative në të cilën të evidentoheshin shkeljet e sipërcituara dhe që punëmarrësi të ishte në gjendje të parashtronte argumentet e tija. Përsa më sipër, nuk kishte ndërmarrë asnjë hap për verifikimin e informacionit të paraqitur nga shtetasi P. LL., po duke e marrë për të mirëqenë ka vijuar procedurën për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, pa mbështetur ligjërisht veprimet e kryera.

Për sa më lart, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për largimin e ankuesit nga puna konstaton se ankuesi është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe se masa e marrë për largimin e tij nga puna është e pajustificuar dhe e pa argumentuar ligjërisht.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se R. S., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Shoqërisë OSHEE sh.a, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit R. S., nga ana e Shoqërisë OSHEE sh.a, për shkak të bindjes politike.

Në referim të pikës 1, OSHEE sh.a, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e R. S., në vendin e mëparshëm të punës.

41. E. C., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)

VENDIM NR. 172, DATË 07.09.2018

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi, ka punuar në pozicionin e Specialistit të regjistrimit të automjeteve në DRSHTRR Berat dhe në vitin 2018, është larguar nga puna për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi ka punuar në pozicionin e Specialistit të regjistrimit të automjeteve në DRSHTRR Berat, nga viti 2008 deri më datë 07.01.2018. Gjatë detyrës së ushtruar, është vlerësuar pozitivisht nga eprorët. Në 7 Janar 2018, punëdhënësi i ka ndërprerë marrëdhëniet e punës, si rezultat i ristrukturimit.

Gjatë trajtimit të ankesës së E. C., u administruan prova se ankuesi ishte anëtarë i subjektit politik, Partia Demokratike e Shqipërisë që prej vitit 2008. Në vitin 2013, në krye të DPSHTRR-së u emërua Y. S., si propozim²⁶ i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, post të cilin e mbajti deri në muajin Shtator të vitit 2017. Më datë 29.09.2017, pas largimit të Y. S. nga detyra, në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, u emërua A. I., me një aktivitet të njohur politik deri përpara emërimit në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 19, datë 15.11.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²⁶ <http://www.gazetatema.net/2017/09/20/drejtoret-e-lsi-qe-rrezikojne-te-largohen-nga-detyra-ja-emrat/>

KONKLUSIONE

Gjatë procedurave të hetimit u evidentua se procedurat për largimin nga puna të ankuesit dhe riorganizimin e institucionit, kanë nisur përpara ndryshimeve të pësura në strukturën organizative të DPSHTRR-së. Megjithëse nga ana DPSHTRR-së u pretendua se ankuesi është larguar nga puna për shkak të ristrukturimit të institucionit, si dhe për shkak të ndryshimit të kërkesave të pozicionit të punës lidhur me arsimin, Komisioneri vlerësoi se ky argumentim nuk qëndronte, pasi nuk ishte i mbështetur në asnjë nga provat dhe informacionet e vëna në dispozicion nga palët.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se DPSHTRR:

- Nuk kishte të parashikuar në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimit e të saj, apo ndonjë dokument tjetër, se *specialistët e regjistrimit të mjeteve*, të kishin përfunduar studimet e larta si *"Inxhinier Mekanik"*. Pra, kërkesat për këtë pozicion pune kishim mbetur të njëjta edhe pas ndryshimeve në strukturë.
- Pavarësisht faktit që kishte larguar ankuesin nga detyra për shkak të ristrukturimit, kjo procedurë ishte bërë ende pa u miratuar struktura organizative e re.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerësoi se E. C., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të tij. Kjo pasi largimi i tij, erdhi pas ndryshimit të Drejtorit të Përgjithshëm të institucionit dhe në shkelje të procedurës ligjore e të pajustificuar të marrëdhënieve të punës.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit E. C., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për shkak të bindjeve politike.

Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e E. C., në vendin e mëparshëm të punës.

42. H. D., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (DPSHTRR)

VENDIM NR. 179, DATË 18.09.2018

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar në pozicionin e Anëtarit të Komisionit të Marrjes në Prova-Praktike, në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë dhe në vitin 2018, është larguar nga puna për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi, ka punuar në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, nga viti 2010 deri në vitin 2011. Më datë 19.04.2011, është emëruar në pozicionin e Anëtarit të Komisionit të Marrjes në Prova-Praktike. Më datë 06 Shkurt 2018, punëdhënësi i ka ndërprerë përfundimisht marrëdhëniet e punës.

Gjatë trajtimit të ankesës së H. D., u administruan prova se ankuesi kishte një aktivitet të njohur politik dhe ishte anëtarë i subjektit politik, *Lëvizja Socialiste për Integrim*. Në vitin 2013, në krye të DPSHTRR-së u emërua Y. S., si propozim²⁷ i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim, post të cilin e mbajti deri në muajin Shtator të vitit 2017. Më datë 29.09.2017, pas largimit të Y. S., nga detyra, në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së, u emërua A. I., me një një aktivitet të njohur politik deri përpara emërimit në pozicionin e Drejtorit të Përgjithshëm të DPSHTRR-së.

Pas emërimit të drejtuesit të ri të institucionit, rezultoi se struktura e DPSHTRR-së kishte pësuar dy herë ndryshime. Ndryshimi i parë, është bërë më datë 20.10.2017 dhe ndryshimi i dytë më datë 23.04.2018. U konstatua se, ndryshimi i parë është realizuar rreth 3 (tre) muaj përpara, largimit të ankuesit nga pozicioni i punës. Ndërsa ndryshimi i fundit është miratuar pak kohë pas largimit të tij, ndërkohë që ai nuk kishte ndërprerë përfundimisht marrëdhëniet financiare me DPSHTRR-në dhe vijonte marrëdhëniet e punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.

²⁷ <http://ëëë.gazetatema.net/2017/09/20/drejtores-e-lsi-qe-rrezikojne-te-largohen-nga-detyra-ja-emrat/>

- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 19, datë 15.11.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

KONKLUSIONE

Megjithëse nga ana DPSHTRR-së u pretendua se ankuesi është larguar nga puna për shkak të ristrukturimit të institucionit, si dhe për shkak të ndryshimit të kërkesave të pozicionit të punës lidhur me arsimin, Komisioneri vlerësoi se ky argumentim nuk qëndronte, pasi nuk ishte i mbështetur në asnjë nga provat dhe informacionet e vëna në dispozicion nga palët.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se DPSHTRR:

- Nuk kishte të parashikuar në Rregulloren për Organizimin dhe Funksionimet e të saj, apo ndonjë dokument tjetër, se *specialistët e testimit*, të kishin përfunduar studimet e larta si “*Inxhinier Mekanik*”. Pavarësisht këtij fakti, ky arsyetim nuk i ishte bërë me dije ankuesit. Gjithashtu, edhe nëse do të ishte miratuar ndryshimi, se *specialistët e testimit*, duhet të kishin përfunduar studimet e larta si “*Inxhinier Mekanik*”, ankuesi nuk duhet të ishte larguar nga puna me këtë arsyetim.
- Fakti që nga ana e DPSHTRR-së nuk u vunë në dispozicion të KMD-së, kopje të dosjeve të specialistëve të testimit, krijoi dyshimin se mes tyre mund të ekzistojnë punonjës të cilët nuk plotësojnë kriterin arsimor “*Inxhinier Mekanik*”, të kërkuar nga punëdhënësi.
- Pavarësisht faktit që gjatë këtij ndryshimi të pësuar në strukturën e datës 23.04.2018, numri i punonjësve specialist të testimi, është shtuar me një pozicion më tepër, ky pozicion nuk i është ofruar ankuesit.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se H. D., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit H. D., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, për shkak të bindjeve politike.

Në referim të pikës 1, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e H. D., në pozicionin specialist testimi, në Sektorin e Testimeve Praktike, të Degës së Drejtuesve të Mjeteve, në DRSHTRR Tiranë.

43. B. XH., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.

VENDIM NR. 116, DATË 09.09.2019

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar pranë Shoqërisë Albpetrol sh.a., prej 30 vitesh dhe së fundmi, ka mbajtur pozicionin e Operatorit të Shitjes së Naftës, pranë Qendrës së Përpunimit të Naftës Fier. Pas ndryshimit të Drejtuesit të Institucionit, ankuesi është larguar nga detyra, për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi B.Xh. ka qenë punonjës i Shoqërisë Albpetrol sh.a nga data 04.02.1985 deri në datë 01.01.2019 dhe në përfundim të marrëdhënieve të punës ka mbajtur pozicionin e punës “Operator i Shitjes së Naftës”. Bazuar në provat e administruara, subjekti ankues mbart shkakun e bindjes politike pasi ka depozituar pranë KMD-së Kartën e Anëtarësisë, ku evidentohet se ankuesi është anëtarë i subjektit politik Partia Demokratike.

Gjatë procesit të ristrukturimit organizativ të shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe krijimit të Qendrës së re të Prodhimit të Naftës Fier, nga totali dy vendeve të punës ‘Operator i Shitjes së Naftës’, ku ishin të punësuar B. Xh., dhe shtetasi V. Z., u reduktua në një. Duke qenë se nga sistemi i pikëzimit ankuesi ishte renditur me pikë më shumë se shtetasi V. Z., për rrjedhojë vijoi marrëdhëniet e punës në QPN Fier.

Më pas, procesi i ristrukturimit përfshiu një tjetër shkurtim të fuqisë punëtore në sektorin Ballsh Hekal të QPN Fier. Si rezultat i zbatimit të Marrëveshjes Hidrokarbure dhe dorëzimit të vendburimit Ballsh-Hekal shoqërisë Anio Oil & Gas sh.a. struktura e sektorit u reduktua në 23 vende pune dhe u krijua një grup prodhimi i emërtuar Grupi Nr. 7. Me ndryshimin e strukturës, vendi i punës së mbante ankuesi ‘Operator i Shitjes së Naftës’ u shkurtua dhe për pasojë nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., nisën procedurat e zgjidhjes së marrëdhënieve të punës, ku me Vendimin nr. 1282, datë 31.12.2018 të Albpetrol sh.a., ankuesit është njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me arsyetimin e ristrukturimit organizativ të Shoqërisë Albpetrol sh.a. dhe dorëzimit të vendburimit të naftës Ballsh-Hekal, shoqërisë Anio Oil sh.a.

Përsa më lart dhe në analizë të situatës së ankuesit lidhur me largimin e tij nga pozicioni i punës, Komisioneri vlerëson se, justifikimi i Shoqërisë Albpetrol sh.a., se ky largim ka ndodhur në kuadër të dorëzimit të vendburimit Ballsh-Hekal, Shoqërisë Anio Oil & Gas sh.a. dhe suprimimit të pozicionit të punës që ai mbante, nuk është objektivisht i justifikuar. Fakti që, pjesë të strukturës së Grupit 7, u bënë punonjës që kanë qenë në dispozicion të QPN Fier, pavarësisht se nuk ishin pjesë e strukturës përpara reduktimit të saj, hedh poshtë pretendimet e ngritura nga Shoqëria Albpetrol sh.a. Gjithashtu, fakti që pjesë të procesit të pikëzimit janë bërë pozicione pune apo punonjës të cilët nuk kanë qenë të parashikuar në strukturën e Grupit

7, është një tjetër provë që hedh poshtë pretendimet e Shoqërisë Albpetrol sh.a., se pjesë të sistemit të pikëzimit janë bërë vetëm punonjësit të cilëve nuk u shkurohej pozicioni i punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 496/10, datë 25.06.2018, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018”.

KONKLUZIONE

Shtetasi V. Z., përpara bashkimit të QPN Patos dhe QPN Ballsh i është nënshtruar vlerësimit sipas sistemit të pikëzimit drejtpërdrejtë me ankuesin dhe pavarësisht faktit që në atë proces pozicioni i tij i punës është suprimuar, nuk është larguar nga puna, por është emëruar në pozicionin “Roje”, ndërsa ankuesit nuk i është ofruar asnjë pozicion tjetër gjatë procedurës së ristrukturimit por është marrë vendimi i largimit nga puna. Sipas të dhënave²⁸ zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në zgjedhjet vendore të vitit 2011 shtetasi V. Z., ka qenë pjesë e listës shumëmemore për Këshilltarë të subjektit politik Partia Socialiste (PS), i renditur me numrin pesë.

Struktura e re, pas dorëzimit të vendburimit Ballsh-Hekal, Shoqërisë Anio Oil sh.a., nuk kishte parashikuar pozicionin e Rojes. Në procesin e pikëzimit dhe emërimit të punonjësve në pozicionin e Operatorit të Prodhimit në Organikën e Grupit 7, janë përfshirë 3 roje dhe ky pozicion nuk i është ofruar ankuesit.

Pavarësisht faktit që ankuesi kishte arsim të përgjithshëm dhe kishte punuar si operator prodhimi apo operator nafte, për mbi 30 vjet, nga ana e Komisionit është vlerësuar që ankuesi të mos bëhet pjesë e sistemit të pikëzimit.

Nga vlerësimi përpara ndryshimit të strukturës së Grupit 7, në pozicionin Operator Prodhimi janë emëruar punonjës të cilët kanë mbajtur më parë pozicionin Shofer (si psh: M. Ç., dhe A. B.), me pikë më pak se ankuesi.

²⁸ http://www.cec.org.al/Portals/0/Documents/CEC%202013/zgjedhje-vendore/2011/html_lshumemerore/110920 - DTI - listat shumemerore tjera 2011/report1/2963.htm

Nga Shoqëria Albpetrol sh.a nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlijnin faktin se procedura e ndjekur për largimin përfundimtar të ankuesit nga puna ka ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se B. Xh., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit B. Xh., nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a., për shkak të bindjeve politike.

44. A. LL., kundër Bashkisë Gjirokastrë

VENDIM 193, DATË 02.10.2018

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka punuar në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve në Bashkinë Gjirokastrë, në pozicionin e Specialistes së Kulturës (Bibliotekës), prej rreth 12 vitesh dhe është larguar nga puna për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesja ka qenë punonjëse në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve në Bashkinë Gjirokastrë, në pozicionin e Specialistes së Kulturës, prej rreth 12 vitesh. Bashkia Gjirokastrë në kuadër të riorganizimit të strukturës së saj, ka shkurtuar pozicionin që mbante ankuesja. Në kuadër të këtij ndryshimi të strukturës, ishte shtuar një pozicion i ri pune, si specialist e organizator eventesh, protokoll i aktiviteteve, menaxher dhe specialist i punës në OJF. Në këto kushte, Bashkia Gjirokastrë, kishte bërë largimin e ankuseses për shkak se nuk plotësonte kriteret e pozicionit të ri të punës.

Pavarësisht faktit që nga ana e Bashkisë Gjirokastrë pretendohet se një nga arsyet e largimit nga puna të ankuseses, ishte dhe mungesa e kualifikimeve për përdorimin e programeve bazë të kompjuterit, rezulton që punonjësit E. B., dhe A. B., që kanë zëvendësuar ankuesen, në dosjet e tyre personale nuk disponojnë certifikatë për përdorimin e programeve bazë të kompjuterit. Në këto kushte, pretendimi i ngritur nga ana e Bashkisë Gjirokastrë nuk qëndronte.

Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2015 në Shqipëri, në drejtimin e Bashkisë Gjirokastrë u emërua Z. R., si propozim²⁹ i subjektit politik Lëvizja Socialiste për Integrim. Z. R., ka patur një aktivitet të spikatur politik. Gjithashtu, u administruan prova se ankuesja kishte një aktivitet të njohur dhe ishte anëtare e subjektit politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Me emërimin e Z. R., në krye të Bashkisë Gjirokastrë, u bë ndryshimi i strukturës së institucionit, duke shkurtuar pozicionin që mbante ankuesja. Pavarësisht se nuk ishin vendosur kriteret për pozicionin e ri të shtuar në strukturën e re të Bashkisë Gjirokastrë, ky pozicion nuk i ishte ofruar ankuseses, duke i bërë ndërprerjen e menjëhershme të kontratës së punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.

²⁹ <http://www.lsi.al/prezantohet-ne-gjirokastr-kandidatja-e-aleances-per-shqiperine-europiane-per-kryetare-e-bashkise-znj-zamira-rami/>

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*”, i ndryshuar, Nenet 9, 21, 23, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 19, datë 15.11.2007 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Larte.

KONKLUZIONE

Referuar informacionit dhe provave të vëna në dispozicion nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, në pozicionin e specialistit të bibliotekës së fëmijëve, fillimisht ka qënë ankuesja dhe A. M., e cila ishte punonjëse prej vitit 2004. Pas largimit të ankuses nga pozicioni i punës, në Agjencinë e Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve, janë kryer disa emëtime të reja. Fillimisht në pozicionin e Përgjegjësit të Bibliotekës është emëruar A. M. Më pas në pozicionin e specialistit dhe organizatorit të eventeve, është emëruar A. A., pozicion të cilin e ka mbajtur deri më datë 07.08.2018, pasi ka dhënë dorëheqjen. Me largimin e A. A., nga ky pozicion, është bërë emërimi i E. B., në pozicionin e specialistit dhe organizatorit të eventeve. Gjithashtu në pozicionin e specialistes së bibliotekës, është bërë emërimi i A. B.

Përsa më lart, pavarësisht faktit që nga ana e Bashkisë Gjirokastrë pretendohet se një nga arsyet e largimit nga puna të ankuses, ishte dhe mungesa e kualifikimeve për përdorimin e programeve bazë të kompjuterit, rezulton që punonjësit E. B., dhe A. B., në dosjet e tyre personale nuk disponojnë çertifikatë për përdorimin e programeve bazë të kompjuterit. Në këto kushte, pretendimi i ngritur nga ana e Bashkisë Gjirokastrë nuk qëndronte.

Pavarësisht faktit, që pozicioni i ri i punës mund t’i ishte ofruar ankuses, duke qënë se i plotësonte kriteret, një gjë e tillë iu mohua nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, duke e vënë kështu në pozita të pabarabarta me punonjësit e tjerë të emëruar.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se Bashkia Gjirokastrë:

- Nuk kishte të parashikuar në organikën apo strukturën e miratuar, përshkrimet dhe kriteret e pozicioneve të punës së punonjësve të Agjencisë së Kulturës, Turizmit, Trashëgimisë dhe Sporteve.
- Largimi i ankuses nga pozicioni i punës, është bërë në mënyrë të pajustificuar dhe të pa argumentuar ligjore.
- Ndryshimi i strukturës së Bashkisë Gjirokastrë preku vetëm pozicionin që mbante ankuesja.

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerësoi se A. LL., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankueses.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetas A. LL., nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, për shkak të bindjeve politike.

Në referim të pikës 1, Bashkia Gjirokastrë, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e A. LL., në pozicionin e mëparshëm të punës.

45. B. D., kundër Postës Shqiptare dhe Filialit të Postës Fier

VENDIM NR. 171, DATË 20.11.2019

Shkaku: Bindja politike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar pranë Postës Shqiptare, Filiali Fier, që nga viti 2016. Pas ndryshimit të Drejtuesit të Institucionit, ankuesi është larguar nga detyra, për shkak të bindjeve politike.

FAKTET

Ankuesi ka filluar punë pranë Postës Shqiptare sh.a., Filiali Fier, më datë 21.09.2016, në pozicionin e Përgjegjës të Burimeve Njerëzore. Referuar propozimit të Filialit të Postës Fier më datë 19.06.2017, ankuesi është transferuar në pozicionin e Specialistit Kosto-Normative/Paga Statistikë.

Referuar Strukturës Organizative të Filialit të Postës Fier, rezulton se arsimi i kërkuar për pozicionin e punës së Përgjegjës të Burimeve Njerëzore është Arsimi i Lartë (pa specifikuar) dhe niveli i pagës 46600 lekë-55000 lekë. Sa i përket pozicionit të punës së Specialistit Kosto-Normative/Paga Statistikë, arsimi i kërkuar për këtë pozicion pune është vetëm Arsimi i Lartë Ekonomik dhe niveli i pagës 45100 lekë-52800 lekë.

Duke qenë se kishte përfunduar arsimin e lartë për Drejtësi dhe nuk plotësonte kërkesat e pozicionit të punës, me shkresën datë 20.06.2017, i është drejtuar punëdhënësit duke e bërë me dije se nuk pranonte këtë pozicion pune dhe duke i kërkuar emërimin në një pozicion në përputhje me arsimin e tij, pasi nuk plotëson kriteret e këtij pozicioni. Në këto kushte, më datë 08.01.2018, ankuesi është emëruar në pozicionin e Specialistit të Cilësisë dhe Sigurisë, në përshtatje me arsimin e tij.

Referuar Strukturës Organizative, rezultoi se arsimi i kërkuar për pozicionin e punës së Specialistit të Cilësisë dhe Sigurisë është Arsimi i Lartë (pa specifikuar) dhe niveli i pagës 46600 lekë-55000 lekë.

Nga Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a., Filiali i Postës Fier është audituar për periudhën 01.02.2016-30.11.2017. Në përfundim të procedurës së auditimit, më datë 12.01.2018, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të shoqërisë, në lidhje me detyrat e ushtruara nga ana e ankuesit, ka konstatuar shkelje në detyrën e ushtruar nga ankuesi gjatë periudhës që ka ushtruar pozicionin e Përgjegjës të Burimeve Njerëzore dhe pozicionin e Specialistit të Kosto-Normative/Paga Statistikë. Sipas Postës Shqiptare sh.a., në përfundim të auditimit të kryer, Drejtoria e Auditit ka rekomanduar dhënien e masës disiplinore “*Ulje në detyrë dhe caktimin në një vend pune që paguhet më pak*”, për ankuesin dhe Përgjegjësen e Sektorit të Shërbimeve dhe Marketingut.

Në vijim, nga ana e Administratorit të Shoqërisë me shkresën datë 24.05.2018, referuar konstatimeve të bëra nga Drejtoria e Auditit, ka vendosur për ankuesin, dhënien e masës disiplinore *“Ulje në detyrë dhe caktimin në një vend pune që paguhet më pak”*.

Mbështetur në propozimet e ardhura nga ana e Filialit të Postës Fier, Administratori i Shoqërisë, me anë të Urdhërit datë 11.07.2018, ka urdhëruar: *“B. D., të lirohet nga detyra ‘Specialist i Sigurisë-Cilësisë e Standarteve’ në Sektorin e Shërbimeve dhe Marketingut dhe të emërohet ‘Shpërndarës’ në Zyrën Postare Qendër Fier”*. Referuar urdhërit të sipërcituar, Filiali i Postës Fier, me datë 25.07.2018, ka urdhëruar emërimin e ankuesit në pozicionin *“Shpërndarës”* në Zyrën Postare Qendër Fier.

Në analizë të informacionit të sipërcituar, gjatë periudhës që ankuesi ka qenë me leje vjetore, nga ana e Filialit të Postës Shqiptare është emëruar në pozicionin e Shpërndarësit, në Zyrën Postare Qendër Fier. Gjithashtu, pavarësisht faktit që ankuesi rezultonte me leje, nga ana e Filialit të Postës Fier, është hartuar kontrata që mban datën 23.07.2018 për emërimin e B. D., në pozicionin e Shpërndarësit, ku në fund të saj rezulton që është cituar *“Refuzoi firmën”* dhe është firmosur nga Drejtoria e Filialit dhe shtetasit³⁰ T. Ll., A. C., dhe E. K.

Mbështetur në provat e administruara, rezulton që Kontrata e Punës që mban datën 23.07.2018 për emërimin e B. D., në pozicionin e Shpërndarësit, në fund të saj është cituar *“Refuzoi firmën”* dhe është firmosur nga Drejtoria e Filialit dhe shtetasit T. Ll., A. C., dhe E. K. Pra, në këto kushte bie poshtë pretendimi i Filialit të Postës Shqiptare se ankuesi e ka pranuar këtë pozicion që në datën e emërimit të tij.

Në vijim, ankuesi është njoftuar nga ana e Filialit të Postës Fier për nisjen e procedurës për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës. Në vijim, me anë të shkresës datë 26.10.2018, Filiali i Postës Fier ka njoftuar ankuesin për përfundimin e marrëdhënieve të punës, ku sërish ankuesi ka nënshkruar marrjen dijeni dhe ka sqaruar se këtë detyrë e ka refuzuar që më datë 08.10.2018.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- *“Karta Sociale Evropiane”* e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

³⁰ Punonjës të Filialit të Postës Fier.

KONKLUSIONE

Nisur nga kronologjia e ngjarjeve, lidhur me largimin e ankuesit nga pozicioni i Përgjegjës të Burimeve Njerëzore dhe emërimin e tij në pozicionin e Specialistit të Kosto-Normativë/Paga e Statistikë;

- Rezulton që emërimi në pozicionin e Specialistit të Kosto-Normativë/Paga e Statistikë, është bërë duke mos marrë parasysh Strukturën Organizative të Filialeve dhe arsimin e ankuesit.
- Argumentimi i Filialit të Postës Shqiptare, se emërimi në pozicionin “*Specialist Kosto-Normative/Paga Statistikë*” të ankuesit, është bërë pasi: ky pozicion kërkon kriter arsimin e lartë dhe përparësi merr arsimit të lartë ekonomik, si dhe ankuesi zotëron një eksperiencë 10 vjeçare si Administrator i Biznesit Privat, nuk qëndronte pasi është në kundërshtim me parashikimet ligjore që rregullojnë marrëdhëniet e punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit dhe për më tepër janë në dëm të këtij të fundit. Kjo pasi, punëdhënësi ka ndryshuar në mënyrë të njëanshme kushtet e punës me të.

Së dyti, lidhur me largimin e ankuesit nga pozicioni i Specialistit të Sigurisë dhe Cilësisë dhe emërimin e tij në pozicionin e Shpërndarësit:

Komisioneri vlerëson se kalimi i ankuesit nga pozicioni i punës “Përgjegjës i Burimeve Njerëzore në atë të Specialistit të Kosto-Normativë/Paga e Statistikë”, është në fakt ndërprerje e kontratës së parë të punës dhe fillim i një kontrate të re pune, pavarësisht se ka vijuar vazhdimësia e marrëdhënies kontraktore të punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit në aspektin financiar, ankuesit i kanë ndryshuar tre elementë thelbësorë siç janë: *pozicioni, kategoria dhe paga*. Pra, ankuesi ka kaluar në një pozicion më të ulët pune, ku arsimit i kërkuar është i lartë Ekonomik dhe paga është më e ulët.

Pavarësisht faktit se ankuesi ka kaluar nga pozicioni i Specialistit të Kosto-Normativë/Paga e Statistikë, në detyrën e Specialistit të Sigurisë dhe Cilësisë, ai është ulur në detyrë duke u emëruar në detyrën e “*Shpërndarësit*”. Në referim të Strukturës së Filialit të Postës Fier, ky pozicion ka si kriter arsimor Arsimin e Mesëm dhe niveli i pagës është nga 31000 lekë deri në 34600 lekë.

Për sa më lart, Komisioneri, konstaton se ai është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe se masat e marra për transferimet apo largimin e tij nga puna janë të pajustificuara, jo proporcionale dhe të pa bazuar në prova dhe ligj.

Në kushtet kur, nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. dhe Filialit të Postës Fier nuk u arrit të provohej që transferimi në një pozicion pune jashtë kriterëve arsimorë dhe zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qenë e justifikuar dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se qëndrimi i punëdhënësit ndaj tij ishte tendencioz dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkak të bindjeve të tij politike.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit B. D., nga ana e Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. dhe Filiali i Postës Fier, për shkak të bindjeve të tij politike.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa nga ana e strukturave të Shoqërisë Posta Shqiptare sh.a. dhe Filialit të Postës Fier, për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me shtetasin B. D.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES EKONOMIKE

46. Grup personash kundër Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 89, DATË 05.04.2018

Shkaku: Gjendja ekonomike dhe raca
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Subjektet ankues ishin përfitues të banesave sociale dhe kishin lidhur kontratë me Bashkinë e Tiranës. Në pamundësi të pagesës së qirasë, për shkak të rënies së të ardhurave mujore, ata ishin njoftuar nga Bashkia Tiranë për të liruar banesat për mospagimin të detyrimeve të prapambetura, për shkak të gjendjes ekonomike dhe races.

FAKTET

Subjektet ankues, në muajin Shtator 2015 kishin lidhur kontratë me Bashkinë Tiranë dhe ishin përfitues të banesave sociale. Kontratat ishin lidhur në bazë të të ardhurave nga punësimi, ndihma ekonomike, pagesa e aftësisë së kufizuar dhe deklaratat e të ardhurave nga mbledhja e materialeve të riciklueshme. Më pas, të gjendur në pamundësi ekonomike për të shlyer detyrimet (për shkak të papunësisë, ndërprerjes së ndihmës ekonomike dhe ndalimit të veprimtarisë së riciklimit nga Bashkia Tiranë), nuk kanë mundur të paguajnë më qiranë e banesave dhe janë njoftuar nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale të Bashkisë Tiranë, për të paguar detyrimet e prapambetura.

Në këto kushte, i janë drejtuar disa herë me shkresë zyrtare Bashkisë Tiranë për të vlerësuar situatën ekonomike të çdo familjeje dhe për t'i ofruar zgjidhje për këtë situatë.

Në fillim të muajit shtator ishin njoftuar nga ana e Bashkisë Tiranë, për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ose në të kundërt duhet të lironin banesat brenda datës 30 Shtator 2017.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/ Çështja Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 9232/2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerësoi se, situata e mospagesës së qirasë të banesës sociale nga ana e këtyre familjeve kishte ardhur për arsye që lidheshin me pamundësinë ekonomike për të paguar, si pasojë e rënies të të ardhurave mujore të tyre.

- Këto familje, në momentin e aplikimit për përfitimin e një banese sociale kanë bërë vetë-deklarimin e të ardhurave, bazuar në veprimtaritë ekonomike informale, siç ishte mbledhja e materialeve të riciklueshme. Mirëpo, pas veprimeve të ndërmarra nga Policia Bashkiake për ndalimin e mbledhjes së këtyre materialeve, si dhe ndalimit të përdorimit të automjeteve të modifikuara për transportin e mallrave, disa nga këto familje, duke mos mundur të ushtronin këto veprimtari janë gjendur në pamundësi për të përballuar shpenzimet e nevojshme të jetesës, ndër to dhe pagesën e qirasë së banesave sociale ku jetojnë.
- Nga ana e Bashkisë Tiranë nuk janë sjellë prova apo dokumentacion ku të mund të provohet se nga ana e tyre ishte bërë paraprakisht një analizë e situatës mbi vlerësimin e efekteve apo impaktit që do të kishin veprimet e ndërmarra nga ana e Policisë Bashkiake.
- Nuk u paraqit asnjë plan konkret për krijimin dhe ofrimin e mundësive reale apo alternativave për punësimin e kësaj kategorie personash që ushtronin këtë aktivitet, goftë ky dhe informal.
- Pjesa më e madhe e anëtarëve në moshë pune të këtyre familjeve figurojnë me statusin e punëkërkuesit të papunë, regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Tiranë.
- Komisioneri vlerësoi se, si pasojë e varfërisë, përjashtimit social dhe mungesës së arsimimit dhe kualifikimeve përkatëse, shumica e romëve dhe egjiptianëve kanë vështirësi për t'u punësuar në tregun formal.
- Komisioneri vlerësoi se, në rrethanat e pamundësisë ekonomike të këtyre familjeve, zgjidhja e mundshme e kontratës së qirasë së banesës dhe lirimi i saj, e cila do të sillte si pasojë humbjen e strehës për familjen, do të thellonte më tepër krizën social-ekonomike të tyre.
- Të gjitha këto familje plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 5 të ligjit nr.9232/2004 “Për programet sociale të strehimit”, i ndryshuar, për t'u përzgjedhur si përfituese të banesave sociale, për shkak të kushteve të vështira social-ekonomike të tyre.
- Komisioneri vlerësoi se Bashkia Tiranë duhet të fokusohet në gjetjen e një zgjidhjeje të përshtatshme dhe të qëndrueshme në kohë, për familjet në pamundësi ekonomike në mënyrë që këto familje të mund të krijojnë të ardhura të qëndrueshme dhe të mjaftueshme për jetesë, si dhe të përbushin detyrimet kontraktore kundrejt Bashkisë Tiranë.
- Komisioneri gjykoi se, Bashkia Tiranë, duhet të bënte sa më shpejt të jetë e mundur një rivlerësim të situatës social-ekonomike për këto familje, në funksion të përcaktimit të masës së subvencionimit të qirasë së ofruar nga ana e këtij institucioni; duke e shoqëruar me marrjen e një plani masash integruese në tregun e punës, gjë që do të ndikonte në aspektin financiar të familjeve përfituese.

- Lidhur me njoftimin publik për lirimin e banesave në rast të mos shlyerjes së detyrimeve, Komisioneri vlerësoi që përpara se të ndërmernte veprime të tilla, Bashkia Tiranë duhet të bënte një analizë paraprake të situatës dhe një vlerësim të gjendjes sociale, nevojave dhe të ardhurave ekonomike të këtyre familjeve; dhe në përfundim të analizimit të këtyre të dhënave, duhet të ndërmernte të gjitha masat e nevojshme, për të evituar që këto familje të mbeteshin të pastreha apo ekspozoheshin dhe më tej ndaj shkeljeve të tjera të të drejtave të njeriut, çka do të çonte në diskriminim të tyre për shkak të gjendjes ekonomike dhe racës së tyre, krahasuar me pjesën tjetër të familjeve që posedojnë një banesë sociale dhe që kanë aftësi paguese për qiranë mujore.
- Komisioneri vlerësoi se Bashkia Tiranë duhet t'u siguronte mundësi reale integrimi në tregun e punës, familjeve debitore që banojnë në banesat sociale me qira.
- Komisioneri vlerësoi se lidhja e një akt-marrëveshjeje midis Bashkisë Tiranë dhe familjeve debitore, për likuidimin me këste të përballueshme të detyrimeve të prapambetura kontraktore, do t'u krijonte mundësi reale këtyre familjeve të shlyenin detyrimet e bartura dhe qiranë mujore në vijim dhe do të krijonte premisat për një mundësi integrimi konkrete të tyre.

Komisioneri konkludon se, mos parashikimi i një praktike aktuale rivlerësimi, në kushtet e reja, pas përkeqësimit të situatës së tyre financiare nga ana e Bashkisë Tiranë, i ka vënë ata në pozita diskriminuese duke rrezikuar që ata të mbeteshin të pastrehë dhe se rivlerësimi objektiv i situatës, shoqëruar me rritjen e masës së subvencionimit të qirasë së banesës sociale nga ana e Bashkisë Tiranë, rast pas rasti, si dhe me masa të tjera integruese, do të rrisnin mundësinë që pagesat e qirasë të ishin të realizueshme, gjë që do të ndikonte pozitivisht në qasjen konkrete social ekonomike të këtyre familjeve në shoqëri.

Komisioneri vlerëson se bazuar në faktin që ky program strehimi ishte i dedikuar vetëm për familjet që kishin mundësi pagese, familjet e gjendura në pamundësi pagese të qirasë për shkak të rënies të të ardhurave të tyre ekonomike, ishin vënë në pozita të pafavorshme dhe të pabarabarta me familjet që kishin mundësi pagese.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të drejtpërdrejtë, të subjekteve ankues: N. N., N. Sh., B. M., dhe Q. L., nga ana e Bashkisë Tiranë, për shkak të “gjendjes së tyre ekonomike” dhe “të racës”.

Në referim të pikës 2, Bashkia Tiranë, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj këtij grupi personash, të bëjë rivlerësimin e masës së subvencionimit të qirasë së banesës sociale, të paguar nga Bashkia.

47. Grup personash kundër Bashkisë Lezhë

VENDIM NR. 116, DATË 04.05.2018

Shkaku: Gjendja ekonomike dhe sociale
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Ankuesit janë banorë të ish-kampit të të burgosurve Torovicë, të cilët janë vendosur në ato ndërtesa pas vitit 1991. Që nga ajo kohë e në vazhdim ky komunitet është përballur me vështirësi ekonomike, mungesë të ujit të pijshëm, grumbullim të mbetjeve urbane për shkak të mungesës së konteniereve të vendosur nga ana e njësisë vendore, infrastrukturë rrugore të amortizuar dhe gjendje të amortizuar të ambienteve të banimit. Me anë të mosveprimeve nga ana e Bashkisë Lezhë, këta banorë janë përballur me një situatë diskriminuese.

FAKTET

Nga informacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezulton se, banorët e ish-kampit të të burgosurve Torovicë, janë vendosur në ato ndërtesa pas vitit 1991. Që nga ajo kohë e në vazhdim ky komunitet është përballur me vështirësi ekonomike, mungesë të ujit të pijshëm, grumbullim të mbetjeve urbane për shkak të mungesës së konteniereve të vendosur nga ana e njësisë vendore, infrastrukturë rrugore të amortizuar dhe gjendje të amortizuar të ambienteve të banimit.

Së pari, prej vitesh, gjendja e infrastrukturës rrugore që lidh Torovicën me aksin rrugor Lezhë-Shkodër, është tejet e amortizuar dhe nuk është kryer asnjë investim. Nga ana e Bashkisë Lezhë në vitin 2016 dhe 2017, janë dërguar pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe Fondit të Zhvillimit të Rajoneve, mes të tjerash edhe projekti për asfaltimin e rrugës Balldre-Torovicë-Bent, me një vlerë 657,108, 372 lekë, por që ende nuk është marrë një miratim nga ana e këtyre institucioneve. Segmenti rrugor prej 500 m, që lidh qendrën e fshatit Marlecaj me ish-kampin e Torovicës, ka nisur të mirëmbahet nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Bashkisë Lezhë.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procedurave hetimore, Bashkia Lezhë ka marrë masa duke hartuar gjatë viteve 2016-2017, projektin për përmirësimin e infrastrukturës rrugore që lidh segmentin kombëtar nga qendra e fshatit Balldre me Torovicën, pjesë e rrugës që prek jo vetëm banorët e ish-kampit, por të gjithë komunitetin e Torovicës.

Së dyti, u konstatua se mungesa e ujit të pijshëm për banorët e ish kampit të Torovicë, është një tjetër problematikë e cila nuk ka gjetur zgjidhje nga ana e ish-Komunës Balldre, por edhe nga ana e Bashkisë Lezhë aktualisht. Banorët arrijnë të sigurojnë ujin e pijshëm nëpërmjet autoboteve të subjekteve private të cilët furnizojnë të gjithë banorët kundrejt një pagese. Gjithashtu, kundrejt pagesës nga ana e banorëve sigurohet edhe uji për përdorim të përditshëm (për higjienën personale dhe familjare, larjen e rrobave etj).

Së treti, grumbullimi i mbetjeve urbane pranë banesave të tyre është një tjetër problematikë që ka vijuar dhe vijon të jetë prezent. Nga informacioni i administruar, rezultoi që Bashkia Lezhë ka vënë në dispozicion të këtyre banorëve kontenierë për grumbullimin e mbetjeve urbane, por që janë të vendosur në një largësi prej 300 metra (në qendër të Marlecaj) nga ish-Kampi i Torovicës. Në këto kushte, banorët e ish-kampit të Torovicës përballen me vështirësi për të aksesuar kontenierët e vendosur nga ana e pushtetit lokal, pasi ndodhen në një distancë të konsiderueshme nga banesat e tyre.

Së katërti, referuar informacionit dhe provave të administruara, ndërtesat e ish-kampit të Torovicës prej vitesh janë në një gjendje tejte të amortizuar kanë nevojë emergjente për rikonstruksionin e tyre. Që nga momenti që këto familje janë vendosur në këto ambjente, nga ana e pushtetit lokal nuk është bërë asnjë përpjekje për të marrë masa për gjetjen e një zgjidhje alternative për strehimin e tyre.

Së fundmi, sa i përket gjendjes së tyre ekonomike, Bashkia Lezhë mbështetur në mundësitë financiare që disponon dhe nëpërmjet projekteve me organizata jo qeveritare, ka marrë masa për të mbështetur ankuesit me ndihmë ekonomike, por edhe duke i mbështetur me paketa ushqimore, pajisje shtëpiake apo bagëti të imta.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës (ECRI).
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 10164, date 15.10.2009, “Për autoritetin rrugor shqiptar”.

KONKLUSIONE

Pavarësisht faktit, që Bashkia Lezhë ka marrë masat për vendosjen e kontenierëve të mbetjeve urbane, ato janë në një largësi të konsiderueshme nga banesat e ankuesve për ti aksesuar, çka sjell si rezultat grumbullimin e mbetjeve pranë banesave të tyre, duke ndotur në këtë mënyrë mjedisin që i rrethon dhe duke rrezikuar shëndetin nga përhapja e sëmundjeve.

Në këtë kuadër, referuar informacionit të administruar, Bashkia Lezhë nuk vuri në dispozicion të KMD-së asnjë informacion zyrtar, projekt apo plan, mbi masat që ka marrë ose që do të ndërmarrë për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe gjetjen e një zgjidhje alternative, për strehimin në kushte sa më dinjitoze të banorëve të ish-kampit të të burgosurve Torovicë.

Përsa më lartë, në analizë të fakteve³¹ dhe provave të sipërcituara, kushtet e infrastrukturës rrugore, mungesa e ujit të pijshëm dhe mungesa e kontenierëve të grumbullimit të mbetjeve urbane, janë fakte të njohura prej kohësh, për të cilat Bashkia Lezhë nuk ka marrë asnjë masë për t'i dhënë zgjidhje kësaj situate. Mos përmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, nga ana e Bashkisë Lezhë, vendos në pozita të pabarabarta ankuesit me banorë të tjerë të kësaj njësie administrative për të cilat janë marrë masa për përmirësimin e kushteve të jetesës.

Përsa i përket shkaqeve të pretenduara nga ankuesit, bazuar në informacionin e depozituar dhe fakteve të bëra publike në media, konstatohet gjendja e rënduar ekonomiko-sociale e ankuesve, ndërsa nga ana e Bashkisë Lezhë, nuk është paraqitur asnjë provë, argument apo fakt i dokumentuar, që do të justifikojë mosmarrjen e masave për sigurimin e ujit të pijshëm, strehimit apo infrastrukturës rrugore.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e Strukturave të Bashkisë Lezhë, në dëm të ankuesve, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të gjendjes ekonomike dhe sociale, të subjekteve ankuese M. V., D. H., dhe P. H., nga ana e Bashkisë Lezhë.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Bashkisë Lezhë, për sigurimin e ujit të pijshëm dhe kontenierëve të mbetjeve urbane, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga e marrja dijeni për këtë vendim.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Bashkisë Lezhë, për gjetjen e zgjidhjeve alternative për strehim dhe përmirësimin e infrastrukturës rrugore, për banorët e ish-kampit të të burgosurve Torovicë.

³¹ <https://www.youtube.com/watch?v=ZXNZ3yLnVIY;>
<https://www.youtube.com/watch?v=hwQAPHQDP1M;>
<https://www.youtube.com/ëatch?v=nsaSyNvAhf8;>

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES ARSIMORE

48. L. DH., kundër Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (USH)

VENDIM NR. 187, DATË 16.12.2019

Shkaku: Gjendja arsimore
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka aplikuar për një vend pune në pozicionin e asistent-lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të Biologji-Kimisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Ajo është skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit për mospërmbushje të kriterit të veçantë të shpallur nga Departamenti.

FAKTET

Referuar njoftimit të bërë në faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, nr. 24, datë 17.06.2019, për një vend pune në pozicionin e asistent-lektore me kohë të plotë për seminarët dhe laboratorët e lëndës “Bio-Kimi mjekësore” dhe lëndës “Bio-Kimi” pranë Departamentit të Biologjisë dhe Kimisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, ankuesja ka paraqitur aplikimin e saj. Njoftimi ka të specifikuarat kërkesat që kandidatët duhet të plotësojnë për këtë pozicion pune, në kriteret specifike dhe kriteret të përgjithshme.

Dosja e kandidates L. Dh., është skualifikuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit, Komision Ad-Hoc, i ngritur për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozicionin e shpallur. Pas disa ankimeve të ankueses, USH ka informuar atë se kandidatura e saj është shkualifikuar nga ana e Komisionit Ad-Hoc vetëm për kriteret specifike të vendosura nga njësia bazë, pra kandidati duhet të jetë diplomuar “Master i shkencave” në “Biologji molekulare” me notë mesatare jo më të ulët se 8.5. Nga aktet e depozituara gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, u provua se ankuesja është diplomuar në degën “Biologji-Kimi” në vitet akademike 2001-2005, diplomë 4-vjeçare dhe me Diplomë Doktrate, ka fituar gradën shkencore “Doktor” në Biologji Molekulare pranë Universitetit të Tiranës.

Bazuar në neni 124/2 të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, diploma e L.Dh është ekuivalente me diplomën e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave”, gjë që bën që ajo të përmbushë kriterin e përcaktuar nga Departamenti i Biologji-Kimisë, sa i takon kërkesës për diplomë të nivelit të dytë “Master i shkencave”, për më tepër që ankuesja zotëron gradën shkencore “Doktor” në drejtimin “Biologji Molekulare” që është një kualifikim dhe më i thelluar i njohurive për kriterin e vendosur “Master i Shkencave” me drejtim “Biologji molekulare”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Social Evropiane, nenet 1 “Pjesë I” dhe “Pjesa V”.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- “Kodi i Punës”, neni 9
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUZIONE

Pas analizimit të procedurës së ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve për një vend pune në pozicionin e asistent lektore me kohë të plotë pranë Departamentit të Biologji-Kimisë, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Komisioneri, konstatoi se, përjashtohen nga konkurrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë kandidatët që zotërojnë një diplomë, që ka zgjatur 4 vite akademike (8 semestra), në fushën Biologji-Kimi, pavarësisht se mund të jenë me tituj shkencor më të lartë se kriteret e kërkuara. Ky kriter bëhet dhe më i pakuptimtë kur kandidatja plotëson kriterin e diplomimit të ekuivalentuar në Master shkencor dhe Doktoraturë në fushën e biologjisë molekulare, por studimet i ka përfunduar përpara periudhës kur ka filluar zbatimin e procesit të Bolonjës, kusht në të cilin ndodhet ankuesja e skualifikuar. Ky veprim krijon dyshimin e arsyeshëm që kandidati fitues të jetë i paracaktuar.

Komisioneri vlerësoi se, në kushtet kur, nga ana e USH-së është vendosur që kriteri, “Master i shkencave” me drejtim “Biologji molekulare” të jetë specifik, atëherë ky kriter duhet të shërbente si kriter vlerësues dhe për rrjedhojë mund të ndryshonte nivelin e pikëzimit, vlerësimit, por nuk duhet të çonte në skualifikimin e kandidates. Skualifikimi i menjëhershëm i kandidates dhe mos përfshirja e saj në pikëzim, ka cenuar të drejtën e ankueses për një konkurs të ndershëm e të drejtë nga ana e USH.

Komisioneri vlerëson se kriteret dhe kualifikimet e kandidatëve, duhet të jenë të diferencuara sipas shkallës së kualifikimit të kandidatëve dhe se vendosja e kufizimeve për kandidatët duhet bërë vetëm në rastet kur është absolutisht e nevojshme mbrojtja në veçanti e interesave të rëndësishme të palëve të interesuara dhe duhet që në të gjitha rastet, masa kufizuese e për zgjedhur të përmbajë cenimin më të vogël të mundshëm, me qëllim që t’i sigurohet të gjithë të interesuarve e drejta për të zgjedhur profesionin dhe për të siguruar mjetet e jetesës nëpërmjet punësimit.

Në përfundim, Komisioneri vlerëson se kandidatja dhe të gjithë kandidatët në kushte të njëjta me ankuesen, diskriminohen në mënyrë të tërthortë nga vendosja e kriterit specifik, sipas të cilit kandidati/tët të cilët zotërojnë një diplomë, që ka zgjatur 4 vite akademike (8 semestra), në fushën Biologji-Kimi, skualifikohen që në fazën e parë.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të L. Dh., dhe të gjithë kandidatëve në kushte të njëjta me të, nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me vendosjen e kriterit specifik nr. 2, në procedurën e konkursit për pozicionin e asistent-lektorese së brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë pranë këtij universiteti, duke përsëritur rishtaz procedurën e punësimit në funksion të gjetjeve të konstatuara në këtë vendim.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të ndryshojë kriterin përjashtues në të gjitha njoftimet për punësim për personel akademik dhe të parashikojë në aktet nënligjore, detyrimin e njësive bazë për të shpjeguar me shkrim në mënyrë të arsyetuar vendosjen e kriterëve të propozuara, që nga data e daljes së këtij vendimi.

49. L. DH., kundër Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (USH)

VENDIM NR. 166, DATË 14.11.2019

Shkaku: Gjendja arsimore
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka aplikuar për një vend pune në pozicionin e lektorese së brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”. Ajo është skualifikuar nga Komisioni i Vlerësimit për mospërmbushje të kriterit të veçantë.

FAKTET

Referuar njoftimit të bërë në faqen e APP nr.48, datë 03.12.2018, për një vend pune në pozicionin e lektorese së brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, (USH) ankuesja L. Dh., ka paraqitur aplikimin e saj. Njoftimi kishte të specifikuar kërkesat që kandidatët duhet të plotësojnë për këtë pozicion pune, në kriteret të përgjithshme dhe kriteret të veçanta.

Dosja e kandidates L. Dh., është skualifikuar nga ana e Komisionit të Vlerësimit, Komision Ad-Hoc, i ngritur për vlerësimin dhe përzgjedhjen e kandidatit fitues për pozicionin e shpallur. Pas disa ankimeve të ankueses, USH ka informuar atë se kandidatura e saj është skualifikuar nga ana e Komisionit Ad-Hoc vetëm për kriteret preferenciale të vendosura nga njësia bazë, pra punimi i doktoraturës duhet të ishte në përshtatje me nevojat e Departamenti Biologji-Kimi, ku preferohej Botanika, duke cituar se, aplikanti duhet: *“Të ketë titullin akademik apo gradën shkencore “Doktor” në Biologji, preferohet me aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”.*

Nga aktet e depozituara gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, u provua se ankuesja mbante, gradën shkencore “Doktor” në “Biologji molekulare”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Social Evropiane, nenet 1 “Pjesë I” dhe “Pjesa V”.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 64/1.
- “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- “Kodi i Punës”, neni 9

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Pas analizimit të procedurës së ndjekur nga Komisioni i Vlerësimit të kandidatëve për një vend pune në pozicionin e lektorese së brendshme pranë Departamentit të Biologji-Kimisë, në Universitetin e Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Komisioneri, konstatoi se, përjashtohen nga konkurrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë të gjithë kandidatët³², përfshirë edhe ankuesen, që kanë titullin akademik apo gradën shkencore “Doktor” në Biologji, por që nuk kanë aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”, duke bërë paragjykes që në fillim gjithë procesin. Ky veprim krijon dyshimin e arsyeshëm që kandidati fitues është paracaktuar nga ana e këtij Komisioni.

Komisioneri vlerësoi se, në kushtet kur, nga ana e USH është vendosur që ky kriter, pra drejtimi në “Botanikë” të jetë preferencial, atëherë ky kriter duhet të shërbente si kriter vlerësues dhe për rrjedhojë mund të ndryshonte nivelin e pikëzimit, vlerësimit, por nuk duhet të çonte në skualifikimin e kandidates. Skualifikimi i menjëhershëm duke mos vlerësuar dosjen e ankuses, për rrjedhojë, mos përfshirja e saj në pikëzimin e kandidatëve, ka cenuar të drejtën e ankuses për një konkurs të ndershëm e të drejtë nga ana e USH.

Komisioneri vlerësoi se kriteret dhe kualifikimet e kandidatëve duhet të jenë të diferencuara sipas shkallës së kualifikimit të kandidatëve dhe se vendosja e kufizimeve për kandidatët duhet bërë vetëm në rastet kur është absolutisht e nevojshme mbrojtja në veçanti e interesave të rëndësishme të palëve të interesuara dhe duhet që në të gjitha rastet, masa kufizuese e për zgjedhur të përmbajë cënimin më të vogël të mundshëm, me qëllim që të sigurohet të gjithë të interesuarve e drejta për të zgjedhur profesionin dhe për të siguruar mjetet e jetesës nëpërmjet punësimit.

Në përfundim, Komisioneri konstatoi se kandidatja dhe të gjithë kandidatët në kushte të njëjta me ankuesen, diskriminohen në mënyrë të tërthortë nga vlerësimi që Komisioni i bën kriterit preferencial, sipas të cilit kandidati i cili duhet të ketë titullin akademik apo gradën shkencore “Doktor” në Biologji, preferohet me aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”, duke sjellë skualifikimin e tyre që në fillim.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të tërthortë të L. Dh., dhe të gjithë kandidatëve në kushte të njëjta me të, nga ana e Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër, përmes vlerësimit të gabuar nga ana e Komisionit të kriterit preferencial, sipas të cilit kandidati i cili duhet të ketë titullin akademik apo gradën shkencore “Doktor” në Biologji, *preferohet me aktivitet të pasur botues dhe drejtim në “Botanikë”*.

Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me skualifikimin e kandidates L. Dh., në konkursin për pozicionin e lektorese së brendshme pranë

³² Kandidatët që kanë konkurrar, po ashtu edhe ata që “hipotetikisht” mund të kishin konkurrar.

Departamentit të Biologji-Kimisë pranë këtij universiteti, duke përsëritur rishtaz procedurën e punësimit në funksion të gjetjeve të konstatuara në këtë vendim.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHOQERORE

50. E. D., kundër Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit (IMT) të Bashkisë Durrës

VENDIM NR. 165, DATË 13.11.2019

Shkaku: Gjendja shoqërore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka patur një banesë në proces legalizimi që në vitin 2005. Në vitin 2017, ankuesja është arrestuar dhe është dënuar me burg për kryerjen e një veprë penale. Nga ana e IMT Bashkia Durrës, pa vënë në dijeni ankuesen, është bërë prishja e banesës së saj gjatë periudhës që ajo ka qenë duke kryer dënimin me burg. Këto veprime kanë përballur ankuesen me trajtim të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e IMT-së Durrës, për shkak të gjendjes shoqërore si e dënuar.

FAKTET

Ankuesja në vitin 1994, ka ndërtuar një shtëpi banimi një-katëshe. Më datë 24.03.2005, është paraqitur pranë Bashkisë Durrës dhe ka kryer Vetëdeklarim për legalizimin e kësaj ndërtese, duke kryer pagesën e detyrimeve për shërbimin e legalizimit. Në kufi me pronën e ankuses, më datë 23.03.2005, F. Z., ka bërë Vetëdeklarim për Legalizim të dy ndërtesave të banimit me sipërfaqe 120 m² e ndërtuar mbi një truall me sipërfaqe 450 m². Lidhur me këtë deklaram Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 490, datë 18.06.2013 *“Për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale”*, ka miratuar kalimin e pronësisë së parcelës ndërtimore në favor të poseduesit, shtetasit F. Z. Me anë të Deklaratës Noteriale datë 22.01.2016, shtetasi F. Z., ka deklaruar se është dakord që procedura për legalizimin dhe regjistrimin e këtij ndërtimi të vazhdojë në emër të ankuses dhe se heq dorë nga çdo pretendim në të ardhmen mbi këtë pronë.

Referuar akteve të vëna në dispozicion, së pari dokumentit³³ të lëshuar nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, E. D., ka lidhur kontratë të Energjisë Elektrike dhe paguan energjinë e konsumuar që prej muajin Dhjetor të vitit 2007. Ndërsa referuar Vërtetimit datë 02.05.2019, të lëshuar nga Ujësjellës Kanalizime Durrës sh.a., konstatohet se është abonente prej muajit Mars 2010 deri në Maj 2019.

Më datë 03.02.2017, pas kontrollit të ushtruar nga ana e strukturave të policisë së shtetit në banesën e ankuses, ajo është arrestuar si e dyshuar për veprën penale të “Prodhimin dhe

³³ Datë 03.05.2019

shitjes së narkotikëve”. Nga muaji Shkurt 2017, deri më datë 10.04.2019, ka vuajtur dënimin me burg pranë Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Ali Demi”, Tiranë.

Gjatë kohës që ka qenë duke vuajtur dënimin me burg, është vënë në dijeni nga ana e personelit të IEVP-së, se nga banesa e saj janë vjedhur të gjitha orenditë, si dhe dyer e dritare. Më datë 10.04.2019, kohë kur ankuesja ka dalë nga IEVP, ka konstatuar se banesa e saj ishte prishur dhe është vënë në dijeni se këto veprime janë kryer nga strukturat e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Durrës.

Pasi ankuesja ka konstatuar prishjen e ndërtimeve të saj, i është drejtuar IMT-së Durrës, duke kërkuar informacionin përkatës. Në përgjigje të kërkesës së paraqitur nga ankuesja, IMT Durrës ka vënë në dispozicion³⁴ të gjithë dokumentacionin dhe praktikën e ndjekur për prishjen e tre banesave të saj.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Ligji Nr. 44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë*”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*”.
- Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje*”, i ndryshuar, neni 2.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Në analizë të parashikimeve ligjore, strukturat e IMT-së Durrës, ndjekin këtë praktikë dhe hapat e parashikuara në Ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007 “*Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme*”, në momentin që ndërtimet pa leje janë ndërtuar pas datës 27.06.2014 ose në proces ndërtimi. Pasi për të gjithë ndërtimet pa leje të ndërtuara deri më datë 27.06.2014, zbatohet Ligji Nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje*”, i ndryshuar.

Mbështetur në legjislacionin në fuqi, konstatohet se ndërtimet e ankueses nuk prekeshin dhe nuk bënin pjesë në objektin apo fushën e veprimit të Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007 “*Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme*”, të ndryshuar, por të Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje*”, i ndryshuar. Referuar provave dhe fakteve të vëna në dispozicion nga ana e palëve në proces, për këto ndërtime ankuesja kishte dorëzuar dhe kishte bërë aplikimin përkatës për legalizimin e tyre. Gjithashtu, fakti që ankuesja ka aplikuar dhe dorëzuar pranë Bashkisë Durrës dhe ALUIZNI-t, të gjithë dokumentacionin e kërkuar, si dhe pagesat përkatëse nga

³⁴ Me anë të shkresës Nr. 853/1 Prot., datë 23.04.2019

viti 2005 e në vijim, për legalizimin e ndërtimeve të saj, provon edhe një herë se ndërtimet e saj janë objekt i Ligjit Nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje*”.

Pavarësisht se ka kërkuar nga ana e strukturave të Policisë së Shtetit dhe Bashkisë Durrës mbështetjen e tyre në procesin e prishjes së ndërtimeve të ankueses, IMT Durrës nuk ka marrë asnjë masë për verifikimin e rastit apo të ndërtimeve të ankueses, nëse janë në proces legalizimi apo janë ndërtime *pa leje të ndërtuara pas datës 27.6.2014*, siç parashikohet në ligjin Nr. 9482, datë 03.04.2006 “*Për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje*”, të ndryshuar.

Në vijim të arsyetimit, përveç faktit që nga ana e IMT-së Durrës nuk është zbatuar legjislacioni i duhur për prishjen e ndërtimeve të ankueses, gjithashtu nuk është vënë në dispozicion asnjë provë apo fakt se në raste të ngjashme me ankuesen ky institucion ka vepruar në të njëjtën mënyrë.

Në kushtet kur, nga ana e IMT-së Durrës nuk u arrit të provohej që procedura e ndjekur për prishjen e ndërtimeve të ankueses, ndjek një qëllim të ligjshëm, si dhe veprimet e kryera janë të arsyeshme dhe proporcionale, Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e IMT-së Durrës, pikërisht për shkakun e pretenduar prej saj, atë të gjendjes shoqërore si e dënuar.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të E. D., për shkak të gjendjes shoqërore pasi vuante dënimin me burg, nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Durrës.

51. Rr. Rr., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)

VENDIM NR. 97, DATË 05.04.2018

Shkaku: Gjendja shoqërore dhe gjendja ekonomike
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Subjektit ankues i ishte ndërprerë furnizimi me energji elektrike duke i përkeqësuar kushtet e jetesës. Familja e tij përbëhej nga 4 persona dhe burimi i vetëm i të ardhurave ishte pagesa e përfituar nga skema e ndihmës ekonomike, në masën 5.000 lekë dhe e kishte të pamundur përballimin e pagesës së faturës së energjisë elektrike për shkak të gjendjes shoqërore dhe

FAKTET

Ankuesit Rr. Rr., që nga data 04.01.2018, i ishte ndërprerë furnizimi me energji elektrike gjë që kishte përkeqësuar kushtet e jetesës. Burimi i vetëm i të ardhurave të familjes së tij që përbëhej nga 4 persona, ishte pagesa e përfituar nga skema e ndihmës ekonomike, në masën 5.000 lekë dhe e kishte të pamundur përballimin e pagesës së faturës së energjisë elektrike.

Ligji Nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, parashikon gëzimin e disa të drejtave të veçanta lidhur me furnizimin me energji elektrike, të siguruara në raste përjashtimore, si pasojë e gjendjes sociale. Këshilli i Ministrave duhej që, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e tij, të miratonte aktet nënligjore për kriteret dhe procedurën për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

Subjekti ankues është penalizuar nga mos nxjerrja e këtyre akteve, pasi mund të ishte përfitues i statusit të klientit në nevojë dhe në këtë rast nuk do t'i ndërpritej furnizimi me energji elektrike, gjë që nuk do të ndikonte negativisht në mënyrën e jetesës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 52/2, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Direktiva 2009/72/EC e Parlamentit Europian dhe Këshillit të Evropës.
- Ligji Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektike”, neni 95, 96.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1,3/5, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- VKM Nr. 503, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.
- VKM Nr. 504, datë 13.09.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

KONKLUSIONE

Komisioneri analizoi situatën e krijuar, duke iu referuar jo vetëm ankesës individuale të RR.RR, por duke e shtrirë problematikën për të gjithë kategorinë e personave që përfitojnë statusin e “klientit në nevojë”, për shkak se mungesa e akteve nënligjore për kriteret dhe procedurën për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, prek drejtpërdrejtë jo vetëm ankuesen si individ, por të gjithë kategorinë sipërcituar.

Komisioneri vlerësoi si masë pozitive hartimin e draft rregullores nga ana e ERE-s “Mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike të klientëve në nevojë”, të cilën e gjen plotësisht të bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, si dhe në përputhje të plotë me parashikimet e LMD-së³⁵ dhe konstatoi se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si struktura përkatëse për hartimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre, të cilat më pas miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor.

Komisioneri konstaton se, mungesa e marrjes së masave për nxjerrjen e akteve nënligjore për hartimin e kriterëve, procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, të cilat miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, ka çënuar rëndë jo vetëm përmbushjen e nevojave më minimale të një jetese normale të kësaj kategorie përfituesish, por edhe dinjitetin e tyre.

Në këtë kuadër, Komisioneri, konstaton se RR.RR, si dhe e gjithë kategoria e personave të cilët sipas përcaktimeve të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, mund të rezultojnë përfitues të statusit të “klientit në nevojë”, janë vënë në pozita jo të favorshme në përputhje me parashikimet e vetë këtij ligji; duke iu mohuar atyre mundësinë për të përfituar nga furnizimi me energji elektrike në periudha të caktuara gjatë të cilave gëzojnë statusin e klientit në nevojë apo dhe në rastet kur klienti, ka paraqitur dhe është në proces të trajtimit të kërkesës së tij, për t’u klasifikuar si “klient në nevojë”, duke i vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të gjendjes së tyre sociale dhe të asaj ekonomike.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit i RR.RR., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për shkak të gjendjes sociale dhe gjendjes ekonomike, përmes mosnxjerrjes së aktit nënligjor, në të cilin parashikohen kriteret dhe procedurat e përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyra e trajtimit të tyre.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të hartojë aktin nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përfitimit të statusit të klientit në nevojë dhe mënyrës së trajtimit të tyre, sipas përcaktimeve të Ligjit nr.43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

³⁵ Shkurtesë për ligjin “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

52. Ex-Officio e çështjes së përlogaritjes së punës së kryer të të dënuarve me burgim kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB)

VENDIM NR. 100, DATË 05.04.2018

Shkaku: Gjendja Shoqërore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Komisioneri ndoqi kryesisht çështjen e shpërblimit të punës së kryer për të dënuarit me burgim në IEVP e ndryshme të Republikës së Shqipërisë. U konstatua se për punën e kryer në burgje ishin krijuar dy praktika, lidhur me përfitimin nga puna: Një pjesë e personave të dënuar që punojnë në burgje shpërbleheshin sipas Vendimit nr. 228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, të Këshillit të Ministrave, duke u shpërblyer me një shumë prej 90 (nëntëdhjetë) lekësh/muaj, ndërsa, pjesa më e madhe e të dënuarve me burgim që kryenin punë të ndryshme në burgje përfitonin ulje dënimi rreth 3.9 ditë/muaj punë sipas Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, në kundërshtim me legjislacionin

FAKTET

Komiteti Shqiptar i Helsinkit³⁶ informoi Komisionerin lidhur me problematikën e hasur gjatë trajtimit të kërkesave/ankesave të të burgosurve apo nga monitorimet e kryera prej tyre në burgje. Komisioneri nisi hetimin kryesisht të kësaj çështjeje dhe u ndodh përpara faktit se, për punën e kryer në burgje ishin krijuar dy praktika: administrative dhe gjyqësore lidhur me përfitimin nga puna. Një pjesë e personave të dënuar që punonin në burgje shpërbleheshin sipas Vendimit nr.228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, të Këshillit të Ministrave, duke u shpërblyer me një shumë prej 90 (nëntëdhjetë) lekësh/muaj, megjithëse ky akt është miratuar përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar. Ndërsa, sipas këtij ligji, të dënuarit që punojnë duhet të trajtoheshin sipas parashikimeve të Kodit të Punës dhe të paguhen me pagë minimale. Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e të dënuarve me burgim që kryenin punë të ndryshme në burgje përfitonin ulje dënimi rreth 3.9 ditë/muaj punë sipas Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor, në kundërshtim me legjislacionin në fuqi për punësimin e të burgosurve”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49/2, 52/1, 116.

³⁶Në vijim do t'i referohemi me shkurtësën KSHH.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Rekomandimi (2006)2, i Këshillit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “Rregullat Evropiane të Burgjeve”.
- Ligji Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, neni 5/2, 34.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1,3/5, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Dekreti Nr. 7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje të lirisë, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, i Presidiumit të Kuvendit Popullor.
- VKM Nr. 228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, i Këshillit të Ministrave.
- VKM Nr. 437, datë 20.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”.

KONKLUSIONE

Komisioneri analizoi situatën e sjellë në vëmendje nga KSHH, parë kjo në respektim të zbatimit të Kushtetutës së R.SH, Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si dhe legjislacionit³⁷.

Komisioneri konstatoi se në 23 burgje të RSH punonin një numër i konsiderueshëm i personave të dënuar me burgim, të cilët:

- Nuk trajtoheshin nga administrata e burgjeve njësoj si shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgjeve, në përputhje me legjislacionin e mësipërm të punës apo të trajtimit të personave të burgosur (për të drejtën e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë në punë, kohëzgjatjes së punës, shpërblimit për punën, ditët e pushimit etj).
- Vetë IEVP-të nuk operonin në të njëjtën mënyrë, ndonëse parashikimet ligjore janë të njëjta për të gjitha institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale në Republikën e Shqipërisë. Pra, nuk kishte një praktikë të unifikuar dhe nga vetë këto institucione.
- Një pjesë e personave të dënuar që punonin në burgje shpërbleheshin sipas Vendimit nr.228, datë 19.05.1993 “Për mënyrën e shpërblimit të punës së të dënuarve me heqje lirie”, të Këshillit të Ministrave, me një shumë prej 90(nëntëdhjetë) lekësh muaj, ndërsa, pjesa më e madhe e të dënuarve me burgim që kryenin punë të ndryshme në burgje përfitonin ulje dënimi rreth 3.9 ditë/muaj punë sipas Dekretit nr.7289, datë 08.04.1989 “Për zbritjen e dënimit të personave të dënuar me heqje lirie, që aktivizohen në punë, kur plotësojnë e tejkalojnë normën”, të Presidiumit të Kuvendit Popullor.

Lidhur me këtë problematikë, Komisioneri vlerësoi se, organet e drejtësisë si gjykata, prokuroria dhe administrata e burgjeve kishin lejuar që një pjesë e personave të dënuar me

³⁷Të brendshëm dhe atij ndërkombëtar.

burgim të përfitonin ulje apo shlyerje të kohës së dënimit, duke iu llogaritur atyre ditët e punës së kryer si ditë burgu, sipas kritereve të dekretit të mësipërm.

- Komisioneri konstatoi gjithashtu se, të dënuarit që punonin në IEVP nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me librezë të kontributeve shoqërore. Në këtë këndvështrim atyre nuk iu paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, çka do të passillte më pas dhe mosvlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë.

Në analizë të sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, personat e dënuar që punojnë punë të ndryshme brenda organikës së burgut duhet të shpërbleheshin me pagë minimale, sipas kritereve të përcaktuara me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave. Në interpretim të parashikimeve ligjore, ata konsiderohen “punëmarrës” dhe duhet të trajtohen në përputhje me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar; pasi megjithëse aktualisht në burgje punojnë një numër i konsiderueshëm i personave të dënuar me burgim, ata nuk trajtohen nga administrata e burgjeve njësoj si shtetasit e tjerë të punësuar jashtë burgut. Kjo sa i takon punësimit dhe trajtimit të tyre gjatë kësaj marrëdhënieje, apo sa i takon të drejtës për mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë, kohëzgjatjes së punës, shpërblimit për punën, ditët e pushimit, etj.

Referuar korrespondencës zyrtare me DPB-në, Komisioneri vlerësoi iniciativat ligjore të ndërmarra prej saj, lidhur me hartimin dhe përcjelljen në adresë të Ministrisë së Drejtësisë për konsultim të mëtejshëm të Projekt-VKM-së “Për nxitjen dhe shpërblimit të punës të burgosurve”³⁸ dhe njëherësh vlerësoi si të nevojshëm ndërhyrjen apo rregullimin e disa parashikimeve të këtij projekt-vendimi, në përputhje edhe me parashikimet ligjore të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Lidhur me këtë, Komisioneri bëri rekomandime specifike të cilat iu bashkëngjiten këtij vendimi.

Në këtë përfundim, Komisioneri, konstaton se personat që vuajnë dënimin në burgje apo ndodhen në paraburgim dhe janë të punësuar pranë këtyre institucioneve, janë vënë në pozita jo të favorshme krahasuar me kategorinë e punonjësve që punojnë dhe ndodhen jashtë këtyre institucioneve; duke iu mohuar atyre mundësinë për të përfituar sipas parashikimeve ligjore respektive.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të drejtpërdrejtë të të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për shkak të gjendjes së tyre sociale (si të dënuar) në fushën e punësimit, në raport me punonjësit e tjerë jashtë burgjeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Ministrave; të mbajnë parasysh rekomandimet e Komisionerit për ndryshimet dhe shtesat e sugjeruara në Projekt-Vendimin “Për nxitjen dhe shpërblimit të punës të burgosurve”.

³⁸ Referuar shkresës me Nr. 1969 Prot., datë 09.03.2017 dhe relacionin bashkëngjitur shkresës.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË SHTATZANISË

53. J .H ., kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) (ish- ZQRPP)

VENDIM NR. 168, DATË 18.11.2019

Shkaku: Shtatzania
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë e punësuar me kontratë më afat të caktuar, në detyrën e Specialistes Hartografe, pranë ish- ZQRPP-së (Sot ASHK). Asaj i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës gjatë periudhës që ka qenë me leje lindjeje.

FAKTET

Subjekti ankues, J. H., nëpërmjet Urdhërit për “Emërim në Detyrë” Nr. 211 Prot, datë 21.02.2017, ka lidhur marrëdhëniet e punës me ish-ZQRPP dhe ka nënshkruar Kontratën Individuale të punës, me kohëzgjatje të përkohshme, duke filluar nga data 21.02.2017-31.12.2017, në detyrën e Specialistes.

Nëpërmjet Urdhërit për “Emërim në Detyrë”, datë 29.12.2017, ka nënshkruar Kontratën Individuale të punës, me kohëzgjatje të përkohshme, nga data 03.01.2018-03.07.2018, në detyrën e Specialistes Hartografe në Sektorin e Përditësimit Dixhital të Hartës.

Referuar Vërtetimit, datë 09.05.2019 të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë, J. H., është trajtuar me raport barrë lindjeje, nga data 23.04.2018-13.04.2019.

Kontrata e punës midis J.H., dhe ish-ZQRPP ka përfunduar me përfundimin e afatit të kontratës”, me datë 03.07.2018, pra gjatë periudhës që ajo ka qenë me raport barrë lindjeje, të paguar nga DRSSH Tiranë.

Para përfundimit të lejes së lindjes, me datë 08.04.2019, ka paraqitur pranë Institucionit një kërkesë, nëpërmjet së cilës kërkonte që, me mbarimin e lejes së lindjes të rikthehej në punë. Ankueses i është komunikuar verbalisht nga drejtori i Projektit se nuk mund të rifillonte punë në pozicionin që ajo kishte patur para se të merrte lejen e lindjes, pasi marrëdhënia juridike e punës me ish-ZQRPP-së/ASHK ka përfunduar në fund të kohës së parashikuar në kontratë, me datë 03.07.2018.

Nëpërmjet shkresës, datë 16.04.2019 ankuesja i është drejtuar ASHK duke kërkuar të njihet me arsyet dhe procedurën e ndjekur lidhur me largimin e saj nga puna (për të cilin nuk kishte marrë asnjë njoftim zyrtar, por vetëm komunikim verbal nga Drejtorja e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, pranë ASHK-së), si dhe ka kërkuar të rikthehet në detyrën që ajo mbante si “Specialiste Hartografe”.

Me shkresën datë 20.09.2019 ASHK, pas 5 muajve, i ka kthyer përgjigje kërkesës së ankueses, duke e informuar se: *“Në përgjigje të kërkesës tuaj, përmes së cilës informoni se me datë 12.04.2019 keni përfunduar lejen e lindjes dhe kërkonit të rifilloni punë pranë Projektit, ku dhe keni punuar më parë, ju bëjmë me dije se, kontrata juaj e punës me ZRPP ka përfunduar në fund të kohës së parashikuar në kontratë, me datë 03.07.201.*

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 54/1, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Konventa nr.183 “Mbrojtja e amësisë, 2000”, neni 8.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Direktiva 76/207 të KEE-së.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
- Direktiva EC Directive 1992/85.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 107/1, 147/1/2, 149/1.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Ankuesja është trajtuar me raport barrë lindje nga data 23.04.2018-13.04.2019.
- ASHK ka ndërprerë marrëdhënien e punës me ankuesen me mbarimin e kontratës së punës me të, e cila ka përfunduar me datë 03.07.2018, pra gjatë periudhës që ajo ka qenë me raport barrë lindje, të paguar nga DRSSH Tiranë.

Pra, lidhur me sa më sipër, punëdhënësi ka patur dijeni se ankuesja ishte me leje barrë lindje dhe gjatë kësaj kohe ajo ka përfituar pagesë nga Sigurimet Shoqërore dhe jo nga ASHK-ja (punëdhënësi).

Nga analizimi në tërësi i fakteve dhe legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerësoi se, ankuesja është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të paligjshëm nga ana e ASHK, trajtim, i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë me faktin që ajo ka qenë me raport për lejen e lindjes për shkak të paaftësisë së përkohshme në punë, leje e cila është e mbështetur në dispozitat përkatëse ligjore. Një fakt i tillë nuk është marrë në konsideratë nga ASHK-ja, por ka përfunduar marrëdhëniet e punës me ankuesen, në një kohë të papërshtatshme për zgjidhjen e kontratës së punës në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Punës, në një kohë që kontrata e punës me ankuesen nuk mund të konsiderohej e përfunduar ende. Ankuesja është ekspozuar haptazi përpara një trajtimi të pa drejtë nga ana e ASHK, pikërisht për shkak të lejes së saj të lindjes.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, J. H., për shkak të “shtatëzanisë³⁹”, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

Agjencia Shtetërore e Kadastrës, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me kërkesën e paraqitur nga J. H., për punësim pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

³⁹ Gjatë ushtrimit të lejes së lindjes.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRKATËSISË PRINDËRORE

54. O. G., kundër Kolegjit Independent Tiranë.

VENDIM NR. 88, DATË 05.04.2018

Shkaku: Përkatësia prindërore
Forma: Diskriminim i drejtëpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Në gjykatë

Fëmija i ankueses nuk është pranuar për t'u regjistruar në klasë të I-rë nga Kolegji Independent për shkak se prindi i saj është ankuar në drejtim të metodave të punës që përdor personeli mësimdhënës i Kolegjit.

FAKTET

Ankuesja ka vërtetuar se, në datë 04.07.2017, me anë të një kërkesë me shkrim ka kërkuar nga Kolegji që t'i vihej në dispozicion një formular për regjistrimin e vajzës së saj në klasë të parë.

Drejtuesi i Kolegjit me shkresën datë 06.07.2017, ka informuar prindin se për shkak të kërkesave të shumta dhe numrit të kufizuar të nxënësve për klasë nuk mund të regjistrojë vajzën në klasë të parë për shkak se janë mbyllur regjistrimet si dhe i ka bërë me dije prindit se: "... Në përfundim të vitit shkollor 2016-2017 keni shprehur pakënaqësinë në lidhje me metodën e punës që përdoret në Kolegj, si dhe preferencat në lidhje me personelin mësimdhënës".

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 116.
- "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", nenet 80 dhe 82.
- Ligji 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë".
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUZIONE

Në dokumente të ndryshme të Kolegjit, si Rregullore e Brendshme e Kolegjit, Kontrata tip dhe deklaratës së F.V, konstatohet se nuk ka një shifër të saktë për numrin e nxënësve në klasë, pasi ky numër varion nga 20 në 24 nxënës për klasë, dhe se në datë 06.07.2017 ka pasur vetëm 7 nxënës që kishin dorëzuar formularin e regjistrimit apo kishin konfirmuar për tu regjistruar në klasë të parë.

Referuar dokumenteve të administruara mbi procedurat e përdorura nga Kolegji në lidhje me regjistrimin e nxënësve në klasë të parë, Komisioneri ka konstatuar se, Kolegji ka pranuar

dhe regjistruar nxënës në klasë të parë deri në një periudhë më shumë se dy muaj pas datës 06.07.2017, datë kur është bërë kërkesa nga O. G., për regjistrimin e vajzës së saj në klasë të parë.

Më shkresën datë 19.07.2017, drejtuar Kolegjit, O. G., është ankuar dhe është shprehur se si ka mundësi që të gjithë fëmijët e grupit të vajzës së saj janë regjistruar dhe vajza e saj nuk është regjistruar. Gjithashtu, ankuesja i ka bërë me dije Kolegjit se fëmija i saj po diskriminohet për shkak të pakënaqësive që ka shprehur ajo si nënë në drejtim të metodave të punës që përdor personeli mësimdhënës i Kolegjit.

Kolegji nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankueses që do të ndihmonte në zgjidhjen dhe sqarimin situatës por e ka trajtuar çështjen sikur institucioni nuk ka detyrim ligjor për të kthyer përgjigje ndaj një ankese për diskriminim.

Komisioneri ka konstatuar se ndjekja e një të drejte ligjore që ka prindi për të diskutuar dhe kërkuar përmirësimin e mësimdhënies, nuk përbën shkelje apo cenim të ndonjë të drejte apo imazhit të institucionit arsimor.

Komisioneri ka konstatuar se përveç trajtimit të pabarabartë të fëmijës, Kolegji në asnjë moment nuk ka marrë në konsideratë pasojat psikologjike që mund ti shkaktoheshin asaj nga ndarja me shokët dhe shoqet e klasës.

Lidhur me sa më sipër, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri ka vlerësuar se fëmija V. K., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Kolegjit, për shkak të përkatësisë prindërore, duke u diskriminuar për shkak të pakënaqësive të shprehura nga O. G., në drejtim të metodave të punës që përdorëshin në Kolegj.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të shtetas V. K., nga ana e Kolegjit, për shkak të përkatësisë prindërore.

Konstatimin e viktimizimit, të shtetas V. K., nga ana e Kolegjit “The Independent”.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRGJEGJËSISË PRINDËRORE

55. A. B., kundër Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZQRPP)

VENDIM NR. 56, DATË 13.02.2018

Shkaku: Përgjegjësia prindërore dhe gjinia
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi A. B., i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës nga punëdhënësi, ZQRPP, gjatë periudhës që ka qenë me raport mjekësor, për përkujdesjen e fëmijës, në kuadër të përgjegjësisë prindërore që ka secili prind në rritjen e fëmijës.

FAKTET

Subjekti ankues, A. B., ka qenë në marrëdhënie pune me Zyrën Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, në detyrën specialist në Sektorin e Regjistrimit dhe Hartografisë Zona 2, nga data 22.10.2013 deri me datën 26.04.2017.

Nga verifikimi i dokumentacionit në dosje rezulton se, subjekti ankues me datë 24.03.2017 ka qenë në punë⁴⁰. Nëpërmjet raporteve mjekësore, të cilat janë paraqitur pranë ZVRPP Shkodër, dokumentohet se ankuesi ka qenë raport mjekësor për ushtrimin e “Lejes prindërore”, për periudhën kohore 26.03.2017-24.06.2017.

Me datë 25.05.2017 ankuesit i është komunikuar lirimi nga detyra, ndërkohë që ai rezulton me raporte mjekësore për “Lejen prindërore”, që përpara kësaj date, konkretisht që në datën 26.03.2017.

Ai është vënë në dijeni të këtij fakti me shkresën me nr.3562/1, datë 26.05.2017 kur Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër⁴¹, i ka kthyer subjektit ankues raportet mjekësore të paraqitura prej tij, me arsyetimin se me datën 24.03.2017 ai kishte qenë në punë (referuar listë-prezencës në vendin e punës) dhe po me atë datë i është komunikuar urdhëri i pezullimit nga puna dhe detyrimi për t’u paraqitur në takim me Kryeregjistruesin, në datën 27.03.2017.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 54/1, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Konventa mbi sigurimet shoqërore (standartet minimale) nr.152 e vitit 1952.

⁴⁰ Referuar Listë Prezencës në Punë.

⁴¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën ZVRPP Shkodër.

- Direktiva e Lejes Prindërore 96/34/e KE-së.
- Jurisprudenca e GJEDNJ/Çështjet Eëller kundër Hungarisë dhe Roca Álvarez kundër Spanjës.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 107/1, 147/1/2, 149/1.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 7703/1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, neni 27/7.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Ankuesi ka qenë me raport mjekësor për periudhën nga 26.03.2017-24.06.2017.
- ZQRPP ka ndërprerë marrëdhënien e punës me ankuesin me datë 26.04.2017, gjatë periudhës që ai ka qenë me raport mjekësor për përkujdesjen e fëmijës, të paguar nga DRSSH Tiranë.

Komisioneri konstatoi se, urdhëri i lirimit i datës 26.04.2017 ishte protokolluar me datë 23.05.2017, pothuajse një muaj pasi është firmosur dhe ankuesi është njohur me të gjatë periudhës kur ishte me raport mjekësor, me datë 27.05.2017.

ZQRPP nuk arriti të provojë që ankuesi kishte qenë në punë në datën e lirimit nga detyra dhe jo duke ushtruar përgjegjësinë prindërore.

Nga ana tjetër, ZQRPP, e cila kishte detyrimin dhe barrën e provës për të provuar se ankuesi nuk ishte trajtuar në mënyrë të pa barabartë e të pafavorshme nga koleget femra, të cilave u është njohur dhe paguar raporti i përkujdesjes ndaj fëmijës, pas lindjes; ZQRPP Tiranë, nuk paraqiti asnjë argument apo dokumentacion provues për të vërtetuar të kundërtën.

Për sa më sipër, Komisioneri gjeti të provuar dhe të mbështetur në argumente bindëse dhe në ligj, se shkak i përgjegjësisë prindërore (raporteve mjekësore për lejen prindërore) ka çuar në trajtimin e pafavorshëm, të padrejtë dhe të paligjshëm të ankuesit nga ana e punëdhënësit, ZQRPP Tiranë. Në këtë kontekst, në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, Komisioneri vlerësoi se ankuesi i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, krahasuar me parashikimet e legjislacionit të brendshëm, kombëtar dhe atij ndërkombëtar.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të drejtpërdrejtë të A. B., nga ana e punëdhënësit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, për shkak të “përgjegjësisë prindërore” dhe për shkak të “gjinisë”.

Në referim të pikës 1, ZQRPP Tiranë, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj ankuesit, të bëjë rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës, pranë ZVRPP Shkodër.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË MOSHËS

56. A. H., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT)

VENDIM NR. 138, DATË 02.10.2019

Shkaku: Moshë dhe gjendja familjare
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja ka qenë në marrëdhënie pune, në detyrë të ndryshme pranë administratës tatimore, për një periudhë prej 19 vitesh. Me riorganizimin e strukturës së AKSHI-t dhe të Administratës Qëndrore Tatimore, ankuesja është larguar nga shërbimi civil për shkak të moshës dhe gjendjes familjare.

FAKTET

A.H., e diplomuar për ekonomi, prej vitit 2000 ka qenë në marrëdhënie punësimi në detyrë të ndryshme në administratën tatimore, fillimisht në Drejtorinë e Tatimeve Fier dhe prej vitit 2004 është transferuar në DPT. A. H., me shkresën datë 26.03.2010, në zbatim të procedurave të ristrukturimit, është emëruar në pozicionin Specialiste në Sektorin e Pajisjeve Fiskale dhe Deklarimit on-line, në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit, në DPT. Me Vendimin datë 21.11.2016, është transferuar në pozicionin Specialist, në Sektorin e Pajisjeve Fiskale në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit në DPT.

Në datë 08.05.2018, me anë të një memoje të bërë nga ankuesja dhe A. D., i janë drejtuar Drejtores së Burimeve Njerëzore në DPT, në të cilën kanë shpjeguar detyrat dhe rëndësinë e Sektorit të Pajisjeve Fiskale, dhe kanë shprehur mendimin se ai sektor duhej të transferohej brenda një drejtorie tjetër në DPT.

Në kuadër të riorganizimit me VKM nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e AKSHI”, të Urdhrit nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në Urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”, të Urdhrit nr.106, datë 21.03.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e organigramës dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore” numri i pozicioneve të punës në Administratën Tatimore Qendrore, është reduktuar me 57 pozicione të cilat kalojnë në përbërje të AKSHI-t, që kuptonte se e gjithë Drejtoria e TIK e DPT, transferohet pa asnjë ndryshim në strukturën e AKSHI-t, duke përfshirë edhe pozicionin e Specialistit të Pajisjeve Fiskale.

Në zbatim të legjislacionit të mësipërm, DAP ka nxjerrë Urdhrin nr. 20, datë 11.03.2019, për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore. Komisioni i Ristrukturimit, i ngritur pranë DPT, me Vendimit nr. 6144, datë 21.03.2019 ka vendosur përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil të A.H.

Me shkresën datë 21.03.2019, DPT ka njoftuar A. H., për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare, si dhe trajtimin e saj sipas pikës 7, të nenit 50 të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Me shkresën datë 21.03.2019 të DAP-it, është njoftuar AKSHI dhe ankuesja, për fillimin e procedurave për vijimin e marrëdhënieve të punës në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore. Me e-mail-in datë 03.04.2019 A. H., ka njoftuar AKSHI-n se po ndjek procedurën ligjore për mos humbjen e statusit të nëpunësit civil.

Referuar deklarimeve të bëra nga përfaqësuesja e DPT në seancën dëgjimore, provohet se DPT, në kuadër të zbatimit të VKM nr. 766, datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019”, ka pasur 48 vende vakante të nivelit ekzekutiv, me status të nëpunësit civil, ndër këto rreth 20 vende vakante, kanë qenë në Drejtorinë e Përgjithshme.

Në përgjigje të interesimit të ankuses për transferimin e saj, DPT justifikohet me faktin se A. H., nuk ka bërë kërkesë për tu transferuar në një pozicion tjetër brenda strukturave të DPT-së.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- VKM Nr. 673, datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.
- VKM Nr. 125, datë 17.02.2016 “Për transferimin e përkohshëm dhe të përhershëm të nëpunësve civilë”.
- VKM Nr. 243, datë 18.03.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.
- VKM Nr. 766, datë 26.12.2018 “Për punësimin e studentëve të ekselencës në institucionet e administratës shtetërore, pjesë të shërbimit civil, për vitin 2019”.
- Urdhrit Nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit “Për disa ndryshime në UrdhrinNr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, “Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.
- Urdhrit Nr. 106, datë 21.03.2019, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e organigramës dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore”.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerëson se ankuesja deri në datë 26.03.2019, datë kur është vënë në dijeni të shkresës me datë 21.03.2019 “Për ndërprerje të marrëdhënieve financiare të A. H.”, nuk ka qenë në dijeni të përfundimit të marrëdhënies së punës në shërbimin civil, në mënyrë që të kishte mundësi që të formalizonte kërkesën e saj për qëndrimin në marrëdhënie punësimi pranë DPT. Në dokumentet e shqyrtuar nuk ekziston asnjë dokument që të provojë se ankuesja është njoftuar nga ana e DPT, për fillimin e procesit të ristrukturimit, sipas procedurës së pikës 7, të nenit 50 të Ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në të cilin shkruhet se: “Nëpunësit që i përkasin institucionit që do të ristrukturohet apo mbyllet njoftohen 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure ...”.

Gjithashtu, DPT nuk arriti të provonte se procesi i ristrukturimit dhe i transferimit të punonjësve ka qenë i barabartë për të gjithë, pasi nuk solli asnjë informacion për të vërtetuar të kundërtën e pretendimit të ankueses, se ishin të paktën dy punonjës (F. B., dhe A. F.) të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Elbasan që ishin në kushte të njëjta me ankuesen që ishin në listën e transferimit dhe nuk janë transferuar tek AKSHI, por janë sistemuar në sektorë të tjerë. Nisur nga fakti se në DPT kishte 48 vende vakante dhe DPT do lidhte kontrata të përkohshme të punës me studentë të ekselencës, tregon se DPT kishte pozicione pune vakante, pjesë e nëpunësit civil, dhe kishte mundësi që të transferonte A. H., në një pozicion tjetër pune, brenda strukturës së DPT.

Komisioneri duke konsideruar se DPT ka patur mundësinë për sistemimin e A. H., në një pozicion tjetër pune pranë strukturave të saj, ka vlerësuar se ankuesja është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana DPT, nëpërmjet mosnjoftimit lidhur me procesin e ristrukturimit si dhe duke u trajtuar ndryshe nga kolegët e saj që u transferuan në pozicione të tjera brenda strukturave të DPT.

Komisioneri vlerëson se, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve gjatë procesit të ristrukturimit duhet të kishte kryer dhe një vlerësim personal dhe profesional të çdo punonjësi që prekej nga ky proces dhe duhet të kishte marrë parasysh dhe pasojat sociale që do të sillte vendimmarrja e saj, duke shteruar çdo mundësi risistemimi në punë të punëmarrësve të cilëve iu ristrukturohej vendi i punës, në këtë rast të punonjësës A. H., e cila është beqare dhe bashkëjeton me prindërit e moshuar.

Rezultoi se DPT, ishte në dijeni të interesimit të ankueses për të vazhduar marrëdhëniet e punësimit pranë DPT. Por dështimi i strukturave të DPT, për të vënë në dijeni ankuesen në kohën e duhur, për fillimin e procesit të ristrukturimit dhe përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, i mohuan ankueses të drejtën të kishte mundësi të kërkonte zyrtarisht, për të ruajtur pozicionin e punës, me status të nëpunësit civil, brenda DPT. Si pasojë e veprimeve të DPT, rezultoi që ankuesja të mos pranonte lidhjen e marrëdhënieve të punës me AKSHI-n, sipas Kodit të Punës dhe të humbte statusin e nëpunësit civil, status për të cilin ankuesja kishte investuar përkushtimin e saj për zhvillimin e karrierës.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, të shtetases A. H., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për shkak të moshës dhe gjendjes familjare.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me A. H.

57. M. K., kundër Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)

VENDIM NR. 43, DATË 19.03.2019

Shkaku: Moshë
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesja ka aplikuar për pozicionin e punës “Oficere sigurie” në shkollat e arsimit parauniversitar dhe është skualifikuar pasi ishte mbi 40 vjeç, kriter ky i përcaktuar në VKM nr.600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”.

FAKTET

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ka shpallur procedurat për 150 vende vakante për oficerë sigurie në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar.

Ankuesja ka aplikuar për këtë pozicion pune dhe ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pranë MASR-së. Ndërkaq, me datë 17.01.2019 Zyra e Koordinimit dhe Monitorimit për oficerë sigurie e MASR-së, nëpërmjet një e-maili e ka njoftuar atë se ishte skualifikuar nga konkurimi, për shkak se ishte mbi moshën 40 vjeç, kriter i cili përcaktohet në VKM nr.600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike⁴².
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës⁴³ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- “Deklarata e ILOS mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë⁴⁴”.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”,
- Jurisprudenca e GJED⁴⁵

⁴² Hyrë në fuqi në vitin 1976.

⁴³ Ratifikuar me ligjin nr. 8086, datë 13.03.1996.

⁴⁴ ⁴⁴ International Labor Organization (Organizata Botërore e Punës)

⁴⁵ ⁴⁵ CJEU, C-416/13, Mario Vital Pérez v. Ayuntamiento de Oviedo, 13 November 2014 ;

- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

VKM Nr. 600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”.

- Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet MB dhe MASR “Për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, nenet 4, 5 dhe 14.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerëson se, oficeri i sigurisë nuk ka si rol parësor ndërhyrjen dhe konfrontimin fizik, (pa e përjashtuar se mund të lindë nevoja rast pas rasti) por megjithatë, testet fizike do të ishin një masë e mjaftueshme, për të vlerësuar, nëse kandidatët posedojnë nivelin e veçantë të kushteve fizike, të nevojshme për kryerjen e detyrës.

Pavarësisht qasjes pozitive për emërimin e një punonjësi jo mësimor/oficer sigurie në ambjentet e shkollave, në funksion në garantimit të një mjedisi të sigurt për nxënësit në shkollë dhe territorin përreth saj, nga ana e MASR nuk përligjet faktin se vendosja e këtij kriteri/moshës, ka ardhur për arsye të ligjshme dhe objektive.

Për oficerët e sigurisë nëpër shkolla është përcaktuar dhe roli i tyre informues, raportues dhe ndërgjegjësues ndërmjet nxënësve, stafit pedagogjik dhe prindërve, duke parashikuar në nenet 6,7, 8, 9, 11, 12 dhe 13 të kësaj Marrëveshjeje.

Komisioneri vlerëson rolin e madh dhe shumë të rëndësishëm që i jepet figurës së oficerit të sigurisë në ambjentet e shkollave dhe vëren se: përgatitja intelektuale, morale, njohuritë në fushën e psikologjisë dhe pedagogjisë, si dhe eksperiencia njerëzore e këtyre punonjësve prevalojnë mbi përgatitjen fizike të tyre; pasi qëllimi dhe roli i oficerit të sigurisë është pikërisht parandalimi, njohja e situatës në shkollë, e psikologjisë së kësaj grup moshe, lidhja me ambjentin e jashtëm, koordinimi me stafin pedagogjik, prindërit dhe organet e sigurisë në funksion të garantimit të sigurisë në shkolla.

Sa më sipër, Komisioneri vlerësoi se shpjegimi i MASR, se për garantimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit brenda në shkollë, si dhe në territorin përreth shkollës ka konsideruar si tejet e arsyeshme që punonjësi jo mësimor (oficeri i sigurisë), të jetë jo më shumë se 40 vjeç, nuk gjen përligje objektive dhe të arsyeshme dhe bie ndesh me rolin dhe funksionin e oficerit të sigurisë, e konkretizuar kjo në marrëveshjen mes MASR dhe MB, ku rol prioritar kanë aftësitë intelektuale, bashkëvepruese, menaxheriale, koordinuese dhe përvoja jetësore e këtij punonjësi.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit të subjektit ankues, M. K., për shkak të “moshës”, përmes zbatimit të VKM-së nr.600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe kritereve për oficerët e sigurisë”, nga ana e Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të rishikojnë VKM-në nr.600, datë 09.10.2018 “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe kritereve për oficerët e sigurisë”, duke hequr kriterin e moshës si kriter kufizues për kandidatët.

58. D.O., kundër Drejtorisë së Shërbimit Spitalor (DSHS) Mat

VENDIM NR. 51, DATË 15.04.2019

Shkaku: Mosha dhe gjendja arsimore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka punuar në pozicionin e Arkëtares/Llogaritares, pranë DSHS Mat për periudhën 2013-2018. Në vitin 2018 është larguar nga puna për shkak të gjendjes arsimore dhe moshës.

FAKTET

Subjekti ankues ka qenë në marrëdhënie të pandërprera pune me DSHS Mat nga data 16.11.2013 deri në datën 25.06.2018⁴⁶, datë kur dhe i janë zgjidhur marrëdhëniet e punës për shkak se nuk përmbushte kriterin arsimor për të qenë “Përgjegjëse Kase”, i cili duhet të ishte arsim i lartë “Ekonomik”.

Referuar Librezës së punës dhe aktit të emërimit, rezulton se me datë 01.11.2010 subjekti ankues ka lidhur për herë të parë marrëdhënien e punës me DSHS Mat, në detyrën e “Dietologes”, të cilën e ka mbajtur deri me datë 31.05.2013. Ndërkaq, referuar Librezës së punës, me datë 16.11.2013 deri me datë 08.04.2015 rezulton të ketë mbajtur po detyrën e “Dietologes”.

Me vendimin datë 08.04.2015 është emëruar në detyrën e “Llogaritares”, pranë DSHS Mat.

Me shkresën datë 18.04.2018 është njoftuar për fillimin e procedurës së zgjidhjes së marrëdhënieve të punës. Nëpërmjet shkresës me datë 20.04.2018 evidentohet fakti i zhvillimit të takimit mes ankueses dhe përfaqësuesit të DSHS Mat, gjatë të cilit i është komunikuar se zgjidhja e marrëdhënieve të punës vjen për shkak se ajo nuk plotëson kriterin e arsimit të lartë, të kërkuar për pozicionin si Përgjegjëse kase. Ankuesja e ka kundërshtuar, pasi detyra për të cilën ajo ishte emëruar ishte ajo e Llogaritares/Arkëtares dhe jo e Përgjegjëses.

Me vendimin datë 25.04.2018 DSHS Mat ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me ankuesen, me motivacionin se arsyeja e largimit të saj nga puna ishte mospërmbushja e kriterëve të vendosura nga Ministria e Shëndetësisë, konkretisht arsimi i lartë ekonomik për pozicionin si Përgjegjëse kase.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin Nr. 8960, datë 24.10.2002.

⁴⁶ Referuar Njoftimit për zgjidhjen përfundimtare të marrëdhënieve të punës.

- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.
- Konventa Nr. 111 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës⁴⁷ “Mbi diskriminimin në fushën e punësimit dhe profesionit”,
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”,
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se DSHS Mat nuk depozitoi asnjë dokument ku të rezultonte që kriteri i arsimit të lartë “Ekonomik”, për pozicionin Recepsionit/Përgjegjës kase të ishte i shprehur specifikisht dhe në mënyrë konkrete. Për më tepër, DSHS Mat nuk ka depozituar asnjë akt shkresor, emërim në detyrë apo kontratë sa i takon provueshmërisë së faktit që ankuesja ka mbajtur “de jure” dhe “de facto” detyrën e Përgjegjës së kasës.

Nga dokumentacioni i depozituar pranë KMD nga subjekti ankues, rezulton se referuar Mandat pagesave/mandat arkëtimeve⁴⁸ të muajve Janar deri në momentin e largimit nga puna, ankuesja ka firmosur në cilësinë e Arkëtares.

Po ashtu, referuar shkresës datë 26.06.2018 “Vërtetim”, lëshuar nga DSHS Mat, me kërkesë të ankuses, rezulton se ankuesja ka mbajtur detyrën e Arkëtares. Konkretisht, shkresa citon: *“Vërtetohet se D. O., ka qenë punonjëse pranë DSHS Mat, me detyrë Arkëtare dhe për muajin maj 2018 është paguar”*.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, rezultoi e provuar se:

- Ankuesja është e datëlindjes 01.05.1959, aktualisht 60 vjeçe dhe për më pak se 2 vite mbush moshën e daljes në pension.
- A. B është e datëlindjes 04.12.1993, aktualisht 26 vjeç. A. B., plotëson vetëm njërin nga dy kriteret e specifikuar në shpallje; është emëruar në detyrë, duke u favorizuar haptazi nga ana e DSHS Mat, në shkelje dhe të vetë kriterëve të shpallura prej tyre.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri, rezulton e provuar se subjekti ankues ka qenë e emëruar në detyrën e Arkëtares dhe jo në atë të Përgjegjës së kasës, siç pretendohet nga ana e DSHS Mat, prandaj dhe argumenti i dhënë prej tyre se ajo është larguar për mospërmbushje të kriterit arsimor lidhur me këtë pozicion pune/arsim i lartë ekonomik, është i pabazuar në fakte dhe prova, përse kohë ajo ka mbajtur pozicion tjetër

⁴⁷ Ratifikuar me Ligjin Nr. 8086, datë 13.03.1996.

⁴⁸ Kopje të tyre ndodhen të depozituara në cilësi prove në dosjen e ankuses pranë KMD-së.

pune. Ankuesja përmbushte kërkesat ligjore të pozicionit në të cilin ishte emëruar, “de jure” dhe që kryente “de facto”, atë të arkëtares.

Mbështetur në sa më sipër, rezultoi se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, për shkak të gjendjes arsimore dhe moshës, përsa i takon largimit të saj nga puna.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit të D. O., nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor (DSHS) Mat, për shkak “të moshës” dhe “të gjendjes arsimore” të saj.

Konstatimin e mosdiskriminimit të D. O., nga ana e DSHS Mat, për shkak “të bindjeve politike” të saj.

Referuar pikës 1, të vendimit, DSHS Mat, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj subjektit ankues, të bëjë rikthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES FAMILJARE

59. R. M., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.

VENDIM NR. 162, DATË 11.11.2019

Shkak: Gjendja familjare
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja R. M., kryefamiljare dhe nënë e një fëmije të mitur u largua nga puna në kuadër të procesit të ristrukturimit të shoqërisë Albpetrol sh.a. Procedurat nuk ishin transparente dhe nuk tregonin se si ishte bërë përzgjedhja e punonjësve për pozicionin e punës, duke cenuar të drejtën e ankuses për trajtim të barabartë në raport me punonjësit e tjerë të cilët nuk u larguan nga puna.

FAKTET

R. M., ka qenë punonjëse e Shoqërisë Albpetrol sh.a në pozicione të ndryshme nga 2011 deri në 2018. Që nga data 01.06.2017 ajo ka mbajtur pozicionin e punës “Jurist” pranë Qendrës së Transportit Patos (aktualisht Qendra e Furnizimit dhe Transportit Patos, QFT Patos). Shoqëria Albpetrol sh.a. është nënshtruar procesit të ristrukturimit si rrjedhojë e të cilit i janë nënshtruar pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj Shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a, ka miratuar listën e punonjësve që do të prekeshin nga procesi i ristrukturimit organizativ dhe reduktimi i fuqisë punëtore në QFT Patos, dhe 1 nga 13 punonjësit që prekeshin nga ristrukturimi organizativ, ishte dhe R. M., në pozicionin e punës si juriste pranë QT Patos.

Në kushtet kur fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në bazë të Akt-Marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga Albpetrol sh.a., vlerësimi nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t’i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit, që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkurtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Pas kryerjes së rristurimit të shoqërisë, numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës së Furnizimit e Transportit Patos do të ishte 85 punonjës, dhe numri i punonjësve të larguar do të ishte 13. Në këtë strukturë nuk ishte parashikuar pozicioni i punës “jurist” por ishte parashikuar një pozicion pune i ri, “specialist zyre & kontratash”, me specialitetin e arsimit të lartë: jurist, ekon, ing, etj. Referuar organikës së vjetër të Qendrës së Furnizimit të Materialeve Teknike Patos, rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve, ishte 34 dhe kishte të parashikuar 1 punonjës në pozicionin e punës si jurist (A. C.). Referuar organikës së vjetër të Qendrës së Transportit Patos, rezulton se numri i përgjithshëm i punonjësve, ishte 67 dhe kishte të parashikuar 1 punonjës në pozicionin e punës si jurist (R. M.). Për sa më sipër, vërehet se të dy pozicionet e punës, “jurist” ishin reduktuar dhe ishte parashikuar një pozicion pune i ri, “specialist zyre & kontratash”.

Komisioni i vlerësimit e pikëzimit pranë kësaj qendre ka hartuar listën e punonjësve të cilët prekeshin nga pushimi kolektiv mbi shkurtimin e pozicionit të vendit të punës, dhe një nga këto punonjëse ishte ankuesja R. M., pozicioni i të cilës si juriste pranë QT Patos ishte shkurtuar, ndërkohë që në këtë listë nuk figuron emri i punonjësit A. C., pozicioni i të cilit, si jurist pranë QFMT Patos, ishte shkurtuar njësoj si ankuesja.

Referuar përshkrimit të punës dhe kualifikimit të kërkuar për pozicionin e punës “specialist zyre&kontratash”, vlerësohet se përshkrimi i punës së këtij pozicioni është pothuajse i njëjtë me përshkrimin e punës së pozicioneve jurist pranë QFMT Patos dhe QT Patos, si dhe arsimi i lartë, jurist, ekon, ing, etj, pra nga ana teknike dhe kualifikimit nuk kishte asnjë pengesë që R. M., të kishte konkuruar për këtë pozicion pune.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” nenet 1, 3, 4, 7, 12, 32 dhe 33.
- Konventa e OKB-së “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”

KONKLUSIONE

Lidhur me procedurën e përzgjedhjes së punonjësit për pozicionin e punës “specialist zyre&kontratash”, Shoqëria Albpetrol sh.a nuk vuri në dispozicion të Komisionerit asnjë informacion apo dokumentacion për të vlerësuar se si ishte bërë përzgjedhja e punonjësit për këtë pozicion pune dhe arsytet përse nuk ishte vlerësuar ankuesja për të konkuruar për këtë pozicion pune.

Komisioneri gjykon se ankuesja R. M., ishte ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë nga ana e Albpetrol sh.a, krahasuar me specialistin jurist të QFMT, i cili ishte në kushte të njëjta

me ankuesen. Ky trajtim kishte lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e largimit të ankueses nga puna dhe të procedurës së përzgjedhjes së punonjësit për pozicionin e punës “specialist zyre&kontratash” pranë QFT Patos.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se Shoqëria Albpetrol sh.a gjatë procesit të ristrukturimit duhet të kishte kryer dhe një vlerësim personal dhe profesional të çdo punonjësi që prekej nga ky proces dhe duhet të kishte marrë parasysh dhe pasojat sociale që do të sillte vendimmarrja e saj, duke shteruar çdo mundësi risistemimi në punë të punëmarrësve të cilëve iu ristrukturohej vendi i punës, në këtë rast të punonjëses R. M., e cila është e ve dhe me një fëmijë të mitur.

Komisioneri vlerëson se nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankueses se është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me punonjësin, A. C., dhe mos sistemimi i saj në pozicionin e “specialist zyre&kontratash” nuk ka ardhur si pasojë e gjendjes familjare e martesore të ankueses. Përkundrazi, Komisioneri vlerësoi se argumentimi i Shoqërisë Albpetrol sh.a, se përfundimi i marrëdhënies së punës me ankuesen për shkak të ristrukturimit organizativ, ka shërbyer vetëm si justifikim, për ta larguar atë nga strukturat e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

Komisioneri duke konsideruar se Shoqëria Albpetrol sh.a ka patur mundësinë për të bërë të mundur që R.M të konkuronte për një pozicion pune pranë QFT Patos, konstatoi se ajo ishte trajtuar në mënyrë të pabarabartë duke u trajtuar ndryshe nga kolegët e saj që nuk u larguan nga puna.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, të shtetases R. M., nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a, për shkak të gjendjes familjare.

Në referencë të pikës 1, të këtij vendimi, nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a, të merren masa për rivendosjen e marrëdhënieve të punësimit me R. M.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË VENDBANIMIT

60. Shoqata “Lëvizja Rinore Egjiptiane - Rome” (LRER), kundër Bashkisë Elbasan dhe Shoqërisë Ujësjiellës Kanalizime sh.a. Elbasan (UKE)

VENDIM NR. 126, DATË 20.09.2019

Shkaku: Vendbanimi
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Mbyllur me gjobë për moszbatim vendimi të KMD

Ankuesi/OJF, është përfaqësues i banorëve të lagjes që i përkasin kryesisht komunitetit rom, në Elbasan. Prej vitesh, banorët e kësaj lagjeje kanë kërkuar nga ana e Bashkisë dhe Shoqërisë UKE sha, të furnizohen me ujë të pijshëm, por nga ana e këtyre institucioneve nuk është ndërmarrë asnjë masë për shkak të vendbanimit.

FAKTET

Ankuesit janë banorë të lagjes “Dyli Haxhire”, rruga “Ilir Shehu” Elbasan. Kjo zonë nuk furnizohet me ujë të pijshëm nga ana e Drejtorisë së Ujësjiellës Kanalizime Elbasan sh.a. (në vijim UKE sh.a.). Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezultoi se, mungesa e ujit të pijshëm, është fakt i njohur prej kohësh referuar ankesave të banorëve, për të cilat Bashkia Elbasan dhe UKE sha., nuk kanë marrë asnjë masë për t’i dhënë zgjidhje kësaj situate.

Të ndodhur në këto kushte, disa prej banorëve kanë gjetur zgjidhje alternative, ndërhyrjen në rrjet në mënyrë private, duke siguruar mbulimin e nevojave minimale për ujë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 i Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës (ECRI).
- Rezoluta e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara 64/292, datë 28 korrik 2010.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 23.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi Nr. 1304, datë 11.12.2009, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e modelit të Rregullores “Për furnizimin me ujë dhe për kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjiellës Kanalizimeve sh.a.”.

KONKLUSIONE

Institucioni i Bashkisë Elbasan dhe UKE sh.a., dështuan të provonin para Komisionerit se kanë bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e kësaj situate, pasi nuk mund të pretendohet se është përmbushur detyrimi ligjor për furnizimin me ujë të pijshëm vetëm për faktin se ekziston rrjeti fizik i dëmtuar i linjave të ujit.

Furnizimi me ujë nuk përfshin vetëm ekzistencën e rrjetit fizik të furnizimit me ujë, por aksesin e qytetarëve në ujin e pijshëm; në mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme, si për përdorimin personal, ashtu edhe për atë shtëpiak. Në këtë këndvështrim, mungesa e furnizimit me ujë të pijshëm apo lejimi i përdorimit të linjave të pakontrolluara për të siguruar mbulimin e nevojave minimale për ujë, nga ana e Bashkisë Elbasan dhe UKE-së, u ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues.

Vazhdimi i kësaj situate për vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se Bashkia Elbasan dhe UKE përmes mosveprimit, kanë neglizhuar të përmbushin detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, mosveprimet nga ana e strukturave të Bashkisë Elbasan dhe UKE-së, në dëm të ankuesve dhe banorëve të kësaj lagjeje kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tyre në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke i vënë në pozita diskriminuese për shkak të vendbanimit të tyre.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit, për shkak të vendbanimit, të banorëve të pjesës së sipërme të rrugës “Ilir Shehu”, nga ana e Shoqërisë UKE sh.a dhe Bashkisë Elbasan.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme për rregullimin e problematikës së këtyre banorëve nga ana e Shoqërisë UKE sh.a dhe Bashkisë Elbasan.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJENDJES SHËNDETËSORE

61. Ex-officio lidhur me mungesën e ilaçeve gjatë muajit Janar 2017 në Shërbimin e Hematologjisë pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë (QSUT)

VENDIM NR. 49, DATË 07.02.2018

Shkaku: Gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Gjatë vitit 2017, Komisioneri ka konstatuar mungesën e medikamentit Velcade, që është pjesë e kimioterapisë për mjekimin e sëmundjeve në Shërbimin e Hematologjisë, duke mosofruar shërbime cilësore në shërbimin publik pranë QSUT-së.

FAKTET

Referuar shkresës datë 09.05.2017 të dërguar nga QSUT, në të cilën informohet se gjatë muajit Janar 2017, janë lidhur shtesat e kontratave për barin Velcade (Bortezomib 3.5 mg), Komisioneri vlerëson se, nisur nga kjo e dhënë, QSUT pranon faktin e mungesës së barit për periudhën e muajit Janar 2017.

Bazuar në “Rregulloren bazë të funksionimit të QSUT ‘Nënë Tereza’”, provohet se QSUT-ja që ka përgjegjësinë e sigurimit dhe mirëadministrimit të barnave për pacientët dhe mënyra se si i siguron ato në sasi dhe kohë është pjesë e procedurave nga ana e strukturave të QSUT-së.

Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik në QSUT, është përgjegjëse për monitorimin e procedurave të konsumit të barnave dhe marrjen e masave në kohë për sigurimin e barnave që janë në mbarim e sipër, sidomos barnat objekt i shqyrtimit të ankesës që janë jetikë për shëndetin e pacientëve të sëmurë me kancer.

QSUT nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit asnjë dokument që të provonte se nga ana e Drejtorisë së Shërbimit Farmaceutik, si drejtori përgjegjëse për monitorimin e konsumit të barnave dhe të vënies në dijeni të menjëhershme të drejtorisë së spitalit, të ishte informuar në kohë apo të ishin bërë propozimet përkatëse për zgjidhjen e situatës së mungesës së barnave në Shërbimin e Hematologjisë. Gjithashtu QSUT, nuk ka informuar Ministrinë e Shëndetësisë, si institucion epror, në lidhje me problematikat dhe mossigurimin e barnave për pacientët e shërbimit të Hematologjisë, gjatë muajit Janar 2017.

Si rezultat i mos sigurimit të ilaçeve, pacientja G. D., dhe të gjithë pacientët e shërbimit të Hematologjisë në QSUT, u është mohuar marrja e mjekimit të plotë dhe efikas sipas përcaktimeve të përshkruara nga mjeku.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 55/1, 59/1/c.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1,3/5, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Rregullore e funksionimit të QSUT “Nënë Tereza”.

KONKLUSIONE

Komisioneri analizoi situatën e krijuar, duke iu referuar jo vetëm situatës individuale të pacientes G. D., por duke e shtrirë problematikën për të gjithë pacientët e repartit të Hematologjisë që kishin mungesë të trajtimit me medikamente mjekësore, për shkak se mungesa e furnizimit me ilaçe në kohë dhe sasi, prek drejtpërdrejtë jo vetëm ankuesen si individ, por të gjithë pacientët që vuajnë nga ajo sëmundje.

Komisioneri konstaton se, mungesa e medikamenteve dhe mosofrimi i shërbimeve cilësore në shërbimin shëndetësor publik, bie ndesh me të drejtat e sanksionuara, në të drejtat dhe detyrimet e pacientit, në të cilën shpjegohet se: *“Të gjithë pacientet kanë të drejtë të mjekohen. Ata kanë të drejtë për kujdesje për shëndetin e tyre; ta përfitojnë atë sipas nevojave, si në raste akute ashtu dhe në raste kronike, të shërbimit parësor dhe spitalor si edhe të kujdesit në bashkësi, pa marrë parasysh aftësinë e tyre për të paguar”*.

Komisioneri ka vlerësuar se, Drejtoria e QSUT-s dhe në veçanti Drejtoria e Shërbimit Farmaceutik, si njësi përgjegjëse për monitorimin e konsumit të barnave, duhet të kishte marrë masat në kohë për ti siguruar pacientes G. D., dhe pacientëve të tjerë të shërbimit të Hematologjisë, medikamentet e duhura në kohën e duhur në mënyrë që të gjithë pacientët e shërbimit të Hematologjisë të marrin mjekimin e plotë sipas protokollit përkatës për të siguruar efektin maksimal të barit në kohën e duhur.

Në këtë kuadër, Komisioneri, konstatoi se G. D., dhe të gjithë pacientët e shërbimit të Hematologjisë, janë vënë në pozita diskriminuese nga ana e QSUT-së duke mos bërë të mundur sigurimin në kohë të medikamenteve mjekësore.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të G. D., dhe të gjithë pacientëve të shërbimit të Hematologjisë, për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e QSUT-së.

Në referim të pikës 1, QSUT-ja si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të sigurojë në kohë dhe në sasi, medikamentet mjekësore që nevojiten në Shërbimin e Hematologjisë, sipas parashikimeve ligjore.

62. L. B., kundër Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI)

VENDIM NR. 90, DATË 05.04.2018

Shkaku: Gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja, në datë 24.02.2014, ka filluar marrëdhëniet e punës pranë AKSHI-t, fillimisht në pozicionin si specialiste dhe nga datë 27.04.2015 në pozicionin si përgjegjëse sektori. Pas dhënies së disa masave disiplinore dhe ndryshimit të pozicionit të punës, është larguar nga puna. L. B., që nga fillimi i marrëdhënies së punës ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore.

FAKTET

Ankuesja ka filluar punë pranë AKSHI-n në detyrën si specialiste në Sektorin e Standardeve TIK dhe Koordinimit të Projekteve me datë 24.02.2014.

Me datë 27.04.2015, është lidhur Kontrata Individuale e Punës mes L.B dhe punëdhënësit AKSHI për kryerjen e detyrave në pozicionin e Përgjegjëses, pranë Sektorit të Përditësimit të Shërbimeve të Portalit, në Drejtorinë e Portalit e-Albania.

Me datë 09.11.2016, ankuses i është komunikuar masa disiplinore “Vërejtje” për shkelje të rregullave të etikës dhe komunikimit në mjediset e brendshme të punës. Me datë 22.11.2016, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” për shkak të sjelljes dhe mosrealizimit në kohë të detyrave funksionale të cilat ishin bërë pengesë për mbarëvajtjen e punës në ofrimin e shërbimeve elektronike. Po në të njëjtën ditë, me Urdhër Emërimi, datë 22.11.2016, L. B., është liruar nga detyra e Përgjegjëses së Sektorit dhe është emëruar në pozicionin si Specialiste.

Urdhërin e Emërimit, datë 22.11.2016, ankuesja e ka kundërshtuar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila me Vendim e ka konsideruar zgjidhjen e marrëdhënies së punës si shkak i ndryshimit të pozicionit të punës pa miratimin e punëmarrësit, dhe ka dëmshpërblyer L. B., me nëntë muaj pagë për zgjidhjen e kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme dhe të pa justifikuar. AKSHI ka ankimuar këtë vendim.

Pas marrjes së vendimit nga gjykata, AKSHI me shkresën “Urdhër Revokimi” datë 28.03.2017, ka revokuar urdhrin e emërimit datë 22.11.2016, në të cilin i ishte propozuar L. B., vijimi i punës si punëmarrëse në pozicionin e specialistes, duke lënë pa punë ankuesen.

Referuar dokumenteve dhe raporteve mjekësore të depozituara nga palët, rezulton se L. B., ka vazhduar marrëdhëniet e punësimit pranë AKSHI-t dhe pas datës 22.11.2016, në pozicionin si specialiste, pavarësisht nga përfitimi i raporteve të paaftësisë të përkohshme në punë nga sëmundje të përgjithshme që paguhet nga Sigurimet Shoqërore ose nga punëdhënësi.

L. B., ka qenë e trajtuar me raport paaftësie të përkohshme në punë nga sëmundje të përgjithshme që paguhet nga Sigurimet Shoqërore ose nga punëdhënësi, pra vërtetohet që L. B., dhe përpara se të emërohej në detyrën si specialiste në datë 22.11.2016 dhe pas shkëputjes së marrëdhënieve të punës në datë 28.03.2017 ka qenë në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe është pajisur me raporte mjekësore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUZIONE

Komisioneri ka vlerësuar se AKSHI në datë 28.03.2017 ka qenë pothuajse i gatshëm që të lëshonte urdhër revokimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me L. B., për shkak të mosnjohimit dhe nuk ka qenë i gatshëm që të revokonte këtë urdhër pas datës 03.04.2017, pasi është vënë në dijeni të ekzistencës së raportit mjekësor të L. B.

AKSHI në cilësinë e punëdhënësit ka patur mundësinë që në datë 28.03.2017 e në vijim në zbatim të Nenin 10.3 të Kontratës Individuale të Punës të jepte masë disiplinore për L. B., për mungesën e lajmërimit për mungesë në punë dhe jo të ndërmernte veprimin për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, pasi në cilësinë e punëdhënësit në vazhdimësi që prej datës 14.11.2016, ka qenë në dijeni të gjendjes shëndetësore të L. B., dhe të përfitimit nga ana e saj të raporteve mjekësore të vlefshme.

Komisioneri ka bindjen se fakti që AKSHI nuk ka pritur që Vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë të marrë formë të prerë, por e ka ekzekutuar menjëherë, sapo ka gjetur një mundësi për mosnjohim të mungesës në punë të L. B., tregon tendencën e punëdhënësit për të ndërprerë marrëdhëniet e punës me subjektin ankues në kohë të papërshtatshme, pavarësisht se AKSHI nuk ka argumentuar se mungesa jo e vazhdueshme në punë e L. B., në pozicionin e specialistes ka sjellë mosrealizimin e objektivave të punës të sektorit ku ishte e punësuar L. B.

Komisioneri vlerëson se, mungesat për shkak të gjendjes shëndetësore të ankuses, janë bërë shkak për AKSHI-n që të ndërmarrë veprimin e revokimit të urdhrit pa pritur që vendimi i gjykatës të marrë formë të prerë, pasi ka qenë vetë AKSHI që në datë 15.03.2017 ka ankimuar vendimin e gjykatës.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7/1, të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri ka gjykuar se L.B. është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e AKSHI-t, trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me gjendjen shëndetësore të ankuses.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetases L. B., nga ana e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, për shkak të gjendjes shëndetësore.

Në referim të pikës 1, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e L. B., në vendin e mëparshëm të punës.

63. A. Ç., kundër Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Mat. (UKM)

VENDIM NR. 190, DATË 01.10.2018

Shkaku: Gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë i punësuar pranë UKM sh.a. Ankuesi është larguar nga puna, për shkak të gjendjes shëndetësore nga ana e UKM sh.a.

FAKTET

Ankuesi është punësuar pranë UKM sh.a, në datën 20.03.2005, në pozicionin “*specialist hidraulik + monovrator*”.

Në vitin 2014, A.Ç, diagnostikohet me sëmundjen “sklerozë multiple”. Referuar Fletëdaljeve të lëshuara nga QSUT, të depozituara në cilësinë e provës pranë KMD-së, rezulton se ai është shtruar disa herë pranë Shërbimit të Neurologjisë dhe Shërbimit Infektiv, të QSUT-së, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.

Gjendja e tij shëndetësore ishte fakt i njohur për Administratorin e UKM sh.a, si dhe për kolegët e A. Ç. Marrëdhënia e punës ka vazhduar deri në datën 01.12.2017, moment në të cilin, kjo marrëdhënie pune është ndërprerë me motivacionin “*mosparaqitje në punë në mënyrë të përsëritur*”.

Në datën e daljes së Vendimit nr. 45, datë 01.12.2017, të Administratorit të UKM sh.a, ankuesi ka qenë me raport paaftësie të përkohshme në punë⁴⁹.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 17 dhe neni 82, pikat 2 dhe 3;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 1, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a), si dhe neni 33, pika 10.

⁴⁹ Referuar raportit mjekësor të lëshuar nga QSUT, Nr. i regjistrimit E007739, ku rezulton se ankuesi ka qenë me raport mjekësor nga data 22.11.2017, deri në datën 06.12.2017;

KONKLUSIONE

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës rezulton se Administratori i UKM sh.a. i ka kërkuar dorëheqjen ankuesit pasi ky i fundit nuk është i aftë për punë. N. M., u shpreh se drejtuesi i UKM sh.a., i ka thënë ankuesit se: *“Mund të të mbaj edhe 1 muaj në punë, por s’ të mbajmë dot më”*.

Qendrimi i padrejtë dhe disfavorizues ndaj të cilit është ekspozuar ankuesi, që lidhet me miratimin e Vendimit nr. 45, datë 01.12.2017, të Administratorit të UKM sh.a për zgjidhjen e kontratës së tij të punës është marrë në kundërshtim me parashikimin e nenit 147/1 të Kodit të Punës.

A.Ç., është cilësuar si i paaftë në punë nga Administratori i UKM sh.a., në kushtet kur autoriteti kompetent KMCAP, nuk ishte shprehur ende për një gjë të tillë. Duke e cilësuar të tillë, si dhe duke i kërkuar dorëheqjen, për shkak se vuante nga *“skleroza multiple”* e ka diskriminuar ankuesin, duke ndërprerë marrëdhëniet e punës në kohë të papërshtatshme.

Njëkohësisht, mos rinovimi i kontratës së punës me A. Ç., afati i së cilës përfundonte në datën 26.08.2017, (pas diagnostikimit të tij, në vitin 2014, me *“sklerozë multiple”*) dhe konstatimi i faktit, se ankuesi ka punuar pa asnjë kontratë pune, me UKM sh.a., nga data 26.08.2017 deri në datën 30.11.2017, është një fakt tjetër i diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të *“gjendjes shëndetësore”*, të A. Ç., nga ana e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a., Mat.

Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a., Mat, për sistemimin në punë të ankuesit, për sa kohë që KMCAP nuk është shprehur me vendim, që ankuesi është i paaftë për punë.

64. Ankues E. G., kundër Bibliotekës Kombëtare Tiranë

VENDIM NR. 43, DATË 07.02.2018

Shkaku: Gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja, prej 16 vitesh ka qenë në marrëdhënie pune me Bibliotekën Kombëtare Tiranë. Me Urdhërin e Drejtores së Bibliotekës Kombëtare, me datë 15.02.2017, ankuesja është emëruar/transferuar nga pozicioni "Specialist i ISBN-së" në Sektorin e Agjencisë Kombëtare të Numrave Ndërkombëtare të Standartizuar në pozicionin e punës "klasifikatore", pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik. Kjo levizje është bere nga punedhenesi per shkak te gjendjes shendetesore.

FAKTET

Subjekti ankues, ka mbajtur detyrën "Specialist i ISBN-së" në Sektorin e Agjencisë Kombëtare të Numrave Ndërkombëtare të Standartizuar, pranë Bibliotekës Kombëtare. Nëpërmjet Urdhërit nr.132 prot., datë 15.02.2017 është transferuar në detyrën "Klasifikatore", pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv.

Këtë emërim punëdhënësi e ka bërë me argumentimin se ankuesja ka rritur në mënyrë të ndjeshme marrjen e raporteve mjekësore dhe se konkretisht citohet se, për vitin 2016 ajo rezulton të ketë 61 ditë pune me raport, ndërkohë për vitin 2017, gjatë një periudhe kohe rreth 8 mujore rezulton të jetë me raport mjekësor të pagueshëm nga punëdhënësi dhe Sigurimet Shoqërore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Pas analizimit të pretendimeve, parashtrimeve të palëve në proces dhe të dokumentacionit, të shqyrtuar, Komisioneri konstatoi se:

- Pozicioni i punës “specialist” pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së me pozicionin “klasifikatore” pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik ishin dy pozicione të ndryshme, sipas përcaktimeve që specifikohen në “Organikën e Bibliotekës Kombëtare” miratuar me shkresën me nr.1305/1 prot., datë 28.03.2014.
- Ankuesja ka depozituar raportet mjekësore konform parashikimeve ligjore pranë punëdhënësit të cilat i janë paguar rregullisht.
- Po ashtu, janë depozituar në cilësi prove sms dhe e-maile të ankuses që provojnë njoftimin e titullarit apo personit përgjegjës të institucionit lidhur me mungesën e saj në punë, justifikuar me raportet mjekësore.
- Fakti i ligjshmërisë së raporteve mjekësore nuk është kundërshtuar nga punëdhënësi dhe për sa kohë ai është njohur me këtë fakt, është kompetencë dhe detyrim i punëdhënësit të zgjidhë problematikën e krijuar me mungesën e justifikuar të ankuses, përmes delegimit apo zëvendësimit të përkohshëm, deri në daljen në punë të saj, pas përfundimit të raporteve mjekësore.
- Me Urdhërin nr.132 prot., datë 15.02.2017, drejtorja e Bibliotekës Kombëtare ka emëruar E .G., në pozicionin “klasifikatore” pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik, pozicion i ndryshëm nga ai që mbante deri në atë moment si “specialiste” pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së.
- Është e pranuar nga ana e Bibliotekës Kombëtare se arsyeja e këtij ndryshimi pozicioni ka ardhur si rezultat i mungesës së zgjatur të ankuses, justifikuar me raporte mjekësore. Pra, si shkak për emërimin në pozicionin e ri të punës ka shërbyer gjendja shëndetësore e ankuses.

Komisioneri gjeti të pabazuar dhe jo ligjor justifikimin e punëdhënësit se kalimi i ankuses në pozicionin klasifikatore u bë si shkak i mungesave të saj të shumta. Kjo, për arsyen se, vërtet në total për gjithë periudhën kohore nga Dhjetori 2015-1 Shtator 2017 ankuesja rezulton të ketë munguar në punë, justifikuar me raportet mjekësore sipërcituar, (282 ditët në total, gjatë viteve 2015-2017), por pjesa më e madhe e këtyre ditëve i përket periudhës pasi ajo kishte kaluar në pozicionin e ri si klasifikatore, pas datës 15 shkurt 2017. Konkretisht, rreth 200 ditë i përkasin periudhës pas 15 Shkurtit 2017-1 Shtator 2017.

Komisioneri vlerëson të pabazuar ligjërisht arsyetimin e Bibliotekës Kombëtare se, realizimi i lëvizjes paralele, pra emërimi i saj në një pozicion pune me të njëjtën kategori page (Kategoria IV-a) konkretisht në pozicionin "klasifikatore" pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik, nuk është ndryshim i kushteve të kontratës së mëparëshme po vazhdim i saj.

Lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri vlerëson se kalimi i ankuses nga pozicioni i punës "specialist", kategoria IV-a, në atë të "klasifikatores" pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik në Bibliotekën Kombëtare Tiranë, ishte në fakt ndërprerje e kontratës së parë të punës dhe fillim i një kontrate të re pune, pavarësisht se ka vijuar vazhdimësia e marrëdhënies kontraktore të punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit në aspektin financiar, dhe pavarësisht se elementi pagë mbetet i njëjtë.

Në këtë kontekst, ankuesja i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë, krahasuar me parashikimet e legjislacionit të brendshëm, kombëtar dhe atij ndërkombëtar, nga ana e punëdhënësit pikërisht për shkak të gjendjes shëndetësore të saj.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, të E. G., nga ana e punëdhënësit, Biblioteka Kombëtare, për shkak të “gjendjes shëndetësore”.

Në referim të pikës 1, Biblioteka Kombëtare, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj E. G., të bëjë rikthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës si “specialiste” pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së.

65. G. H., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.

VENDIM NR. 200, DATË 30.12.2019

Shkaku: Gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi G. H., ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë Albpetrol sh.a për rreth 38 vite, deri në datën 26.10.2018, datë në të cilën i është zgjidhur marrëdhënia e punës. Shoqëria Albpetrol sh.a ka shkëputur marrëdhëniet e punës me ankuesin për shkak të shkurtimit të vendit të punës, në kuadër të procesit të ristrukturimit të Shoqërisë, pa marrë parasysh gjendjen e tij shëndetësore.

FAKTET:

Subjekti ankues, G. H., ka qenë në marrëdhënie pune me Shoqërinë Albpetrol sh.a (Shoqërinë) për rreth 38 vite, deri në datën 26.10.2018, datë në të cilën i është zgjidhur marrëdhënia e punës. Shoqëria Albpetrol sh.a ka shkëputur marrëdhëniet e punës me ankuesin për shkak të shkurtimit të vendit të punës, në kuadër të procesit të ristrukturimit të Shoqërisë. Së fundmi ai citon se ka punuar në pozicionin “Roje Objekti” pranë Qendrës së Administrimit të Kontrollit të Pronës Patos.

Ankuesi është punonjës i aksidentuar në vendin e punës, fakt i dokumentuar me dokumentacionin mjekësor, nëpërmjet të cilit provohet se ai është shtruar dhe kuruar për një periudhë të gjatë disa muajore në Spitalin Rajonal Fier, kështu citojmë konkretisht, periudhat nga: 03.11.1990-13.11.1990; 26.02.1991-05.03.1991; 28.03.1994-05.04.1994, si dhe;

Bazuar në dokumentet: “Vërtetim Diagnoze”, lëshuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, me datë 29.07.2019, “Përshkrim diagnoze dhe gjendjeje shëndetësore të ankuesit”, sipas përshkrimit të mjekes toksikologe, Dr. L. B., të Spitalit Rajonal Fier, datë 29.07.2019 dhe “Vërtetim Diagnoze”, lëshuar nga Drejtoria e Spitalit Rajonal Fier, me datë 03.10.2019, ankuesi ka dokumentuar gjendjen shëndetësore/sëmundjen e tij, ardhur për shkak të punës së tij, të përcaktuar si sëmundje kronike e fituar në vendin e punës, përcaktuar si: *“intoksikacion kronik nga hidrokarburet e naftës/ hepatitis toxica chronica” si pasojë e intoksinimit*.

Bazuar në Urdhërin Nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcës Nr. 1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri, parashikohet se kriteret mbi të cilat do të kryhej vlerësimi me pikëzim ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) Vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Mbështetur në këto kriterë, duke iu referuar Procesverbalit Model-3, të datës 06.07.2018, si dhe Procesverbalit Model-2/individual, të datës 06.07.2019, rezulton se ankuesi është vlerësuar në total me 40 pikë, respektivisht si më poshtë:

- 20 pikë është vlerësuar për plotësimin e kriterit të arsimit të ulët profesional që nuk përputhet me kërkesat e strukturës së re në qendrën përkatëse,

- 0 pikë për kriterin e kualifikimit profesional, pasi nuk ka kualifikim profesional,
- dhe 20 pikë për kriterin e vjetërsisë në punë, pasi ky punonjës ka 37.9 vite punë në industrinë e naftës).

Nëpërmjet shkresës me nr.6260 prot., datë 19.07.2018 të Shoqërisë Albpetrol sh.a ankuesi është njoftuar për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv, me arsyetimin se, pas procesit të vlerësimit dhe pikëzimit për punonjësit e QAKP Patos, ai nuk plotëson kriteret e mjaftueshme për vazhdimin e marrëdhënieve të punës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike⁵⁰.
- “Karta Sociale Europiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Deklarata e ILOS “Mbi kriteret themelore dhe të Drejtat në Punë”.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr.10 237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, neni 5, 25, 28, 29 i tij.
- Vendimi Nr. 496/10, datë 25.06.2018, i Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë “Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018”.

KONKLUZIONE:

Në referencë të përcaktimeve të Urdhërit Nr. 50, datë 02.07.2018, të Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcës nr.1, e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri, parashikohet se: *“Albpetrol sh.a do të ketë në konsideratë duke vlerësuar dhe mundësitë ligjore që nga pushimet kolektive, të përjashtohen kategoritë e punonjësve si: ... Punonjësit të cilët janë aksidentuar në punë, duke pasur aftësitë fizike për kryerjen e punës, kur nuk iu mbyllet vendi i punës”*

Së pari, referuar sa mësipër, subjekti ankues nuk duhej t’i ishte nënshtruar pushimit kolektiv për faktin se, ai ishte punonjës i aksidentuar në vendin e punës, fakt i dokumentuar.

⁵⁰ Hyrë në fuqi në vitin 1976.

Nëpërmjet dokumentacionit mjekësor ankuesi ka faktuar gjendjen shëndetësore/sëmundjen, ardhur për shkak të punës së tij, të përcaktuar si sëmundje kronike e fituar në vendin e punës, përcaktuar si: *“intoksikacion kronik nga hidrokarburet e naftës/ hepatitis toxica chronica” si pasojë e intoksikimit*”.

Nga ana e Shoqërisë nuk u sollën prova dhe argumentime bindëse që të mund të provonin apo përlligjinin faktin se ata nuk kishin dijeni për gjendjen shëndetësore të ankuesit/sëmundjen e tij kronike, fituar gjatë marrëdhënieve të punës me Shoqërinë Albpetrol sh.a.

Së dyti, përpos faktit që ai nuk duhej të ishte rivlerësuar nga Komisioni i vlerësimit, pasi duhet të ishte klasifikuar automatikisht bazuar në statusin e gjendjes së tij shëndetësore; ai është vlerësuar në mënyrë të padrejtë nga ky Komision, pasi nuk i kishin llogaritur fare kualifikimin profesional. Vetëm bazuar në këtë të fundit ai duhet të kishte marrë dhe 25 pikë të tjera, pikëzim i cili do ta klasifikonte atë me 65 pikë në total.

Mbështetur në gjithë sa më sipër ankuesi nuk duhej t'i ishte nënshtruar fare vlerësimit nëpërmjet pikëzimit, por dhe në rastin kur është realizuar, për më tepër vlerësimi i kryer nga Komisioni i Vlerësimit, nuk ka qenë korrekt dhe i drejtë.

Komisioneri gjykon se ankuesi është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh. a.

VENDIMI:

Konstatimi i diskriminimit për shkak të gjendjes shëndetësore të G. H., nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a.

66. K. K., kundër Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) dhe Drejtorisë së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (QSUT)

VENDIM NR. 66, DATË 16.03.2018

Shkak: Gjendja shëndetësore
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi, prind i një fëmije i cili vuan nga një sëmundje e rëndë shëndetësore, ka kërkuar nga FSDKSH dhe QSUT, që medikamenti me të cilin trajtohet djali i tij, për shkak të kostos shumë të lartë për t’u blerë, të bëhet pjesë e listës së barnave të rimbursueshme. Mosmarrja e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse ka vënë në pozita diskriminuese ankuesin, duke i përkeqësuar gjendjen shëndetësore.

FAKTET

Shtetasi N. K., djali i subjektit ankues, në vitin 2014, është diagnostifikuar, me Inflammatory Myofibroblastik Sarcoma. Nga mjekët specialist të shtetit Turk, ku ai është kuruar, i është rekomanduar që të mjekohet me medikamentin “*Xalkori 200 mg Krizotinib*”. Ky mjekim nuk gjendej në Shqipëri dhe në rrugë private ankuesi e ka siguruar kurën çdo muaj, me një çmim prej 3800 Euro. I detyruar nga situata ekonomike, ka nisur të trajtojë me një medikament tjetër djalin e tij, por rezultatet ishin negative në raport me ato të medikamentit “*Xalkori 200 mg Krizotinib*”.

Në këto kushte, i është drejtuar Kryeministrit, Ministrisë së Shëndetësisë, FSDKSH dhe drejtorisë së QSUT-së, për të përfshirë barin “*Krizotinib*”, në listën e barnave të rimbursuara, por pa marrë asnjë përgjigje pozitive. Nga të dhënat e siguruar, QSUT, FSDKSH dhe Ministria e Shëndetësisë, kanë patur dijeni për këtë rast.

Nga ana e Shërbimit të Onkologjisë së QSUT-së, është propozuar përfshirja e barit Crizotinib (Xaklori), në listën e barnave të rimbursueshme, por nuk ishte marrë asnjë masë në zgjidhjen e situatës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 55/1 dhe 59/1, germa “c”,
- Ligji Nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, neni 10.
- Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenet 1, 3/1/2, 7/1, 20/1/2, 32/1/a dhe c/ dhe nenin 33/10.
- Vendimi Nr. 37, datë 19.11.2013, i Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

KONKLUSIONE

Institucionet ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, pavarësisht faktit që kanë nisur procedurën për dërgimin pranë Këshillit të Administrimit të FSDKSH-së, të propozimit për përfshirjen e barit Crizatinib (Xalkori) në Listën e Barnave të Rimbursueshme, nuk i kanë dhënë asnjë zgjidhje nevojës imediate për trajtimin e duhur mjekësor. Këto hapa të ndërmarra nuk mund të shihen si një zgjidhje për problemin shëndetësor të ankuesit, pasi atij nuk i është siguruar një trajtim i përshtatshëm mjekësor, sipas rekomandimeve të mjekëve.

Komisioneri vlerëson se Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, FSDKSH, si njësi përgjegjëse, duhet të kishin marrë masat në kohë për ti siguruar pacientit, medikamentin në kohën e duhur në mënyrë që sëmundja e tij të mos bëjë progres.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në analize të të dhënave të vëna në dispozicion nga palët, vlerëson se veprimet e kryera nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, duke mos bërë të mundur sigurimin në kohë të medikamentit mjekësor, përbejnë diskriminim të drejtpërdrejtë të shtetasit N. K., për shkak të gjendjes së rënduar shëndetësore, pasi mosmarrja e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse, për t'i siguruar ankuesit, medikamentin në kohën e duhur, mund të vërë në rrezik jetën tij.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të N. K., për shkak të gjendjes shëndetësore, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, si subjekte që kanë konsumuar sjelljen diskriminuese, të sigurojnë në kohë, medikamentin mjekësor që nevojitet në për trajtimin e shtetasit N. K.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË AFTËSISË SË KUFIZUAR

67. D. E., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (DPB) dhe Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Vlorë (IEVP)

VENDIM NR. 61, DATË 13.05.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi, është person me aftësi të kufizuara, i cili punon pranë IEVP Vlorë. Gjatë ndryshimit të pozicionit të punës nga ana e punëdhënësit, nuk është mbajtur në vëmendje arsimi i ankuesit përshtatja e pozicionin të punës me aftësinë e kufizuar.

FAKTET

Me propozim të Drejtorit të IEVP Vlorë Nr. 46 prot., datë 12.01.2010 dhe miratuar me Urdhërin Nr. 332/2 prot., datë 18.01.2011, ankuesi është emëruar në pozicionin e Kartelistit pranë IEVP Vlorë. Duke qënë se punonjësja që mbante detyrën e specialistes së financës do të largohej nga kjo detyrë pasi përfitonte pensionin e pleqërisë dhe ky vend pune mbetej vakant, atëherë Drejtori i IEVP-së Vlorë, i ka propozuar DPB-së, emërimin e D. E., në pozicionin e specialistit të financës. Në këto kushte, me Urdhër Nr. 1568/1 prot., datë 01.03.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, D. E., është emëruar në pozicionin e specialistit të financës. Referuar propozimit me nr. 686 prot., datë 15.05.2015, të Drejtorit të IEVP-së Vlorë, DPB me urdhër të nr. 4518/1, datë 19.05.2015, ka transferuar ankuesin në pozicionin e Specialistit të Edukimit në Sektorin e Çështjeve Shoqërore. Lidhur me këtë transferim ankuesi me anë të shkresës datë 26.05.2015, i është drejtuar Drejtorit të IEVP Vlorë, me anë të së cilës ka kundërshtuar emërimin në pozicionin e Specialistit të Edukimit, për shkak se nuk plotësonte kriterin arsimor të kërkuar për këtë pozicion pune, duke qënë se kërkohej arsimi i lartë i psikologut apo punonjësit social. Pavarësisht kundërshtimit për emërimin në këtë pozicion, nga ana e IEVP Vlorë nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare dhe ka mbajtur këtë pozicion pune deri më datë 04.11.2016, kur është transferuar me Urdhër Nr. 8465, datë 26.10.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në pozicionin e Kartelistit, në Sektorin Juridik të IEVP-së Vlorë.

Gjatë vitit 2016, IEVP Vlorë, i është nënshtruar një auditimi nga ana e Njesisë së Auditimit të Burgjeve, ku në Raportin Përfundimtar të Auditimit “Për vlerësimin e veprimtarisë së IEVP Vlorë, për periudhën 01.11.2014 deri 01.06.2016”, në pikën 10, paragrafi 4, ndër të tjera është theksuar fakti se është bërë emërimi jashtë kriterëve arsimore të dy punonjësve, D. E., dhe specialistes së financës, O. M., jashtë kriterëve.

Edhe pse Njësia e Auditit të Burgjeve kishte konstatuar emërimin e specialistes së financës dhe emërimin e ankuesit në pozicionin e specialistit të edukimit, nga ana e IEVP Vlorë dhe

DPB-së nuk është marrë asnjë masë, por ai është transferuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve në pozicionin e kartelistit, në Sektorin Juridik të IEVP-së Vlorë, me pagë më të ulët dhe në një pozicion në të cilin kërkohet arsimi i mesëm.

Në këto kushte, ankuesi me shkresën datë 21.06.2018, i është drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, duke e vënë në dijeni lidhur me transferimet e tij nga njëri pozicion në tjetrin dhe kërkuar që të merren masa për rikthimin e tij në detyrën e specialistit të financës. Pavarësisht kërkesës së sipërcituar, ankuesi nuk ka marrë asnjë përgjigje zyrtare nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Pavarësisht faktit që ankuesi plotësonte kriteret e pozicionit të punës së Specialistit të Financës, nga ana e IEVP Vlorë është propozuar emërimi i tij në pozicionin e Specialistit të Edukimit, duke kërkuar kështu emërimin në një pozicion pune jashtë kriterëve arsimore. Gjithashtu, ka vijuar transferimi i ankuesit nga ana e DPB-së dhe IEVP Vlorë, në një pozicion pune jashtë kriterëve arsimore dhe me pagë më të ulët, duke e kaluar nga pozicioni i Specialistit të Edukimit, në atë të Kartelistit. Referuar informacionit të dhënë nga ana e IEVP Vlorë, këto lëvizje janë bërë duke marrë parasysh punën me orar të reduktuar për shkak të raportit të invalidit të D. E., si dhe duke zbatuar kriteret përkatëse të përshtatjes së arsimit të përfunduar me detyrën funksionale.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49 dhe 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (Konventa e OKB-së ose CRPD e OKB-së) dhe Protokolli i saj alternativ ka hyrë në fuqi më 3 maj 2008, ndërsa u ratifikuan nga shteti në dhjetor 2011.
- Direktiva 2000/78/KE *“Për përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe në marrëdhëniet gjatë punës”*
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 *“Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 *“Për mbrojtjen nga diskriminimi”*, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Urdhëri Nr. 58, datë 24.04.2017, i Kryeministrit të RSH-së *“Për miratimin e strukturës e të organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe sistemit të institucioneve në varësi të saj”*.
- Urdhëri Nr. 6783, datë 13.11.2017, i Ministrit të Drejtësisë, *“Për miratimin e kriterëve të posaçme për pozicionet e punës në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale”*, në pikat 1 dhe 6.

KONKLUZIONE

Transferimet e ankuesit nga njëri pozicion në tjetrin dhe mosmarrja e masave nga ana e DPB-së dhe IEVP Vlorë për të përshtatur pozicionin e punës së ankuesit me arsimin e tij ka

përballur ankuesin me një trajtim të disfavorshëm dhe të paligjshëm. Vazhdimi i kësaj situate për vite me radhë pa ndërmarrë asnjë masë rregulluese, provon se DPB-së dhe IEVP Vlorë përmes mosveprimit, kanë neglizhuar të përmbushin detyrimet ligjore për emërimin e punonjësve sipas strukturave përkatëse.

Nga ana e punëdhënësit, nuk u sollën argumenta ose prova për të hedhur poshtë pretendimin e ankuesit se transferimi dhe ulja e tij në detyrë, nuk ka ardhur si pasojë e aftësisë së kufizuar. Përkundrazi, Komisioneri ka bindjen se argumentimi i IEVP Vlorë se lëvizjet e ankuesit në pozicione të ndryshme pune dhe ulja në detyrë, janë kryer për shkak të ngarkesës voluminoze të punës, si dhe orarin e reduktuar të punës së D. E., për shkak të statusit të invalidit, tregon qartë se ankuesi është paragjykuar dhe diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se, me veprimet dhe mosveprimet e ndërmarra nga ana e strukturave përgjegjëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë, në dëm të ankuesit, kanë sjellë për pasojë edhe vendosjen e tij në kushte të disfavorshme, pa shkaqe të arsyeshme, duke e vënë në pozita diskriminuese për shkak të aftësisë së kufizuar.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit D. E., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë për shkak të aftësisë së kufizuar.

Konstatimin e mosdiskriminimit, të shtetasit D. E., nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe IEVP Vlorë për shkak të gjendjes arsimore.

Në zbatim të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëherëshme nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe I.E.V.P Vlorë, për emërimin e ankuesit në pozicionin e Specialistit të Financës.

68. G.K., kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR) Korçë

VENDIM NR. 102, DATË 12.04.2018

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

G. K., është regjistruar në klasë të parë në një shkollë në Korçë. Duke qenë se fëmija është me aftësi të kufizuara prindrit i kanë bërë kërkesë shkollës për vendosjen në dispozicion të një mësuesi ndihmës sipas parashikimeve ligjore në fuqi. Mos marrja e masave, ka vënë në pozita jo të barabarta nxenesin G. K., duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin mësimor të të nxënës.

FAKTET

A.K., është prindi i fëmijës G. K., me aftësi të kufizuara, të vërtetuar me Vendim KMCAP-je. Fëmija është i regjistruar në klasën e parë dhe ndjek procesin mësimor pranë shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë. Prindërit e fëmijës para dy muajve kanë paraqitur një kërkesë pranë shkollës dhe pranë DAR Korçë, ku kanë kërkuar mësues mbështetës për të birin, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje. Ankuesi kërkon nga KMD të ndërmerren masat e nevojshme nga ana e DAR Korçë, lidhur me caktimin e një mësuesi mbështetës, sipas përcaktimeve në Udhëzimin Nr. 38, datë 07.10.2014 “Kriteret e mësuesit ndihmës dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

Drejtoria Rajonale Arsimore Korçë ka informuar Komisionerin se: “... Pas kontaktit me Komisionin e Vlerësimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara ju bëjmë me dije se ky fëmijë është vlerësuar nga Komisioni në vitin 2015, periudhë në të cilën ai frekuentonte kopështin. Në momentin e vlerësimit nga ana e këtij Komisioni fëmija nuk ka patur një vlerësim nga KMCAP, dhe prindit të tij i është rekomanduar realizimi i këtij vlerësimi (KMCAP) me qëllim mundësinë e rishikimit të dytë nga ana e Komisionit. Paralelisht fëmija është ndjekur me plan edukativ individual⁵¹ në kopësht. Nga informacioni i marrë nga shkolla që frekuenton fëmija, ky raport vlerësimi është dorëzuar në muajin Shkurt 2018. Deri në këtë moment Komisioni nuk ka marrë asnjë kërkesë për rivlerësim të fëmijës”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 57, neni 116
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Neni 1 i Ligjit Nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3 neni 7, Neni 17

⁵¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën PEI.

- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nenet 64/3 dhe 65/3,
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3,
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 93-96
- Urdhëri Nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar

KONKLUZIONE

Legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njësive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t’i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

Ngritja e një komisioni për vlerësimin e nxënësve të tillë është detyrim konkret për drejtuesit e institucioneve arsimore të zakonshme. Mirëpo, sikundër rezultoi gjatë shqyrtimit të kësaj çështjeje, nuk u vu në dispozicion asnjë dokument a shkresë zyrtare se nga ana e drejtorit të shkollës, të jetë bërë kërkesë me shkrim pranë DAR Korçë, për mësues ndihmës. Gjatë trajtimit të çështjes nuk u siguruan prova që prindi të kishte paraqitur me shkrim një kërkesë të tillë ,siç parashikohet në DN, por një fakt i tillë nuk shlyen nga detyrimi për sigurimin e mësuesit mbështetës as DAR Korçë dhe as shkollën 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë, pasi referuar proces verbalit të mbajtur nga Komisioni multidisiplinar i DAR Korçë, ata kanë qenë në dijeni të faktit se fëmija vuan nga çrregullime të spektrit autik, që në periudhën kur ai ishte i regjistruar në arsimin parashkollor, në Kopshtin nr. 12, Korçë.

KMD konkludoi se ankuesi është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga sa parashikohet në Dispozitat Normative të Arsimit Parauniversitar dhe ligjin për Arsimin Parauniversitar, duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin e të nxënës në procesin mësimor.

Kjo ka bërë që ankuesi të mos marrë shërbimin që duhet t’i ofrohet sipas parashikimeve të DN dhe të cënohet në të drejtën e tij për një trajtim sa më dinjitoz, me qëllim integrimin dhe ofrimin e arsimimit në përputhje me standartet që kërkojnë aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të nxënësit G. K., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë, duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin mësimor të të nxënës.

Mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Sevasti Qirjazi”, Korçë dhe DAR Korçë, të marrin masat e menjëhershme, për ofrimin e mësuesit ndihmës në procesin mësimor të të nxënit, për nxënësin G. K.

69. S. G., kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR) Korçë dhe Shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë

VENDIM NR. 40, DATË 07.02.2018

Shkak: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

A.G., është nxënëse me aftësi të kufizuara pranë shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë. Nga ana e institucioneve arsimore nuk janë marrë masa për të mbështetur me mësues ndihmës nxënësen. Mos marrja e masave, ka vene ne pozita jo te barabarta nxënësen A.G., duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin mësimor të të nxënit

FAKTET

Ankuesja S. G.⁵² paraqiti ankesë në emër të vajzës së saj e cila është nxënëse në klasën e 6-të në shkollën 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë.

Me vendim të Komisionit Multidisiplinar të DAR Korçë, në vitin 2015, është vendosur që fëmija të asistohet në klasë nga një mësues ndihmës. Pavarësisht vendimit të marrë nga DAR Korçë, që nga viti 2015 e në vazhdim, ajo nuk ka patur për asnjë moment mësues ndihmës.

Ankuesja ka kërkuar me anë të një shkrese pranë DAR Korçë që fëmija të asistohet nga një mësues ndihmës, por nuk ka marrë asnjë përgjigje me shkrim. Nëpërmjet telefonit i është informuar nga DAR Korçë se nuk ka mundësi financiare të vendosë një mësues ndihmës për vajzën e saj.

Sipas DAR Korçë, Komisioni Multidisiplinar funksionon normalisht, duke bërë vlerësimin e aftësive të nxënësve dhe nevojat e veçanta që ata kanë, si dhe duke caktuar mësues ndihmës për rastet ku është e mundur. DAR Korçë vuri në dispozicion të KMD-së, kopje të Procesverbalit të vlerësimit të nxënëses A. G., nga Komisioni Multidisiplinar dhe kopje të Planit Edukativ Individual të hartuar nga Shkolla 9 vjeçare “Sotir Gurra” për vitin shkollor 2016-2017.

Në mungesë të mësuesit ndihmës, për nxënësen A. G., është dhënë një zgjidhje e provizore duke angazhuar dy praktikante të praktikës profesionale për ta asistuar dy orë në ditë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 57, neni 116
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Ligji Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Neni 1 i Ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3 neni 7, Neni 17

⁵² Në cilësinë e prindit të fëmijës A. G.,

- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nenet 64/3 dhe 65/3,
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,
- Ligji Nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3,
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 93-96
- Urdhëri Nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar.

KONKLUZIONE

Referuar parashikimeve të legjislacionit⁵³, DAR Korçë ka detyrime të rëndësishme, lidhur me asistencën dhe kujdesin ndaj nxënësve me aftësi të kufizuar që mësojnë në institucionet arsimore të qytetit të Korçës. DAR Korçë kishte ngritur Komisionin Multidisiplinar dhe kishte vlerësuar nxënësen A. G. Nga ana e shkollës nuk ka pasur vlerësim të rezultateve të këtij PEI, si dhe është hartuar PEI vetëm për vitin shkollor 2016-2017. Drejtuesi i shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra” nuk ka paraqitur kërkesë me shkrim për nevojën e nxënëses A. G., për t’u asistuar me mësues ndihmës, gjatë procesit mësimor, siç përcaktohet në legjislacionin përkatës.

⁵³ DAR/ZA-ja ngre komisionin multidisiplinar të përbërë nga një mjek pediatër (kur është e mundur, mjek pediatër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.

Kryetar i komisionit është drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.

Komisioni, me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij. Komisioni mblidhet 3 herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit mësimor.

Drejtori i institucionit arsimor këshillohet me komisionin e institucionit arsimor para se t’i drejtohet komisionit pranë DAR/ZA-së dhe bashkëpunon me prindërit e fëmijës për të paraqitur kërkesën e tij.

Prindi i paraqet komisionit pranë DAR/ZA-së raportin vlerësues të fëmijës së tij të kryer nga Komisioni Mjekësor i Caktimit të Aftësisë për Punë, kur fëmija është vlerësuar nga ky komision mjekësor.

Komisioni:

njofton prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës;

i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjelltas; sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin;

rekomandon shërbimet shpesh që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese;

rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor, kur fëmija nuk e ka.

Vlerësimi dhe praktika e punës së komisionit mbështetet në standardet ndërkombëtare të vlerësimit dhe funksionimit të aftësisë së kufizuar (standarde të Organizatës Botërore të Shëndetësisë).

Komisioni fton të paktën një prind gjatë vlerësimit të fëmijës dhe po të jetë e nevojshme, të afërm të tij. Kur fëmija është në kopsht/shkollë, përveç prindit marrin pjesë: punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionin arsimor, mësues të fëmijës të caktuar nga drejtori i institucionit arsimor.

1. Komisioni rekomandon ndjekjen e shkollës së specializuar vetëm kur gjykon se ndjekja e një shkolle të zakonshme nuk do të zhvillonte sa duhet fëmijën me aftësi të kufizuara (AK).

2. **Komisioni njofton me shkrim drejtorin e institucionit të zakonshëm arsimor se cilët nga fëmijët me AK do të mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore të zakonshme, të përshtatura ose individuale.**

3. **Komisioni pranë DAR/ZA-së udhëzon komisionet e institucioneve arsimore për punën me nxënësit me AK.**

Komisioni mban dokumentacionin e gjendjes fillestare të fëmijës me AK dhe përditëson ecurinë e tij në bashkëpunim me komisionin në institucionin arsimor.

DAR/ZA-ja siguron kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së komisionit.

Nxënësja A. G., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga sa parashikohet në DN⁵⁴ dhe ligjin për Arsimin Parauniversitar, duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin e të nxënësve në procesin mësimor.

Kjo ka bërë që nxënësja A. G., të mos marrë shërbimin që duhet t'i ofrohet sipas parashikimeve të DN dhe të cenohen në të drejtën e saj për një trajtim sa më dinjitoz, me qëllim integrimin dhe ofrimin e arsimit në përputhje me standartet që kërkojnë aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të nxënëses A. G., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e drejtorisë së Shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë, duke mos i ofruar asistencë me mësues ndihmës në procesin mësimor të të nxënësve, si dhe përmes mosvlerësimit të ecurisë së nxënëses gjatë periudhës që ajo ka ndjekur këtë shkollë.

Mbështetur në parashikimet e ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë dhe DAR Korçë, të marrë masat e menjëhershme, për ofrimin e mësuesit ndihmës në procesin mësimor të të nxënësve, për nxënësen A. G.

Drejtorja e Shkollës 9-vjeçare “Sotir Gurra”, Korçë dhe DAR Korçë, të marrë masat, që situata të tilla diskriminuese të mos përsëriten në të ardhmen, ndaj kategorisë së nxënësve me aftësi të kufizuara.

⁵⁴ Shkurtesë për Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar.

70. Ankues D. S., kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale (DAR), Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”

VENDIM NR. 53, DATË 07.02.2018

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Nxënësit D. S., i diagnostifikuar me *Autizëm Fëmënor*, nuk i ofrohet mbështetje me mësues ndihmës, në procesin e të nxënës në procesin mësimor nga DAR, Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”.

FAKTET

Nxënësi D. S., i diagnostifikuar me *Autizëm Fëmënor*, nxënësi në Shkollën 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, në Tiranë, nuk është asistuar me mësues ndihmës, në procesin e të nxënës në procesin mësimor.⁵⁵

Komisioni i vlerësimit të shkollës caktoi që D. S., të ndjekë klasën e pestë duke arsyetuar vendimin me faktin se djali ishte 12 vjeç dhe i zhvilluar fizikisht.

Prindi e ka konsideruar të papërshtatshëm këtë vlerësim dhe ka kërkuar caktimin e një mësuesi ndihmës. Nëna e fëmijës është munduar të integrojë djalin në mësim, por pa rezultat. Ajo shpreh shqetësimin se djali i saj me *Autizëm* është i diskriminuar, për shkak se shkolla dhe DAR Tiranë nuk kanë marrë masa për të vlerësuar saktë nevojat e tij për mësues ndihmës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 57, neni 116
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Neni 1 i Ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3 neni 7, Neni 17
- Ligji nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nenet 64/3 dhe 65/3,
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,
- Ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3,
- Ligji nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 93-96

⁵⁵ Ankesa është paraqitur nga L. S., nëna e fëmijës, si përfaqësuese ligjore e tij, në ushtrim të përgjegjësisë prindërore, e përfaqësuar përpara KMD nga një organizatë me interesa legjitime, që mbron të drejtat e PAK / ADRF

KONKLUSIONI

Drejtoria e shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, Tiranë nuk ka marrë masat për vlerësimin e nevojave dhe të hartimit të planit PEI për nxënësit D. S., menjëherë sapo nxënësi është paraqitur dhe regjistruar në shkollë, pasi nuk ka një vendim të komisionit të shkollës për vlerësimin e nevojave për nxënësin D. S., si dhe hartimi i Planit edukativo-individual (PEI) nga ana e shkollës, është realizuar në periudhën Shkurt 2017, pa miratimin e prindit.

Drejtoria Arsimore Rajonale, Tiranë ka njoftuar prindin e fëmijës se Komisioni Psiko-social ka shkuar në shkollë për të bërë vlerësimin e fëmijës por nxënësi nuk ka qenë prezent në shkollë, si rezultat i mosfrekuentimit të shkollës nga ana e tij. Në lidhje me këtë, Komisioni psiko-social i DAR Tiranë dhe drejtuesi i shkollës duhet të kishin marrë masa për lajmërimin në kohë të nënës, në mënyrë që realizohej vlerësimi i nevojave të djalit. Pavarësisht kësaj, në periudhën në vazhdim Komisioni psiko-social i DAR Tiranë, duhet të kishte marrë masat për të bërë vlerësimin e nevojave të nxënësit D. S., pasi ishte në dijeni se ai ishte regjistruar në shkollë.

Nxënësi D. S., është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, nga sa parashikohet në Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar dhe Ligji për Arsimin Parauniversitar, përmes mos përfitimit të asistimit me mësues ndihmës në procesin e të nxënit në procesin mësimor dhe argumentet e dhëna nga Drejtoria e Shkollës “Shyqyri Peza” dhe DAR Tiranë, vërtetojnë faktet se shkolla nuk ka dashur të pranojë nxënësin në klasë pa patur një mësues ndihmës.

Ndodhemi përpara shkeljes së ligjit nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, përmes mos ofrimit të asistencës me mësues ndihmës, në procesin e të nxënit në procesin mësimor, për nxënësin me Autizëm.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të nxënësit D. S., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, përmes mos përfitimit të asistimit me mësues ndihmës në procesin e të nxënit në procesin mësimor.

Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e DAR Tiranë Qytet, që nxënësit D.S., ti caktohet një mësues ndihmës sipas vlerësimit të Komisionit Psikosocial.

71. Ankuesë F. B., kundër Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

VENDIM NR. 170, DATË 19.11.2018

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Mungesa e akteve nënligjore për vlerësimin e aftësisë së kufizuar dhe caktimin e një mësuesi ndihmës në arsimin dhe formimin profesional, cënon të drejtën për arsim profesional të nxënësës F. B., me aftësi të kufizuara, referuar vendimit të KMCAP.

FAKTET

Nxënësja F. B., e diagnostifikuar me diagnozën: “Çrregullim pervaziv i zhvillimit autizëm me zhvillim të theksuar të funksionit”.

Në vitin shkollor 2017-2018, është regjistruar për herë të parë në Shkollën “Isuf Gjata” në degën (kabinet, konfeksion).⁵⁶ Për shkak të numrit të pamjaftueshëm të nxënësve, klasa nuk u hap. Vajza vazhdoi në një degë tjetër, edhe vitin tjetër shkollor por në mënyrë jo të rregullt, për arsye se nuk kishte mësues ndihmës.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë⁵⁷, të cilës ankuesja i ka kërkuar informacion lidhur me praktikën e përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në arsimin profesional, ka informuar se nuk ka një praktikë të veçantë të përfshirjes së personave me aftësi të kufizuara në shkollat dhe kurset profesionale.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 57, neni 116
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”,
- Ligji nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Neni 1 i Ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, neni 3 neni 7, Neni 17
- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, nenet 64/3 dhe 65/3,
- Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”,
- Ligji Nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3,
- Ligji Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 93-96

⁵⁶ Ankesa është paraqitur nga Z. B., si përfaqësuese ligjore e tij, në ushtrim të përgjegjësisë prindërore.

⁵⁷ Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përgjegjëse për zhvillimin e politikave shtetërore në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional, referuar Vendimit nr. 503, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”.

- Nenit 2, germa (ç), përcakton se qëllimi i Ligjit nr. 15, datë 16.02.2017 “*Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë*” është që të garantojë mundësi të barabarta për të gjithë individët që duan të ndjekin studimet në fushën e Arsimit dhe Formimit Profesional (AFP).
- Në nenin 5/a dhe d, të këtij ligji përcaktohet se: “*Sistemi i AFP-së bazohet në këto parime themelore: a) Parimi i gjithëpërfshirjes: Sistemi i AFP-së ofron mundësi arsimimi dhe formimi profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim. d) Parimi i garantimit të pjesëmarrjes: Sistemi i AFP-së krijon kushtet financiare, fizike dhe shoqërore për individët për të përfutur nga mundësitë e të nxënës gjatë gjithë jetës*”.

KONKLUZIONI

Komisioneri konstatoi se, ndërkohë që për nxënësit me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin mësimin në institucionet arsimore publike ka parashikime ligjore⁵⁸, për nxënësit me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin mësimin në institucionet e arsimit dhe formimit profesional nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nuk është parashikuar asnjë procedurë se si mund të bëhet e mundur ndjekja e mësimin dhe sigurimi i mësuesit ndihmës nga fëmijët me aftësi të kufizuara në arsimin dhe formimin profesional.

Referuar dokumentacionit, Komisioneri vlerëson se Ministria e Financave dhe Ekonomisë pavarësisht se është vënë në dijeni të rastit të nxënëses F. B., nuk ka ndërmarrë masa konkrete për vlerësimin dhe zgjidhjen e çështjes së frekuentimit të arsimit dhe formimit profesional nga fëmijët me aftësi të kufizuara. Ndërkohë që, Shkolla e Mesme Profesionale “I. Gjata”, Korçë ka vënë në dijeni MFE-në për këtë problematikë të nxënëses F. B.

Në kuptim të nenit 7/1 të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁵⁹, nxënësja F.B. është ekspozuar para një trajtimi të padrejtë e të pabarabartë, përmes mosveprimit, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për hartimin e procedurave ligjore për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin dhe formimin profesional dhe sigurimit të mësuesit ndihmës.

Rezulton se, nxënësja F.B. është diskriminuar në raport me fëmijët e tjerë që duan të ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm apo të orientuar. Fëmijëve me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin arsimin dhe formimin profesional, nuk i ofrohen mundësitë për t’u vlerësuar dhe për të përfutur mësues ndihmës. Ajo është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, pikërisht për shkak të aftësisë së kufizuar.

Rezulton se, nga mosveprimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, nxënëses F.B. i është mohuar e drejta e arsimit për shkak të aftësisë së kufizuar, si pasojë e diskriminimit të saj për këtë shkak.

⁵⁸ Këto rregullime gjenden në nenet 64 dhe 65 të Ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të cilat janë cituar në ratste të ngjashme të shqyrtuara nga KMD

⁵⁹ Neni 7/1, parashikon se: “Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”.

Trajtimi aktual i fëmijëve me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin arsimin dhe formimin profesional, bie ndesh me vetë qëllimin e Ligjit “Për arsimin dhe formimin profesional në RSH”, i cili në parimet kryesore të tij, ka parimin e gjithëpërfshirjes dhe ofrimin e mundësisë së arsimit dhe formimit profesional për të gjithë, pa asnjë diskriminim.

Komisioneri konkludon se nxënësja F. B., i është nënshtruar një një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë, nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përmes mungesës së hartimit të procedurave ligjore për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në arsimin dhe formimin profesional dhe sigurimit të mësuesit ndihmës, krahasuar me fëmijët e tjerë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë, gjimnaz dhe të arsimit të mesëm të orientuar.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të fëmijës F. B., nga ana e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, për shkak të aftësisë së kufizuar.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë të hartojë aktin nënligjor përkatës për përcaktimin e kriterëve, procedurës së vlerësimit dhe caktimit të mësuesit ndihmës, kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes e të emërimit të mësuesit ndihmës, për fëmijët me aftësi të kufizuara që duan të ndjekin arsimin dhe formimin profesional.

72. Ankues S. L., kundër Aleat sh.p.k. pranë Njesisë Bashkiake Nr. 6 dhe Nr. 7 në Tiranë, Ministrisë së Brendshme dhe Bashkisë Tiranë

VENDIM NR. 188, DATË 17.12.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces (Gjoke për mospërbushje të vendimit)

Ankuesja S. L., është person me aftësi të kufizuara. Ajo shkoi pranë zyrave të ALEAT SH.P.K për të aplikuar për pasaportë, por zyrat nuk janë të aksesueshme për personat që janë në karrocë me rrota, aftësi e kufizuar.

FAKTET

Ankuesja e cila është me aftësi të kufizuara⁶⁰ është paraqitur për të kryer aplikimin për t'u pajisur me pasaportë, pranë zyrave të Aleat sh.p.k, për Njësinë Bashkiake nr. 6 dhe nr. 7, në Tiranë. Ankuesja pretendon se vendi i aplikimit kishte shkallë nga të gjitha anët dhe asnjë rampë për të siguruar aksesin e saj në zyrat përkatëse. Ajo pretendon se u përball me arrogancën e punonjësës që mbante vulën e Minibashkisë, e cila i thotë se duhet të kishte marrë masa për të marrë njerëz me vete, për të ngritur karrocën me rrota të së bijës. Ankuesja u transportua për në zyrat e aplikimit, me ndihmën e personave, që u gjendën aty pranë.

Në vijim, ankuesja pretendon se u ndesh me paaftësinë e stafit, që merrej me procedurat përkatëse. Operatorët insistonin për marrjen e shenjave të gishtërinjve të saj, ndërkohë që një gjë e tillë ishte e pamundur, për shkak të dëmtimeve të saj, fizike. Ajo shprehet se insistimi i njërës prej operatorëve, ishte i tepruar, duke shkelur integritetin e saj. Vetëm pas insistimit të saj, personat përgjegjës komunikuan me eprorët e tyre, të cilët i qartësuan mbi procedurat, që duheshin ndjekur në raste të tilla.

Përveç sa më sipër, ambienti, ku kryhej aplikimi për pasaportë ishte shumë i ngushtë dhe jo i mobiluar sipas standardeve të përshtatshme, për personat me aftësi të kufizuara. Stafi i Aleat sh.p.k. nuk menaxhonte radhën në mënyrën e duhur dhe nuk kishte prioritet për personat me aftësi të kufizuara.

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 57, neni 116
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Komenti i Përgjithshëm i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi

⁶⁰ Referuar Librezës së Identitetit “Për përfituesit e Statusit të Invalidit Paraplegjik e Tetraplegjikë”.

- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”.

KONKLUSIONE

Komisioneri konstatoi se në zyrën e Aleat sh.p.k., që mbulon shërbimet publike për aplikim për dokumente identifikuese të shtetasve shqiptarë, për Njësitë Bashkiake nr. 6 dhe 7, mungon aksesueshmëria fizike për individët me aftësi të kufizuara. Sigurimi i aksesueshmërisë fizike për këtë kategori individësh është detyrim ligjor në kuadër të konventave ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, ashtu sikurse edhe nga legjislacioni i brendshëm shqiptar.

Përveç sa më sipër, Komisioneri çmoi gjithashtu se mungesa e informacionit mbi faktin, se qytetarët mund të ri-aplikojnë për karta identiteti dhe pasaporta elektronike pranë çdo zyre të Aleat sh.p.k., ka qenë gjithashtu një çështje për t’u patur nën vëmendje. Nëse ankuesja do të kishte patur një informacion të tillë, do të ri-aplikonte pranë një zyre tjetër të Aleat sh.p.k., ku nuk do të mungonte aksesueshmëria fizike për individët me aftësi të kufizuara. Ky informacion mund t’u jepej të gjithë shtetasve shqiptarë nëpërmjet afishimeve pranë zyrave të gjendjes civile, apo në shumë mënyra të tjera praktike dhe efikase, në mënyrë që situata të tilla të shmangen.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të S. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Ministria e Brendshme.

Konstatimin e diskriminimit të S. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Aleat sh.p.k.

Konstatimin e mosdiskriminimit të S. L., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Bashkia Tiranë.

Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Ministrisë së Brendshme, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, e individëve me aftësi të kufizuara në tërësi, në zyrën e Aleat sh.p.k. që mbulon Njësitë Bashkiake Nr. 6 dhe 7, Tiranë.

Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Ministrisë së Brendshme, për të të shpërndarë në publik informacionin e duhur, me mjete dhe mënyra efikase, lidhur me mundësitë e shtetasve shqiptarë për të riaplikuar për dokumentet identifikuese, pranë çdo zyre të Aleat sh.p.k.

Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Aleat sh.p.k., për të kryer parashikimet përkatëse në Manualin respektiv, lidhur me procedurat, që duhen ndjekur për marrjen e gjurmëve të gishtërinjve, për individët me aftësi të kufizuara.

Rekomandohet që, Ministria e Brendshme dhe Aleat sh.p.k., të garantojnë aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara, në të gjithat pikat e territorit të Republikës së Shqipërisë, ku ofrojnë shërbimin për aplikimin dhe riaplikimin e kartave të identitetit dhe pasaportave.

73. T. M., kundër J. M., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe njëkohësisht N/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe V. V., Shef i Policisë Bashkiake Sarandë

VENDIM NR. 111, DATË 23.08.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi T. M., është me aftësi të kufizuar në lëvizje. Institucionet përgjegjëse nuk kanë vepruar për ti garantuar të drejtën që të aksesojë banesën e tij.

FAKTET

Ankuesi është invalid i plotë. Për këtë arsye, për të lehtësuar aksesin në banesën e tij, në bazë të Autorizimit nr. 2044/1, datë 31.07.2018, të Bashkisë Sarandë, është autorizuar të kryejë punime për vendosjen e një rampe me konstruksion të lehtësuar metalik, për përshtatjen e ndërtesës së banimit, për personat me aftësi të kufizuara.

Bashkia Sarandë vuri në dispozicion të ankuesit dhe Z. F., skicën e e vend ndërtimit të rampës, e cila fillonte nga trotuari i rrugës e ngjitej deri tek skaji perëndimor i verandës së pallatit, sipërfaqe, e cila ndodhet në bashkëpronësi me shtetasit V. H., dhe banorëve të pallatit. V. H., ka në pronësi të tij një sipërfaqe prej 40 m², të cilën e shfrytëzon si lokal. Por përveç kësaj sipërfaqeje, ai shfrytëzon edhe 15 m² sipërfaqe të verandës së pallatit, të cilën e ka në pronësi të përbashkët me banorët e pallatit, ku banon ankuesi.

Veranda e pallatit shfrytëzohet si lokal, duke e bërë të pamundur aksesin e tij, si invalid në këto ambiente, për të shkuar në banesën e tij. Për këtë arsye, ai i është drejtuar disa herë me kërkesë me shkrim, Bashkisë Sarandë, Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe Policisë Bashkiake të këtij institucioni, por nga ana e këtij institucioni nuk ka patur asnjë reagim zyrtar për të ndërhyrë dhe për të zgjidhur çështjen konkrete.

Ai pretendon diskriminim për shkak të gjendjes së tij shëndetësore dhe aftësisë së kufizuar nga ana e J. M., Drejtor i Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore dhe njëkohësisht N/Kryetar i Bashkisë Sarandë dhe V. V., Shef i Policisë Bashkiake Sarandë, pasi ata nuk kanë vepruar në zbatim të kompetencave të tyre ligjore, për të mbrojtur të drejtat e tij si qytetar dhe si person që ndodhet në gjendje jo të mirë shëndetësore dhe me aftësi të kufizuara duke e lënë të ekspozuar përballë fyerjeve, kërcënimeve e pengimit për akses në banesën e tij, nga pronari i biznesit V. H.

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
- Komenti i Përgjithshëm i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,

- Ligji Nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”
- Vendimi Nr. 1074, datë 23.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masave për mënjanimin e pengesave në komunikim dhe infrastrukturë në ofrimin e shërbimeve publike për personat me aftësi të kufizuara”,
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11
- Ligji Nr. 10 112, datë 9.4.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, nenet 35-36
- Vendimi Nr. 447, datë 16.06.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”.

KONKLUSIONE

Komisioneri çmoi se në zbatim të legjislacionit, Bashkia Sarandë ka marrë fillimisht masat e nevojshme për të siguruar aksesueshmërinë e ankuesit, si person me aftësi të kufizuar, në banesën e tij. Por pavarësisht kësaj, Komisioneri ka konstatuar gjithashtu, se pavarësisht lehtësive dhe kushteve që Bashkia Sarandë ka krijuar për të, ankuesi nuk arriti dot t’i gëzojë dhe t’i përdorë këto lehtësi, pasi veranda e pallatit ku ai banon, që është në bashkëpronësi ndërmjet banorëve të pallatit dhe V. H., përdoret nga ky i fundit për të ushtruar biznesin e tij privat.

Bashkia Sarandë nuk ka garantuar të drejtën e ankuesit për të patur akses për banesën e tij, nëpërmjet verandës së pallatit, duke përdorur rampën. Në këtë mënyrë, ky institucion, pavarësisht ankesave të depozituara nga ankuesi nuk ka ndërhyrë në bazë të kompetencave që i atribuon Vendimi nr. 447, datë 16.06.2010, i Këshillit të Ministrave, “*Për miratimin e rregullores tip të administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit*”, duke mos garantuar të drejtën e tij për një strehim të përshtatshëm. Zgjidhja e ofruar për ankuesin ka qenë ajo gjyqësore, ndërkohë që ka qenë detyrimi parësor i Bashkisë Sarandë për të ndërhyrë e për të zgjidhur situatën konkrete.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të T. M., për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Bashkia Sarandë. Konstatimin e mosdiskriminimit të T. M., për shkak të gjendjes shëndetësore, nga Bashkia Sarandë.

Në referencë të pikës 1 të këtij vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Sarandë për të garantuar të drejtën e ankuesit, për të patur akses të lirë në verandën e pallatit ku jeton dhe për ta përdorur si rrugë të lirë kalimi për në banesën e tij.

74. Ex-officio për përshtatshmërinë dhe aksesueshmërinë e banesave sociale aktuale për personat me aftësi të kufizuar

VENDIM NR. 36, DATË 26.01.2018

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim në formën e “mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme”
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Banesat sociale të ndërtuara nga Bashkia e Tiranës në zonën e Shkozës, janë të pa-aksesueshëm nga ana e Personave me Aftësi të Kufizuara duke iu mohohuar e drejta për t’u strehuar në kushte të barabarta me të tjerët.

FAKTET

Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar⁶¹ informon Komisionerin se: “Gjatë zhvillimit të punës së organizatës, janë informuar, që banesat sociale të ndërtuara në zonën e Shkozës, janë të papërshtatshme për përdorim nga ana e PAK. PAK kanë aplikuar ndër vite në programin e strehimit pranë Bashkisë Tiranë por vetëm së fundmi kanë arritur që të përfitojnë banesa sociale. Personat me aftësi të kufizuar përfaqësojnë një ndër grupet prioritare për të përfituar banesa sociale me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës, papërshtatshmëria e këtyre ambienteve sjell cënimin e kësaj të drejte dhe diskriminimin e tyre.

Mungesa e përshtatshmërisë së këtyre ndërtesave në përputhje me kriteret e parashikuara në VKM nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara”, ka sjellë mungesë aksesimi për t’u shfrytëzuar nga ana e personave me aftësi të kufizuara dhe për rrjedhojë mohim të së drejtës për t’u strehuar në kushte të barabarta me të tjerët. Banesat të cilat iu ofrohen PAK, ndodhen minimalisht në katin e dytë të këtyre ndërtesave dhe e vetmja mënyrë aksesimi janë shkallët. Referuar VKM-së sipërcituar duhet që në këto banesa të ndërtohet ashensor sipas parametrave të përcaktuar në rregullore ose të gjenden zgjidhje të tjera më pak të kushtueshme.

Sipas Bashkisë banesat sociale me qira janë ndërtuar në vitin 2007 dhe nuk ishin parashikuar kushtet për shfrytëzimin e tyre nga ana e personave me aftësi të kufizuara. Kjo pasi, VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”, është miratuar një vit më vonë nga ndërtimi i banesave sociale.

Në zbatim të VKM Nr. 1503, datë 19.11.2008, “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”, duhej që të ndërtohej ashensor sipas parametrave të përcaktuara në këtë rregullore ose të gjendeshin zgjidhje të tjera më pak të kushtueshme, në

⁶¹ Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën FSHDPAK.

mënyrë që mos të kishte mungesë aksesit për shfrytëzim nga ana e personave me aftësi të kufizuar.

Për rrjedhojë personave me aftësi të kufizuar u mohohet e drejta për t'u strehuar në kushte të barabarta me të tjerët, duke mos përmbushur kështu një detyrim ligjor, që banesat e vëna në dispozicion të jenë komode dhe të aksesueshme për ata.

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh,
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*
- Ligji Nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*
- Komenti i Përgjithshëm i Komitetit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara,
- Ligji Nr. 93/2014, *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi në nenin 32, pika 1, germa a), c) nenin 3, pika 7, nenin 7, pika 1, nenin 20, pika 1, germa a) pika 2, germa c), germa d) dhe, nenin 33, pika 10 VKM nr.1503, datë 19.11.2008, “Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuara””*
- Vendimin Nr. 1074, datë 23.12.2015 *“Për Përcaktimin e Masave së për Mënjanimin e Pengesave në Komunikim dhe Infrastruktura në Ofrimin e Shërbimeve Publike për Personat me Aftësi të Kufizuar”,*

KONKLUSIONE

Fakti se projekti i banesave sociale me qira⁶² është hartuar në vitin 2007 dhe parashikimet e VKM-së *“Për miratimin e rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga ana e personave me aftësi të kufizuar”*⁶³, e po ashtu ligji 93/2014 *“Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar”* dhe ligji nr.73, datë 09.07.2015, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, janë miratuar pas vitit 2007, nuk e shkarkon Bashkinë nga detyrimi ligjor i parashikuar në ligjin nr.9232/2004 “Për Programet Sociale për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane”, i cili ka përcaktuar zbatimin e rregullave për eliminimin e barrierave arkitektonike në banesat, hapësirat dhe shërbimet publike, si dhe përcakton se duhet të trajtohen me përparësi familjet që kanë në përbërjen e tyre një person me aftësi të kufizuar.*

Personave me aftësi të kufizuar duhet t'u sigurohet e drejta për të pasur një jetesë të pavarur, duke eliminuar pengesat infrastrukturore të cilat i vendosin ata në kushte të pabarabarta në shoqëri. Barrierat infrastrukturore dhe mungesa e përshtatshmërisë së banesave sjell mohimin e së drejtës për t'i gëzuar lirisht këto banesa duke i vendosur personat me aftësi të kufizuar në pozita diskriminuese.

⁶²Referuar përgjigjes zyrtare të Bashkisë së Tiranës, me shkresën me nr.2891/2 prot., datë 12.02.2016. (miratimi i Listës së Përfutësve të tyre si dhe shpërndarja e tyre ka filluar në vitin 2015)

⁶³ VKM Nr.1503, datë 19.11.2008 (pas 2007-ës).

Banesat sociale në Shkozë, qartësisht nuk kanë siguruar të drejtën e strehimit në mënyrë efektive për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar, si pasojë e mosrespektimit të kriterëve ligjore, të përcaktuara në VKM sipërcituar dhe gjithë aktet e tjera ligjore e nënligjore.

Në kushtet kur personat me aftësi të kufizuar përfaqësojnë një ndër grupet prioritare për përfitimin e banesave sociale, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetesës, mungesa e aksesueshmërisë së këtyre ambienteve sjell cenimin e kësaj të drejte dhe trajtim të pabarabartë me të tjerët në gëzimin e kësaj të drejte.

Në rastin në shqyrtim, ligjvënësi ka përcaktuar se, Autoritetet përgjegjëse të institucioneve që ofrojnë shërbime për publikun, pra Bashkitë, janë të detyruara të sigurojnë një nivel bazë të përshatshmërisë ndërtimore në mjediset ekzistuese në administrim të tyre.

Në këtë kontekst, është detyrim i Bashkisë së Tiranës, të krijojë mundësitë për lehtësimin e kushteve për aksesueshmërinë e banesave sociale aktuale për personat me aftësi të kufizuar, si dhe të hartojë projekte të reja për shërbime dhe banesa sociale me qira, ku të parashikohen me prioritet të gjitha masat dhe kushtet e domosdoshme për t'i bërë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse, për këtë kategori personash.

Mohimi i përshtatjes së arsyeshme, në strehim për personat me aftësi të kufizuar, ka sjellë për pasojë diskriminimin e tyre për shkak të aftësisë së kufizuar të tyre, pasi i ka vendosur në pozita jo të barabarta me të tjerët, sa i takon gëzimit të kësaj të drejte.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit në formën e “mohimit të një përshtatjeje të arsyeshme”, nga ana e Bashkisë së Tiranës, ndaj kategorisë së personave me aftësi të kufizuar, përmes vënies në pozita të pabarabarta dhe jo të favorshme krahasuar me të tjerët, duke iu mohuar atyre mundësinë për akses dhe për shfrytëzim të banesave sociale.

Bashkia e Tiranës të krijojë mundësitë për lehtësimin e kushteve për përshatshmërinë dhe aksesueshmërinë e banesave sociale aktuale për personat me aftësi të kufizuar.

Të hartojë projekte të reja për shërbime dhe banesa sociale me qira, ku të parashikohen me prioritet të gjitha masat dhe kushtet e domosdoshme për t'i bërë të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse, veçanërisht për personat me aftësi të kufizuar.

Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi, Bashkia e Tiranës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat, projektet, strategjinë për personat me aftësi të kufizuar, për përshatshmërinë dhe aksesueshmërinë e banesave sociale. (të dërgojë një kopje të aktit).

75. Shoqata Shkodrane e Invalidëve Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, të lindur ose të aksidentuar gjatë jetës kundër Bashkisë Shkodër

VENDIM NR. 67, DATË 10.06.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces (Gjobë për mospërbushje të vendimit)

Personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë nuk u është garantuar transporti urban qytetas falas nga ana e Bashkisë Shkodër, sikurse parashikohet në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke iu mohuar e drejta për t'u trajtuar në kushte të barabarta me të tjerët.

FAKTET

Duke filluar nga data 15 janar 2019, transporti falas për individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë të këtij qyteti është ndërprerë, pasi operatorët e shërbimit urban nuk kompensohen nga Bashkia Shkodër, për ofrimin e transportit falas për individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë të këtij qyteti. Bashkia Shkodër ka lidhur kontrata shërbimi me 2 (dy) operatorë të shërbimit urban, për një periudhë 5 vjeçare. Në këto kontrata parashikohet ofrimi i shërbimit urban falas për disa kategori vulnerabël, ndër të cilat edhe për kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Nëpërmjet një shkrese të Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, drejtuar të gjithë Kryetarëve të Bashkive dhe për dijeni Prefektëve të Qarqeve, këta të fundit informohen se ligji nr. 37/2014, datë 10.04.2014, "Për disa shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 "Për transportet rrugore", i ndryshuar", për momentin mbetet i pazbatueshëm, për sa kohë nuk janë miratuar aktet nënligjore përkatëse. Në nenin 3, të këtij ligji parashikohet se: "*Fondet për kompensimit e tarifës së transportit të kategorisë së personave, që përfitojnë nga legjislacioni në fuqi për transportin qytetas, përballohen nga institucionet përgjegjëse, sipas ligjit. Masa kriteret dhe procedurat për kompensimin e kësaj tarife përcaktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.*"

Sipas Bashkisë Shkodër, aktet nënligjore që përcaktojnë masat, kriteret procedurat për kompensimin e tarifave nuk kanë dalë ende, pasi Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë është në procesin e vlerësimit dhe hartimit të projektvendimeve për përcaktimin e mënyrës së kompensimit të shërbimit të transportit për kategoritë që përfitojnë lehtësira sipas legjislacionit në fuqi.

Ministri përgjegjës udhëzon Kryetarët e Bashkive, që të mbikqyrin në mënyrë të vazhdueshme respektimin e detyrimeve kontraktuale, mbi këtë të drejtë të invalidëve të punës nga shoqëritë e transportit. Sipas Bashkisë e gjithë problematika lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë me mungesën e aktit përkatës nënligjor, i cili duhet të përcaktojë, masat, kriteret dhe procedurën e kompensimit për transportin falas të kategorive të veçanta të personave me aftësi të kufizuara

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁶⁴
- Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*,
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 *“Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”* (i ndryshuar)
- Ligji Nr. 27/2012 *“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”*
- Ligjit Nr. 8626, datë 22.06.2000 *“Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”* (i ndryshuar),
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 *“Për transportet rrugore”* (i ndryshuar)
- Vendimit Nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”*,
- Udhëzimit Nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, *“Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit,*
- Udhëzimi Nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, *“Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve.”*

KONKLUSIONE

Komisioneri konkludon se Bashkia Shkodër ka dështuar në marrjen e masave për heqjen e të gjitha pengesave institucionale, për të krijuar të gjitha lehtësitë për garantimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuara.

Ky dështim lidhet me:

Së pari, Bashkia Shkodër i ka ndërprerë përpjekjet e saj me pushtetin qendror për t'i dhënë një zgjidhje përfundimtare situatës, në lidhje me përcaktimin e masave, kriterëve dhe procedurat për kompensimin e tarifës së transportit qytetas për udhëtarët që përfitojnë lehtësi me ligje të veçanta. Korrespondenca e fundit shënohet në vitin 2015 dhe pas këtij viti nuk rezultojnë më interesim nga ana e Bashkisë Shkodër, për të nxitur Këshillin e Ministrave në nxjerrjen e aktit nënligjor për masat, kriteret dhe përfitimin e kompensimit për personat me aftësi të kufizuara.

⁶⁴Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

Së dyti, pavarësisht kësaj, Bashkia Shkodër ka pasur të gjithë mundësinë për zgjidhjen vetë të situatës konkrete, nisur nga fakti që transporti qytetas është funksion i saj, ekskluziv, për t'ia garantuar të gjithë banorëve të saj⁶⁵, duke garantuar përkujdesje sociale të veçantë për personat me aftësi të kufizuar⁶⁶. Pikërisht në funksion të faktit, që transporti qytetas është funksion ekskluziv i Bashkisë, Ligji nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar), në nenin 10, germa c)⁶⁷, të tij parashikon edhe vendosjen e tarifës së shërbimit urban nga vetë Bashkia. Gjithashtu, neni 85, i ligjit nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) parashikon se fondet për kompensimin e transportit qytetas përballohen nga Bashkitë.

Diferencimi midis invalidëve të punës, të cilët sipas ligjit të posaçëm⁶⁸ përfitojnë transport falas dhe personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët marrin kompensim, jo vetëm që është i padrejtë dhe diskriminues, me aktet e reja ligjore është i tejkaluar dhe të njëjtat garanci, që ofrohen për një kategori duhen garantuar edhe për kategoritë e tjera. Nisur nga fakti që ofrimi i shërbimit të transportit për personat me aftësi të kufizuar, realizohet në mënyrën më të plotë dhe të thjeshtë duke e garantuar atë falas, kjo duhet të ndodhë për të gjitha kategoritë e individëve me aftësi të kufizuar, pa asnjë lloj dallimi apo diferencimi.

Për këtë arsye, mos-nxjerrja e akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, që në vetvete përbën një mosveprim shumë të rëndë, nuk mund të shërbejë si pengesë për Bashkinë Shkodër për zgjidhjen përfundimtare të situatës, pasi rendi juridik i ofron të gjitha mundësitë, që transportin falas, Bashkia mund dhe duhet ta garantojë vetë, si duke nxjerrë aktet e nevojshme normative, ashtu edhe duke bërë parashikimet për përfitimin e shërbimit falas për personat me aftësi të kufizuar.

Së treti, mosveprimi i Bashkisë Shkodër kundrejt operatorit, i cili në mënyrë sistematike nuk ka respektuar detyrimet ligjore dhe kushtet kontraktore për garantimin e transportit falas për individët me aftësi të kufizuar, duke mos kryer monitorimet e nevojshme dhe duke mos marrë masat për mos-përsëritjen e situatës, e ka vështirësuar përfitimin e transportit qytetas për personat me aftësi të kufizuar dhe konkretisht për individët që i përkasin kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, deri në Janar të 2019, duke mos ia garantuar fare këtë lehtësi, pas muajit Janarit 2019. Kjo situatë i ka ekspozuar individët paraplegjikë e tetraplegjikë në Shkodër kundrejt një situate të padrejtë, disfavorizuese dhe diskriminuese duke i vendosur atyre pengesa institucionale, të cilat mund dhe duhej të ishin rregulluar.

Detyrimi për të siguruar shërbim falas në transportin urban qytetas parashikohet edhe në certifikatat dhe licencat e operatorëve të shërbimit. Bashkia Shkodër është autoriteti përgjegjës që lëshon certifikatat dhe licencat për këta operatorë. Operatori i shërbimit “Ergys

⁶⁵ Në referencë të neneve 22 dhe 23, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

⁶⁶ Në referencë të nenit 24, të Ligjit Nr. 139/2015. “Për vetëqeverisjen vendore”.

⁶⁷ Neni 10, germa c), i Ligjit Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar) parashikon: “Tarifat e biletave të transportit qytetas të udhëtarëve me autobus miratohen me vendim të këshillit të njësisë së qeverisjes vendore, sipas nenit 14 të këtij ligji.”.

⁶⁸ Referuar nenit 11, të Ligjit Nr. 7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit të punës” (i ndryshuar);

2010MS” sh.p.k. nuk ka zbatuar përcaktimet në dokumentet e mësipërme dhe ka paraqitur këtë problematikë që prej vitit 2015. Pavarësisht kësaj, Bashkia Shkodër nuk ka ndërmarrë asnjë masë ndaj këtij subjekti.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstaton se Bashkia Shkodër nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, si dhe për rregullimin e situatës në mënyrë përfundimtare.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se kësaj kategorie individësh me aftësi të kufizuara, sikurse edhe të gjitha kategorive të tjera që bëjnë pjesë në këtë grupim, u është mohuar një e drejtë, e cila u është dhënë nga legjislacioni në fuqi, kjo falë mosveprimeve Bashkisë Shkodër.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të aftësisë së kufizuar, të kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, nga ana e Bashkisë Shkodër.

Në referencë të pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Bashkisë Shkodër, për të siguruar dhe garantuar lehtësitë në transport ndaj kësaj kategorie.

Rekomandohet që, Këshilli i Ministrave të marrë masa për ndryshimet në legjislacion dhe në aktet nënligjore, sipas nenit 20, të Ligjit nr.93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”*

76. Shoqata e Invalidëve Para dhe Tetraplegjikë të Shqipërisë, Qarku Durrës kundër Bashkisë Durrës

VENDIM NR. 119, DATË 09.09.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në proces (Gjobë për mospërbushje të vendimit)

Personave para dhe tetraplegjikë nuk u sigurohet akses fizik në mjetet e transportit publik në Qarkun e Durrësit, duke iu mohuar e drejta për t'u trajtuar në kushte të barabarta me të tjerët.

FAKTET

Invalidëve para dhe tetraplegjikë nuk u sigurohet akses fizik në mjetet e transportit publik në qarkun e Durrësit. Autobusët e shërbimit urban nuk kanë platformë lëvizëse për të siguruar aksesin e personave me aftësi të kufizuar ose edhe kur e kanë refuzojnë ta vënë në dispozicion të individëve, që bëjnë pjesë në këtë kategori vulnerabel.

Përfaqësuesja e shoqatës e ka konstatuar një gjë të tillë, në mënyrë të drejtpërdrejtë, pasi kur ka kërkuar të përdorë shërbimin e transportit urban në linjën e transportit urban Durrës-Plepa, drejtuesi i autobusit jo vetëm ka refuzuar të ulë platformën, që i shërben personave me aftësi të kufizuar për të hipur në autobus, por nuk i ka dhënë as kohë, që ajo të mund të asistojë nga persona të tjerë për t'u ngjitur në autobus. Ajo shprehet se autobusi vijues, që është ndalur në stacion nuk ka patur platformë të pjerrët dhe në këto kushte, ajo është ndihmuar nga persona të rastit, të cilët e kanë ngritur dhe transportuar atë dhe karrocën e saj me rrota brenda autobusit.

Sjellja dhe trajtimi i drejtuesit të autobusit të parë ishte fyes e denigrues, ndërkohë që edhe mungesa e aksesueshmërisë në autobusin e dytë të linjës së sipërpërmendur, ka cënuar rëndë dinjitetin e saj, si dhe e ka vënë para riskut, që të transportohej nga njerëz që u gjenden pranë saj rastësisht, të cilët ishin të patrajnuar të operonin me karrocën me rrota.

Rezultoi se një pjesë e mjeteve të transportit publik të operatorit urban Maren Bus sh.p.k., të kontraktuar nga Bashkia Durrës, ishin të pajisur me platformën lëvizëse, që siguron aksesueshmërinë fizike të personave me aftësi të kufizuar në autobusë, ndërkohë që një pjesa tjetër e këtyre automjeteve nuk janë të pajisur me një pajisje të tillë, duke e diskriminuar këtë kategori individësh, për shkak të aftësisë së kufizuar. Mungesa e një platforme lëvizëse në autobusët e kësaj shoqërie, përbën një pengesë në kuptimin e ligjit nr. 93/201, datë 24.07.2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara", pasi pengon aksesin fizik në automjetet urbane qytetase, të individëve me aftësi të kufizuar, duke kufizuar mundësinë e tyre për të vetëvepruar.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁶⁹
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” , nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”,
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar
- Ligji Nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në ligjin Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar),
- Ligji Nr. 8308, datë 18.03.1998 “Për transportet rrugore” (i ndryshuar)
- Vendimit Nr. 85, datë 08.02.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për prodhimin shpërndarjen dhe pajisjen e udhëtarëve me bileta transporti rrugor”,
- Udhëzimit Nr. 5627, datë 18.11.2016, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”,
- Udhëzimi Nr. 3743, datë 10.07.2017, i Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Mbi modelet dhe standartet e biletave të transportit rrugor të udhëtarëve”.

KONKLUSIONE

Legjislacioni shqiptar siguron mbrojtje të të drejtave të kategorisë së individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të cilët janë pjesë e grupit të individëve me aftësi të kufizuara. Ligji nr.8626, datë 22.6.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” (i ndryshuar) parashikon detyrimin e shtetit për të krijuar kushte për të sëmuret paraplegjikë dhe tetraplegjikë, që ata të marrin pjesë në jetën shoqërore njëjloj si të tjerët, duke siguruar për ta një nivel ekonomik të nevojshëm për të jetuar në mënyrë dinjitoze, kushte banimi, jetesë e punë të përshtatshme, si dhe u krijon mundësi normale për kurim, arsimim, veprimtari çlodhëse, argëtuese dhe sportive.

Në rastin e transportit urban qytetas përgjegjësia për të monitoruar plotësimin e kriterit të aksesueshmërisë fizike të automjeteve të transportit urban është e njëjësive të qeverisjes vendore. Në pikën 6, të nenit 23 “Funkcionet e Bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikohet: “Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: ...6. Transportin publik vendor”.

⁶⁹Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

Referuar Kontratave të Shërbimit Nr. 6731, datë 27.10.2014 dhe nr. 3879, datë 25.06.2014, të lidhura ndërmjet Bashkisë Durrës dhe Shoqërisë Maren Bus sh.p.k., rezulton se ky operator shërbimi ofron shërbimin urban qytetas për linjat Durrës-Unazë-Kënetë-Plepa-Durrës dhe Durrës-Plepa-Durrës. Ngjarjet e ndodhura dhe problematika e parashtruar nga ankuesja kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me mos sigurimin dhe mos ofrimin e shërbimit për aksesueshmërinë fizike në autobusët e këtij operatori. Në bazë të kontratave të mësipërme rezulton se ato përmbajnë parashikime, lidhur me detyrimin e operatorit të shërbimit për ofrimin e lehtësirave dhe sigurimin e aksesueshmërisë fizike të individëve me aftësi të kufizuar. Në nenin 12 të Kontratave të sipërcituara parashikohet: *“Operatori detyrohet që:- Të sigurojë vende të rezervuara vecanërisht për personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatëzënë, të moshuarit”*. Në nenin vijues parashikohet: *“...të ketë ulje të njëanshme nga ana e pasagjerit, kur autobusi është i ndaluar në stacion”*.

Bashkia Durrës nuk ka monitoruar zbatimin e kontratave të lidhura me operatorin Maren Bus sh.p.k., pasi ajo nuk ka depozituar në cilësinë e provës pranë KMD-së, asnjë raport monitorimi të autobusëve të dy linjave të mësipërme, si para edhe pas seancës dëgjimore⁷⁰ të zhvilluar pranë Komisionerit, mbi këtë çështje. Neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar)⁷¹ ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në rastin konkret Bashkisë Durrës. Në këtë rast, Bashkia Durrës duket të provonte se nga ana e saj janë marrë të gjitha masat e nevojshme për garantimin aksesueshmërisë fizike në transportit qytetës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe të evidentonte qartësisht kontrollet dhe monitorimet e kryera ndaj operatorit të shërbimit urban qytetas Maren Bus sh.p.k, apo edhe ndaj operatorëve të tjerë, si dhe masat respektive të marra ndaj subjekteve që kanë rezultuar se nuk kanë zbatuar parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura dhe kontratave të shërbimit.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1, të LMD, Komisioneri gjykon se individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Durrësit i janë nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e Bashkisë Durrës.

Njëkohësisht, Komisioneri gjykon se operatori urban Maren Bus sh.p.k., duke u bërë palë në këtë proçedim administrativ, refuzoi të bashkëpunojë me Komisionerin dhe njëkohësisht, në kushtet kur ky subjekt ka patur barrën e provës për të vërtetuar, se ai ka zbatuar parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe të kontratave të shërbimit të lidhura me Bashkinë Durrës, mbi sigurimin e aksesueshmërisë fizike të individëve me aftësi të kufizuar dhe nuk ka dhënë informacionin e kërkuar, prezumon faktin se pretendimet e A. H., janë të vërteta.

⁷⁰ Referuar proçesverbalit të seancës dëgjimore rezulton se përfaqësuesit e Bashkisë Durrës janë shprehur se në vijim të saj do të zhvillohet kontrolle në autobusët e linjave qytetase dhe do të merren masa ndaj operatorëve të shërbimit urban që nuk ofrojnë aksesueshmëri fizike për personat me aftësi të kufizuar.

⁷¹ Neni 82, pikat 2 dhe 3, të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Proçedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) parashikon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. 3. Në mënyrë që të mbështesin pretendimet e tyre, palët mund t’i bashkëlidhin kërkesës për fillimin e proçedurës administrative dokumente ose fakte të ndryshme.”

Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se në kuptim të nenit 7, pika 1, të LMD, operatori urban Maren Bus sh.p.k. ka ekspozuar ndaj një qendrimi të padrejtë dhe disfavorizues, individët që i përkasin kategorisë paraplegjikë-tetraplegjikë, duke mos siguruar dhe duke refuzuar të ofrojë aksesueshmërinë fizike të tyre në mjetet e shërbimit urban, që ky operator përdor për të ofruar shërbimin urban qytetas në qytetin e Durrësit.

Njëkohësisht, në kushtet kur ankuesja pretendon se edhe ato automjete që kanë platformë lëvizëse, refuzojnë ta vënë në përdorim për të siguruar aksesin fizik të individëve me aftësi të kufizuar në autobusë dhe nga ana e Shoqërisë Maren Bus nuk është dhënë asnjë fakt dhe provë për të vërtetuar të kundërtën, Komisioneri gjykon se kjo shoqëri ka diskriminuar serish kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë, për shkak të aftësisë së kufizuar. Nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të tilla, Shoqëria Maren Bus sh.p.k. bie ndesh me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, sikurse edhe me detyrimet kontraktore.

Për sa më sipër, shërbimi urban qytetas është një shërbim publik, i cili, sikurse është përmendur me sipër, menaxhohet nga njësitë e qeverisjes vendore dhe në rastin konkret nga Bashkia Durrës. Detyrimi për të monitoruar dhe kontrolluar zbatimin e parashikimeve të akteve të sipërpërmendura dhe përcaktimeve në kontratat e shërbimeve ka qenë detyrim i Bashkisë Durrës, e cila ka gjithashtu tagrin për të licencuar operatorët e shërbimit urban⁷² dhe për të marrë masa ndaj tyre në rast mospërmbushje të detyrimeve ligjore dhe atyre kontraktore. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri konstatoi se Bashkia Durrës nuk ka vepruar në bazë të kompetencave, që asaj i atribuohen nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, për të ndaluar faktin e mos ofrimit të lehtësirave në transport për kategorinë e individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë. Gjatë hetimit administrativ rezultoi se ky institucion nuk i ka kryer detyrimet e tij, duke diskriminuar individët paraplegjikë dhe tetraplegjikë për shkak të aftësisë së kufizuar.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga Bashkia Durrës.

Konstatimin e diskriminimit të individëve paraplegjikë dhe tetraplegjikë të qytetit të Durrësit, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga operatori i shërbimit urban qytetas Maren Bus sh.p.k.

Në referencë të pikës 1, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e Bashkisë Durrës, për të garantuar aksesueshmërinë fizike të kategorisë së individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, në automjetet e shërbimit urban qytetas.

Në referencë të pikës 2, të këtij Vendimi, të merren të gjitha masat e nevojshme nga ana e operatorit urban Maren Bus sh.p.k., për të garantuar aksesueshmërinë fizike të individëve paraplegjikë e tetraplegjikë, në automjetet e shërbimit urban qytetas, sipas legjislacionit në fuqi.

⁷² Shih Udhëzimin Nr. 5627, datë 18.11.2016 “Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”.

77. B. N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Qendra Spitalore Universitare Tiranë (QSUT)

VENDIM NR. 17, DATË 05.02.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminimi i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesit B. N., i diagnostifikuar me Hemofili të tipit B/formë e rëndë, nuk i ofrohet medikamenti i nevojshëm Faktor IX, në sasinë e duhur dhe të rekomanduar nga mjeku hematolog, duke i shkaktuar invaliditet të pjesshëm.

FAKTET

Ankuesi B.N.⁷³ është diagnostikuar me Hemofili të Tipit B, e formës së rëndë, shkaktuar nga mungesa e Faktorit IX të koagulimit. Në kushtet kur ankuesi vuan nga Hemofili B, ai kërkon mjekim me medikamentin Faktor IX, i cili është koagulant, tepër i domosdoshëm për t'u marrë në sasinë e nevojshme. Mungesa e këtij medikamenti ose mosmarrja e tij në sasinë e duhur shkakton invaliditet, të pjesshëm ose të plotë. Ankuesit B. N., nuk i është siguruar mjekim i përshtatshëm mjekësor, për shkak të mungesës së medikamentit Faktor IX. Kështu, gjatë trajtimit të sëmundjes, ai nuk e ka marrë asnjëherë medikamentin Faktorit IX në sasinë e duhur, të rekomanduar për mjekim të përshtatshëm të sëmundjes, pasi në farmacinë e QSUT-së nuk ka sasi të mjaftueshme të Faktorit IX, për të përballuar nevojat e pacientëve hemofilikë që kurohen pranë këtij spitali. Kjo ka shkaktuar përkeqësim të sëmundjes dhe invaliditetin e pjesshëm të ankuesit, i cili ka statusin e personit me aftësi të kufizuar, i përcaktuar si invalid i Grupit të II, i paaftë për punë në masën 50%, sipas Vendimin të KMCAP.

Mungesa e profilaksisë dhe Faktorit IX i ka shkaktuar ankuesit dhe Inhibitor. Ky i fundit është një substancë, e cila pengon efektin e Faktorit IX, dhe sjell si pasojë që hematoma të shtohet dhe në rastin me të keq, në rastin e hemorragjisë cerebrale, mund të shkaktojë vdekjen.

Analizat për verifikimin dhe diagnostikimin e inhibitorit nuk mund të kryhen pranë QSUT.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë

⁷³ I përfaqësuar përpara KMD nga një organizatë me interesa legjitime, bazuar në nenin 33, pika 1 të Ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi.

- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁷⁴
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” , nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10
- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”,
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar
- Ligji Nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar),
- Ligji Nr. 10383/2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 5, nenin 10.

KONKLUZIONI

Komisioneri gjykoi se, institucionet përgjegjëse duhet të kishin marrë masat e nevojshme për të parashikuar dhe kërkuar buxhetin e nevojshëm, për të sigurimin e medikamentit Faktor IX për të sëmurët me Hemofili B. Strukturat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT-së disponojnë informacion të saktë mbi numrin e pacientëve me Hemofili B, dhe në bazë të eksperiencës shumëvjeçare mund të kryenin përlogaritjet e duhura, lidhur me buxhetin apo sasinë e medikamentit që duhet të prokurohet, në mënyrë që pacientët hemofilikë B të trajtohen në mënyrë të përshtatshme me medikamentin Faktor IX.

Buxheti i kufizuar nuk mund të justifikojë faktin e mossigurimit në sasinë e duhur të medikamentit Faktor IX për ankuesin B. N. E drejta për shëndet është një e drejtë që nuk të kushtëzohet nga buxheti i limituar i shtetit, aq më tepër kur bëhet fjalë për ofrimin e mjekimit të përshtatshëm për një individ me aftësi të kufizuara, sic është rasti i ankuesit.

Në vlerësimin e Komisionerit, mos siguri në sasinë e duhur të medikamentit Faktor IX, bie gjithashtu në kundërshtim me Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Sëmundjeve të Lindura të Gjakut, ku ndër të tjera, është rekomanduar marrja në ngarkim e rimbursimit 100% nga shteti, e sasive të nevojshme të faktorëve të koagulimit për të siguruar mjekimin e duhur.

Njëkohësisht, Komisioneri ka vlerësuar se, mungesa e një protokolli për trajtimin e sëmundjes së Hemofilisë ka ndikuar në mostrajtimin e duhur mjekësor të ankuesit si dhe ka shkaktuar mungesën e profilaksisë në funksion të mjekimit të përshtatshëm, dhe mos konsiderimin me prioritet të kësaj sëmundjeje.

Komisioneri ka parë me shqetësim dhe faktin se testi i Inhibitorëve të koagulimit, për pacientët me Hemofili, nuk mund të kryhen pranë QSUT-së, për shkak të nevojës për trajnim të veçantë të personelit dhe kostos së lartë. Për këtë arsye, ankuesi B. N., dhe pacientët e tjerë

⁷⁴Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

me Hemofili, i drejtohen institucioneve mjekësore private, të cilët ofrojnë kosto të lartë, ndaj janë të detyruar t'i kryejnë shumë rrallë, ndërkohë që këto teste duhen ribërë disa herë në muaj.

Mbështetur në analizën e mësipërme, Komisioneri gjykon se ankuesi B. N., i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë e disfavorizues nga ana e institucioneve përgjegjëse, lidhur me mos ofrimin në sasinë e duhur dhe të rekomanduar, të medikamentit Faktor IX.

Mungesa e mjekimit të përshtatshëm për ankuesin B. N., duke mos i ofruar sasinë e duhur dhe të rekomanduar të medikamentit Faktor IX, e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, të B. N., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).

Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të *“gjendjes shëndetësore”*, të B. N., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT).

Marrjen e masave të menjëhershme nga të dy institucionet e mësipërme, për trajtimin e pacientit B. N., me sasinë e rekomanduar nga mjeku hematolog të Medikamentit Faktor IX.

78. Ex-officio e Pacientëve me Hemofili në Shqipëri kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT)

VENDIM NR. 77, DATË 25.06.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar, vendbanimi
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Pacientëve me Hemofili në Shqipëri nuk u garantohet trajtimi mjekësor i përshtatshëm, në sasi të duhura dhe të rekomanduara të medikamenteve koagulant Faktor. Si pasojë, për disa prej tyre është shkaktuar aftësi e kufizuar. Për pacientët hemofilikë nuk ofrohet shërbimi mjekësor në spitalet rajonale, pranë vendbanimeve të tyre.

FAKTET

Komisioneri, ka filluar hetimin administrativ me iniciativë, ex-officio,⁷⁵ bazuar në informacionin e përcjellë nga një organizatë me interesa legjitime, që mbron të drejtat lidhur me kujdesin shëndetësor, në emër të të gjithë pacientëve me Hemofili⁷⁶ në Shqipëri, ku parashtrihen 2 problematika, që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me mënyrën e trajtimit mjekësor dhe atë të ofrimit të shërbimit mjekësor ndaj pacientëve hemofilikë në Shqipëri: *problematika e parë* konsiston në mos sigurimin në sasinë e duhur të medikamenteve koagulant Faktor, për të sëmurët hemofilikë dhe *problematika e dytë* ka të bëjë me mos ofrimin e shërbimit mjekësor, që konsiston kryesisht në ofrimin e medikamenteve koagulant, në spitalet rajonale të Shqipërisë, ndaj të sëmurve hemofilikë, pasi ky shërbim ofrohet vetëm pranë QSUT, Tiranë.

Në Qendrën Kombëtare të Hemofilisë gjejmë trajtim mjekësor të gjithë pacientët hemofilikë të Shqipërisë, në total 235 të tillë. Medikamentet e familjes Faktor administrohen vetëm nga QSUT, Tiranë. Aktualisht, 152 pacientët hemofilikë, që banojnë në rrethe të ndryshme të vendit, detyrohen të udhëtojnë, disa herë në muaj në Tiranë, për mjekim.

Buxheti për blerjen e koagulantëve për hemofilikët nuk është i mjaftueshëm. Nevoja e pacientëve me hemofili për sasinë e Faktorit koagulant është e ndryshme, në varësi të nivelit të sëmundjes, ndërkohë që buxheti i disponueshëm për prokurimin/blerjen e tyre është i pamjaftueshëm, dhe një pjesë sigurohet përmes donacioneve. Gjithsesi, kjo sasi e siguruar, nuk është e mjaftueshme për të mbuluar nevojat e të gjithë pacientëve me hemofili.

⁷⁵ Bazuar në nenin 32, pika 1, germa c), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

⁷⁶ Sëmundja e Hemofilisë konsiston në një çrregullim të trashëguar të hemoragjisë së shkaktuar nga përqëndrime të ulëta të faktorëve të veçantë të koagulimit. Hemofilia e tipit A shkaktohet nga mungesa e Faktorit VIII të koagulimit të gjakut, mungesa e Faktorit IX shkakton Hemofilinë B. Hemofilia trajtohet me faktorin koagulant që i mungon pacientit, sipas nevojave të tij, në bazë të recetave të dhëna nga mjeku specialist.

Mos trajtimi me sasinë e nevojshme të koagulantit përkatës, sjell pasoja të rënda për pacientët hemofilikë, si shfaqja e inhibitorit, invalidizimi i pjesshëm e i plotë, ndërsa mungesa e mjekimit mund të ketë pasoje vdekjen. Hemofilia e rëndë shkakton aftësi të kufizuar tek pacientët.

Shpërndarja gjeografike e pacientëve hemofilikë në Shqipëri, rezulton të jetë: 39 pacientë nga veriu i vendit dhe 60 nga jugu. Referuar moshës, 73 pacientë janë të mitur ndërsa 42 janë mbi 45 vjeç. Ndërsa, 60 pacientë hemofilikë janë në gjendje të rëndë dhe me aftësi të kufizuara.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁷⁷
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*,
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 *“Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”* (i ndryshuar)
- Ligji Nr. 27/2012 *“Për disa ndryshime në ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”*
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 *“Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”* (i ndryshuar),
- Ligji Nr. 10383/2011 *“Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, në nenin 5, nenin 10.

KONKLUSIONE

Nga hetimi administrativ, ka rezultuar se sasia e medikamentit Faktor të siguruar nëpërmjet procedurave të prokurimit, nuk është e mjaftueshme për të gjithë pacientët që vuajnë nga Hemofilia. Ndërkohë që, institucionet përgjegjëse mundohen të përballojnë mungesën nëpërmjet donacioneve, fakt që nuk e bën më të sigurtë, përballimin e nevojave afatgjata të këtyre pacientëve, me medikamentet koagulant.

Komisioneri gjykon se institucionet përgjegjëse duhet të kishin marrë masat e nevojshme për parashikuar dhe kërkuar buxhetin e nevojshëm, për sigurimin e medikamentit faktor për pacientët me Hemofili.

Strukturat përkatëse të MSHMS dhe QSUT-së disponojnë dhe administrojnë informacion të saktë mbi numrin aktual të pacientëve me Hemofili, si dhe në bazë të eksperiencës shumëvjeçare, mund të ishin kryer kryej përlllogaritjet e duhura, lidhur me buxhetin apo sasinë e medikamentit që duhet të prokurohet, në mënyrë që pacientët hemofilikë të trajtohen

⁷⁷Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

në mënyrë të përshtatshme me medikamentin Faktor. Buxheti i kufizuar nuk mund të justifikojë faktin e mossigurimit në sasinë e duhur të medikamentit Faktor për pacientët hemofilikë. E drejta për shëndet është një e drejtë që nuk të kushtëzohet nga buxheti i limituar i shtetit, aq më tepër kur bëhet fjalë për ofrimin e mjekimit të përshtatshëm për individë me aftësi të kufizuara.

Nga 235 pacientë hemofilikë, 152 jetojnë jashtë Tiranës. Ata duhet të udhëtojnë disa herë në muaj drejt Tiranës, për të tërhequr medikamentin Faktor. Në të shumtën e rasteve, udhëtimi në drejtim të Tiranës zgjat më shumë se 1 orë, fakt që është i papërballueshëm nga pacientët hemofilikë, për sa i përket lodhjes dhe riskut të dëmtimeve dhe hemorragjive, por edhe shpenzimeve që duhet të mbulojnë vetë. Për këto arsye, Komisioneri gjykon se pacientëve hemofilikë, që banojnë jashtë Tiranës duhet t'u garantohet asistencë e specializuar mjekësore, në mënyrë permanente, sikurse t'iu sigurohet edhe trajtimi me medikamente koagulant, pranë qendrës më të afërt shëndetësore, pranë vendbanimit të tyre.

Në lidhje me shkakun e mbrojtur, krahas shkakut të *“aftësisë së kufizuar”*, i cili vlen për atë kategori pacientësh hemofilikë, të cilët si pasojë e sëmundjes që vuajnë, janë invaliziduar pjesërisht apo tërësisht, Komisioneri gjykon se në rastin e pacientëve hemofilikë, *“gjendja shëndetësore”* përbën shkakun kryesor të diskriminimit të pretenduar.

Shkaku i *“vendbanimit”* lidhet me mos ofrimin e shërbimit mjekësor për pacientët hemofilikë, që jetojnë jashtë Tiranës. Komisioneri gjykon, se këta pacientë janë të diskriminuar për shkak të *“vendbanimit”* të tyre, pasi këtyre pacientëve duhet t'u garantohet një shërbim mjekësor sa më i aksesueshëm, në mënyrë sa më të përshtatshme dhe pranë spitaleve rajonale, në afërsi me vendbanimin e tyre.

Shkelje e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, e shkaktuar nga mungesa e ofrimit në sasinë e duhur të medikamenteve koagulant Faktor, për të sëmurët hemofilikë, e cila i ka shkaktuar në shumicën e rasteve aftësi të kufizuar dhe mos ofrimi i shërbimit mjekësor, në spitalet rajonale të Shqipërisë, në afërsi të vendbanimeve të tyre, i ka ekspozuar para një trajtimi të pabarabartë, të padrejtë dhe disfavorizues, pacientët me Hemofili në Shqipëri, për shkak të gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar dhe vendbanimit, nga ana e MShMS dhe QSUT-së.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të *“gjendjes shëndetësore”*, të pacientëve hemofilikë në Republikën e Shqipërisë, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT), si pasojë e mos garantimit të trajtimit të tyre, me sasinë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor.

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, të pacientëve hemofilikë, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT), si pasojë e mos garantimit të trajtimit me sasinë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor.

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të “*vendbanimit*”, të pacientëve hemofilikë me vendbanim jashtë Tiranës, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si pasojë e mosofrimit të shërbimit mjekësor dhe medikamentit Faktor në spitalet rajonale, pranë vendbanimeve të tyre.

Referuar pikave 1 dhe 2, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga të dy institucionet e mësipërme, për garantimin e sasisë së nevojshme të medikamentit Faktor, për pacientët me hemofili.

Referuar pikës 3, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për t’iu siguruar shërbim mjekësor nga mjekë të specializuar dhe për t’iu garantuar trajtimin me sasinë e duhur të medikamentit Faktor, pacientëve hemofilikë, në spitalet rajonale.

79. K. M., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) dhe Qendes Spitalore Universitare Tirane (QSUT)

VENDIM NR. 143, DATË 10.10.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ankuesit K. M., person me aftësi të kufizuara dhe i diagnostikuar me Hemofili të tipit A/formë e rëndë, nuk i sigurohet medikamenti i nevojshëm Faktor VIII, në sasinë e duhur dhe të rekomanduar nga mjeku specialist, si dhe nuk i ofrohet mjekimi pranë vendbanimit të tij.

FAKTET

Ankuesi K. M., vuan nga Hemofilia e Tipit A, formë e rëndë, e cila është e shoqëruar me aftësi të kufizuar të tij. Referuar Vendimit të KMCAPI Lezhë, ankuesi është “invalid i grupit të parë”, që ka nevojë për përkujdesjen e vazhdueshme të një personi. Ai është ndeshur me mungesën e theksuar të medikamentit Faktor VIII.

Medikamentet e familjes Faktor administrohen nga Farmacia Qendrore e QSUT-së dhe pacientët mund ta tërheqin vetëm në Tiranë.

Ankuesi K. M., duke qenë banor në qytetin e Lezhës, duhet të udhëtojë disa herë në muaj për të tërhequr medikamentin Faktor VIII, pranë QSUT-së. Udhëtimi nga Lezha drejt kryeqytetit, zgjat më shumë se 1 orë, dhe mundësia për të pësuar dëmtim fizik, e si rrjedhim hemorragji, qoftë edhe nga dëmtimi më i vogël, është e pranishme në çdo moment, përveç lodhjes dhe vështirësive dhe shpenzimeve të udhëtimit.

Për më tepër, ankuesi rezulton në gjendje të rëndë shëndetësore dhe me aftësi të kufizuara, e si pasojë risku i dëmtimeve nga udhëtimet e herëpashërëshme është tepër evident. Qarku Lezhë ka 8 pacientë hemofilikë, ndër të cilët bën pjesë edhe ankuesi.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- Konventa e OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”⁷⁸
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10

⁷⁸Ratifikuar me ligjin Nr. 108/2012 “Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”.

- Ligji Nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”,
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar
- Ligji Nr. 27/2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik
- Ligji Nr. 8626, datë 22.06.2000 “Statuti i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik” (i ndryshuar),
- Ligji Nr. 10383/2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 5, nenin 10.

KONKLUZIONI

Legjislacioni i miratuar nga shteti shqiptar, sikurse edhe konventat e ratifikuara me ligj, konsiderohen si masa të ndërmarra ndaj personave me aftësi të kufizuara, në kuadër të zbatimit të detyrimeve konkrete të shtetit shqiptar, për t’iu siguruar këtyre individëve, akses në shërbimin shëndetësor. Mbështetur në sa më sipër, para institucioneve përgjegjëse del si detyrë parësore zbatimi i këtij legjislacioni, si dhe ofrimi i një shërbimi shëndetësor cilësor dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara. Subjektet kundër së cilëve drejtohet ankesa kanë detyrimin ligjor t’i sigurojnë pacientëve hemofilikë, trajtim të përshtatshëm mjekësor.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk siguron dot sasinë mjaftueshme të medikamentit Faktor VIII, për pacientët që vuajnë nga Hemofilia e tipit A. Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se institucionet përgjegjëse duhet të kishin marrë masat e nevojshme për parashikuar dhe kërkuar buxhetin e nevojshëm, për të sigurimin e medikamentit faktor për të sëmurët me Hemofili, aq më tepër kur predispozicioni i pacientëve me këtë sëmundje është invalidizimi i tyre.

Strukturat përkatëse të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT-së disponojnë dhe administrojnë informacion të saktë mbi numrin aktual të pacientëve me Hemofili, si dhe në bazë të eksperiencës shumëvjeçare të QSUT-së, mund të kryhej edhe një parashikim i përafërt mbi pacientët e rinj, që mund të paraqiten nga viti në vit, për të kryer përlllogaritjet e duhura, lidhur me buxhetin apo sasinë e medikamentit që duhet të prokurohet, në mënyrë që pacientët hemofilikë të trajtohen në mënyrë të përshtatshme me medikamentin Faktor.

Komisioneri ka konstatuar se ndaj ankuesit, i cili është pacient hemofilik, me aftësi të kufizuara, nuk jepet shërbimi i duhur, në sasinë e duhur të medikamentit të nevojshëm, nga institucionet përgjegjëse, duke i ekspozuar ata ndaj një trajtimi të padrejtë e disfavorizues.

Ankuesi duhet të udhëtojë disa herë në muaj drejt Tiranës, për të tërhequr medikamentin Faktor VIII, ndërkohë që çdo herë që udhëton përballet me riskun e dëmtimeve dhe hemorragjive të brendshme dhe të jashtëm. Në të shumtën e rasteve, udhëtimi në drejtim të Tiranës zgjat më shumë se 1 orë, fakt që është i papërbalueshëm nga ankuesi, jo vetëm për sa i përket lodhjes dhe riskut për të pësuar dëmtime, por edhe shpenzimeve, që ai duhet të mbulojë çdo herë që udhëton për në Tiranë. Një gjë e tillë, ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin dhe buxhetin e tij familjar.

Komisioneri gjykon se ankuesi që banon në qytetin e Lezhës, duhet t'i garantohet asistencë e specializuar mjekësore, në mënyrë permanente, sikurse t'i sigurohet edhe trajtimi me medikamente koagulantë, pranë Spitalit Rajonal të Lezhës, pranë vendbanimit të tij.

Mungesa e mjekimit të përshtatshëm për ankuesin K.M, duke mos i ofruar sasinë e duhur dhe të rekomanduar të medikamentit Faktor VIII, si dhe mos ofrimi i shërbimit mjekësor, në Spitalin Rajonal të Lezhës, pranë vendbanimit të tij, e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe QSUT.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit, për shkak të *“aftësisë së kufizuar”*, të K. M., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Qendrës Spitalore Universitare Tiranë (QSUT), si pasojë e mos garantimit të trajtimit me sasinë e duhur dhe të mjaftueshme të medikamentit koagulant Faktor VIII.

Konstatimin e diskriminimit të K.M., për shkak të *“vendbanimit”*, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si pasojë e mosofrimit të shërbimit mjekësor dhe medikamentit Faktor në Spitalin Rajonal të Lezhës, pranë vendbanimit të tij.

Referuar pikës 1, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga të dy institucionet e mësipërme, për garantimin e sasisë së nevojshme të medikamentit Faktor VIII, për K.M.

Referuar pikës 2, të këtij Vendimi, të merren masa të menjëhershme nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për t'i siguruar shërbim mjekësor nga mjekë të specializuar dhe për t'iu garantuar trajtimin me sasinë e duhur të medikamentit Faktor VIII, K.M, pranë Spitalit Rajonal Lezhë.

80. A. B., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)

VENDIM NR. 255, DATË 19.12.2018

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë dhe aftësia e kufizuar.
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ndaj shtetasit A. B., i diagnostikuar me “*Skizofreni e tipit paranoid*”, i deklaruar i papërgjegjshëm penalisht, nuk zbatohet masa mjekësore e “mjekimit të detyruar në një institucionin mjekësor”, por *de facto* trajtohet si “i dënuar”, duke u mbajtur në institucion penitenciar, në shkelje flagrante të legjislacionit në fuqi.

FAKTET

Shtetasi A. B. është person me aftësi të kufizuar mendore, me diagnozë “*Skizofreni e tipit paranoid*”.

Pas kryerjes së një vepre penale prej tij, me Vendim Gjyqësor të formës së prerë, është vendosur se ndaj tij duhet të zbatohet masa mjekësore e mjekimit të detyruar në një institucion shëndetësor.

Situata “*de facto*” e shtetasit A. B., nga viti 2001 e deri aktualisht vijon të mbetet e njëjtë, pasi mbahet dhe trajtohet në ambjentet e IEVP Krujë.⁷⁹ Shtetasit A. B., përfshirë edhe të gjithë shtetasit/pacientët e tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, të akomoduar në institucione penitenciar, në raport me të sëmurët e tjerë mendorë që kurohen dhe trajtohen në spitalet psikiatrike të sektorit publik, nuk u ofrohet i njëjti shërbim mjekësor si atyre në spitalet psikiatrike, për më tepër duke u kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, tej masës që përkon me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Ky shtetas bën pjesë në grupin e personave të sëmurë të shëndetit mendor, ndaj të cilit duhet të zbatohet masa mjekësore e mjekimit të detyruar në një institucion shëndetësor, përcaktuar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë, por që vazhdon të jetë i akomoduar në ambjentet e IEVP Krujë. Pra, ai “*de facto*” trajtohet si një person “i dënuar”, kur në fakt duhet të trajtohej si “pacient i shëndetit mendor” në një institucion psikiatrik, në zbatim të vendimit gjyqësor sipërcituar.

⁷⁹ Në kushte të ngjashme apo të njëjta me të ndodhen 275 shtetas, aktualisht të gjithë shtetasit me vendim gjyqësor, masë mjekësore “*mjekim i detyruar*” dhe “*shtrim i përkohshëm*”, nga të cilët: 184 shtetas në IEVP Krujë dhe 91 shtetas në IVSHB Tiranë (Qendra Spitalore e Burgjeve) dhe në Institutin e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, IEVP Krujë, ku prej vitesh trajtohen në këto dy institucione, në mungesë të një institucioni të veçantë mjekësor.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁸⁰
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*,
- Ligji nr. 44/2012 *“Për shëndetin mendor”*, pikat 1 dhe 2 të nenit 28,
- Neni 45 i ligjit Nr. 8331/1998 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*,
- Dokumentit *“Mbi Rregullat Europiane të Burgut”*, të Këshillit të Europës.

KONKLUZIONE

Referuar legjislacionit në fuqi, shtetasit me masa mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, duhet të trajtohen në institucione mjekësore të posaçme ku diagnostifikohen, kurohen dhe rehabilitohen me qëllim mbrojtjen e shëndetit mendor. Ata duhet të trajtohen dhe kurohen në mënyrë të barabartë me pacientët e tjerë, të sëmurë të shëndetit mendor. Ata gëzojnë të njëjtat të drejta dhe duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë me personat e tjerë që nuk kanë kryer vepër penale por që janë të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tyre mendore. Përkundrazi, ata mbahen në ambjentet e IEVP Krujë dhe IVSHB Tiranë, duke iu mohuar shërbimin mjekësor në përputhje me protokollin e miratuar të sëmundjeve të shëndetit mendor.

Mbajtja në IEVP Krujë e shtetasit A. B., jo vetëm nuk i garanton atij trajtim kurues, siç ka urdhëruar gjykata, por përkundrazi, regjimi izolues i sistemit të burgjeve ka përkeqësuar më tej gjendjen e tij mendore. Në mungesë të trajtimit të posaçëm dhe rehabilitues, mundësia që ky shtetas të ketë përmirësim shëndetësor është pakësuar dhe kjo vërtetohet edhe nga vendimet e mëvonshme gjyqësore për rishikimin e masës.

Justifikimi i institucioneve përgjegjëse se, në mungesë të një institucioni të veçantë mjekësor, ata kanë qenë të detyruar të mbajnë shtetasin A. B., dhe të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në ambjentet e IEVP Krujë dhe IVSHB Tiranë, nuk mund të përbëjë shkak për kufizimin e paligjshëm të lirisë dhe të drejtave të tyre themelore. Kjo situatë i privon ata nga marrja e mjekimit të përshtatshëm dhe të specializuar nga një staf i kualifikuar dhe specializuar, gjë që ka shkaktuar përkeqësim shëndetësor të gjendjes së tyre mendore.

Në këto kushte, IVSHB Tiranë dhe IEVP Krujë janë pjesë e sistemit penitenciar ku zbatohen rregulloret përkatëse për trajtimin e personave të burgosur. Ndërkohë që, shtetasit A.B dhe të tjerë, janë pacientë të shëndetit mendor dhe jo shtetas të dënuar, për sa kohë nuk kemi të bëjmë me një vendim gjyqësor të formës së prerë që t’i deklarojë këta shtetas fajtorë për

⁸⁰Ratifikuar me ligjin Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

kryerjen e ndonjë vepre penale apo që të ketë caktuar kufizimin e përkohshëm të lirisë së tyre në ambjentet e IEVP-ve.

Trajtimi mjekësor në institucionin, IEVP Krujë, e ka vendosur shtetasin A. B., në pozita të pabarabarta me të sëmurët e tjerë mendorë, në mungesë të ofrimit të shërbimit të njëjtë mjekësor si atyre që kurohen në institucione shëndetësore publike, duke kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara me Kushtetutë, tej masës që përkon me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

Trajtimi i papërshtatshëm shëndetësor me pasoja të dëmshme për shëndetin e pacientëve me sëmundje të shëndetit mendor, ka qenë objekt i analizës dhe vendimmarrjes së GJEDNJ, në çështjen “*Groni kundër Shqipërisë*”, ku Gjykata konstatoi cenim të nenit 3 të Konventës, duke argumentuar se rreziku i sëmundjes është shoqëruar me mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor dhe kohëzgjatjen e kohës së burgimit (megjithëse shtetasi Groni kishte cilësinë e një shtetasi të dënuar dhe jo me masë mjekësore, që vuante nga një sëmundje e shëndetit mendor). Sipas GJEDNJ-së, mungesa e trajtimit të duhur mjekësor ka çuar në trajtimin degradues të tij, të parashikuar në kuptimin e nenit 3 të KEDNJ-së.

Ndaj shtetasit A.B. dhe të gjithëve të ndodhur në kushtet të njëjta apo të ngjashme me të, duhet të zbatohen protokollat përkatëse, të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Përkundrejt parashikimeve ligjore, sipas të cilave, personave me çrregullime mendore duhet t’u ofrohet kujdes në një mjedis sa më pak shtrëngues, nga ekupe multidisciplinare që i përgjigjen në mënyrë komplekse nevojave mjekësore, psikologjike, sociale dhe të rehabilitimiti., pacientët me masë mjekësore “mjekim i detyruar” janë vendosur dhe mbahen në mënyrë të paligjshme në institucionet penitenciare dhe ndaj tyre aplikohet një regjim i mirëfilltë sigurie burgu.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe të “aftësisë së kufizuar”, të shtetasit A. B., dhe të gjithë kategorisë të sëmurëve të shëndetit mendor të ndodhur në të njëjtat apo kushte të ngjashme me të, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në referim të pikës 1, MSHMS me bashkëpunimin e MD, deri në ngritjen e një institucioni të posaçëm:

- Të marri të gjitha masat e nevojshme për përshtatjen e ambienteve të IVSH Tiranë dhe dy godinave 4 dhe 5 në IEVP Lezhë⁸¹ për akomodimin e shtetasve me vendim gjyqësor me masë mjekësore “Shtrim i detyruar në një institucion psikiatrik”, si një institucion i posaçëm mjekësor.
- Ta pajisë atë me të gjithë infrastrukturën e nevojshme dhe të domosdoshme mjekësore dhe personelin e specializuar mjekësor dhe psiko-social.

⁸¹Referuar paragrafit III, faqe 6 e vendimit.

- Godinat të kalojnë tërësisht nën administrimin dhe kujdesin e MSHMS, sikurse parashikohet në ligjin nr.44/2012 “Për shendetin mendor”.

81. A. N., kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS)

VENDIM NR. 46, DATË 28.03.2019

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Në gjykatë

Ndaj shtetasit A. N., person me aftësi të kufizuar mendore, me diagnozë *çrregullim skizofrenik, tipi bipolar*, nuk zbatohet masa mjekësore e “mjekimit të detyruar në një institucionin mjekësor”, por *de facto* trajtohet si “i dënuar”, duke u mbajtur në institucion penitenciar, në shkelje flagrante të legjislacionit në fuqi.

FAKTET

Shtetasi A. N., është person me aftësi të kufizuar mendore, me diagnozë *çrregullim skizofrenik, tipi bipolar*.

Në vitin 2011, me vendim gjyqësor të formës së prerë, ndaj tij është caktuar masa mjekësore “Mjekim i detyruar në një institucion mjekësor”, për shkak të kryerjes së veprës penale “Prishje e rendit dhe qetësisë publike”, e cila do të ekzekutohet pranë Spitalit të Burgjeve, Reparti Psikiatrik Tiranë.

Fillimisht, ai është trajtuar në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve (Spitali i burgut), ndërsa, nga Qershori 2014 e në vijim, ai është vendosur në IEVP Krujë, ku po zbatohet masa mjekësore. Me vendimet e mëvonshme gjyqësore të rishikimit të masës mjekësore, është konfirmuar masa duke lënë në fuqi mjekimin e detyruar në një institucion psikiatrik të shtetasit A. N. Pra, ai “*de facto*” trajtohet si një person “i dënuar”, kur në fakt duhet të trajtohej si “pacient i shëndetit mendor” në një institucion psikiatrik, në zbatim të vendimit gjyqësor sipërcituar.

Përfaqësuesi ligjor i shtetasit A. N., shprehet se ai nuk është as i paraburgosur dhe as i dënuar me burgim, por si person me aftësi të kufizuar mendore, ndaj të cilit duhet të zbatohet masa mjekësore e mjekimit të detyruar në një institucion shëndetësor, përcaktuar kjo nga një vendim gjyqësor i formës së prerë.

Kufizimi i lirisë së tij është në kundërshtim me vendimet e gjykatës dhe statusin e tij si i sëmurë mendor. Mbajtja në ambjentet e IEVP Krujë jo vetëm nuk i garanton trajtim kurues dhe rehabilitues, sipas urdhërimeve të gjykatës, por regjimi izolues i sistemit të burgjeve ka përkeqësuar më tej gjendjen e tij mendore. Në mungesë të këtij trajtimi, mundësia që shtetasi A. N., të ketë përmirësim shëndetësor është pakësuar dhe kjo vërtetohet dhe nga vendimet e mëvonshme gjyqësore për rishikimin e masës.

Sipas Protokollit të Kujdesit Diagnostik dhe Terapeutik për Skizofreninë, të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sëmundja e skizofrenisë trajtohet në mënyrë

efektive përmes një plani trajtimi që kombinon terapinë me barna me shërbimet dhe terapitë mbështetëse.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁸²
- Ligjit Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*,
- Ligji Nr. 44/2012 *“Për shëndetin mendor”*, pikat 1 dhe 2 të nenit 28,
- Neni 45 i ligjit Nr. 8331/1998 *“Për ekzekutimin e vendimeve penale”*,
- Dokumentit *“Mbi Rregullat Europiane të Burgut”*, të Këshillit të Europës.

KONKLUZIONI

Komisioneri, referuar legjislacionit në fuqi, shtetasit me masa mjekësore “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik”, duhet të trajtohen në institucione mjekësore të posaçme ku diagnostifikohen, kurohen dhe rehabilitohen me qëllim mbrojtjen e shëndetit mendor. Ata duhet të trajtohen dhe kurohen në mënyrë të barabartë me pacientët e tjerë, të sëmurë të shëndetit mendor. Ata gëzojnë të njëjtat të drejta dhe duhet të trajtohen në mënyrë të njëjtë me personat e tjerë që nuk kanë kryer vepër penale por që janë të papërgjegjshëm për shkak të gjendjes së tyre mendore.

Ndaj shtetasit A. N., dhe të tjerëve të ndodhur në kushtet të njëjta apo të ngjashme me të, duhet të zbatohen protokollat përkatëse, të cilat duhet të jenë të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

IEVP Krujë është pjesë e sistemit penitenciar ku zbatohen rregulloret përkatëse për trajtimin e personave të burgosur. Ndërkohë që subjekti ankues, është pacient i shëndetit mendor dhe jo shtetas i dënuar. Mbajtja në IEVP Krujë e shtetasit A. N., nuk i garanton atij trajtim kurues, siç ka urdhëruar gjykata. Në mungesë të trajtimit të posaçëm dhe rehabilitues, mundësia që ky shtetas të ketë përmirësim shëndetësor është pakësuar dhe kjo vërtetohet edhe nga vendimet e mëvonshme gjyqësore për rishikimin e masës së dënimit.

Justifikimi i institucioneve përgjegjëse se, në mungesë të një institucioni të veçantë mjekësor, ata kanë qenë të detyruar të kryejnë këtë veprim (mbajtjen e ankuesit dhe të gjithë shtetasve të tjerë në kushte të njëjta apo të ngjashme me të, në ambjentet e IEVP Krujë dhe IEVP “Ali Demi” Tiranë), nuk mund të përbëjë shkak për kufizimin e paligjshëm të lirisë dhe të drejtave të tyre themelore. Kjo situatë e privon shtetasin A.N nga marrja e mjekimit të përshtatshëm

⁸²Ratifikuar me ligjin nr. Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

dhe të specializuar nga një staf i kualifikuar dhe specializuar, gjë që nuk ka lejuar përmirësimin shëndetësor të gjendjes së tij mendore.

Trajtimi mjekësor i shtetasit A. N., realizohet brenda ambjenteve të IEVP-së, duke e vendosur atë në pozitë të pabarabartë me të sëmurët e tjerë mendorë, në mungesë të ofrimit të shërbimit të njëjtë mjekësor si atyre që kurohen në institucione shëndetësore publike, duke kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara me Kushtetutë, tej masës që përkon me vendimin gjyqësor të formës së prerë.

Rezulton qartazi se, shtetasi A.N. është diskriminuar në raport me të sëmurët e tjerë mendorë që kurohen dhe trajtohen në spitalet psikiatrike të sektorit publik, pasi atij nuk i ofrohet i njëjti shërbim mjekësor si atyre në spitalet psikiatrike, për më tepër duke i kufizuar lirinë dhe të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, tej masës që përkon me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Në lidhje me shkakun e mbrojtur, A. N., mbart shkakun “përkatësia në një grup të veçantë”, pasi hyn tek ato subjekte me aftësi të kufizuar mendore, për të cilët gjykata ka faktuar kryerjen e një krimi, pra ka cilësuar rrezikshmërinë shoqërore, por i përjashtuar nga përgjegjësia penale, si dhe shkakun e “aftësisë së kufizuar”, referuar vendimit të KMCAP, i cili e ka diagnostikuar me diagnozën: “Çrregullim skizoafektiv, tipi bipolar”, për të cilët Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje.

Komisioneri, me Vendimin nr.255, datë 19.12.2018, është shprehur me konstatimin e diskriminimit, të gjithë personat që i përkasin kategorisë të sëmurëve të shëndetit mendor të cilët janë të akomoduar në sistemin e IEVP-ve, dhe ka rekomanduar ngritjen e një institucioni të përshtatshëm për këta persona. Në këtë këndvështrim, Komisioneri thekson dhe njëherë nevojën që institucionet përgjegjëse të marrin masa, për përshpejtimin e zbatimit të vendimit të Komisionerit në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe mosdiskriminimit.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të drejtëpërdrejtë, për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë” dhe të “aftësisë së kufizuar” të shtetasit A. N., nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në referim të pikës 1, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të marrin masa për zbatimin sa më të shpejtë të Vendimit nr. 255, datë 19.12.2018 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

82. E. K., kundër Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Korçë

VENDIM NR. 258, DATË 20.12.2018

Shkaku: Aftësia e kufizuar
Forma: Diskriminim i tërthortë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Familja ankueses, që përbëhet nga 4 anëtarë trajtohet me ndihmë ekonomike dhe ka në përbërje një person me aftësi të kufizuar. Familja e saj është në pamundësi të përballojë pagesat e energjisë elektrike për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”.

FAKTET

Familja e ankueses, e cila përbëhet nga 4 persona⁸³, trajtohet me ndihmë ekonomike, pasi të dy bashkëshortët janë të papunë. Bashkëshorti i ankueses, është i regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë si punëkërkues i papunë⁸⁴, por ende nuk është punësuar. Referuar vendimit të KMCAP Korçë, datë 05.07.2017, djali i tyre, 15 vjeçar vuan nga autizmi. Të ardhurat e kësaj familjeje konsistojnë në ndihmën ekonomike, si dhe pagesën e kujdestarisë dhe të aftësisë së kufizuar, që shteti jep për djalin e tyre autik.

Ankuesja është debitore ndaj Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., Korçë dhe Ujësjellës Kanalizime sh.a., Korçë dhe e ka të pamundur të shlyejë detyrimet e prapambetura ndaj dy shoqërive, në kushtet e vështira ekonomike, në të cilat ndodhet familja e saj. OSHEE sh.a Korçë, fillimisht, e ka ndërprerë furnizimin me energji elektrike për familjen e ankueses, por në vijim e ka rilidhur, pasi ka konstatuar gjendjen e vështirë ekonomike, në të cilën ndodhej kjo familje. Ankuesja kërkon të përfitojë nga skemat lehtësuese të OSHEE sh.a. dhe UK Korçë, duke qenë se familja e saj bën pjesë në kategorinë e familjeve që përfitojnë ndihmë ekonomike, si dhe në kushtet kur djali i saj është me aftësi të kufizuara. Njëkohësisht, ajo kërkon nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë⁸⁵, dhënien e mundësisë për punësimin e bashkëshortit të saj

Vendimi nr. 64, datë 27.12.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE sh.a. “*Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jofamiljarë*” parashikon skema lehtësuese për ata konsumatorë familjarë që kanë detyrimeve të prapambetura deri në 31 dhjetor 2016. Referuar informacionit të marrë nga OSHEE sh.a., Korçë, ankuesja rezulton debitore për periudhën Janar 2017- Maj 2018, periudhë, e cila nuk përfshihet në vendimin e sipërcituar. Këshilli Mbikëqyrës i kësaj shoqërie ka vendosur që periudha e mbuluar nga skemat lehtësuese për

⁸³ Referuar çertifikatës familjare, së lëshuar nga ZGJC, Njësia Administrative Korçë 234, Nr. 014212907, datë 04.06.2018.

⁸⁴ Referuar Vërtetimit Nr. 475, datë 04.06.2018, të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë.

⁸⁵ Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë nuk është subjekt kundër së cilit drejtohet ankesa, por kërkohet bashkëpunimi i saj, për punësimin e bashkëshortit të ankueses.

kategoritë në nevojë të jetë deri në datën 31.12.2016. OSHEE sh.a. ka theksuar faktin se pavarësisht mos përfshirjes në skemat lehtësuese të kategorisë së familjeve me ndihmë ekonomike, detyrimet e së cilave shtrihen përgjatë periudhës 1 janar 2017 e në vijim, politikat orientuese të shtetit shqiptar, të cilat janë ndjekur nga kjo shoqëri në miratimin e Vendimit nr. 64, datë 27.12.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE sh.a., kanë patur në fokus të tyre, subvencionimin e familjeve në nevojë, përfshirë këtu edhe ato familje që përfitojnë ndihmë ekonomike.

Familja, i përket jo vetëm kategorisë së familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, por edhe ka në përbërje të saj një fëmijë me aftësi të kufizuar, gjë që e rëndon pozitën e saj, ekonomike, sepse e bën të pamundur punësimin e njërit prej bashkëshortëve, për të siguruar të ardhura, për të paguar detyrimet ndaj OSHEE sh.a, apo shoqërive të tjera që sigurojnë shërbime për familjarët. Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike duhen trajtuar në mënyrë të njëjtë, pavarësisht periudhës kohore përgjatë së cilës ato mbartin debi ndaj OSHEE sh.a. Nëse për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë miratuar kushte lehtësuese për likuidimin me këste mujore, të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike të krijuara deri në datën 31.12.2016, e njëjta gjë duhet të bëhet edhe për ato familje që i përkasin të njëjtës kategori, por që debia e tyre i përket një periudhë kohore të mëpasshme.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Konventa e OKB-së *“Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*⁸⁶
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10
- Ligji Nr. 93/2014 *“Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”*
- Vendimi Nr. 64, datë 27.12.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE sh.a. *“Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jofamiljarë”*
- Vendimi Nr. 8, datë 14.1.2015, *“Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 këh në muaj”*, (i ndryshuar).

KONKLUSIONE

Komisioneri gjykoi se pavarësisht periudhës, së cilës i përkasin debitë e kategorive në nevojë, mundësia për t’u ofruar kushte lehtësuese për pagesën e tyre, duket të jetë e njëjtë. Familja e ankueses i përket jo vetëm kategorisë së familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, por edhe ka në përbërje të saj një fëmijë me aftësi të kufizuar, gjë që e rëndon pozitën e saj, ekonomike, sepse e bën të pamundur punësimin e njërit prej bashkëshortëve,

⁸⁶Ratifikuar me ligjin Nr. 108/2012 *“Për Ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara”*.

për të siguruar të ardhura, për të paguar detyrimet ndaj OSHEE sh.a, apo shoqërive të tjera që sigurojnë shërbime për familjarët.

Familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike duhen trajtuar në mënyrë të njëjtë, pavarësisht periudhës kohore përgjatë së cilës ato mbartin debi ndaj OSHEE sh.a. Nëse për familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, janë miratuar kushte lehtësuese për likuidimin me këste mujore, të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike të krijuara deri në datën 31.12.2016, e njëjta gjë duhet të bëhet edhe për ato familje që i përkasin të njëjtës kategori, por që debia e tyre i përket një periudhë kohore të mëpasshme.

Komisioneri gjykoj se Vendimi nr. 64, datë 27.12.2017, i Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE sh.a. *“Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jofamiljarë”* e ka ekspozuar ankuesen, si edhe atë pjesë të familjeve, që i përkasin kategorisë së familjeve, që trajtohen me ndihmë ekonomike, me debi pas datës 31.12.2016, si dhe atë me tëpër kur këto familje kanë në përbërje të tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, ndaj një trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe disfavorizues.

Komisioneri gjykon që Këshilli Mbikëqyrës i OSHEE sh.a. duhet të kishte marrë në konsideratë idenë e shtrirjes në kohë të këtij vendimi edhe përgjatë vitit 2017 e ne vijim. Në këtë mënyrë, kjo masë do të cilësohej me karakter pozitiv për ato familje, të cilat janë në pamundësi totale për shlyerjen e detyrimeve të tyre ndaj OSHEE sh.a., sikurse familja e ankueses.

Komisioneri gjykoj se punësimi i njërit prej bashkëshortëve është i domosdoshëm, për përmirësimin e gjendjes ekonomike dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura ndaj UKKO sh.a. dhe OSHEE Korçë. Në kushtet kur, ankuesja luan rolin e kujdestares së djalit të saj me aftësi të kufizuara, punësimi i bashkëshortit të saj duhet të konsiderohet si një çështje me tëpër prioritet nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, e cila në shkresën e saj nr. 543, datë 19.06.2018, drejtuar Komisionerit, ka shprehur gatishmërinë e saj për zgjidhjen e kësaj çështjeje.

Komisioneri vlerëson se vendosja e një skeme lehtësuese që prek të gjithë qytetarët e Shqipërisë dhe që tregohet akoma më e ndjeshme kundrejt disa kategorive, të cilat janë më të pamundura që të përballojnë akumulimin e debisë (përfituesit e ndihmës ekonomike, pensionistët, familjet që kanë në përbërje persona me aftësi të kufizuara etj.) është një masë pozitive. Nga ana tjetër vendosja e një afati, brenda të cilit duhet të jetë akumuluar debia, në mënyrë që të përfitohet skema lehtësuese, është një kriter, i cili jo vetëm nuk paraqet arsyeshmëri, as synon përmbushjen e një qëllimi, por vendos në kushte më të disavantazhuara pikërisht ato kategori, të cilat janë më të pamundura për të përballuar pagesën e energjisë elektrike.

Njëkohësisht, Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin nr. 8, datë 14.01.2015, i cili parashikon kompensim për diferencën e çmimit të energjisë elektrike deri në 300 Këh. Padyshim që edhe kjo është një masë pozitive, por që është dukshëm e pamjaftueshme për kategoritë e pamundura ekonomikisht, si në rastin e ankueses e cila ka akumuluar debi pas

hyrjes në fuqi të VKM-së, si dhe pas përfundimit të afatit të parashikuar nga Vendimi nr. 64, datë 27.12.2017, i Këshillit Mbikëqyrës të OSHEE sh.a.

Në kushtet kur, familja e ankueses, pavarësisht miratimit të VKM nr. 8/2015, vazhdon akoma të akumulojë debi për shkak të të ardhurave të pamjaftueshme, Vendimi i sipërpërmendur i Këshillit Mbikëqyrës së OSHEE sh.a., në momentin që vendos një afat kohor të paarsyeshëm dhe jo në përmbushje të një qëllimi specifik, ndodhet në kushtet e diskriminimit të tërthortë ose indirekt.

Në rastin konkret, është e vërtetë që kriteri kohor prek të gjithë qytetarët pa asnjë lloj dallimi, por është pikërisht pasoja disavantazhuese që ajo gjeneron mbi kategoritë e njerëzve në nevojë, të cilët përfitojnë vetëm ndihma nga shteti, si dhe ndodhen edhe në kushte papunësie, të cilët janë të pamundur që të paguajnë energjinë që konsumojnë dhe debinë që kanë akumuluar për energjinë e konsumuar më parë që e bën atë diskriminuese.

Në ndjekjen e kësaj llogjike, Komisioneri mbështetet edhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në çështje të tilla si Biao kundër Danimarkës⁸⁷, 24 Maj 2016, ku ndër të tjera gjykata shprehet: *“Dallimi në trajtim është diskriminues nëse nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë nëse nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme e proporcionalitetit midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet.....Një politikë ose masë e përgjithshme që ka efekte paragjyquese në mënyrë jo proporcionale në një grup të caktuar mund të konsiderohet diskriminues edhe kur nuk ka për qëllim specifik atë grup dhe nuk ka qëllime diskriminuese. Megjithatë, ky është rasti vetëm nëse politika ose një masë e tillë nuk ka ndonjë justifikim “objektiv dhe të arsyeshëm””*.

Nisur nga sa më sipër, vendosja e një afati kohor, brenda së cilit mund të përfitohet skema lehtësuese, për aq kohë sa nuk ka një përlligje të arsyeshme dhe objektive, si dhe nuk përmbush ndonjë qëllim, është diskriminuese dhe si rrjedhojë duhet ndryshuar, duke hequr afatin e vendosur.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të tërthortë, për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”, të E.K, nga ana e OSHEE sh.a., nëpërmjet Vendimit nr. 64, datë 27.12.2017, të Këshillit të saj Mbikëqyrës *“Mbi miratimin e skemave për pagesën me këste të detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike për kategorinë e klientëve familjarë/jofamiljarë”*.

Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”, të E. K, nga ana e Ujësjellës Kanalizimeve sh.a. Korçë.

Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, OSHEE sh.a. të marrë të gjithë masat e nevojshme për rregullimin e situatës diskriminuese, nëpërmjet amendimit të vendimit të sipërpërmendur ose miratimit të një vendimi të ri.

⁸⁷Vendime të përzgjedhura të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut të vitit 2016, botim i Avokaturës së Shtetit, çështja Biao kundër Denmark, 24 Maj 2016, i GJEDNJ-së, paragrafi 90-91 Aplikimi nr. 38590/10, fq. 323-324.

Rekomandohet që familja e ankueses, të lidhë Akt-marrëveshje me Ujësjetllës Kanalizime sh.a., Korçë, për të përfituar nga skemat lehtësuese të ofruara nga kjo shoqëri, për të shlyer detyrimet e prapambetura.

Të merren masa të menjëhershme nga ana e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Kombëtar të Punësimit Korçë, lidhur me punësimin e Gj. H.,(bashkëshorti i ankueses) si dhe të njoftohet Komisioneri mbi to.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË PËRKATËSISË NË NJË GRUP TË VEÇANTË

83. E. J., kundër Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” (QSUT), Tiranë.

VENDIM NR. 92, DATË 08.07.2019

Shkaku: Përkatësi në grup të veçantë (anëtarësia në Shoqatën e Infermierëve)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi E. J., ka punuar në pozicionin e infermierit pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë. E. J., është gjithashtu edhe kryetari i “Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë”. Ankuesit i janë ndërprerë marrëdhëniet kontraktuale të punës me QSUT, për shkelje të kushteve të kontratës së punës, për shkak të “gjendjes arsimore”, “gjendjes shoqërore” dhe “përkatësisë në një grup të veçantë”.

FAKTET

Ankuesi E. J., ka qënë në marrëdhënie pune me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, që prej datës 03.12.2009, kur ndërmjet palëve është lidhur Kontrata Individuale e Punës, me afat të pacaktuar, e cila është rinovuar në vijim në datën 15.05.2012. E. J., ka punuar në disa pozicione pune në pavione të ndryshme të QSUT-së dhe pozicioni i fundit i punës, që ka mbajtur në këtë institucion mjekësor, ka qënë Infermier Pavioni pranë Polit të Administrimit të Integruar të Spitalit Polivalent.

Përveç pozicionit të punës si infermier pranë QSUT-së, E.J. që prej fundit të vitit 2016 e në vijim ka mbajtur edhe pozicionin e kryetarit të “Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë”. Shoqata në fjalë është e regjistruar si personi juridik, nëpërmjet Vendimit nr. 5489, datë 02.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. E. J., në cilësinë e Kryetarit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë ka vepruar në mbrojtje të të drejtave të infermierëve, duke filluar që nga deklaratat dhe intervistat në shtypin e shkruar dhe atë viziv, e deri në përpjekjet për zhvillimin dhe organizimin e protestave të ndryshme. Kështu gjatë vitit 2017, Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë e kryesuar nga E. J., ngriti zërin në lidhje me çështjen e pagesës së vendparkimit brenda QSUT-së, për automjetet e infermierëve⁸⁸, në kushtet kur kjo pagesë nuk aplikohet për kryeinfermierët dhe mjekët. E. J., ka dhënë disa intervista, në mbrojtje të të drejtave të infermierëve, ku përmendet artikulli “*Ulje pagash për 4 mijë infermierë, E.J.:* Do

⁸⁸ Shoqata e Infermierëve të Shqipërisë ka depozituar ankesën nr. 90, datë 02.07.2018, pranë KMD-së, lidhur me çështjen në fjalë. Me anë të vendimit Nr. 146, datë 02.07.2018, KMD ka vendosur mospranimin e ankesës, pasi ishte depozituar jashtë afatit ligjor, të përcaktuar në ligjin Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”;

i drejtohemi gjykatës”, botuar në Gazetën Shqiptare, të datës 30.06.2018; artikulli në Faxëeb.al “Diplomat e infermierëve, reagon kryetari i Shoqatës: Do u mbahen nga 50 mijë lekë....”, etj. Në intervistën e dhënë në Gazetën Shekulli, në datën 03.12.2018, E. J., është shprehur gjithashtu si vijon: “Ne një pyetje kemi: Pse nuk caktohet një fond për të stimuluar infermierët me një pagë shtesë ose edhe sikur 10 mijë lekë të reja, jo vetëm shpërblim selektiv?Ky është diskriminim, pasi çdo infermier kontribuon për jetën e pacientëve...”.

Në vijim të intervistave të dhëna nga ana e tij në media, nëpërmjet Vendimit nr. 891, datë 11.12.2018, të Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT-së, është vendosur që ankuesit t'i ndërpriten marrëdhëniet kontraktuale të punës me QSUT, për shkelje të kushteve të kësaj kontrate, përkatësisht nenit 9⁸⁹ të saj, ku parashikohen detyrimet e punëmarrësit, si dhe për shkelje të Kodit të Etikës, së punonjësve të QSUT-së, përkatësisht nenit 4, pika 4.5⁹⁰ të saj. Referuar vendimit të mësipërm, në respektim të afatit të njoftimit, duke filluar nga data e marrjes dijeni, marrëdhënia e punës së ankuesit me QSUT-në, ndërpritet në datën 15.03.2019.

Për sa më sipër, ankuesi E.J. thekson se situata e mësipërme dhe largimi i tij nga puna ka lidhje të drejtpërdrejtë me faktin se ai është Kryetar i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë dhe nën këtë cilësi ka ngritur zërin në median e shkruar dhe atë elektronike, për të drejtat e infermierëve, lidhur me përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e pagave, të cilat janë të ulëta dhe mbi mënyrën diskriminuese, se si infermierët trajtohen në krahasim me personelin tjetër, shëndetësor.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e R.Sh, neni 18;
- Ligji Nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) neni 9;
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 1, neni 3, pika 8, neni 7, pika 1, nenet 12-13, neni 21, pika 1, neni 32, pika 1, gërma a) e neni 33, pika 4, gërma dh), si dhe pikat 10-11.

KONKLUZIONE

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, rezultoi se ekziston një ndërthurje e detyrimeve të E. J., në cilësinë e punëmarrësit ndaj QSUT-së dhe detyrimeve të tij, në cilësinë e kryetarit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, ndaj kategorisë së infermierëve. Komisioneri gjykon se, në kushtet kur, E.J. ka qenë i lidhur kontraktualisht në marrëdhënie pune me QSUT-në, ka patur detyrim ligjor të zbatojë dispozitat e kontratës individuale së punës, si dhe të akteve të tjera nënligjore, të cilat kanë funksion rregullator të marrëdhënieve etike ndërmjet

⁸⁹ Neni 9, i Kontratës Individuale të Punës parashikon: “Punëmarrësi ruan me besnikëri interesat e ligjshme të punëdhënësit”.

⁹⁰ Neni 4, pika 4.5. e Kodit të Etikës parashikon: “Punonjësi i QSUT nuk duhet të bëjë në publik komente të papërshtatshme, të tilla si: ...deklarata apo opinione personale që mund të interpretohen si zyrtare; sulme kundër administratës ose punonjësve të tjerë të institucionit, etj. Në rastet e daljes në media, ai është i detyruar të marrë më parë konfirmim mbi qëndrimin institucional pranë Zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe në asnjë rast të shkelë këtë Kod”.

punëmarrësve dhe QSUT-së. Ndërkohë që, në cilësinë e kryetarit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, ai ka patur dhe ka detyrim të llojë për interesat e infermierëve të Shqipërisë, si dhe të mbrojtë të drejtat e tyre. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se E. J., duhet të balancojë detyrimet që rrjedhin nga dy pozicionet që ai mban, duke kryer një ekuilibrim ndërmjet tyre.

Komisioneri gjykon gjithashtu se, zgjidhja e kontratës së punës për E. J., ka ardhur në një moment, pasi ai ka kryer një aktivitet të dendur, në median e shkruar dhe atë vizive, për mbrojtjen e të drejtave të infermierëve, e sidomos për ata infermierë që punojnë në QSUT.

Komisioneri gjykon se qëllimi i intervistës së dhënë në Gazetën Shekulli nuk ka qenë thjesht mbrojtja e të drejtave dhe interesit personal, por mbrojtja e tërësisë së të drejtave të infermierëve të QSUT-së. Komisioneri gjykon se mendimi dhe opinioni i shprehur nga ana e tij në këtë intervistë, në cilësinë e drejtuesit të shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, e ka penalizuar ankuesin, deri në largim nga puna, duke e ekspozuar ndaj një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues. Njëkohësisht, KMD ka konstatuar se qëndrimi i mbajtur ndaj E. J., nga ana e QSUT-së, ka qenë i ndryshëm nga qëndrimi i mbajtur ndaj G. H., apo infermierëve të Urgjencës së Kirurgjisë, të cilët sërish kanë “kritikuar” QSUT-në nëpërmjet thënieve të tyre në intervistë. I vetmi i penalizuar nga intervista e dhënë në datën 03.12.2018, në Gazetën “Shekulli” ka qenë E. J., ndërkohë që personat e tjerë që janë intervistuar nuk janë proceduar disiplinarisht.

Komisioneri gjykon se si pasojë e reagimit në intervistën e dhënë në gazetën Shekulli në datën 03.12.2018, E. J., është viktimizuar deri në zgjidhje të kontratës së punës.

KMD vlerëson se zgjidhja e marrëdhënieve të punës me E. J., nuk është e lidhur vetëm me intervistën e dhënë sa më sipër, por me të gjithë aktivitetin e tij, në cilësinë e kryetarit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit të E. J., nga ana Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë.

84. N. M., kundër ish Kancelarit dhe Administratorit të Universitetit të Tiranës (UT)

VENDIM NR. 197, DATË 11.10.2018

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë
Forma: Diskriminim në formën e shqetësimit
Fusha: Punësim
Statusi: Vendimi nuk është kundërshtuar

Ankuesja N. M., duke qenë e punësuar dhe personel në varësi të Rektorit të UT-se shqetësohet në marrëdhëniet e punësimit nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit të UT për shkak të konfliktit të kompetencave midis këtyre dy organeve drejtuese të Universitetit të Tiranës.

FAKTET

Ankuesja N. M., është komanduar në pozicionin e punës si Drejtore e Drejtorisë Juridike pranë Universitetit të Tiranës dhe ka lidhur kontratë pune me afat të caktuar nga data 19.06.2017 deri në përfundim të procedurave të konkursit për atë vend pune. Në përfundim të procedurave të konkurimit ankuesja është emëruar në pozicionin e Drejtores së Drejtorisë Juridike në Rektoratit të UT-së.

Gjatë gjithë periudhës nga emërimi i N.M., mes ish Kancelarit të UT-s dhe Rektorit ka patur mosdakordësi në lidhje me kompetencat e emërimit të personelit të Rektoratit, gjë që ka çuar në mos kryerjen e pagesës për një periudhë të gjatë të të gjithë personelit të Rektoratit të UT-s dhe jo vetëm të personelit femër. Me vendim të formës së prerë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka konsideruar se kontrata e lidhur mes Rektorit të UT-së dhe ankuses ka qenë e rregullt dhe ka vendosur detyrimin e Universitetit të Tiranës për t'i paguar N. M., pagën mujore duke filluar nga data 19.06.2017 e në vazhdim të ushtrimit të detyrës.

S.D është emëruar në detyrën si Administrator i UT-së sipas Vendimit nr. 26, datë 07.12.2017 të Bordit të Administrimit (filluar marrëdhëniet e punës në datë 11.12.2017) dhe ka konstatuar situatën e mosdakordësisë mes strukturave drejtuese të UT-së, dhe për këtë fakt ka patur një korrespondencë shkresore mes Rektorit dhe Administratorit për rregullimin situatës së trashëguar në lidhje me kompetencën për emërimin e personelit të UT-së.

Që nga data 20.12.2017 e në vijim, Administratori i UT-s ka qenë në dijeni të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në të cilin konstatohet rregullsia e marrëdhënieve të punësimit mes Universitetit të Tiranës dhe punonjëses N. M., dhe detyrimin e UT-së për kryerjen e pagesës së ankuses sipas kushteve të kontratës.

Administratori i UT-së edhe pas njohjes me vendimin e gjykatës ka dërguar disa shkresa duke i kërkuar N. M., lirim të mjediseve të punës dhe mos paraqitjen në punë duke e njoftuar për mosnjohjen e kontratës së punës.

Situata e krijuar mes drejtuesve të Universitetit të Tiranës është bërë objekt i kontrollit dhe nga ana e Ministrisë së Arsimit Sporteve dhe Rinisë, e cila ka ngritur grupin e punës për kontrollin e paligjshmërisë së veprimtarisë së UT-së me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Sipas këtij projekt-raportit nga ana e MASR është gjetur si shkelje dhe punësimi i N. M. Universiteti i Tiranës duke mos rënë dakord me projekt raportin, ka përcjellë observacionet përkatëse por që nuk ka marrë asnjë raport përfundimtar nga ana e MASR.

MARS ka miratuar Udhëzimin nr.27, datë 29.12.2017 të MASR *“Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”*, nëpërmjet të cilit saktësohen dhe sqarohen kompetencat midis këtyre dy organeve drejtuese të Universitetit të Tiranës.

Me vendim të Bordit të Administrimit të UT-së në datën 05.04.2018 është kryer pagesa për N.M sipas vendimit të gjykatës.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” nenet 1, 3, 4, 7, 12, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Komisioneri vlerësoi se, sjellja dhe veprimet e Administratorit të UT-së ndaj ankueses kanë ardhur si rezultat i faktit që ish Kancelari i UT-së e ka konsideruar punësimin e N.M nga ana e Rektorit si të paligjshëm dhe jashtë kompetencave, prandaj dhe ka mbajtur të njëjtin qëndrim si ish Kancelari, por në vijim pas sqarimit të kompetencave sipas Udhëzimit nr.27, datë 29.12.2017 të MASR, Vendimit të Gjykatës, Vendimin të Bordit të Administrimit të UT-së, situata e pagesës së pagave të punonjësës N. M., është zgjidhur dhe nuk ekziston më. Komisioneri konkludoi se N.M., nuk i është nënshtruar dhe ekspozuar një qëndrimi të padrejtë dhe disfavorizues, nga ana e ish Kancelarit dhe Administratorit të Universitetit të Tiranës.

Administratori i UT-së bazuar në vendimin gjyqësor të formës së prerë duhet të kishte ndërtuar marrëdhëniet e punësimit mes tij dhe ankueses N.M, duke respektuar kontratën e punës dhe jo duke vazhduar mosnjohjen e Vendimit të Gjykatës dhe duke i kërkuar ankueses lirin e mjedisëve të zyrës dhe dorëzimin e dokumentacionit. Në kushtet kur punonjësja dhe raporti i saj i punës ishte i njohur si i rregullt dhe i ligjshëm nga një vendim gjykate që kishte marrë formën e prerë, vendi i punës i ankueses duhej konsideruar i padiskutueshëm dhe asnjë veprim kundërshtues nuk duhej të ishte ndërmarrë.

N.M ishte cilësuar si punonjëse, që bën pjesë në grupin mbështetës të Rektorit të UT-së. Komisioneri vlerësoi se shkresat e Administratorit të UT-së drejtuar ankueses në të cilat i bëhet presion për lirim të mjediseve të punës me pretekstin se ankuesja ishte duke kryer vepër penale për shkak të ushtrimit pa të drejtë të detyrës e kanë vendosur N. M., në kushte të disfavorshme, duke cenuar dinjitetin e saj dhe duke i krijuar një mjedis intimidues dhe gjendje pasigurie në punë për shkak se është konsideruar si përkrahëse e Rektorit të Universitetit të Tiranës (përkatësia në një grup të veçantë).

Sa i takon pretendimit të ankueses për diskriminim për shkak të gjinisë, në lidhje me mospagimin e pagave dhe dhënies së shpërblimit të fundvitit, ankuesja nuk solli prova dhe fakte dhe të identifikonte një krahasues për të provuar se mospagimi i pagave kishte ardhur si rezultat i gjinisë së saj dhe se punonjësit meshkuj të ndodhur në të njëjtën situatë me ankuesen ishin në trajtuar ndryshe.

VENDIMI

Konstatimin e mosdiskriminimit të shtetases N. M., nga ana e Administratorit të UT-së, për shkak të gjinisë.

Konstatimin e diskriminimit në formën e shqetësimit të shtetases N. M., nga ana e Administratorit të UT-së, për shkak të përkatësisë në një grup të veçantë.

Në referim të pikës 1, Administratori i UT-s, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrë masa për ndalimin e shqetësimit të punonjësës N. M.

85. D. D., kundër Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS)

VENDIM NR.76, DATË 19.03.2018

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Arsim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi D. D., ka mbaruar studimet në shkollën e mesme, në shtetin e Belgjikës. Ka kërkuar rivlerësimin e diplomës së tij, nga Komisioni i Posaçëm në MAS, pasi procedura e ndjekur për njëvlershmërinë e diplomës së tij ishte diskriminuese, për shkak të përlogaritjes së mesatares më të ulët se ajo e diplomës origjinale të marrë në shtetin belg.

FAKTET

Subjekti ankues, në vitin shkollor 2012 ka mbaruar studimet në shkollën e mesme, në shtetin e Belgjikës. Me datë 01.08.2016 ka dorëzuar pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dokumentacionin përkatës për vijimin e procedurave për njëvlershmërinë e diplomës së arsimit parauniversitar, në Republikën e Shqipërisë.

Me datë 24.08.2016, Komisioni i Posaçëm në MAS, ka nxjerrë dokumentin e njëvlershmërisë së dëftesës/diplomës së shkollës së mesme për procedura të mëtejshme nga AKP-ja.

Nota mesatare e viteve të shkollimit është 6.7 (gjashtë pikë shtatë)

Nota mesatare e provimeve të maturës: 7.7 (shtatë pikë shtatë).

Nota D₁: Gjuhë dhe Letërsi Shqipe: 5 (pesë).

Nota D₂: Matematikë: 10 (dhjetë).

Nota D₃: Gjuhë e huaj: 6.4 (gjashtë pikë katër).

Nota Z₁: Psikologji: 8.5 (tetë pikë pesë).

Nota Z₂: Biologji e Thelluar: 8.5 (tetë pikë pesë).

Nota mesatare e përgjithshme: 7.2 (shtatë pikë dy).

Komisioni ka vlerësuar ankuesin me notë 5 për lëndën “Gjuhë dhe letërsi shqipe”, në kushtet kur ai nuk e kishte zhvilluar asnjëherë këtë lëndë, nuk kishte dhënë ndonjë provim për të matur njohuritë përkatëse.

Ankuesi provoi me dokumentacion se bënte pjesë në grupin e studentëve që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në një shtet të huaj dhe që duan të njëvlerësojnë diplomat e tyre në RSH, në mënyrë që të ndjekin IAL-të në RSH. Diploma e shkollës së mesme të lartë, lëshuar nga shteti belg, vërteton se ai ka mbaruar studimet në këtë shtet.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 99, 100.

- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 17, 21, 32 dhe 33.
- Ligji Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
- Udhëzimi Nr. 44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”.
- Udhëzimi Nr. 13, datë 22.07.2016 “Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, në Institucionet e Arsimit të Lartë, për vitin akademik 2016-2017”.

KONKLUZIONE

Në analizë të legjislacionit në fuqi, të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se, ankuesi nuk ishte vlerësuar me objektivitet nga ana e Komisionit të Posaçëm⁹¹, sa i takon vlerësimin të tij lidhur me lëndën e gjuhës shqipe me notën pesë, lëndë të cilën ai nuk e kishte zhvilluar në shtetin belg.

Komisioneri vlerësoi jo logjik dhe të pa bazuar ligjërisht argumentin e MAS se:

- Komisioni, në njëvlershmërinë e dokumentacionit shkollor të shtetasve shqiptarë/të huaj, që vijnë nga jashtë vendit për të aplikuar në IAL-të, gjuhën zyrtare të shkollimit të shtetit nga ai vjen, e njehson me gjuhën shqipe dhe letërsinë.
- Vlerësimin e ankuesit me notën pesë për gjuhën shqipe dhe letërsinë, në një kohë kur ai nuk e ka zhvilluar këtë lëndë.
- Të pa bazuar referimin e MAS tek “Tabela e konvertimit për sistemin e vlerësimit në institucionet arsimore në RSH”, , për arsyen se po t’i referohemi kësaj tablele, vërehet se aty janë përfshirë 18 shtete, numërtuar nga 1-18, ku citohen specifikisht: Greqia, Gjermania, Italia, Kosova, SH.B.A, Turqia, Luksemburgu, Austria, Bullgaria, Rumania, Finlanda, Polonia, Sllovenia, Danimarka, Norvegjia, Zvicra dhe Anglia. Pra, shihet qartë që Belgjika, shteti ku ankuesi ka përfunduar studimet parauniversitare nuk citohet fare dhe nuk është e përfshirë në këtë tabelë. Për këtë arsye, Komisioneri vlerësoi se Komisioni nuk justifikoi faktin që kishte vlerësuar me notën pesë gjuhën shqipe dhe letërsinë, duke iu referuar kësaj tablele.
- Po ashtu, MAS nuk justifikoi as mënyrën se si ishte arritur në këtë vlerësim nga ana e Komisionit, pasi edhe pse është kërkuar nga Komisioneri, nuk solli asnjë provë, shkresë për ta provuar atë.
- Komisioneri, konstatoi shkelje ligjore edhe sa i takon procesin për ndjekjen e procedurave të njëvlershmërisë së dëftesave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit, pasi Komisioni nuk mbante asnjë akt shkresor (procesverbal).

Komisioneri vlerëson se, ankuesi, ashtu dhe të gjithë aplikantët e tjerë janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme sa i takon praktikës së ndjekur nga Komisioni në raport me parashikimet

⁹¹Në vijim do t’i referohemi si Komisioni.

ligjore, specifike. Në përfundim, Komisioneri konstatoi se ky trajtim e kishte vënë ankuesin në pozitë të diskriminimit të drejtpërdrejtë nga ana e Komisionit të Posaçëm, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të drejtpërdrejtë të D. D., nga ana e Komisionit të Posaçëm, pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ministria e Arsimit dhe Sportit, (Komisioni i Posaçëm), si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, ndaj ankuesit, rekomandohet të shqyrtojë rishtaz vendimin lidhur me njëvlershmërinë e diplomës së ankuesit.

MAS të realizojë zbatimin e germës e), pika 2, e kreut 3, të Udhëzimit nr.44, datë 21.08.2013 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të njëvlershmërisë së dëftësave dhe diplomave të nxënësve të arsimit parauniversitar të ardhur nga jashtë vendit”.

86. B. B., kundër Drejtorit të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH)

VENDIM NR. 21, DATË 06.02.2019

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë (Anëtarësia në Sindikatën e Punonjësve)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Zbatuar

Ankuesi punon si zjarrëfikës pranë MZSH Tiranë, Stacioni nr.5 “Qyteti Studenti”. Ai është zgjedhur Kryetar i Sindikatës së Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (SPMZSH). Ankuesi pas zgjedhjes së tij si Kryetar është transferuar qëllimisht nga Drejtori i MZSH Tiranë, nga vendi i tij i punës në Stacionin nr.6 “Tuneli Krrabë”.

FAKTET

Nga informacioni dhe dokumentacioni i administruar gjatë procedurave hetimore rezultoi se, me Urdhërin nr.50, datë 13.02.2014 të Prefektit të Tiranës, subjekti ankues, B. B është emëruar në detyrën “Shofer zjarrëfikës” pranë PMNZSH-së. Me Urdhërin nr.32985, datë 12.09.2017 të Drejtorit të MZSH-së, është emëruar Personel drejtimi automjesh në Stacionin nr.5 “Qyteti Studenti”, në Drejtorinë e MZSH-së. Me Urdhërin 1122, datë 23.10.2017 B. B është graduar me gradën “Asistent Zjarrfikës”.

Me Vendimin nr.7, datë 10.07.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është bërë regjistrimi si person juridik i Sindikatës së Punonjësve për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (SPMZSH) dhe B. B është zgjedhur Kryetar i parë e saj.

Me shkresën me nr. 29245 prot., datë 27.07.2018 të Drejtorit të MZSH-së, B. B., është transferuar nga Stacioni nr.5 “Qyteti Studenti” në Stacionin nr.6 “Tuneli Krrabë”, pa pëlqimin dhe dijeninë e tij, duke cënuar kështu të drejtat dhe funksionin e tij si sindikalist. Zona në Stacionin nr.6, “Tuneli Krrabë”, nuk mbulohej me valë nga kompanitë telefonike dhe atij në funksion të realizimit të detyrës së tij si Kryetar i Sindikatës, përveç detyrës funksionale të punonjësit të MZSH-së (asistent zjarrfikës) i duhet të jetë vazhdimisht në komunikim me çdo anëtar të sindikatës për çdo problem që ata mund të kenë (qoftë edhe hipotetikisht). Fakti që kjo zonë nuk mbulohet me valë nga kompanitë telefonike u pranua dhe nga Drejtori i MZSH Tiranë.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 50, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.

- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 181, pikat 3, dhe 5, neni 186, pika 1/c.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji nr.152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Referuar kronologjisë së ngjarjeve dhe dokumentacionit të administruar, lidhur me faktimin e momentit të marrjes dijeni nga ana e Drejtorit të MZSH-së për krijimin e Sindikatës dhe zgjedhjes së ankuesit si Kryetar i saj, Komisioneri vlerësoi se, transferimi i subjektit ankues ka ndodhur në kushtet kur MZSH-ja nuk kishte asnjë dijeni për faktin e pretenduar nga ankuesi.

Mirëpo, gjatë trajtimit të kësaj çështjeje, MZSH-ja ishte vënë në dijeni të faktit të krijimit dhe funksionimit të Sindikatës (SPMZSH) dhe zgjedhjes së ankuesit si Kryetar i saj, për rrjedhojë duhet të kishte marrë masat për zbatimin efektiv të gjithë garancive dhe lehtësirave ligjore që legjislacioni në fuqi ka parashikuar për përfaqësuesit e sindikatave.

Mosmarrja e masave konkrete për rregullimin e situatës në favor të subjektit ankues nga ana e MZSH-së edhe pas marrjes dijeni të faktit të krijimit të Sindikatës dhe qënies së ankuesit si Kryetar i saj, krijoi dyshimin e arsyeshëm se ai është ekspozuar ndaj trajtimit të padrejtë, pikërisht për shkak të përkatësisë së tij në sindikatë, dhe se qëndrimi i tij në Stacionin nr.6 “Tuneli Krrabë”, në një zonë më të largët e cila nuk mbulohet efektivisht me valë nga kompanitë telefonike, vështirëson shumë ushtrimin e funksionit të Kryetarit të Sindikatës.

Lidhur me sa më sipër, Komisioneri konstaton se MZSH-ja ishte në shkelje të parashikimeve të LMD-së, pasi me mosveprimin e saj, edhe pas marrjes dijeni të faktit të qënies së subjektit ankues në cilësinë e Kryetarit të Sindikatës, nuk ka ndërmarrë asnjë masë për transferimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës dhe as ka shprehur vullnet për ta marrë në konsideratë një fakt të tillë.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit të B. B., nga ana e Drejtorit të MZSH-së, për shkak të përkatësisë së tij në një grup të veçantë.

Referuar pikës 1, të vendimit, MZSH-ja, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj subjektit ankues, B. B., të bëjë rikthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

87. P. S., kundër Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR)

VENDIM NR. 135, DATË 02.10.2019

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka kandiduar për të qenë pjesë e Bordit të Administrimit pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër (USH), si kandidaturë e votuar nga studentët. Bazuar në pikëzimin dhe vlerësimin e KIZ, duhet të ishte shpallur ai fitues nga ana e Ministres së MASR-së, dhe jo kandidatura e renditur në vendin e dytë, i cili nuk plotësonte as kriteret e kërkuara për pozicionin si anëtar i Bordit Administrimit të Universiteteve Publike.

FAKTET

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e Bordit të Administrimit të Universiteteve Publike”, një nga anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët paraqesin tri kandidatura. Ministri përgjegjës për arsimin emëron një prej kandidatëve të paraqitur nga studentët, të cilët duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë si dhe anëtarët e tjerë të bordit përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Lidhur me sa mësipër, studentët e vitit të tretë Financë-Kontabilitet, Fakulteti Ekonomik, Universiteti Shkodër, kanë propozuar të përfaqësohen nëpërmjet kandidaturës së ankuesit, P. S.

Komisioni Institucional Zgjedhor (KIZ), pranë Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër ka miratuar 5 kandidatura. (P.S (ankuesi), A.P., N. Ç., S. B., T. P.,) renditur si më poshtë:

A. P., është votuar me 151 pikë në total.

N. Ç., është votuar me 133 pikë në total.

P. S., (ankuesi) është votuar me 665 pikë në total.

S. B., është votuar me 8 pikë në total.

T. P., është votuar me 379 pikë në total.

Bazuar në vërtetimin e Institutit të Përndjekurve Politikë, provohet se subjekti ankues gëzon statusin e të përndjekurit politik, për të cilin referuar akteve që depozitohen në MASRS, kjo e fundi ka patur dijeni lidhur me këtë fakt.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 116.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Social Evropiane, nenet 1 “Pjesë I” dhe “Pjesa V”.
- Direktiva e Këshillit 2000/78/KE të 27 nëntorit 2000 për “Përcaktimin e një kuadri të përgjithshëm për trajtimin e barabartë në punësim dhe marrëdhëniet gjatë punës”.
- Ligji nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, neni 64/1.
- “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- “Kodi i Punës”, neni 9
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.782, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e Bordit të Administrimit të Universiteteve Publike”.
- Urdhri nr.41, datë 24.01.2019 “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit” i Ministrit të MASR.
- Shtojca nr.1, bashkëlidhur këtij Urdhri “Njoftim për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”.

KONKLuzion

MASR nëpërmjet shkresës me nr. 322 prot., datë 14.01.2019 ka kërkuar nga KIZ, pranë Universiteteve Publike, të përcaktojnë afatet për aplikim nga kandidatët, të vlerësojnë aplikantët për përmbushjen e kriterëve të vendimit, si dhe të hartojnë listat me kandidatët që plotësojnë kriteret për votim nga ana e studentëve. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kriterë si dhe anëtarët e tjerë të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

Në vijim të zbatimit të sa më sipër, Ministri i MASR-së, nëpërmjet Urdhrit nr.41, datë 24.01.2019 “Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”, si dhe në mbështetje të pikës 7, të VKM nr.782, datë 26.12.2018, ka urdhëruar që: *“Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të kryhet në përputhje me kriteret, procedurën dhe dokumentacionin që duhet dorëzuar, sipas përcaktimeve të VKM nr.782, datë 26.12.2018 dhe shtojcës nr.1 të njoftimit, bashkëlidhur këtij Urdhri”.*

Shtojca nr.1, bashkëlidhur këtij Urdhri “Njoftim për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë”, ka të specifikuar kërkesat e pranimit, në kërkesa të përgjithshme dhe kërkesa të veçanta që duhet të plotësojë kandidati. Kështu, në mënyrë të detajuar tek “Kërkesat e veçanta” që duhet të plotësojë kandidati është specifikuar, ndër të tjera që:

- “Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;

- Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë”.

Në kontekst të përmbushjes dhe plotësimit të kriterëve të përcaktuara, Komisioneri ka konstatuar se, kandidatura e T. P., e përzgjedhur si kandidaturë fituese nga ana e Ministres së MASR⁹²-së, nuk plotëson kriteret e kërkuara dhe përcaktuara në aktet nënligjore, sipërcituar. Ky fakt, u provua nga verifikimi i dokumentacionit të T. P., konkretisht lidhur me mosplotësimin e dy prej kriterëve të përcaktuara tek kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

1. Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike;
2. Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë;

Parë në rrafsh krahasues, subjekti ankues, haptazi është trajtuar në mënyrë të pabarabartë krahasuar me T. P., pasi, nga këqyrja e dokumentacionit dhe CV-së së të tij, rezulton se ankuesi qartazi i përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara.

Komisioneri konstaton se, nga këqyrja e dokumentacionit të kandidatit të përzgjedhur si fitues, T. P., dhe subjektit ankues, MASR ka shkelur haptazi dhe vetë kriteret e përcaktuara në Udhrrin e saj, Nr. 41, datë 24.01.2019.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të drejtpërdrejtë të subjektit ankues, P. S., për shkak të “përkatësisë në një grup të veçantë”, nga ana e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, lidhur me vendimmarrjen e saj për përzgjedhjen e kandidaturës fituese të përfaqësuesve të studentëve në Bordin e Administrimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër.

⁹² Referuar Urdhrit nr.329, datë 07.06.2019 “Për disa ndryshime në Urdhrrin nr.155, datë 13.03.2019 “Për lirimimin nga detyra të anëtarëve të Bordit të Administrimit të Universitetit “Luigj Gurakuqi” Shkodër dhe emërimin në detyrë të anëtarëve të rinj, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin”, të Ministrisë së MASR.

88. F. B., kundër Spitalit Universitar të Traumës (SUT)

VENDIM NR. 176, DATË 02.12.2019

Shkaku: Përkatësia në një grup të veçantë
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Subjekti ankues me detyrë Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT dhe zv/President i Shoqatës së Infermierëve, është komanduar të punojë Infermier Shërbimi i Kirurgjisë 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, të cilin ai e ka kundërshtuar. Në vijim, i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare dhe kontrata e punës me SUT, gjë që ka ndodhur për shkak të denoncimeve të tij mediatike për mangësitë dhe vështirësitë që hasin në përditshmërinë e punës së tyre, mjekët, infermierët dhe shoferët e Urgjencës së Tiranës, duke e lidhur me mungesën e kushteve dhe mjeteve të punës, mungesën e medikamenteve.

FAKTET:

Ankuesi ka një eksperiencë pune si infermier prej rreth 30 vitesh. Ai ka lidhur marrëdhëniet e punës me Autoritetin Shëndetësor Rajonal Tiranë (ARSH), me datë 28.05.2011⁹³ në detyrën e infermierit të Urgjencës. Në datën 01.01.2016 është transferuar nga ARSH Tiranë, me detyrë Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, datë

Denoncimet e ankuesit kanë kulmuar me datë 28.10.2018 me daljen e tij në TV Neës 24, ku ka folur në një minutazh prej rreth 44 minutash lidhur me sfidat, mangësitë dhe vështirësitë që hasin në përditshmërinë e punës së tyre, mjekët, infermierët dhe shoferët e Urgjencës së Tiranës, duke e lidhur me mungesën e kushteve dhe mjeteve të punës, mungesën e medikamenteve etj, gjëra të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në pamundësinë e tyre për t'u ofruar me efektivitet dhe në mënyrën e duhur ndihmën mjekësore pacientëve/qytetarëve që kanë nevojë për të.

Me Urdhërin nr.2471, datë 13.11.2018 “Urdhër për dhënie mase disiplinore personeli punonjës në SUT”, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, me motivacionin për thyerje të kërkesave të pikës 1, të Deklaratës së Konfidencialitetit, si dhe dhënie informacioni pa qenë i autorizuar nga SUT, dhënie informacioni të SUT në TV private dhe portale private pa autorizim.

Me Urdhërin nr.2782, datë 20.12.2018 “Urdhër për dhënie mase disiplinore personeli punonjës në SUT”, ankuesit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna”, me motivacionin “Moszbatim të të Urdhërit nr.1558, datë 20.08.2018, për përdorimin e uniformës së punës gjatë orarit zyrtar të punës, konstatuar nga ekipi i kontrollit të SUT me datë 14.12.2018, në vendqendrimin “Stadiumi Dinamo”.

⁹³ Referuar Kontratës Individuale të Punës.

Nëpërmjet shkresës me nr.426 prot., datë 08.02.2019, “Vendim për komandim në detyrë personel infermieror në SUT”, subjekti ankues me detyrë Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, për nevoja pune dhe shërbimi, është komanduar të punojë Infermier Shërbimi i Kirurgjisë 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT, nga data 08.02.2019 deri në një urdhër të dytë.

Pavarësisht se marrëdhëniet e punës i janë ndërprerë nëpërmjet Urdhërit nr.1264, datë 10.05.2019 “Për ndërprerje marrëdhënie financiare dhe kontratë pune personeli Infermier në SUT”, për mosprezencë të justifikuar në punë, në fakt atij kontrata i është zgjidhur që me datë 08.02.2019.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Karta Sociale Europiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 9.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Statuti i Urdhërit të Infermierëve në Republikën e Shqipërisë⁹⁴, neni 7.

KONKLUSIONE

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se SUT nuk arriti të provojë se:

- Komandimi i ankuesit nga Infermier në Shërbimin e Urgjencës Ambulatore në SUT, në Infermier Shërbimi i Kirurgjisë nr. 2, në Shërbimin e Konsultave të Specializuara Ambulatore në SUT nuk kishte ndryshuar elementët thelbësorë të kontratës së punës së ankuesit: pagën, vendin e punës dhe përshkrimin e punës.
- Komandimi ishte për arsye të justifikuara dhe në respektim të procedurës së rregullt ligjore.
- Masat disiplinore të dhëna ndaj tij ishin në respektim të procedurës së rregullt ligjore, ishin të drejta, të justifikuara dhe proporcionale.
- Komandimi i tij nuk ishte “*de jure*” dhe “*de facto*” zgjidhje e kontratës së punës.
- Komandimi nuk kishte të bënte me denoncimet e tij mediatike për mangësitë dhe vështirësitë që hasin në përditshmërinë e punës së tyre, mjekët, infermierët dhe shoferët e Urgjencës së Tiranës, duke e lidhur me mungesën e kushteve dhe mjeteve të punës, mungesën e medikamenteve etj, gjëra të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në pamundësinë e

⁹⁴ Urdhri i Infermierit është krijuar në bazë të Ligjit Nr. 9718 datë 19/04/2007, ndryshuar me Ligjin Nr. 10 462 datë 13/09/2011, ndryshuar me Ligjin Nr. 124 datë 25/09/2014 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”.

tyre për t'u ofruar me efektivitet dhe në mënyrën e duhur ndihmën mjekësore pacientëve/qytetarëve që kanë nevojë për të.

Komisioneri konstaton se SUT nuk ka ndjekur një linjë logjike lidhur me komandimin e ankuesit dhe ka dështuar të provojë se ka ardhur për një arsye të ligjshme dhe të justifikuar. Pra, shihet qartë se sjellja e padrejtë ndaj ankuesit, finalizuar me largimin e tij përfundimtar nga puna ka ardhur pikërisht pas denoncimeve të tij publike, mediatike si zv/president i Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë dhe anëtar i Urdhërit të Infermierëve të Shqipërisë.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të F. B., nga ana e Spitalit Universitar të Traumës Tiranë (SUT), për shkak të denoncimeve të tij mediatike, në cilësinë e zv/presidentit të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë.

SUT, të marrë masat për ndreqjen e pasojave, duke rikthyer F. B., në punë, në detyrën e mëparshme si Infermier i Urgjencës së Tiranës.

ÇËSHTJE DISKRIMINIMI PËR ÇDO SHKAK TJETËR

89. A. B., dhe E. I., kundër M. B., dhe B. L., në cilësitë si drejtor/botues dhe kryeredaktor të Gazetës TemA.

VENDIM NR. 101, DATË 05.04.2018

Shkaku: Për çdo shkak tjetër (Lidhja familjare dhe vendlindja)
Forma: Diskriminim në formën e shqetësimit dhe shoqërimit
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Vendimi nuk është kundërshtuar

Ankuesit janë bashkëshortë të lindur në Tropojë. E. I., është Prokurore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Drejtuesit e gazetës TemA për shkak të detyrës së prokurores në datë 21.10.2017 e në vijim, kanë publikuar disa artikuj duke përdorur gjuhë urrejtje, nisur nga vendlindja e prokurores si dhe duke bërë etiketime mbi lidhjet familjare dhe personale të ankuesve.

FAKTET

Sipas informacionit të publikuar në Gazetën “TemA” dhe në portalin e gazetës online, në datë 21.10.2017, në artikullin: “Prokurorët Tropoanë, kushërinj të S. B., duan arrestimin e S. T.,” shkruhet mes të tjerash se: “E. I., nga Tropoja, është pjesëtare e grevës së urisë të Sh. B., në vitin 1999. Gruaja e A. B., kushëri i dytë i Sh. B., G. O., nga Tropoja....”.

Në datë 21.10.2017, në artikullin: “Kushërinjtë e S. B., kundër kushërinjve të S. T.,” me autor M.B, në mes të tjerash shkruhet se: “....e kupton se përse kanë shkuar në atë seancë tre prokurorë, të tre nga Tropoja, me lidhje politike e fisnore me S. B..... Kjo është komedia e fundit e drejtësisë politiko-tropojane, që shkatërroi sistemin e drejtësisë në vend..... Është e pazakontë se si në një seancë dëgjimore, ti mund të shikosh fytyrën reale të drejtësisë së S. B., jo vetëm nga boshllëku intelektual, korruptimi politik, por dhe pamjen vizive dhe fjalorin e saj”.

Në datë 22.10.2017, në artikullin: “Lidhjet me S.B., dhe njolla e zezë e bashkëshortit” në mes të tjerash shkruhet se: “... Bashkëshorti i saj ka qenë kandidat për deputet i PD-së. Jo vetëm kaq, por sipas një burimi të gazetës TemA, ai ka edhe një “njollë të zezë”, e cila me sa duket i është hequr në Shqipëri me ndihmën e bashkëshortes....”.

Në datë 25.10.2017 në artikullin: “Burri i prokurores së S.T., i përfshirë në trafik prostitucioni në Itali e Belgjikë. Vrau vëllanë e ish të fejuarës, pse i tregoi....”, në mes të tjerash shkruhet se: “.....I.H., duke ironizuar ‘qytetarin digjital’ka publikuar disa të dhëna për bashkëshorten e prokurores E. Y..... Dua të tregoj se burri i prokurores E.I., A.B., së bashku me dëshmitarin e gjyqit të A. H., tropojanit A.M., kanë punuar bashkë në trafikun e prostitutave në Itali e më pas në Belgjikë.....A.B., përpara se të njihej me E.I., ka qenë i fejuar me një vajzë nga Tirana, por kur i vëllai i të fejuarës ka marrë vesh se ai merret me trafik femrash, i ka treguar të motrës e cila e ka braktisur këtë A.B. Ai në shenjë hakmarrje ka vrarë të vëllain e ish-të fejuarës tek “Stacioni i Trenit”...”.

Në datë 10.11.2017, në artikullin “Dilemat e E. R., si viktimë e shtypit” në mes të tjerash shkruhet se: “...Burri i kësaj gruas nga Tropoja, që është bërë prokurore ‘antikorrupsion’, kërkon për mua dhe kryeredaktorin, dy vjet burg, se gazeta ka botuar intervistën e një personi publik, që e akuzon burrin e kësaj ‘kryevetingares’, se ka qenë i përfshirë në aktivitet prostitucioni...”.

M. B., dhe B. L., nuk kanë ofruar asnjë informacion apo pretendim në përgjigje të shkresës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 17/2, 18, 22/1.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 10, 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Ligji Nr. 10128, datë 11.05.2009 “Për Tregtinë Elektronike”.
- Ligji Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Rekomandimi 97(20) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës.

KONKLUZIONE

Në analizë të artikujve të sipërcituar, Komisioneri ka vlerësuar se, qëndrimin antitropojan, botuesi dhe kryeredaktori i gazetës “TemA” e justifikojnë me anë të “argumenteve” se të gjithë personat që kanë prejardhje nga Tropoja, janë të “emëruar” në funksione publike sepse kanë lidhje fisnore dhe politike me S. B., janë të paaftë, kanë boshllëqe vizive dhe të fjalorit. Nga ana tjetër në artikujt objekt shqyrtimi nuk është lënë pa përmendur dhe bashkëshorti i E. I., duke e etiketuar si të përfshirë në trafik prostitucioni dhe si vrasës. Argumentet e dhëna dhe gjuha e përdorur nga autorët në këto artikuj vlerësohet si përdorim i gjuhës së urrejtjes duke u nisur nga vendlindja e prokurores së përmendur si dhe duke bërë etiketime duke u nisur nga lidhja familjare dhe jeta personale e ankuesve.

Komisioneri nga gjykimi i gjuhës së përdorur në artikujt objekt shqyrtimi, ka vlerësuar se në të gjitha rastet, mbrojtja e reputacionit të subjekteve ankuese dhe në veçanti të E. I., si funksionare publike, duhet të ketë përparësi mbi lirinë e medias.

Komisioneri ka vlerësuar se gjuha e përdorur nga M.B., dhe B.L., për shkak të vendlindjes së E.I dhe lidhjes familjare për A.B, reflekton dukshëm një qëndrim të qëllimtë diskriminues në mënyrë të tillë që cënon rëndë parimin e mosdiskriminimit, në zbatim të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” dhe sulme të tilla ndaj grupimeve të veçanta të popullsisë të kryera përmes fyerjes, stigmatizimit apo shpifjeve janë të mjaftueshme për autoritetet për të përligjur trajtim të menjëhershëm dhe efikas kundër shprehjeve raciste përballë lirisë së shprehjes të ushtruar në mënyrë të papërgjegjshme.

Në çështjen në fjalë, Komisioneri mban parasysh edhe dy fakte të tjera të rëndësishme që janë, cilësia e M. B., dhe B.L., si persona publikë dhe mjetin nëpërmjet të cilit janë përhapur artikujt. Në komentet që kanë shoqëruar artikujt e përmendur nga ankuesit, komentuesit e artikujve kanë shprehur komente fyese dhe denigruese ndaj ankuesve.

Në përfundim, nisur nga shqyrtimi i këtyre fakteve, Komisioneri gjykon se, mosmarrja e masave apo veprimeve nga ana e drejtuesve të gazetës Tema, ka sjellë për pasojë edhe vendosjen e ankuesve në kushte të disfavorshme, duke krijuar kështu një mjedis frikësues, përçmues, poshtërues e ofendues.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7/1, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri gjykon se A. B., dhe E. I., janë ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e M. B., dhe B. L., trajtim i cili ka lidhje të drejtpërdrejtë, me vendlindjen e E. I., dhe lidhjen familjare të A. B.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasës E. I., nga ana e shtetasve M. B., dhe B. L., për shkak të vendlindjes në formën e shqetësimit.

Konstatimin e diskriminimit në formën e shoqërimit dhe shqetësimit të shtetasit A. B., nga ana e shtetasve M. B., dhe B. L.

90. Grup personash kundër Bashkisë Mallakastër

VENDIM NR.178, DATË 17.09.2018

Shkaku: Çdo shkak tjetër (Lidhja familjare)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Të mira dhe shërbime
Statusi: Zbatuar

Vëllezërit O. K., dhe M. K., bijtë e J. K., ekzekutuar me pushkatim gjatë ish-regjimit komunist, kanë kërkuar nga Bashkia Mallakastër ndryshimin e emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”. Nga ana e Bashkisë nuk u është kthyer asnjë përgjigje zyrtare, duke mos i dhënë zgjidhje problematikës.

FAKTET

O. K., dhe M. K., kanë paraqitur të kërkesë pranë Bashkisë Mallakastër, lidhur me shfuqizimin e Vendimit nr.27, datë 29.05.2002, pika III e tij i cili ka emërtuar rrugën në drejtim të KPTHN-së, “Rruga Mehmet Shehu”. Ata kanë kërkuar riemërtimin e kësaj rruge, me një emër të denjë për pasqyrimin e vlerave më të mira, të qytetarëve të Ballshit, Mallakastrës.

Subjektet ankues kanë provuar lidhjen familjare me J. K., (vërtetohet se janë të bijtë e tij) dhe kanë dhënë një panoramë të gjerë të kalvarit të vuajtjeve të familjes së tyre nga ish-regjimi komunist, duke renditur kronologjinë e ngjarjeve që nga arrestimi i paligjshëm i babait të tyre, J. K., ekzekutimi i tij, dëbimi dhe internimi i nënës dhe shtatë fëmijëve (përfshirë dhe ankuesit), sekuestrimi i pasurisë së tyre, etj.

Me datë 09.11.2017 në adresën elektronike të Bashkisë Mallakastër, ankuesit kanë depozituar kërkesë lidhur me riemërtimin e rrugës “Mehmet Shehu”, Mallakastër.

Bashkia Mallakastër u ka kthyer përgjigje kërkuarëve se është kompetencë e Këshillit Bashkiak dhe jo e Bashkisë Mallakastër dhe për rrjedhojë duhet t’u drejtohen Këshillit Bashkiak Mallakastër.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 18, 48.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, Neni 14.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 19.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Ankuesit bartin shkakun e pretenduar dhe se institucioni ndaj të cilit ankohen. Bashkia Mallakastër, ka patur dijeni si për problematikën, ashtu edhe për faktin se ata janë bijtë e J. K., i cili ishte dënuar dhe ekzekutuar nga regjimi komunist, në vitin 1951.

Bazuar në korrespondencën dhe dokumentacionin e depozituar nga palët pranë KMD-së, ka rezultuar se kërkesa drejtuar Bashkisë Mallakastër për heqjen dhe ndryshimin e emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”, si emërtim diskriminues, ka qenë e përsëritur nga ana e ankuesve. Pavarësisht pretendimit se Bashkia Mallakastër ka refuzuar shqyrtimin e kërkesës për heqjen dhe ndryshimin e emërimit të rrugës “Mehmet Shehu”, u konstatua se nga ana e Bashkisë Mallakastër i është kthyer përgjigje ankuesve por jo në lidhje me pretendimet e tyre thelbësore por në lidhje me emailt e B. M., dhe llojet e tyre, gjë që u faktua nga komunikimi me e-mail mes D. D., dhe Bashkisë Mallakastër

Komisioneri vlerësoi se, përgjigjja e Bashkisë, *prima facie* dukej sikur e përmbush detyrimin për të dhënë informacion, por realisht nuk ndihmon në zgjidhjen e ankesës së subjekteve përmes adresimit të saj tek organi kompetent dhe se është kompetencë e Bashkisë të vendosë për emërtimin e rrugëve, apo për ndryshimin e këtyre emërtimeve. Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” vendimmarrjen për emërtimin e tyre ia njeh Këshillit Bashkiak.

Pavarësisht ndarjes së kompetencave brenda një njësie të vetëqeverisjes vendore, Komisioneri vlerëson se në kuadër të bashkëpunimit dhe detyrimit ligjor për zgjidhjen e ankesave të publikut, është detyrim i një organi të Bashkisë Mallakastër që të përcjellë shqetësimet e personave, kërkesat apo ankesat një organi tjetër të po asaj njësie. Në rastin konkret ishte detyrim i administratës së Bashkisë Mallakastër që duhej t’ia dërgonte kërkesën organit të brendshëm kompetent të Bashkisë Mallakastër, Këshillit Bashkiak me përfaqësues Kryetarin e Këshillit Bashkiak.

Bashkia Mallakastër nuk tregoi vullnet institucional për t’u angazhuar në përcjelljen e problematikës në organin e saj të brendshëm, në Këshillin Bashkiak, dhe aq më tepër të ndërmarrë veprime pozitive në këtë drejtim. Për shkak të ndjeshmërisë njerëzore së ankuesve, si bij të J.K, ekzekutimin e të cilit e kishte urdhëruar pikërisht njeriu, emrin e të cilit mban një nga rrugët që është në administrim territorial të kësaj Bashkie, dhe pasjes dijeni të këtij fakti nga ana e këtij institucioni; Bashkia nuk duhet të mbante qëndrim indiferent ndaj kërkesës së tyre dhe të mjaftohej thjesht me dhënien e përgjigjes se nuk është në kompetencën e saj të emërtojë rrugët.

Në këto kushte, duke analizuar faktet dhe dokumentacionin e grumbulluar gjatë trajtimit të ankesës, shpjegimet e dhëna nga palët, si dhe legjislacionin përkatës lidhur me sa më sipër, Komisioneri vlerëson se paligjshmëria e veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Mallakastër në mosdhënien e një përgjigje mbi kërkesën e ankuesve, si dhe mos gjetja e një arsyeje të kësaj sjelljeje të kryer nga organi publik, krijon bindjen e një trajtimi disfavorizues dhe diskriminues kundrejt ankuesve për shkak të përkatësisë prindërore.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të subjekteve ankues: O. K., dhe M. K., nga ana e Bashkisë Mallakastër, përmes mosveprimit të saj në trajtimin e problematikës.

Referuar pikës pikës 1, të vendimit, Bashkia Mallakastër, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese ndaj ankuesve, të trajtojë kërkesën e tyre për ndryshim të emërimit të “Rrugës Mehmet Shehu”, në Këshillin Bashkiak Mallakastër.

91. E. G., kundër Bibliotekës Kombëtare Tiranë

VENDIM NR. 52, DATË 16.04.2019

Shkaku: Çdo shkak tjetër (Ankimimet)
Forma: Diskriminim në formën e viktimizimit
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesja, prej 16 vitesh ka qenë në marrëdhënie pune me Bibliotekën Kombëtare Tiranë. Me datë 21.06.2017 ka paraqitur ankimim për diskriminim nga punëdhënësi, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ajo është larguar nga puna me datë 11.12.2017, ndërkohë që Komisioneri po shqyrtonte çështjen e saj dhe ende nuk ishte shprehur me vendim përfundimtar.

FAKTET

Ankuesja ka mbajtur detyrën "Specialist i ISBN-së" në Sektorin e Agjencisë Kombëtare të Numrave Ndërkombëtare të Standartizuar, pranë Bibliotekës Kombëtare. Nëpërmjet Urdhërit nr.132 prot., datë 15.02.2017 është transferuar në detyrën "Klasifikatore", pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv. Ankuesja e ka kundërshtuar administrativisht dhe gjyqësisht këtë transferim, duke e konsideruar atë si ndryshim të kundraligjshëm të kushteve të kontratës individuale të punës.

Pretendimin për shkaqe diskriminuese lidhur me transferimin e saj, ankuesja e ka bërë objekt të shqyrtimit administrativ të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, datë 21.06.2017, i cili në përfundim të këtij shqyrtimi, nëpërmjet vendimit nr.43, datë 07.02.2018 ka konstatuar diskriminimin e subjektit ankues nga ana e punëdhënësit (Biblioteka Kombëtare) për shkak të gjendjes së saj shëndetësore.

Komisioneri si masë rregulluese ka urdhëruar Bibliotekën Kombëtare të bëjë rikthimin e E. G., në vendin e mëparshëm të punës si "specialiste" pranë Sektorit të Agjencisë Kombëtare të ISBN-së. Ndërkohë, me Urdhërin nr. 6, datë 11.12.2017 punëdhënësi ka ndërprerë marrëdhëniet e punës me ankuesen.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- Karta Sociale Evropiane, ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Nenet 9, 143, 153 etj.
- Ligji Nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", nenet 80 dhe 82.

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Nga shqyrtimi i dokumenteve të administruara nga Komisioneri dhe kronologjia e ngjarjeve, rezultoi se:

- Ankimimi i ankueses për diskriminim nga ana e Bibliotekës është paraqitur pranë KMD-së në **datën 21.06.2017**.
- Zgjidhja e marrëdhënieve të punës nga Bibilioteka është bërë bazuar në Urdhërin nr.6, **datë 11.12.2017**.
- Komisioneri ka disponuar me vendimin nr.43 ka dalë me **datë 07.02.2018**. Nëpërmjet këtij vendimi Komisioneri ka konstatuar diskriminimin e ankueses nga ana e punëdhënësit, Bibliotekës Kombëtare, për shkak të “gjendjes shëndetësore”; sa i takon kalimit të ankueses nga pozicioni i punës "specialiste", në atë të "klasifikatores" pranë Sektorit të Katalogimit Retrospektiv Elektronik në Bibliotekën Kombetare Tiranë.

Komisioneri konstatoi se, ankuesja është larguar përfundimisht nga puna si rezultat i këtij ankimimi, ndërkohë që çështja e saj ishte ende në shqyrtim dhe para se KMD-ja të shprehej me vendim përfundimtar.

VENDIMI

Konstatimi i diskriminimit në formën e viktimizimit, të E. G., nga ana e Bibliotekës Kombëtare, për shkak të ankimimit me pretendim diskriminimin e saj, të paraqitur pranë KMD-së.

92. V. H., kundër Shoqërisë Albpetrol sh.a.

VENDIM NR. 113, DATË 26.08.2019

Shkaku: Çdo shkak tjetër
Forma: Diskriminim i Drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka qenë në marrëdhënie të pandërprera pune me Shoqërinë Albpetrol sh.a nga data 07.03.2012 deri në datën 29.07.2018, datë në të cilën i është zgjidhur marrëdhënia e punës, për shkak të situatës së krijuar mes tij dhe me Administratorit të Shoqërisë, si rezultat i raportit të hartuar prej tij lidhur me situatën e monitorimit mjedisor.

FAKTET

Subjekti ankues, V. H., ka qenë punonjës i Shoqërisë Albpetrol sh.a nga data 01.03.2013 deri më datë 20.07.2018. Gjatë kohëzgjatjes së marrëdhënieve të punës me Shoqërinë, ka patur ndryshime të pozicionit të punës, duke mbajtur detyrat si më poshtë:

- Specialist pranë Drejtorisë së Monitorim-Supervizimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure Patos, nga data 01.03.2013 deri më datën 30.04.2013.
- Specialist pranë Sektorit të Monitorim-Supervizimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure, nga data 01.05.2013 deri më datën 22.06.2014.
- Specialist pranë Drejtorisë së Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurimit Teknik në Administratën e Shoqërisë Albpetrol sh.a, nda data 23.06.2014 deri më datë 20.07.2018.

Nëpërmjet shkresës datë 09.07.2018 të Administratorit të Shoqërisë ndaj ankuesit është marrë masa për fillimin e procedurës për zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës, me motivacionin e nënshkrimit në emër të Administratorit të Shoqërisë pa autorizim përkatës të Akt marrëveshjes me Ndërmarrjen e Pastrimit Fier.

Në datën 23.07.2018⁹⁵ ankuesi ka marrë dijeni për Vendimin nr.444, datë 19.07.2018 të Administratorit të Shoqërisë për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës si specialist i Drejtorisë së Mjedisit, Shëndetit dhe Sigurimit Teknik (MSHST). Motivacioni për largimin nga puna ishte për shkak se ai kishte kryer veprime të pa autorizuar paraprakisht nga titullari i Shoqërisë duke nënshkruar për llogari të kësaj Shoqërie Akt-Marrëveshjen me Ndërmarrjen e Pastrimit Fier.

Ankuesi solli dokumente që provonin se ai, në cilësinë e personit përfaqësues të Shoqërisë Albpetrol sh.a ka lidhur në mënyrë të vazhdueshme Akt-Marrëveshje të ndryshme, me Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit Patos, lidhur me shërbimet që kjo e fundit duhet t'i ofronte Shoqërisë Albpetrol sh.a, për periudhën nga viti 2016-2018.

⁹⁵ Në këtë periudhë ankuesi ka qenë me raport mjekësor.

Denoncimin e situatës kritike mjedisore në disa nga stacionet e Shoqërisë, për shkak të detyrës, kompetencave dhe të profesionit të tij, ankuesi e ka dokumentuar nëpërmjet shkresave shkresave zyrtare.

- Me nr.4968 prot., datë 12.06.2018 “Dërgojmë të dhënat e monitorimit mjedisor në Albpetrol sh.a për 3 mujorin e parë të vitit 2018”, të dhënat e këtij raportimi janë negative, pasi është raportuar nga ankuesi se në disa stacione lëshohet gaz i cili është vdekjeprurës si për punëtorët ashtu edhe për banorët e zonës.
- Me nr.4784 prot., datë 05.06.2018 “Relacion lidhur me të dhënat e monitorimit mjedisor në Albpetrol sh.a për 3 mujorin e parë të vitit 2018”.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 18, 49, 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike⁹⁶.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9, 147, 148 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.
- Rregullores së Shoqërisë për DMSHTS.
- Neni 57 i Kontratës Kolektive të Punës.

KONKLUSIONE

Lidhur me argumentimin e Albpetrol sh.a se largimi i ankuesit kishte ardhur për shkak të kryerjes nga ana e tij të veprimeve të paautorizuara nga titullari i Shoqërisë duke nënshkruar dokumente për llogari të Albpetrol sh.a; Komisioneri konstatoi se:

Së pari, nga këqyrja e akteve të administruara gjatë këtij procesi, rezultoi e provuar se subjekti ankues, në cilësinë e personit përfaqësues të Shoqërisë Albpetrol sh.a ka lidhur në mënyrë të vazhdueshme Akt-Marrëveshje të ndryshme, me Ndërmarrjen e Pastrim Gjelbërimit Patos, lidhur me shërbimet që kjo e fundit duhet t’i ofronte Shoqërisë Albpetrol sh.a, për periudhën nga viti 2016-2018.

Së dyti, nënshkrimi i Akt-Marrëveshjes së fundit⁹⁷ nga ana e ankuesit në emër të Shoqërisë, ka ardhur si rezultat i zbatimit të Urdhërit të Drejtorit të tij, Sh. G., në përbushje të rekomandimeve të lëna nga Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë (DRSH) Fier.

⁹⁶ Hyrë në fuqi në vitin 1976.

⁹⁷ Me nr.extra prot., datë 05.07.2018.

Së treti, qartazi subjekti ankues, për zbatimin e urdhërit të eprorit direkt, z.Sh.G është ndëshkuar me masën më të ashpër, atë të zgjidhjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës, krahasuar me eprorin e tij, Sh. G. Ndërsa vetë urdhëruesi, Sh. G., ka marrë masë më të lehtë disiplinore, edhe pse në thelb bëhej fjalë për të njëjtën “shkelje” të perzumuar nga ana e Albpetrol sh.a. Në këtë kontekst, haptazi Albpetrol sh.a ka bërë një trajtim të diferencuar, të pabarabartë dhe të pafavorshëm të ankuesit krahasuar me Sh. G., duke mos justifikuar në mënyrë objektive, të arsyeshme dhe proporcionale dhënien e masës disiplinore ekstreme ndaj ankuesit.

Së katërti, Shoqëria Albpetrol sh.a nuk provoi që ankuesi të kishte kryer faj të rëndë apo të kishte bërë shkelje me pasoja të rënda për Shoqërinë. Përkundrazi, efektet e nënshkrimit Akt-Marrëveshjes së datës 05.07.2018, me nr.extra prot., ishin në favor të Albpetrol sh.a dhe për më tepër nuk ka patur asnjë pasojë, kosto financiare për Shoqërinë, pasi shërbimi është kryer pa pagesë. Shërbimi i DDD i kryer në ambjentet e Albpetrol sh.a është një shërbim në dobi të përmirësimit të higjenës së shoqërisë dhe shëndetit të punonjësve, po ashtu dhe zbatim i Rekomandimit të lënë nga DRSF Fier për ndërhyrje urgjent lidhur me sa më sipër. Nga ana tjetër, ankuesi kishte shmangur dhe gjobën që do merrej nga DRSF Fier nëse nuk do ndërhyhej urgjent për marrjen e masave.

Së pesti, referuar Rregullores së Shoqërisë për DMSHTS, dhe akteve të disponuara gjatë procedurës hetimore⁹⁸, u konstatua se ndër të tjera, detyrat e realizuara nëpërmjet lidhjes dhe zbatimit të Akt-Marrëveshjeve të tilla bënin pjesë në detyrat funksionale të kësaj Drejtorie, për pasojë ishin edhe detyra funksionale të ankuesit si specialist i saj.

Denoncimi i situatës kritike mjedisore në disa nga stacionet e Shoqërisë nga ana e ankuesit është dokumentuar shkresërisht nëpërmjet relacioneve lidhur me të dhënat e monitorimit mjedisor në Albpetrol sh.a për 3 mujorin e parë të vitit 2018, ku të dhënat e këtij raportimi janë negative, pasi është raportuar nga ankuesi se në disa stacione lëshohet gaz i cili është vdekjeprurës si për punëtorët ashtu edhe për banorët e zonës.

Ndërprerja e marrëdhënies së punës me ankuesin është bërë nëpërmjet Vendimit nr.444, datë 19.07.2018 të Administratorit të Shoqërisë. Referuar kronologjisë së ngjarjeve dhe akteve shkresore sipërcituar, ankuesi provon se largimi i tij nga puna ka ardhur menjëherë pas konfliktit të lindur si rezultat i këtij raportimi.

Në kushtet kur, nga ana e Albpetrol sh.a nuk u arrit të provohej që zgjidhja e marrëdhënieve të punës me ankuesin ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qenë e justifikuar, proporcionale dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm për qëndrimin e Shoqërisë ndaj tij, dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerësoi se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkakun e pretenduar prej tij, atë të denoncimit të situatës kritike mjedisore në disa nga stacionet e

⁹⁸ Në shkresat poshtëcituar ankuesi ka firmosur si person përgjegjës i kontrolluar i Shoqërisë Albpetrol sh.a:

- Akt-kontroll i DRSF Fier, me nr.171 prot., datë 25.01.2-018.
- Akt-kontroll i DRSF Fier, me nr.177 prot., datë 26.01.2-018.
- Akt-kontroll i DRSF Fier, me nr.178 prot., datë 26.01.2-018.
- Akt-kontroll i DRSF Fier, me nr.1110 prot., datë 25.04.2-018.

Shoqërisë, si pasojë e së cilës rrezikohet jo vetëm shëndeti dhe jeta e punonjësve të saj, por edhe e komunitetit që jeton afër tyre.

VENDIMI

Konstatim i diskriminimit të V. H., nga ana e Shoqërisë Albpetrol sh.a, për shkak të konfliktit të krijuar mes tij dhe Administratorit të Shoqërisë, si rezultat i raportit të hartuar prej ankuesit lidhur me situatën e monitorimit mjedisor për 3 mujorin e parë të vitit 2018.

93. A. H., Kundër Shoqërisë Albpetrol Sh.A.

VENDIM NR. 13, DATË 21.01.2019

Shkaku: Çdo shkak tjetër (Për shkak të ankimit)
Forma: Diskriminim/Viktimizim
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi, ka mbajtur detyrën e drejtorit të Drejtorisë Juridike pranë Albpetrol sh.a. Ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë në raport me kolegët e tjerw, për shkak të ankimit¹ të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier kundër punëdhënësit.

FAKTET

Ankuesi A. H., ka mbajtur detyrën e drejtorit të Drejtorisë Juridike pranë administratës së Albpetrol sh.a., prej datës 04.11.2013 deri më datë 15.01.2018. Me vendimin nr. 14, datë 15.01.2018, i është zgjidhur kontrata e punës dhe është liruar nga detyra e Drejtorit të Drejtorisë Juridike duke kaluar në pozicionin e specialistit të Drejtorisë Juridike. Për këtë, i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me pretendim diskriminim për shkak të bindjeve politike, ku Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është pjesë e procesit si palë e tretë.

Administratori i Shoqërisë Albpetrol sh.a., me Vendimin Nr. 703, datë 10.12.2014, ka përcaktuar që punonjësit e shoqërisë të cilët punojnë në administratën qendrore të shoqërisë të përfitojnë shpërblym në pagë sipas titujve shkencor. Gjatë kontrolleve të ushtruara nga KLSH, në vitet 2016 dhe 2017, është konstatuar se pagesat e gradave shkencore janë kryer në mënyrë të kundraligjshme dhe nisur nga ky fakt, në rekomandimet e lëna ka urdhëruar arkëtimin e shumave të përfituara nga këta punonjës, si rrjedhojë e dëmit ekonomik të shkaktuar ndaj shoqërisë Albpetrol sh.a. Administratori i shoqërisë në zbatim të rekomandimeve të lëna nga KLSH-ja, me vendim Nr. 226, datë 04.04.2018 me lëndë *“Për anullimin e vendimit Nr. 703, datë 10.12.2014”*, në pikën 1 ka urdhëruar, *“Të ndërpriten të gjitha pagesat shtesë mbi pagë për të gjithë punonjësit përfitues”*, si dhe në pikën 4 të këtij urdhëri është parashikuar kryerja e të gjitha procedurave administrative dhe gjyqësore për kthimin e këtyre shumave.

Fillimisht, Shoqëria Albpetrol, ka bërë me dije vetëm ankuesin se, referuar Raportit të Kontrollit të Lartë të Shtetit të vitit 2017, Nr. 576/44, datë 31.12.2017 (protokolluar në Albpetrol me Nr. 916, datë 02.02.2018), është debitor në vlerën 308,000 lekë, për periudhën Mars 2016-Dhjetor 2017, për përfitimin e pagesës për titullin Master Shkencor, në mënyrë të padrejtë. Në një moment të dytë, me datë **27.09.2018**, pra në të njëjtën ditë janë njoftuar shtatë punonjësit e tjerë pjesë e raportit të KLSH.

Sipas parashikimit të sipërcituar në Kodin e Punës, afati përfundimtar për të njoftuar punonjësit debitor ndaj shoqërisë ka qënë data 02.08.2018. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vëren se njoftimi i punonjësve dhe ish punonjësve të Shoqërisë Albpetrol sh.a.,

përveç ankuesit, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së është bërë në të njëjtën datë (27.09.2018) dhe pas përfundimit të afatit 6-mujor të parashikuar në Kodin e Punës.

Gjithashtu, nga provat e vëna në dispozicion nga ana e ankuesit, Shoqëria Albpetrol sh.a., në vitin 2015 i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Fier me kërkesë padi⁹⁹, nëpërmjet së cilës ka kërkuar kthimin e dëmit financiar të shkaktuar ndaj saj, nga tre punonjës. Në përfundim të arsyetimit të saj, Gjykata e Shkallës së Parë Fier, lënë në fuqi¹⁰⁰ edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë, ka vendosur¹⁰¹ rrëzimin e kërkesë padisë së Shoqërisë Albpetrol sh.a., ndër të tjera me arsyetimin se: “...duke iu referuar përmbajtjes së nenit 203/2 të Kodit të Punës, vlerëson se paditësi Albpetrol sh.a., Patos, ka hequr dorë nga e drejta për të kërkuar zhdëmtimin e dëmit nga të paditurit punëmarrës, duke qënë se nuk e ka kërkuar këtë të drejtë brenda afatit gjashtë mujor nga dita që ka marrë dijeni për dëmin e shkaktuar nga shkaktuesit e tij. Kjo e drejtë është shuar dhe nuk mund të kërkohej më rivendosja e saj nëpërmjet gjykatës...”.

Nga procedura hetimore, rezultoi se Shoqëria Albpetrol sh.a., veç ankuesit, nuk kishte njoftuar asnjë punonjës apo ish punonjës për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar deri në momentin që ankuesi ka paraqitur ankesë tek Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në këto kushte, duke mos njoftuar deri më datë 02.08.2018, punonjësit debitor, për kthimin e detyrimeve të konstatuara nga KLSH, Shoqërisë Albpetrol sh.a., i humb e drejta për zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar nga punëmarrësit.

Përsa më lart, fakti që punonjësit e tjerë të Shoqërisë Albpetrol sh.a., janë njoftuar përtej afateve ligjore për kthimin e dëmit të shkaktuar dhe në të njëjtën datë, krijon dyshimin e arsyeshëm se ky veprim ka qënë i paramenduar, si dhe është bërë në mënyrë që këta punonjës të mos kthejnë dëmin e shkaktuar shoqërisë. Duke qënë se kthimi i dëmit të shkaktuar, i është kërkuar brenda afateve vetëm ankuesit, krijohet dyshimi i arsyeshëm i trajtimit të tij në mënyrë të pabarabartë, në raport me punonjësit e tjerë të Shoqërisë Albpetrol sh.a., me të cilët ndodhet në të njëjtat kushte. Nga ana tjetër rezulton se gjithsesi veprimi i Shoqërisë Albpetrol sh.a kundrejt ankuesit nuk është i paligjshëm, përkundrazi ai është bërë brenda parashikimeve ligjore.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.
- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokolli 12 i saj.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.

⁹⁹ Nr. xxxxx-01365-62-xxxx (xxxx) Rregj. Them., datë 09.06.2015

¹⁰⁰ Me vendim Nr. xxxx, datë 02.11.2017

¹⁰¹ Nr. 62-xxxx-xxxx (xxxx), datë 24.11.2015

- Ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Edhe pse veprimi kundrejt ankuesit rezulton i ligjshëm, kjo gjë nuk e shmang trajtimin e pabarabartë të Shoqërisë Albetrol sh.a. Marrja e vendimit me koshiençë të plotë nga kjo shoqëri për mos pretendimin e kthimit të shumave brenda afatit kundrejt subjekteve të tjerë në kushte të ngjashme me ankuesin, është një zgjedhje që kjo shoqëri ka vendosur në lidhje me këtë situatë konkrete, duke mos e rënduar kthimin e shumave tek punonjësit, por duke e mbajtur atë barrë vetë. Kjo ide përforcohet edhe nga fakti që Shoqëria Albetrol sh.a., ka pasur eksperiencë dhe precedente¹⁰² të mëparshëm me situata të ngjashme kthimi shume, çka do të thotë që vendimarrja e saj ka qenë krejtësisht e vetëdijshme.

Në këtë kontekst, marrja përsipër nga ana e Shoqërisë Albetrol sh.a., e mbulimit të shumave për tu kthyer për të shtatë punonjësit duke trajtuar ndryshe vetëm ankuesin, i cili rezulton i vetmi që ndërkohë kishte ngritur një padi kundër shoqërisë, krijon dyshimin e arsyeshëm se kjo sjellje është bërë vetëm për shkak të ankimit duke e vendosur atë në pozicionin e të viktimizuarit.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se A. H., është ekspozuar ndaj një trajtimi të pabarabartë në formën e viktimizimit, nga ana e Shoqërisë Albetrol sh.a., trajtim i cili ka ardhur si pasojë direkte pas ankimit të tij në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, me pretendim diskriminimin gjatë procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit në formën e viktimizimit, të shtetasit A. H., nga ana e Shoqërisë Albetrol sh.a., për shkak të ankimit¹⁰³ të bërë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier.

¹⁰² Vendim i Gjykatës së Apelit Vlorë Nr. xx-xxx-xxxx (xxxx), datë 24.11.2015

¹⁰³ Ankim me pretendim diskriminimin për shkak të bindjeve politike nga Albetrol sh.a., më datë 17.04.2018

94. F. Ç., kundër Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak Nr. 6670

VENDIM NR. 148, DATË 18.10.2019

Shkaku: Çdo shkak tjetër (për shkak të denoncimit)
Forma: Diskriminim i drejtpërdrejtë
Fusha: Punësim
Statusi: Në gjykatë

Ankuesi ka ushtruar detyrën e Specialistit të Transportit, në Repartin Ushtarak Nr. 4030, nën varësi të Komandës Mbështetëse. Me dëshirë ka dal në rezervë dhe ka shkëputur marrëdhëniet financiare më datë 30.11.2017 me Ministrinë e Mbrojtjes. Pas largimit nga detyra, ai është ngarkuar nga punëdhënësi si i vetmi përgjegjës shkeljen e një procedure tenderi, për shkak se F.Ç ka denoncuar disa praktika antiligjore dhe procedura të dyshimta në vendin e punës.

FAKTET

Gjatë periudhës 2016-2017, ka ushtruar detyrën e Specialistit të Transportit, në Repartin Ushtarak Nr. 4030, nën varësi të Komandës Mbështetëse. Në zbatim të Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes nr. 2162, datë 23.11.2017 *“Për dalje në rezervë oficer aktiv”* ankuesi me dëshirë ka dal në rezervë dhe ka shkëputur marrëdhëniet financiare më datë 30.11.2017 me Ministrinë e Mbrojtjes. Në vijim ai është trajtuar me pagesë kalimtare pranë Repartit Ushtarak Nr. 6670.

Në muajin Prill 2017, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Gjendjes së Gomave të Automjeteve, i cili përbëhej nga 4 persona: ankuesi dhe shtetasit J. Q., Xh. L., dhe Sh. L. Nga ana e komisionit ishte bërë vlerësimi i nevojave të pajisjes me goma të mjetit Tip Benz 508-D me targë MM 554 KM (sipas Urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 167, datë 10.04.2003 *“Për miratimin e normave të përdorimit të gomave dhe baterive në automjetet e FA”*) dhe ishte vendosur pajisja e tij me 4 goma të reja.

Në fillimin e vitit 2018, mbështetur në Programin e Punës, Drejtoria e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Mbrojtjes kishte realizuar një procedurë vlerësimi të veprimtarisë ekonomiko-financiare në Batalionin e Mbështetjes Rajonale. Gjatë auditimit të zhvilluar në Repartin Ushtarak Nr. 4030, Njësia e Auditimit ka konstatuar se mjetit Tip Benz 508-D me targë MM 554 KM, nuk i janë vendosur 4 goma të reja, siç ishte përshkruar në Procesverbalin nr. 1, datë 19.04.2017, por ishin vendosur 2 goma të reja.

Ankuesi u ngarkua me përgjegjësi nga ana e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm dhe Repartit Ushtarak Nr. 4030

LEGJISLACIONI I ZBATUESHËM

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, neni 116.

- Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin Nr. 8137, datë 31.07.1996, Nenet 11 dhe 14, si dhe Protokollin 12 i saj.
- “Karta Sociale Evropiane” e rishikuar, është ratifikuar nga Shqipëria me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002.
- Ligji Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Nenet 9 dhe 203.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenet 80 dhe 82.
- Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 3, 4, 7, 12, 21, 32 dhe 33.

KONKLUSIONE

Nga shqyrtimi i akteve të administruara gjatë këtij procesi, nuk rezultoi i provuar se subjekti ankues, të jetë vënë në dijeni nga ana e Njesisë së Auditimit apo Komandantit të Repartit nr. 4030, lidhur me procedurën, auditimin e kryer, Projekt Raportin e Auditimit apo Raportin Përfundimtar, për t’i dhënë mundësinë për të paraqitur observacionet lidhur me gjetjet e këtij raporti. Gjithashtu, rezultoi se nga ana e Njesisë së Auditimit nuk është marrë asnjë masë për të analizuar rekomandimet e papranuara nga shtetasit J. Q., dhe Sh. L., por janë mjaftuar me observacionet e dërguara prej tyre për t’i përjashtuar nga përgjegjësia e përvetësimit të 2 prej gomave të cituara në Procesverbalin nr. 1, datë 19.04.2017.

Së dyti, pavarësisht faktit që në Komisionin e Ndërrimit të Gomave kanë qënë 4 punonjës, nga ana e Njesisë së Auditit, janë përjashtuar nga përgjegjësia 3 prej tyre. Në rastin konkret nga ana e Njesisë së Auditit J. Q., dhe Sh. L., janë përjashtuar nga përgjegjësia me pretendimin se kanë dhënë observacionet përkatëse, ndërsa përsa i përket shtetasit Xh. L., nga ana e palës ndaj së cilës është paraqitur ankesa nuk është dhënë asnjë argument pse është përjashtuar nga përgjegjësia e përvetësimit të 2 prej gomave.

Së treti, referuar akteve të disponuara gjatë procedurës hetimore, konstatohet se ndër të tjera, për më shumë se një herë i është drejtuar institucionit, për ta vënë në dijeni lidhur me praktika anti ligjore dhe procedura të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin në Repartin Ushtarak 4030.

Në kushtet kur, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030 nuk u arrit të provohej që caktimi i përgjegjësisë për përvetësimin e dy gomave dhe mos vënia në dijeni të ankuesit lidhur me procedurën e auditimit ka ndodhur për shkaqe të arsyeshme, ligjore dhe se masa e marrë ndaj tij ka qënë e justifikuar, proporcionale dhe e drejtë; duke krijuar kështu dyshimin e arsyeshëm se qëndrimi i punëdhënësit ndaj tij ishte tendencioz dhe nga ana tjetër ankuesi provon dhe dokumenton se mbart një prej shkaqeve të mbrojtura nga LMD-ja; Komisioneri vlerëson se subjekti ankues, i është nënshtruar trajtimit të padrejtë nga ana e punëdhënësit, pikërisht për shkakun e pretenduar prej tij, atë të denoncimit të praktikave anti ligjore dhe procedurave të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin në Repartin Ushtarak 4030.

VENDIMI

Konstatimin e diskriminimit të shtetasit F. Ç., nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Repartit Ushtarak nr. 4030, për shkak të denoncimit të praktikave anti ligjore dhe procedurave të dyshimta të cilat mbaheshin dhe kryheshin në Repartin Ushtarak 4030.

Në referim të pikës 1, Ministria e Mbrojtjes dhe Reparti Ushtarak nr. 4030, si subjekte që kanë konsumuar sjelljen diskriminuese, të marrin masa për heqjen e masës administrative të dhënë nga ana e Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe kthimin e shumës financiare të mbajtur ankuesit.

KONTAKTE:

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Tiranë

Adresa: Rruga “Durrësit”, Nr.27 (ish Ministria e Mjedisit), Tiranë

Tel: + 355 4 243 1078

E-mail: info@kmd.al

Zyra Rajonale Shkodër

Adresa: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1

Kodi Postar: 4001

Tel: + 355 4 243 1078

E-mail: info@kmd.al

Zyra Rajonale Korçë

Adresa: Pranë Bashkisë Korçë, Rr: 28 Nentori, Nr.1

Kodi Postar: 7001

Tel: + 355 4 243 1078

E-mail: info@kmd.al

Zyra Rajonale Fier

Adresa: ADISA Lagjia 11 Janari, “Shtëpia e Ushtarakëve”

Kodi Postar: 9301

Tel: + 355 4 243 1078

E-mail: info@kmd.al

Numri jeshil, pa pagesë: 08000606

FCB: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi